



ISSN 2413-1334



Policimi dhe **SIGURIA**

Nr. 14
PRILL
2019

Revistë periodike shkencore
Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2019



POLICIMI DHE SIGURIA
AKADEMIA E SIGURISË

Policimi
dhe **SIGURIA**

BOTIM PERIODIK
Botuar nga Akademia e Sigurisë, Tiranë

NR 14
PRILL
2019

Copyright © - Akademia e Sigurisë, Tiranë.

Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Akademisë së Sigurisë. Asnjë material nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ripublikohet, modifikohet, shpërndalet apo shitet në asnjë mënyrë, i plotë apo pjesë të tij në formë elektronike apo në letër, pa autorizimin e shkruar të Akademisë së Sigurisë. Përdorimi i materialeve të kësaj reviste, pa autorizim, përbën shkelje penale të së drejtave të autorit.

Akademia e Sigurisë zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Policinë e Shtetit dhe Arsimin e lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike. Pikëpamjet e shprehura në revistën "Policimi dhe Siguria", janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Akademisë së Sigurisë. Autorët e publikimeve në revistën "Policimi dhe Siguria" gëzojnë liri të plotë akademike, me kushtin e vetëm që kur shkruajnë, ata të zbatojnë të gjithë legjislacionin përkatës si të komunikimit edhe atë profesional, i cili nuk cenon të drejtat e ndryshme. Autorët janë të vetëdijshëm dhe mbajnë përgjegjësi individuale lidhur me problemet e plagjiaturës. Çdo shkelje në këtë drejtim i ngarkon ata me përgjegjësi sipas ligjeve në fuqi.



Botues

AKADEMIA E SIGURISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE

Rruga e Elbasanit, Sauk, Tiranë

NR **14**
PRILL
2019

BORDI EDITORIAL

Kryetari i Bordit

Dr. Xhavit SHALA

Anëtarët e Bordit

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Prof. Dr. Ismet ELEZI

Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI

Prof. Dr. Giovanni ARCUDI

Prof. Dr. Laura TAFARO

Prof. Asc. Dr. Snezana MOJSOSKA

Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI

Prof. Asc. Dr. Ferdinand ELEZI

Prof. Asc. Dr. Idriz HAXHIJA

Dr. Frank HARRIS

Dr. Albert HITOALIAJ

Redaktor shkencor
Dr. Albert HITOALIAJ

Punimet grafike
Andi OSMANI

Realizimi teknik

*Qendra Kërkimore Shkencore,
Akademia e Sigurisë*

Revista shkencore "**Policimi dhe Siguria**", botohet nga "Qendra Kërkimore Shkencore" e Akademisë së Sigurisë, me qëllim përmbushjen e standardeve më të larta në veprimtarinë kërkimore-shkencore në aktivitetin e Akademisë së Sigurisë.

P Ë R M B A J T J A

1. **Ministri i Brendshëm, Dr. Sandër LLESHAJ**
Fjala përshëndetëse në konferencën shkencore ndërkombëtare "Krimi kompjuterik, kërcënimi kibernetik dhe siguria kombëtare" 8
2. **Dr. Xhavit SHALA, Msc. Anisa AGASTRA, Prof. Asc. Dr. Idriz HAXHIJA, Dr. Albert HITOALIAJ**
Përfundime e rekomandime të konferencës së III-të shkencore ndërkombëtare "Krimi kompjuterik, kërcënimi kibernetik dhe siguria kombëtare" 12
3. **MSc. Besnik SHEHAJ**
Sekreti hetimor dhe e drejta për informim 42
4. **Prof. Asc. Dr. Qestsor ORHAN**
Armët e lehta të zjarrit. 56
5. **MSc. Osman QYSTRI**
Falsifikimi i dokumenteve cenon funksionimin normal të institucioneve shtetërore dhe publike 70
6. **Prof. Asc. Dr. Stavri SINJARI**
Alen Pinkerton, legjendë e policisë amerikane 80
7. **MSc. Qetësor GURRA, MSc. Jonida GURRA**
Ndikimi i madhësisë së një shteti kundrejt sigurisë dhe faktorit gjeopolitik . . 96
8. **MSc. Adriatik AGO**
Reformimi i mënyrës së fitimit të gradave në Policinë e Shtetit. 110
9. **Msc. Roland ALUSHANI**
Roli i strukturave të policimit në komunitet, në përballje me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm 116
10. **MSc. Nënkolonel (r) Alqi NIKOLLA**
Lidhja e krimit të organizuar me terrorizmin - një rrezik për sigurinë 126
11. **MSc. Fatos VELIU, Prof. Dr. Pëllumb DANAJ, MSc. Albana VELI**
Diplomacia shqiptare, në themel të luftrave për pavarësi, në historinë e betejave intelektuale para 1912-s. 144

12.	Dr. (proc.) Kozeta LIGEJA	
	Sistemi demokratik dhe siguria publike.	154
13.	Av. Sheldiana JANO	
	Parandalimi i terrorizmit, dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm, që favorizojnë terrorizmin	162
	Abstraktet në anglisht / Abstracts	172



POLICIMI DHE SIGURIA
AKADEMIA E SIGURISË

«Pres me interes të lartë përfundimet e konferencës, të cilat do të përfshihen në procesin e hartimit të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike»



Dr. Sandër LLESHAJ

MINISTRI I BRENDSHËM



Policia e Shtetit duhet t'i nënshtrohet një programi rrënjësor transformimi dhe modernizimi, i cili do të mundësojë që ajo të bëhet e aftë për të përballuar sfidat e një shoqërie, që përditë e më tepër ekziston edhe në realitet virtual. Për të ndodhur ky ndryshim i madh dhe i shpejtë, duhet që në radhë të parë Akademia e Sigurisë të shndërrohet në promotor të këtij shndërrimi modernizues. Kurrikulat e saj duhet që në mënyrë progresive të krijojnë hapësirë për teknologjinë e informacionit, për programimin kompjuterik, për financat, për ekonominë digjitale. Këtu duhet të mësohet mirë përdorimi i droneve, i sensorëve të tjerë, i sistemeve inteligjente të analizës së informacionit, siguria kibernetike, etj. Dhe bashkë me hapësirën për këto subjekte shkencore Akademia duhet të hapë dyert dhe të bëhet tërheqëse për një profil të ri studentësh dhe pedagogësh, të cilët janë futur ndërkohë në botën e re, që zotërojnë njohuritë, mjeshtëritë dhe pasionin e domosdoshëm për të lundruar dhe për të pasur sukses në këtë realitet të ri.

Lleshaj, S.
« Pres me
interes të lartë
përfundimet e
konferencës,
të cilat do të
përfshihen në
procesin
e hartimit të
Strategjisë
Kombëtare
të Sigurisë
Kibernetike »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

Fjala e zëvendësministrit (asokohe) të Brendshëm, Sandër Lleshaj, në konferencën shkencore ndërkombëtare "Krimi kompjuterik, kërcënimi kibernetik dhe siguria kombëtare"

*E nderuar znj. Zëvendëskryetare e Kuvendit,
të nderuar përfaqësues të misioneve diplomatike apo policore,
zonja dhe zotërinj,*

Së pari, ju falënderoj për ftesën për të marrë pjesë në këtë veprimtari, e cila është në vijim të një tradite shumë të mirë të Akademisë së Sigurisë dhe me këtë rast dëshiroj të shpreh vlerësimet më të mira organizatorëve të konferencës, Akademisë së Sigurisë dhe Qendrës Kërkimore Shkencore dhe bashkëpunëtorëve të saj nga vendi dhe nga bota.

Sipas një burimi të hapur informacioni, vetëm dje më kanë informuar se në botë janë regjistruar rreth 11 milionë sulme kibernetike, me natyra nga më të ndryshmet, nga sulmet financiare, ideologjike, sabotimi i bizneseve, dëmtimi i reputacionit të kompanive apo thyerja e masave të sigurisë për autoritetet dhe rrjetet shtetërore. Dhe kjo është vetëm pjesa që shihet dhe mund të ketë shumë më tepër që nuk shihet. Por në fakt bota sot nuk përballet thjesht me krimin kibernetik për të cilin ju i keni kushtuar këtë konferencë, por me luftën kibernetike në tërësi. Por për fat të keq, ose për shumëkënd ajo ende nuk ekziston thjesht për faktin që nuk shihet. Dhe ky është një iluzion mjaft i rrezikshëm.

Edhe Shqipëria është një vend me risk shumë të lartë në fushën kibernetike, i cili kushtëzohet si nga shkalla shumë e lartë e penetrimit të internetit, edhe të shërbimeve online dhe të teknologjive të komunikimit. Nga ana tjetër Shqipëria po bën edhe një përparim shumë të madh në këtë fushë, pra në fushën e aplikimit të teknologjive moderne të komunikimit, të internetit etj.

Qeveria shqiptare është në një proces ambicioz të modernizimit të shërbimeve për

Lleshaj, S.

« Pres me interes të lartë përfundimet e konferencës, të cilat do të përfshihen në procesin e hartimit të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

qytetarët, përmes ofrimit të tyre, përherë e më shumë, përmes platformave elektronike. Përhapja e gjerë e teknologjisë së informacionit dhe internetit në vend, si dhe rritja e shpejtë e ofertës së shërbimeve online për qytetarët, rrit në mënyrë të ngjashme dhe riskun e përbaljes me kërcënimet kibernetike për individët, për bizneset, për institucionet dhe për shoqërinë në tërësi.

Në vendin tonë, në vitin 2017, e krahasuar me vitin 2010, sipas të dhënave të Policisë, janë evidentuar 3.3 herë më shumë vepra penale në fushën e krimeve kompjuterike. Pra është figura e krimit e cila ka rritjen më të lartë në krahasim me të gjithë figurat e krimit me të cilat përballet Policia e Shtetit shqiptar dhe në të njëjtën kohë niveli i zbulueshmërisë së tyre është vetëm 27%. Pra, rreth 3 herë më i ulët se mesatarja e zbulueshmërisë së krimeve të tjera.

Mjaftojnë këto shifra për të kuptuar se me çfarë sfide përballemi dhe sa do të jetë serioziteti i përbaljes në të ardhmen. Pra, 3 herë më shumë krime dhe 3 herë më pak zbulueshmëri në këtë domen. Dhe këtu qëndron një ndër sfidat më të rëndësishme për të gjitha institucionet e sigurisë dhe në veçanti për Policinë e shtetit shqiptar.

E dimë të gjithë se në dekadat e fundit, botës sonë fizike i është shtuar dhe një botë e re, një botë virtuale ndaj dhe Policia si dhe institucionet e tjera të sigurisë, është e detyruar të bëhet përherë e më pranishme në këtë botë të re. Ajo duhet të jetë e pranishme në autostrada digjitale, në qytete digjitale, në mjediset publike digjitale e kështu me radhë. Dhe për të ndërtuar një prani të re dhe krejt të veçantë kërkohen mjete dhe metoda krejt të panjohura më parë.

Që të ndodhë kjo duhet një qasje krejtësisht e re, madje do të thosha një qasje revolucionare.

Policia e Shtetit duhet t'i nënshtrohet një programi rrënjësor transformimi dhe modernizimi, i cili do të mundësojë që ajo të bëhet e aftë për të përbaluar sfidat e një shoqërie, që përditë e më tepër ekziston edhe në realitet virtual. Për të ndodhur ky ndryshim i madh dhe i shpejtë, duhet që në radhë të parë Akademia e Sigurisë të shndërrohet në promotor të këtij shndërrimi modernizues. Kurrikulat e saj duhet që në mënyrë progresive të krijojnë hapësirë për teknologjinë e informacionit, për programimin kompjuterik, për financat, për ekonominë digjitale. Këtu duhet të mësohet mirë përdorimi i droneve, i sensorëve të tjerë, i sistemeve inteligjente të analizës së informacionit, siguria kibernetike, etj.. Dhe bashkë me hapësirën për këto subjekte shkencore Akademia duhet të hapë dyert dhe të bëhet tërheqëse për një profil të ri studentësh dhe pedagogësh, të cilët janë futur ndërkohë në botën e re, që zotërojnë njohuritë, mjeshtëritë dhe pasionin e domosdoshëm për të lundruar dhe për të pasur sukses në këtë realitet të ri.

Por, një gjë është faktor kritik në këtë proces: *Koha*.

Për ata që e njohin ligjin e *Gordon Moor* është e ditur se shpejtësia e ndryshimit në këtë realitet është eksponenciale. Pajisjet kompjuterike bëhen përherë e më të vogla në përmasa, çmimi i tyre ulet përherë e më shumë, ndërkohë që kapacitetet e tyre rriten në mënyrë eksponenciale. Pra, ritmi i ndryshimit në këtë realitet është jashtëzakonisht i lartë, madje shpeshherë edhe marramendës për shumëkënd. Ai është eksponencial ndërkohë që ne njerëzit jemi të programuar, të krijuar për të menduar dhe vepruar në mënyrë lineare. Por, ky destinim i yni për të menduar dhe vepruar në këtë mënyrë, pra në mënyrë lineare, rrezikon që të na lërë përherë jashtë loje, nëse nuk gjejmë zgjidhjet e duhura.

Përbalimi i kësaj sfide, në dukje të humbur, mund të bëhet vetëm nëpërmjet një

qasjeje inteligjente, e cila bazohet te ndërtimi i programeve dhe i ekipeve, të cilat krijojnë shanse për të tejkaluar limitet tona individuale. Hartimi i një strategjie kombëtare për sigurinë kibernetike do të jetë një ndër hapat e rëndësishëm, i cili do të përcaktojë objektivat, rrugët dhe burimet e nevojshme për të realizuar këtë qëllim. Në këtë kuadër Policia e Shtetit dhe posaçërisht Akademia e Sigurisë do të kenë rol të rëndësishëm për të luajtur.

Duke përfunduar i uroj suksese të gjithë pjesëmarrëseve vendas dhe veçanërisht miqve të huaj në këtë konferencë, si dhe pres me interes të lartë përfundimet saj, të cilat do të përfshihen në procesin e hartimit të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike, si dhe në procesin e hartimit të programit të modernizimit të Policisë së Shtetit shqiptar.

Ju faleminderit!

Lleshaj, S.

« Pres me interes të lartë përfundimet e konferencës, të cilat do të përfshihen në procesin e hartimit të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

Përfundime e rekomandime të konferencës së III-të shkencore ndërkombëtare "Krimi kompjuterik, kërcënimi kibernetik dhe siguria kombëtare" / "Computer crime, cybercrime and National Security"

Përgatiti:

Dr. Xhavit SHALA

Msc. Anisa AGASTRA

Prof. Asc. Idriz HAXHIJA

Dr. Albert HITOALIAJ

Me datë 21 nëntor 2018 zhvilloi punimet konferenca e III-të ndërkombëtare e Akademisë së Sigurisë me temë "Krimi kompjuterik, kërcënimi kibernetik dhe siguria kombëtare". Objekti kryesor i kësaj konference ishte prezantimi i kërkimeve, studimeve, analizave shkencore e të prognozave nga aspekti i hetimit të krimeve kompjuterike dhe kërcënimeve kibernetike të sigurisë kombëtare e ndërkombëtare, konkretizuar me punime të mirëfillta shkencore, për të nxitur debate dhe për të trajtuar në nivel të gjerë, kombëtar e ndërkombëtar, rëndësinë dhe nevojën e zgjerimit të dijeve dhe aplikimit të tyre përballë sfidës së hetimit dhe kërcënimeve të reja të kufijve virtualë, parandalimit të krimeve kibernetike në Shqipëri, si dhe përmirësimin e politikave për trajtimin e këtyre çështjeve.

Kjo konferencë kishte për qëllim të trajtonte në mënyrë shkencore, në aspektin analitik e strategjik të kërcënimeve të krimeve kibernetike dhe terrorizmit kibernetik për sigurinë kombëtare; në aspektin ligjor e proceduralo hetimor të krimeve kompjuterike si dhe në atë akademik për paraqitjen e praktikave ekzistuese, të programeve e trajnimeve për punonjësit e policisë e më gjerë në fushën e krimeve kibernetike si dhe dhënien e rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të politikave për trajtimin e këtyre çështjeve.

Konferenca i filloi punimet me seancën plenare ku dhe u bënë përshëndetjet e të ftuarve VIP. Konferencën e përshëndetën dhe zëvendëskryetarja e Kuvendit të Shqipërisë prof. dr. Vasilika Hysi dhe ministri i Brendshëm dr. Sandër Lleshaj.

Më pas konferenca i zhvilloi punimet në tre sesione paralele. Sesioni i I-rë: Aspekte strategjike të krimit kibernetik dhe impakti në sigurinë kombëtare; sesioni i II-të: Hetime profesionale të krimeve kibernetike dhe sesioni i III-të: Aspekte ligjore, ekonomike e psikosociale të krimeve kibernetike. Në përfundim të tre sesioneve paralele u zhvillua sesioni i përbashkët përmblyës ku u dhanë ku u bënë diskutimet përmblyëse dhe u dhanë përfundimet dhe rekomandimet e konferencës.

« Përfundime e rekomandime të Konferencës së III-të shkencore ndërkombëtare »

Policimi dhe Siguria nr.14, 2019

Konferenca e III-të Ndërkombëtare e Akademisë së Sigurisë me temë “Krimi kompjuterik, kërcënimi kibernetik dhe siguria kombëtare” arriti të bashkojë njëzëri akademikët, shkencëtarët, profesionistët dhe ekspertët e fushave të shkencave kompjuterike, prokurore, gjyqtare, oficerë të policisë gjyqësore, e të tjerë, duke ndarë eksperiencat, praktikat, punimet shkencore dhe gjetjet për të gjitha aspektet gjithëpërfshirëse të fushës së krimeve kibernetike. Konferenca përbushi qëllimin dhe objektivat e saj.

Më poshtë po japim në mënyrë të përmbledhur përfundimet dhe rekomandimet e konferencës.

A. Përfundimet e sesionit të parë, “Aspektet strategjike të krimit kibernetik dhe impakti në sigurinë kombëtare”

- Zgjerimi i përdorimit të teknologjisë informacionit dhe komunikimit do të shoqërohet në vazhdimësi me rrezikun dhe kërcënimin kibernetik. Intensiteti dhe pasojat e përballjes mes tyre do të varen në një masë të madhe nga suksesi në ndërtimin e kapaciteteve të nevojshme, si në sektorin publik, edhe në atë privat, për tu përballur me këtë dukuri, si dhe, nga shkalla e ndërgjegjësimit dhe e edukimit të përdoruesve të kësaj teknologjie, për sigurinë kibernetike.

- Sigurinë kibernetike mund ta përkufizojmë si “ruajtje të konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informatave në hapësirën kibernetike”.

- Siguria kibernetike është pjesë përbërëse e sigurisë kombëtare, pasi ajo mbështet mirëfunksionimin e shtetit dhe shoqërisë si dhe konkurrueshmërinë e ekonomisë dhe inovacionin. Në strategjinë tonë të sigurisë kombëtare sulmet kibernetike klasifikohen si rreziqet të nivelit të parë.

- Ekziston pasiguria për të nesërmen në fushën kibernetike, referuar kjo rrezikut që është prezent nga veprime të jashtëligjshme që synojnë individin, biznesin, industrinë dhe strukturat e qeverisjes (qendrore/lokale).

- Niveli i vlerësimit të riskut, me qëllim zhvillimin e politikave dhe strategjive të qenësishme (jo utopike), nuk është në nivelin me të cilin zhvillohet teknologjia dhe në nivel me qasjen e individit/shoqërisë ndaj teknologjisë në vend.

- Është i pazëvendësueshëm roli i ekzekutivit për të koordinuar punën që nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe edukimit të ndikojë në vetëdijesimi dhe fuqizimin e të gjithë niveleve të shoqërisë shqiptare për tu përballur me kërcënimin kibernetik në rritje dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike të informacionit si dhe vetë infrastrukturën kritike të vendit.

- Ka mungesë bashkëpunimi ndërinstucional (përfshirë individin dhe sistemin bankar) duke mos bërë të mundur ndërveprimin në kohë reale (*online*) për parandalimin (certifikimin e pajisjeve duke shmangur përdorimin e programeve pirate), evidentimin (evidentimi nëpërmjet instalimit të antivirusit ose programeve sinjalizuese (interceptuese), raportimin (sensibilizimi/trajnimi për mënyrën dhe kohën e denoncimit të një veprimi të paligjshëm që ndodh nëpërmjet përdorimit të PC ose internetit) dhe ruajtjen e të dhënave në mënyrë të përdorshme.

- Kërcënimet kibernetike dhe gjetja e mënyrave për t’iu kundërpërgjigjur atyre me sukses, ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme për t’i parandaluar ato dhe për të eliminuar pasojat me sa më pak humbje, vlerësimet dhe analizat për tendencën e tyre janë vënë në qendër të vëmendjes për qeveritë, komunitetet dhe agjencitë e specializuara,

« Përfundime
e rekomandime
të Konferencës
së III-të
shkencore
ndërkombëtare »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

bizneset private dhe për individët. Pikërisht, një vëmendje e tillë ka bërë që sot ka shumë agjenci, sisteme, ligje, strategji e praktika që analizojnë, trajtojnë, vlerësojnë hapësirën dhe kriminalitetin kibernetik, shkëmbejnë eksperiencë dhe vendosin kufij për parandalim, reduktim e mbrojtje të sigurisë në hapësirën kibernetike. Kjo sepse:

- Vitet e fundit, kërcënimi kibernetik është listuar si një nga pesë rreziqet kryesore që i kanoset vendeve dhe shoqërive perëndimore, krahas terrorizimit, përhapjes së armëve të dëmtimit në masë dhe spiunazhit. Vëmendje të veçantë në këtë drejtim merr fakti i rritjes së nivelit të këtij rreziku, shpejtësisë së tij dhe i zgjerimit të spektrit, pasi vetëm 10 vite më parë, krimi kibernetik ka qenë një kërcënim i pakonsiderueshëm në krahasim me ditët e sotme që është në krye të listës së kërcënimeve. Për arsyet e mësipërme, përgjigja e përshtatshme ndaj këtij kërcënimi nuk përqendrohet në mbrojtjen me mënyra ushtarake dhe as duke konsideruar masa në kuadër të përgjegjësive dhe misionit të forcave të armatosura. Përgjigja ndaj këtij fenomeni po shikohet në përmirësimin e gjithanshëm të infrastrukturës dhe të sigurisë kibernetike në nivel kombëtar.

- Më anë të hapësirës kibernetike dhe internetit, sot po kryhen transaksione elektronike (*e-commerce*) dhe transaksione jotregtare në rang global. Përderisa bota që na rrethon po transferon produktet dhe shërbimet e saj *online* dhe ne varemi prej tyre gjithnjë e më tepër, atëherë siguria kibernetike nuk është opsionale, por është detyrim dhe nuk ka alternativë.

- Siguria kibernetike po vlerësohet në të gjitha nivelet e organizimit shoqëror dhe atij shtetëror. Për sektorin shtetëror, siguri kibernetike do të thotë siguri kombëtare, do të thotë interesa kombëtare dhe prosperitet ekonomik të vendit. Sektori privat sigurinë kibernetike e vendos në raport me ekosistemin e rreziqeve dhe të mundësive që i paraqiten biznesit apo shërbimeve që ky sektor ofron dhe në këtë mënyrë, do të gjykojë më mirë rreth përgjegjësive që dalin në kuadër të sigurisë kibernetike. Individit, me interes dhe i ndërvarur plotësisht nga bota digjitale në të cilën jeton ai, do ta kuptojë më mirë se sa e rëndësishme është siguria kibernetike për të.

- Hapësira kibernetike po konsiderohet si një komponent i rëndësishëm dhe konkret i sigurisë kombëtare, ashtu si dhe hapësira ajrore, hapësira detare, hapësira tokësore dhe për këtë po ngrihen struktura dhe organizma për të menaxhuar, operuar dhe siguruar këtë hapësirë.

- Në botë ka raporte globale të dedikuara që pasqyrojnë situatën në disa ose shumicën e vendeve të rajonit, siç janë “Indeksi Global i *Cybersecurity* 2015 i ITU-së” për vlerësimin e nevojave; “Profili *Cyberwellness* dhe i BSA-së”; “*Dashboard* 2015 e maturisë së kibernetikës së BE-së”; etj.

- BE ka hartuar *Strategjinë e sigurisë kibernetike* e cila ka për qëllim të standardizojë dhe të unifikojë kundërveprimin e shteteve anëtare, apo dhe më gjerë, ndaj ndërhyrjeve të paautorizuara në rrjetet kibernetike, për shkak të veçorisë së krimit kibernetik, si krim që ka shtrirje ndërkombëtare, duke e bërë të domosdoshëm bashkëpunimin e bashkëveprimin e shteteve, në luftën ndaj tij, duke eliminuar pengesat që sjellin legjislacionet e veçanta të shteteve, apo mekanizma të tjerë institucionalë. Paketa e Kibernetikës së BE-së propozon tri shtylla për veprim: elasticitetin, parandalimin dhe mbrojtjen.

- NATO po fokusohet në ndërtimin e një mbrojtje kibernetike të fortë dhe të qëndrueshme, në kuadër të rritjes së qëndrueshmërisë dhe të elasticitetit të shërbimeve, qeverisjes, infrastrukturës dhe furnizimeve që ofron ajo dhe çdo shtet anëtar. Ajo është

fokusuar dhe po ndjek me përparësi implementimin e *zotimit në fushën e kibernetikës*, nga ana e shteteve anëtare, të marrë në samitin e Varshavës dhe atë të Brukselit. NATO e ka cilësuar tashmë sigurinë kibernetike si një komponent operacional të veçantë, dhe po synon në ndërtimin e kapaciteteve në këtë fushë. Ajo gjithashtu është duke zhvilluar partneritetin me vendet e tjera në fushën kibernetike si një aspekt me rëndësi që kontribuon në rritjen e kapaciteteve të vendeve aleate dhe partnere në fushën kibernetike dhe në fund të fundit, në rritjen e sigurisë kibernetike në përgjithësi.

- NATO dhe Bashkimi Evropian janë duke bashkëpunuar ngushtë në fushën e mbrojtjes kibernetike. Kohët e fundit është firmosur marrëveshja teknike (shkurt 2016) midis strukturës së NATO-s (*NATO Computer Incidente Response Team, NCIRT*) që merret me menaxhimin e incidenteve kompjuterike (dhe strukturës së Bashkimit Evropian për menaxhimin e këtyre incidenteve (*Computer Emergency Response Team, CERT*)).

- Legjislacioni i kohëve të fundit, siç është *Direktiva* e vitit 2016 e Parlamentit Evropian për sigurinë e sistemeve të rrjetit dhe informacionit, u fokusua gjerësisht në kërcënimet ndaj infrastrukturës kritike dhe kishte për qëllim përmirësimin e sigurisë në kibernetike për të mbrojtur të ashtuquajturat shërbime thelbësore si tregjet në internet, motorët e kërkimit dhe shërbimet e informatikës, që janë jetike për bizneset, qeveritë dhe qytetarët.

- Një nga sfidat kryesore të identifikuara për të ardhmen në fushën kibernetike vlerësohet të jetë përgatitja e brezit të ardhshëm në përgjithësi dhe të ekspertëve të mirëfilltë në veçanti në fushën kibernetike.

- Ndërsa në vendet e Ballkanit legjislacioni për fushën dhe krimet me natyrë kibernetike ka vakuume e boshllëqe. Më shumë progres duket se është arritur me hartimin e strategjive të sigurisë kibernetike dhe vlerësimet gjithëpërfshirëse të rrezikut. Në këto vende akoma nuk ka një konsolidim të politikave arsimore e trajnuese të mirëfillta për këtë fushë.

- Bashkimi Evropian, NATO dhe vendet perëndimore i kanë kushtuar vëmendje të madhe ndërtimit dhe ngritjes së kapaciteteve në këtë fushë. Ato kanë krijuar agjenci të posaçme për të vlerësuar dhe menaxhuar rrezikun që u kanoset ndaj infrastrukturës kombëtare. Këto agjenci kanë për mision përcaktimin e standardeve, planeve të veprimit, zbatimin e ligjit dhe analizimin e praktikave me qëllim bashkëpunimin në kuadër të trajtimit efektiv të problematikës së kriminalitetit kibernetik dhe sigurisë në hapësirën kibernetike. Më konkretisht:

- Në kuadër të BE-së, vepron agjencia e quajtur ENISA (*European Union Agency For Network and Information Security*), e cila ka një rol të theksuar në përcaktimin e standardeve, rekomandimeve dhe angazhimeve tjera në fushën e sigurisë kibernetike.

- Përveç saj janë dhe agjencia Europol/EC3 dhe EDA që merren me zbatimin e ligjit dhe mbrojtjes, respektivisht në fushën kibernetike duke analizuar tendencat e vlerësimit të rrezikut, trajnimit dhe shkëmbimit të praktikave më të mira.

- Në NATO është krijuar dhe funksionon Bordi i NATO-s për Menaxhimin e Mbrojtjes Kibernetike (*Cyber Defence Management Board, CDMB*). Në bord ftohen te marrin pjesë përfaqësuesit e lartë të vendeve anëtare të cilët përgatisin politikat kombëtare për sigurinë kibernetike.

- Në Forcat e Armatosura janë krijuar agjenci e komanda të posaçme në nivel strategjik dhe struktura në çdo nivel më të ulët për menaxhimin e sistemeve të ndërlidhjes

« Përfundime e rekomandime të Konferencës së III-të shkencore ndërkombëtare »

Policimi dhe Siguria nr.14, 2019

dhe të informacionit (SNI). Struktura, organizimi, misioni dhe veprimtaria e tyre janë zhvilluar në bazë të politikave kombëtare dhe atyre të NATO-s, BE-së dhe agjencive ndërkombëtare të teknologjisë së informacionit, ku vendi ynë bën pjesë.

- Strukturat e policisë dhe të mbrojtjes së të miturve në shtetet e Bashkimit Evropian dhe veçanërisht ndërmjet vendeve fqinjë me njëri-tjetrin, pavarësisht sfidave me të cilat ballafaqohen, si ndër strukturat kyçe në krimin kibernetik, mund të shërbejnë edhe si një model inkurajues qendror për ndërtimin e lidhjeve mes aktorëve të ndryshëm të brendshëm, funksionimin dhe zhvillimin e qasjeve kombëtare dhe ndërkombëtare për të trajtuar problemin e keqpërdorimit të TIK-ut me pasojë dëmtimin dhe jetëkërcënimin.

- Shërbimi është gjithashtu pika ndërkombëtare e kontaktit për emergjencat me karakter informatik brenda rrjeteve të vendosura në G8 dhe në Këshillin e Evropës dhe që veprojnë 24/7. Si pjesë e aktiviteteve që kanë për qëllim luftimin e pornografisë së fëmijëve në linjë, shërbimi policor i komunikimeve, merr pjesë në mbledhjet e task forcës së krimit elektronik (ECTF), Koalicioni Evropian Financiar (KEF) dhe është pjesë e rrjetit të policisë të quajtur *task force virtuale në nivel global* (VGTF).

- Në Shqipëri ka një historik të pasur tashmë rreth zhvillimit dhe hartimit të kapaciteteve për fushën e kibernetikës e sigurisë kombëtare, ku në kuadër të bashkëpunimeve dhe modeleve të praktikave të huaja, po ndërtohen kuadri ligjor e strategjike për trajtimin, vlerësimin, hetimin, parandalimin e reduktimin e krimeve kibernetike. Megjithatë mbetet ende punë për të bërë në këtë drejtim, por ka edhe risi e veprimtari që janë realizuar si:

- Është me interes dhe ka një përputhje evidente, midis Strategjisë të Sigurisë Kibernetike të BE-së dhe asaj shqiptare, ku kjo e fundit, duket se i është përmbajtur nocioneve, parimeve, standardeve, metodologjisë dhe rekomandimeve të së parës.

- Në Shqipëri ekziston një kuadër i plotë me dokumente strategjike/ligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e kibernetikës, si:

- Strategjia e Sigurisë Kombëtare (SSK) e cila është dokumenti më themelor planifikues për sigurinë kombëtare në Republikën e Shqipërisë, që ka qëllim të udhëheqë vendin në përmbushjen e përparësive kombëtare të sigurisë nëpërmjet një procesi planifikimi dhe vendimmarrjeje strategjike.

- Strategjia ndërsektoriale e sigurisë së informacionit (2008-2013) ose Strategjia Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit (2008-2013) (SNSHI) e miratuar me VKM nr. 59 datë 21.1.2009 përbën dokumentin e parë strategjik që përcaktonte drejtimit kryesorë dhe objektivat e zhvillimit në fushën e shoqërisë së informacionit për periudhën 2008-2013, ku përmendej siguria kibernetike.

- Siguria kibernetike që në vitet 2008-2013 është konsideruar si një nga fushat me prioritet për shkak të vizionit të Qeverisë shqiptare për të rritur e zhvilluar qeverisjen përmes ofrimit të e-shërbimeve.

- Që nga viti 2014 Shqipëria ka pranuar parimisht që të jetë pjesë e grupit fillestar të masave të ndërtimit të besimit, të OSBE-së për hapësirën kibernetike.

- Shqipëria merr pjesë rregullisht në stërvitjen vjetore të Koalicionit Kibernetik të NATO-s (*Cyber Coalition*), stërvitja më e madhe kibernetike e NATO-s, duke rritur rolin e saj në këtë stërvitje dhe duke thelluar mënyrën e ndërveprimit me NATO-s dhe shtetet anëtare të saj. Shqipëria gjithashtu merr pjesë aktive në projektet e NATO-s, lidhur me sigurinë kibernetike.

- Si anëtare e NATO-s, Shqipëria nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit,

me Qendrën e Përgjithshme të Përgjegjësisë *Cyber*, të NATO-s, për rritjen e mbrojtjes kibernetike, në 2013, dhe po negocion nënshkrimin e versionit të ri të këtij memorandum. Ky version bazohet në dokumentin e mbrojtjes kibernetike “Politika e mbrojtjes kibernetike të NATO-s”, e miratuar nga të gjitha vendet e NATO-s në samitin e Wells-it në vitin 2014.

- Shqipëria ka krijuar një kuadër ligjor dhe doktrinar të pasur për cilësimin dhe kualifikimin e sulmeve kibernetike. Strategjia e Sigurisë Kombëtare 2014-2020 “Për vendosjen dhe respektimin e standardeve më të larta në drejtim të ruajtjes dhe mbrojtjes së informacionit në të gjitha trajtat e ekzistencës së tij, duke përqendruar përpjekje të veçanta për mbrojtjen nga sulmet kibernetike”; VKM nr. 303, datë 31.03.2011 “Për krijimin e njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit në Ministrinë e Linjës dhe Institucionet e varësive”; ligji nr. 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”, klasifikon sulmet kibernetike si një lloj i një rëndësie të veçantë.

- Strategjia Sektoriale për Mbrojtjen Kibernetike 2018-2020 është përgatitur dhe mbështetur në një sërë dokumentesh të rëndësishme si: Dokumentin “NATO *Enhanced Cyber Defence Policy*” (Samiti i Wellsit, shtator 2014), i cili konsideron mbrojtjen kibernetike si pjesë të detyrave kryesore të Aleancës për mbrojtjen kolektive, duke konfirmuar që në hapësirën kibernetike zbatohet ligji ndërkombëtar;

- Vendimet e Samitit të Varshavës (qershor 2016), i cili rikonfirmoi mandatin mbrojtës të NATO-s dhe njohu hapësirën kibernetike si një “domain” operacional, në të cilin NATO-ja duhet të mbrojë veten me efektivitet ashtu siç vepron në ajër, tokë dhe det. Po në këtë samit, u miratua gjithashtu dokumenti me zotimet “Pledge” në interes të rritjes dhe forcimit të mbrojtjes kibernetike. Shqipëria ka një plan të qartë për realizimin e detyrimeve në kuadër të këtij dokumenti.

- “Dokumenti i politikave për sigurinë kibernetike 2015-2017”, i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 973, datë 2.12.2015 përbën instrumentin më të rëndësishëm shtetëror në vendin tonë, sa i përket politikave dhe masave për sigurinë kibernetike, i cili, në përgjithësi, është “...në linjë me Strategjinë për Sigurinë Kibernetike të Bashkimit Evropian.

- Në kuadër të NATO-s, FA synojnë të bëhen pjesë e një infrastrukture, rrjeti të federuar, të aftë që të mbështesin një ambient koalicioni edhe në kushtet operacionale dhe në misionet të ndryshme. Ky rrjet i federuar apo i certifikuar për misionet e ardhshme të Aleancës nënkupton krijimin e kapaciteteve të SNI qysh në kohë paqe dhe funksionimi i plotë operacional i tyre duke filluar në ditën zero të operacionit. Vendeve aleate, u jepet mundësia që të jenë pjesë kësaj iniciative në nivele e kontribute të ndryshme. Në kuadër të këtij programi, infrastruktura operacionale e NATO-s është e aftë që të sigurojë shërbimet e informacionit të kërkuar, të jetë e shkallëzuar dhe fleksibël që të bëjë të mundur zhvendosjen, mbijetesën dhe rizhvendosjen e forcave të dërguara dhe të mbështesë funksionet e komandim kontrollit (C2) të vendit tonë dhe forcave pjesëmarrëse të Aleancës në një operacion të NATO-s.

- Strukturat për mbrojtjen e infrastrukturave kritike të informacionit në Shqipëri:

- bazuar në SNSHI, në vitin 2011 me mbështetjen e “Programit shqiptar të sigurisë kibernetike” të USAID-it, u krijua Agjencia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike (ALCIRT), si institucion kombëtar për reagimin ndaj incidenteve kibernetike, e cila vepron nën autoritetin e Kryeministrit. Kjo agjenci:

- zhvillon seminare trajnimi të sektorit qeveritar dhe joqeveritar, nga Instituti i Inxhinierisë Programuese të Universitetit *Carnegie Mellon* (SEI), në drejtim të ndërtimit

« Përfundime
e rekomandime
të Konferencës
së III-të
shkencore
ndërkombëtare »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

të kapaciteteve për t'i rezistuar kërcënimeve operacionale dhe për të zhvilluar procese për menaxhimin e incidenteve të sigurisë kibernetike;

- është përgjegjëse për pjesëmarrjen në përgatitjen e strategjisë kombëtare të sigurisë kibernetike,

- zhvillon hartimin e legjislacionit përkatës;

- zhvillon bashkëpunimin me të gjitha institucionet relevante, organizatat ndërkombëtare, sektorin privat dhe organizimin e fushatave ndërgjegjëse.

- Vlerësohet se për arsye të kapaciteteve shumë të kufizuara njerëzore dhe infrastrukturore, nuk ka qenë në gjendje të kryejë mirë, si përgjigjen ndaj incidenteve kibernetike, edhe aktivitete më të gjera si, arsimi dhe fillimi i një partneriteti të qëndrueshëm. Vlen të theksohet së një dukuri e tillë, është prezentë në shume vende perëndimore, ku mungesa e kapaciteteve dhe ekspertëve në këtë fushë ka ndikuar negativisht në ritmin e ndërtimit të kapaciteteve.

- Në Shqipëri me hyrjen në fuqi të ligjit “Për sigurinë kibernetike”, konsiderohen të rëndësishme skuadrat CERT sektoriale dhe kombëtare, si një ndër përpjekjet kryesore në kuadër të strategjive për mbrojtjen e infrastrukturave kritike të informacionit, të cilat identifikojnë operacionet kritike të sektorëve, kërcënimet e mundshme kibernetike dhe hartojnë plane për trajtimin e incidenteve dhe rimëkëmbjen e sistemeve kritike në raste sulmesh. Gjithashtu trajnimi dhe edukimi i personelit që përdor dhe administron CII-të, është një faktor kyç për parandalimin e incidenteve kibernetike.

- Në rast të një sulmi kibernetik, rekomandohet një bashkëveprim ndërmjet CERT-ëve sektorialë dhe CERT-ëve kombëtarë, për menaxhimin sa më efektiv të krizës. Në Shqipëri, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) vepron në cilësinë e CERT-it kombëtar. Në këtë drejtim, është jetike ndërtimi i kapaciteteve reaguese ndaj kërcënimeve kompjuterike CERC (*Computer Emergency Response Capability*). NATO i ka të ndërtuara këto kapacitete (pajisje dhe personel) dhe te gatshme për t'i përdorur për rrjetet e veta por dhe për vendet e tjera anëtare, pas miratimit rast pas rasti nga Këshilli i Atlantikut të Veriut (NAC). Nisur nga kjo praktikë vendi ynë duhet ti zotërojë këto kapacitete nën një strukturë të vetme shtetërore dhe të gatshme për të rivendosur situatën fillestare aty ku ndodhin incidente apo sulme kibernetike.

- Krahas bashkëpunimit në nivel kombëtar, struktura përgjegjëse kombëtare, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike duhet te shkëmbejë informacione në lidhje me incidentet dhe sulmet në fushën kibernetike si dhe të ndajë eksperiencat tona në menaxhimin e tyre me Platformën e NATO-s për këtë qëllim “Malware Information Sharing Platform”. Kjo platformë është e krijuar në kuadër të Mbrojtjes së Zgjuar “Smart Defence”, ku vendi ynë është pjesëtar i kësaj platforme.

- Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit ka një strukturë të posaçme për zbulimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e krimit kompjuterik - sektori për hetimin e krimit kompjuterik, në departamentin e policisë kriminale, ku punojnë 5 specialistë të hetimit të këtij krimi; po ashtu, është edhe një seksion i hetimit të krimit kompjuterik në drejtorinë vendore te policisë, në Qarkun e Tiranës, me 2 specialistë hetimi, i krijuar rishtazi.

- Struktura qeveritare që merren me sigurinë dhe krimin kibernetik në Shqipëri janë: Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik

(AKCESK), Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Policia e Shtetit, Sektorë të krimeve kibernetike në Prokurorinë e Përgjithshme, Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH), Ministria e Mbrojtjes, DSH dhe AISM nën varësinë e Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, drejtorja e ndërlidhjes, (SNI) në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, duke u mbështetur në standardet kombëtare, të NATO-s dhe ato ndërkombëtare, Drejtoria e Shifrës (DSH), Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes dhe Sigurisë (AISM), Banka e Shqipërisë (BSH), Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (IDP).

- Pavarësisht ekzistencës së disa dokumenteve strategjike, bazës ligjore e institucioneve qeveritare, është konstatuar se Shqipërisë i nevojitet një plan i detajuar dhe ambicioz me masa konkrete për të ndërtuar kapacitetet e duhura, si burimet dhe teknologjinë, për të marrë masat e duhura në mënyrë maksimale rreth këtij fenomeni mbarëkombëtar.

- Mendime të ndryshme të autorëve në punimet e tyre u sollën edhe në lidhje me faktin nëse ekziston ose jo një strategji e mirëfilltë kombëtare e sigurisë kibernetike dhe se duhet punë e vazhdueshme për plotësimin e dokumentacionit për këtë çështje.

- Gjithsesi, punimet e konferencës sollën në vëmendje se draft i parë i ligjit ekziston dhe është duke u shqyrtuar nga aktorët kryesorë në këtë fushë.

- Në konferencë kontribuuan me punimet e tyre eksperte nga Italia të cilët paraqiten praktikën italiane në këtë fushë dhe konkretisht si më poshtë.

- Në Itali është hartuar një protokoll i sigurisë kompjuterike menjëherë i përdorshëm pavarësisht nga sektorët profesionistë dhe privatë në të cilët përdoret, është në përputhje me standardet e rregullores evropiane 679/2016 GDPR, me dispozitat e Garantit të Privatësisë në kontekstin Europian dhe ndërkombëtar, dhe me standardet kryesore të përdorura nga qeveritë, për të mbrojtur rrjetet kompjuterike në përdorim, ku përshkruhen hapat themelore procedurale, në fushën e sigurisë kompjuterike, duke ilustruar dispozitat ekzistuese dhe rregullat e sjelljes që duhet të ndiqen në menaxhimin e duhur dhe trajtimin e informacionit të klasifikuar në kuadër të kompanive dhe të shoqërive. Me anë të këtij protokollit ruhet siguria kompjuterike nëpërmjet bashkëpunimit të funksioneve: përfaqësuesit ligjor, zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave DPO, oficerit të sigurisë (nën varësinë e DPO-së) në kuadër të monitorimit dhe parandalimit të veprimtarive të ndryshme. Rekomandohen protokolle të tilla në Shqipëri në administratën publike apo në kompanitë private.

- Italia zbaton dhe programin *CyberChallenge.IT*. Ky është program kombëtar italian trajnues për sigurinë kibernetike që e ka fokusin në shënjimin, rekrutimin, trajnimin, dhe zhvillimin e konkurseve në nivele lokale, kombëtare e ndërkombëtare për zhvillimin profesional së të rinjve në këtë fushë. Aty do të hapen 3.5 milionë vende pune të reja në fushën e sigurisë kibernetike.

- Në konferencë kanë kontribuar me punime shkencore kumtues nga Kosova, të cilët veç të tjerash kanë trajtuar edhe problematikën e kriminalitetit kibernetik dhe sigurisë kombëtare për shtetin e tyre, me përfundimet si më poshtë:

- Në Kosovë akoma nuk është miratuar njëra nga strategjitë kryesore, që është Strategjia Kombëtare e Sigurisë prandaj edhe prioritetet nuk janë të përcaktuara në kuadër të një strategjie gjithëpërfshirëse. Masat e deritanishme janë më tepër reflektim i *qasjeve akademike apo arritje nga bashkëpunimi ndërkombëtar* se sa qasje të brendshme të mirëstrukturuara.

« Përfundime
e rekomandime
të Konferencës
së III-të
shkencore
ndërkombëtare »

Polici
dhe
Siguria
nr.14, 2019

- Republika e Kosovës ka resurse të limituara në aspektin e burimeve njerëzore, teknike dhe teknologjike, për tu përballuar me rreziqe të natyrave të tilla, prandaj është shumë i domosdoshëm krijimi i mekanizmit ndërinstytucional, i cili do të jetë më i efektshëm në shfrytëzimin racional të burimeve në mes të së gjitha institucioneve shtetërore përshtirë edhe sektorin privat.

- Në fushën e sigurisë kibernetike, Republika e Kosovës, ka në zbatim, një bazë të gjerë ligjore mjaft moderne dhe të konsoliduar, sidoqoftë edhe në këtë fushë ka nevojë për rishikim të ligjit “Për parandalim dhe luftim të krimit kibernetik”, ligji i cili, tani thjesht sa nuk i përshatet më kohës, ndryshimeve teknike dhe teknologjike.

- Sfidat kryesore me të cilat përballlet realiteti në Kosovë përmenden mungesa e një Agjenci funksionale ligjzbatuese, mungesa e një baze bashkëkohore ligjore dhe kapacitetet njerëzore e strategji të qarta në këtë fushë.

Lidhur me përfundimet e mësipërme të seksionit të parë “Aspektet strategjike të krimit kibernetik dhe impakti në sigurinë kombëtare” të konferencës , janë dhënë rekomandimet si më poshtë:

- Shihet si e domosdoshme ndërtimi i një strategjie koherente gjithëpërfshirëse për të zgjidhur hallkat e dobëta që rrezikojnë sistemin dhe gjithë sigurinë në rang global, duke përfshirë përmirësimin e konventave, sensibilizimin e masave, ndërtimin e ekipeve të posaçme kundër kiberterrorizmit, hartimin e masave dhe legjislacionit përkatës për mbrojtjen e konsumatorit virtual dhe përcaktimin e detyrave të komunitetit të inteligjencës. Për këtë:

- Organizatat ndërkombëtare, në veçanti Kombet e Bashkuara, duhet të përgatisin për miratim konventa ndërkombëtare për unifikimin e ligjeve të aplikuara në hapësirën kibernetike.

- Në kuadër të sensibilizimit duhet të merren një plan masash nga institucionet publike me kompetencë në këtë fushë në mënyrë që të mos cenohet tregtia elektronike.

- Ndërtimi i një ekipi kundër kiberterrorizmit, duhet të jetë në kohë reale dhe dinamike, me që armët do të ndryshojnë vazhdimisht formë e mënyrë.

- Në mungesën e tanishme të bashkëpunimit gjyqësor mes vendeve, është e nevojshme të krijohet një gjykatë e për *Cyberspace*, për të mundësuar drejtësi globale për të marrë masa për sulme globale kibernetike. Paqja dhe drejtësia në hapësirën kibernetike duhet të mbrohen nga e drejta ndërkombëtare përmes një traktati ose një grupi traktatesh nën Kombet e Bashkuara, që mund të sigurohet duke zgjeruar juridiksionin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale. Por, duke pasur parasysh pozicionet e ratifikimit për Gjykatën Ndërkombëtare Penale, çdo zgjidhje që mund të përfshijë pranimin nga Kina, Rusia dhe Shtetet e Bashkuara, duhet sot të jetë i kufizuar në një tribunal ndërkombëtar”.

- Realizimi nga strukturat ushtarake të masave për sigurinë e për mbrojtjen e komunikimit, informacionit dhe sistemeve të tjera elektronike i cili është i depozituar, përpunuar, ose transmetuar në këto sisteme në lidhje me konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë, vërtetimin dhe mos mohimin e tij.

- Shtetet duhet të marrin masa për hartimin dhe zbatimin e parashikimeve ligjore në funksion të rritjes së sigurisë së konsumatorëve në transaksionet *online* dhe të identifikojnë e monitorojnë personat që realizojnë përpunimin e të dhënave të konsumatorëve dhe tregtarëve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Komuniteti i inteligjencës do të duhet të:
- investojë më shumë në zhvillimin e kapaciteteve të burimeve të hapura.
- të përmirësojë sistemin e trajnimeve dhe të afrojë studiuesit dhe analistët të ngarkuar me gjetjen dhe shfrytëzimin e burimeve të hapura të informacionit.
- të përmirësimin të aftësive gjuhësore,
- të bëjë të mundur investime shtesë në pajisje dhe mjete, në ndihmë të zgjidhjes së problemeve dhe të sfidës së mbingarkesës së informacionit, duke lehtësuar procesin.
- Shihet e nevojshme ngritja e nivelit të kooperimit mes trupave hetimore dhe gjyqësore të vendeve të ndryshme, me qëllimin për t’iu përgjigjur nevojave për një hetim të shpejtë dhe efikas të krimit kompjuterik.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar në ndjekjen dhe hetimin e këtyre llojeve krimesh është kusht *sine qua non*, pasi është krim që kryhet në largësi, me lehtësi, nga shtetas apo grupe me shtrirje në shtete të ndryshme.
- Shtetet anëtare duhet të rrisin bashkëpunimin në hapësirën kibernetike në kuadër të identifikimit të personave përgjegjës dhe vendosjen e tyre përpara përgjegjësisë.
- Në kuadër të sigurisë kombëtare të Shqipërisë kundër rreziqeve dhe sulmeve kibernetike, është thelbësore miratimi i strategjisë kundër krimit kibernetik, hartimi i miratimi i ligjeve të reja në këtë kuadër dhe vazhdimi i procesit të adaptimit me dokumentacionin përkatës nga praktikat e BE-së dhe të tjera. Për këtë:
- Së pari duhet punuar me identifikimin e problemeve dhe sigurimin e informacionit mbi krimin kibernetik në nivel nacional, rajonal dhe ndërkombëtar. Ka shumë rëndësi identifikimi sipas ekspertizës mbi sigurinë kibernetike në Evropë sipas:
 - Programit ISO 27001 - standardi ndërkombëtar i praktikës më të mirë;
 - Sistemit ISMS - Sistem i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit;
 - Programit Horizon 2020 - program kërkimi dhe inovacioni në BE;
 - *Digital Forensics* – procesi i zbulimit dhe interpretimi i të dhënave elektronike.
 - Duhet hartuar politika të posaçme dhe duhet planifikuar një strategji mbrojtjeje, që kërkon mendime strategjike, kohë të gjatë për diskutime, negociime, propozime përgjatë zhvillimit të aktiviteteve bashkëpunuese me aktorë të ndryshëm për hedhjen e hapave afatshkurtër në raste incidentesh kibernetike, duke pasur fokusin në gjetjen e zgjidhjes, dhe jo vetëm në identifikim të problemeve.
 - Paraqitet e nevojshme në vazhdim aderimi dhe adoptimi i konventave, dokumenteve strategjike në nivele të OKB-së, BE-së, KE-së, NATO-s, OSBE-së, që lidhen me sigurinë/mbrojtjen kibernetike dhe dokumentet kombëtare, të mbështetura mbi kapacitete konkrete e të mirëfinancuara.
 - Duhet nënshkruar një memorandum bashkëpunimi në fushën e krimit kibernetik, midis të gjitha agjencive ligjzbatuese.
 - Me miratimin e ligjit për sigurinë kibernetike, rekomandohet që në bazë të Direktivës së BE-së 2016/1148, të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 6 korrik 2016, “Mbi masat për një nivel të përbashkët të lartë të sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit në Bashkimin Europian”, të miratohen ndryshimet dhe plotësimet e dispozitave të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me krimin kibernetik, për vepra penale të tjera në fushën e sigurisë kibernetike, siç i kanë parashikuar vendet e BE-së, ku Shqipëria po plotëson detyrimet e saj për t’u bërë pjesë e saj.
 - Duhet të zhvillohet një metodologji për adresimin e rrezikut, ose adoptim i metodologjive ekzistuese dhe i një metodologjie konsistente për të identifikuar CII-të

kombëtare.

- Duhet hartuar një manual me masa për mbrojtjen e infrastrukturave kritike të informacionit.

- Duhet hartuar dhe implementuar kërkesat minimale të detyrueshme të sigurisë kibernetike, për institucionet shtetërore, publike e private, me qëllim mbrojtjen e infrastrukturës kritike të informacionit dhe parandalimin e krimeve kompjuterike dhe kërcënimeve kibernetike.

- Duhet zhvilluar procedura të unifikuar për zbulimin e cenueshmërisë.

- Shihet me prioritet zhvillimi i bashkëpunimeve/partneriteteve brenda e jashtë Shqipërisë për praktika, përmirësimin e infrastrukturës dhe qasjeve të ardhshme të sektorit publik e privat, fuqizim të institucioneve, alokim të fondeve, shtimin dhe kualifikimin e personelit, etj., në fushën e problematikës së krimeve e kërcënimeve kibernetike duke përfshirë:

- Mbrojtjen e infrastrukturës së informacionit dhe zhvillimi i praktikave të mbrojtjes së tyre, duke nënvizuar kërkesat në rastin e Shqipërisë, sipas sektorëve kritikë, në zbatim të kuadrit rregullator kombëtar dhe europian, të fushës së sigurisë kibernetike.

- Rritjen e kapaciteteve profesionale, strukturave të mirë organizuara e të specializuara, bashkëveprimin dhe bashkëpunimin institucional dhe ndërkombëtar si dhe sensibilizimit të popullsisë për rreziqet dhe mënyrat sesi mund të mbrohen nga sulmet kibernetike, për të mos rënë pre e tyre duke sjellë minimizimin e pasojave.

- Krijimin e një *task force* publike-private që të merret me ndarjen e qarkullimit e të dhënave dhe informacionit, me qëllim parandalimin dhe luftën kundër krimit dhe garantimin e politikave të duhura të sigurisë.

- Bashkëveprim dhe koordinim mes strukturave të hetimit të krimit kompjuterik dhe të gjithë aktorëve të shoqërisë që mund të ndihmojnë në krijimin e një mjedisi të sigurt për fëmijët që janë e ardhmja e kombit.

- Shtim i punonjësve të kualifikuar e të trajnuar për çështjet e kibernetikës.

- Krijimi i një sistemi alarmi dhe trajtimi kombëtar në rast incidentesh.

- Shtimi i investimeve për rritjen e sigurisë në rrjetet/sistemet shtetërore.

- Ekzekutivi nevojitet të marrë masat për të ndërmarrë një qasje sinergjike e cila do të rrisë partneritetin mes sektorit publik dhe privat, në luftën kundër krimit kibernetik dhe të ndërtojë institucione të specializuara në sistemin e sigurisë kibernetike.

- Ndërgjegjësim i sektorit privat për të kuptuar që siguria kibernetike për sektorin privat nuk ka të bëjë vetëm me krimin kibernetik apo standardet e sigurisë, por është gjithashtu thelbësore për ekonominë, dhe, që nevojitet hartimi i politikave më të gjëra për të garantuar infrastrukturë dhe trafik të sigurt.

- Fuqizimi i CERT-it kombëtar, duke mundësuar që ai të ketë kapacitetin e nevojshëm për t'iu përgjigjur çdo lloj incidenti.

- Alokimi i fondeve dhe mjeteve financiare të nevojshme për përballimin e sfidave në rritje ndaj krimit kibernetik, në risi teknologjike, përgatitje kapacitetesh, stërvitje të përbashkëta me partnerë të brendshëm e të jashtëm, ndryshime strukturore, drejtime në raport me trendin digjital dhe problemet e identifikuara të krimit kibernetik.

- Fokusi i politikave shtetërore shqiptare në drejtim të luftës kundër krimit kibernetik duhet të përqendrohet në pikat kyçe, të cilat sjellin edhe problemet dhe pengesat për suksesin ndaj këtij fenomeni, që mund të jenë hartimi dhe konsolidimi i politikave kundër krimit kompjuterik, nëpërmjet krijimit të një baze të fortë ligjore të harmonizuar me BE-në, ndërmarrja e reformave të thella në organet ligjzbatuese dhe

sektorët që janë të ndjeshëm ndaj këtij lloj krimi, mbështetjes të vazhdueshme teknike, financiare dhe me burime njerëzore të kualifikuara e të specializuara ndaj këtyre sektorëve, duke përfshirë dhe:

- fuqizimin e institucioneve ekzistuese: identifikimi i institucioneve kryesore në fushën e sigurisë kibernetike dhe sigurimi që ata të kenë staf të mjaftueshëm dhe të trajnuar specialistë të fushës juridike dhe informatike (IT);

- zgjerimin e rrjetit të kontakteve me policinë e vendeve të tjera, për një shkëmbim të frytshëm dypalësh për çështje të përbashkëta dhe, për të siguruar një shkëmbim të vazhdueshëm të informacionit në fazën operationale, me përditësimin e vazhdueshëm të teknikave hetimore dhe inovacioneve teknologjike;

- shtimin e numrit të oficerëve të zbatimit të ligjit që punojnë në fushën e krimit kibernetik dhe mundësimin e trajnimeve të vazhdueshme të tyre;

- forcimin e ndërveprimit midis ekspertëve në sektorët e informatikës, hetimit, ato qeveritare dhe joqeveritare, në mënyrë që të kuptohet më mirë, si të jemi në gjendje të luftojmë krimin kibernetik.

- Duke vendosur plane bashkëpunimi kombëtare për t'u aktivizuar në rastet e incidenteve kibernetike, shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të ndajnë në mënyrë të qartë rolet dhe përgjegjësitë, dhe të zgjedhin veprimet e reagimit.

- Kompanitë celulare duhet të krijojnë filtra që mbrojnë fëmijët nga përdorimi i internetit në faqe me rrezikshmëri të lartë.

- Për shkak të shkallës së lartë të rrezikut e kërcënimeve kibernetike, sugjerohet që në Shqipëri të aplikohet përvoja e Kosovës, duke mundësuar “Caktimin e Koordinatorit Kombëtar dhe Këshillit Shtetëror për Sigurinë Kibernetike”, si institucion përgjegjës për përbushjen e objektivave. Ky institucion do të monitorojë indikatorët strategjik për sigurinë kibernetike dhe do të raportojë në mënyrë periodike tek Kryeministri dhe Këshilli i Sigurisë Kombëtare.

- Në konferencë pati dhe një rekomandim që Shqipëria e Kosova të ndjekin praktikën e shtetit të Maltës, që po ndërton politika për të investuar për të qenë një qendër e kriptovalutave *block chain*, dhe padyshim që kjo do t'i rrisë vlerat e kriptovalutave dhe interesimin për tu marrë me këto lloj valutash.

- Rekomandohet të ndiqen praktikat më të mira të huaja për ngritjen e qendrave kombëtare për të luftuar pornografinë *online* me fëmijë. Këto qendra, duhet të:

- kryejnë dhe koordinojnë të gjitha hetimet dhe veprimtaritë parandaluese në lidhje me abuzimin e fëmijëve *online*;

- përditësojnë rregullisht listën e zezë të faqeve të pornografisë me fëmijë, duke ofruar monitorim 24 orë, pritje dhe njoftim, vënie në listën e zezë dhe filtrim, marrëdhëniet me institucionet financiare, analizim të pamjeve, koordinim të hetimeve e bashkëpunim ndërkombëtar;

- mundësojë punë parandaluese dhe reagime konkrete e të shpejta ndaj veprave penale të abuzimit *online*, mbështetur në tre shtylla: qasje sinergjike = partneriteti publik-privat = siguri e përbashkët, ndarja dhe qarkullimi i të dhënave dhe informacionit, përfshirja e agjencive të specializuara të zbatimit të ligjit.

- Në konferencë kanë kontribuar me punime shkencore kumtues nga Kosova, të cilët veç të tjerash kanë dhënë rekomandimet përkatëse për Shtetin e Kosovës në luftën ndaj krimit kibernetik, si më poshtë:

- Identifikimi në vazhdimësi i nevojave për ndërtim të kapaciteteve, duke marrë për bazë trendin dhe format e krimit kibernetik; punimi i programeve të trajnimit dhe

« Përfundime e rekomandime të Konferencës së III-të shkencore ndërkombëtare »

Policimi dhe Siguria nr.14, 2019

ndjekja e trajnimeve, në ndarjen bazike, ku duhet të trajnohen zyrtarët policor të cilët nuk merren drejtpërdrejt me hetimin e krimit kibernetik, ose, merren me ato vepra që mund të trajtohen edhe në nivele më të ulëta dhe në trajnim të specializuar, ku duhet të trajnohen zyrtarët policor të cilët merren drejtpërdrejt me hetimin e krimit kibernetik.

- Të bëhet analizë periodike e gjendjes së përgjithshme për krimet kibernetike dhe të nxirren rekomandime për parandalim dhe luftim të krimit kibernetik.

- Të ndërtohet një mekanizëm i qëndrueshëm që merret me hetimin e krimit kibernetik.

- Të ndërtohet qasje strategjike sa i përket bashkëpunimit ndërinstytucional, me sektorin privat, ndërkombëtar dhe me akademinë.

- Të mundësohet anëtarësimi në organizata të ndryshme ndërkombëtare të cilat trajtojnë krimin kibernetik.

- Të themelohet një bazë e të dhënave e veçantë e cila do të plotësohet me të dhënat nga rastet aktuale si dhe rastet në të ardhmen.

- Të organizohen fushata të ndryshme, nëpërmjet konferencave, broshurave, shfaqjes së videove nëpër televizione, bisedave me fëmijë nëpër shkolla etj. me qëllim vetëdijësimin e qytetarëve dhe zyrtarëve nëpër institucionet qeveritare e të tjera.

- Rekomandime për Policinë e Shtetit Shqiptar për luftën ndaj kriminalitetit kibernetik:

- Përpjekjet e Policisë së Shtetit duhet të orientohen dhe intensifikohen, në fushën e kriminalitetit kibernetik.

- Stafi policor shqiptar duhet të trajnohet më shumë mbi teknologjinë e sulmet kibernetike.

- Teknologjia dhe pajisjet e përdorura nga Policia e Shtetit duhet të jenë të gjeneratës së fundit, për të zbuluar krimet kibernetike dhe parandaluar sulmet kibernetike.

- Bashkëpunimi me institucionet e tjera dhe me kompanitë që ofrojnë shërbimet e internetit apo kompanitë celulare duhet të jetë më konkret, më efikas dhe në kohë reale, për shkak të dinamikës së shpejtë të zhvillimit të sulmeve kibernetike.

- Komunikimi me publikun, për të sensibilizuar çdo person, për dëmet që mund të shkaktojnë sulmet kibernetike dhe keqpërdorimi i sistemeve kompjuterike. Fushatat sensibilizuese për ndërgjegjësimin e personave, organizatave, bizneseve janë shumë të nevojshme, për të bërë prezent rreziqet që i kanosen çdokujt.

- Hetimi i krimeve kompjuterike në mënyre profesionale duke shfrytëzuar praktikat më të mira botërore.

B. Përfundime të sesionit të II-të “Hetime profesionale të krimeve kibernetike”

- Nga një studim i thelluar i Qendrës Kërkimore Shkencore në Akademinë e Sigurisë, ka rezultuar se:

- Ka një trend në rritje në evidentimin e veprave penale në fushën e krimeve kompjuterike ndërkohë që niveli i zbulueshmërisë së këtyre veprave penale është i ulët në raport me veprat e tjera penale.

- Për periudhën 2012-2018 niveli mesatar i zbulueshmërisë së këtyre veprave penale është 37.32%, me një trend në rënie, por me një ngritje të lehtë në vitin 2018.

- Format më e përhapur e krimit në këtë fushë është mashtrimi kompjuterik me 33.9%, ndërhyrja e të dhënave kompjuterike me 28.9% dhe falsifikimet kompjuterike

me 20.7% të totalit të veprave penale në këtë fushë për vitet 2015–2018.

- Referuar treguesve objektivë të kriminalitetit në këtë fushë (të dhënave të evidentuara nga policia dhe prokuroria) mund të përcaktojmë këtë profil të autorëve të krimeve kibernetik: Kryesisht i përkasin moshës 18 deri 35 vjeç (67.7%). Pjesa më e madhe e tyre janë të gjinisë mashkullore (rreth 90%), me arsim 9 vjeçar (47.5%) dhe me arsim të mesëm (35.7%). Shumica e tyre (77.2%) janë ndjekur në gjendje të lirë dhe vetëm 10% në gjendje arresti.

- Nga anketimi i realizuar nga Qendra Kërkimore Shkencore në Akademinë e Sigurisë në kuadër të studimit të mësipërm ka rezultuar se:

- Shumica e të anketuarve mendojnë se zhvillimi i teknologjisë së sotme të informacionit dhe komunikimit luan rol të rëndësishëm në të gjithë aspektet e jetës duke përfshirë biznesin, komunikimin dhe edukimin, aksesin në informacion e shërbime publike dhe në fushën e privatësisë. Për shumicën e të anketuarve ky zhvillim teknologjik, cenon privatësinë ndërkohë që për një pjesë të konsiderueshme të anketuarve (31.7%) komunikimi nëpërmjet kësaj teknologjie nuk është aspak i sigurt ose është pak i sigurt.

- Është relativisht e lartë (36.8%), pjesa e të anketuarve që nuk kanë njohuri për krimin kibernetik. Për shkak të mungesës së njohurive në këtë fushë kjo pjesë mund të bëhet lehtësisht shënjestër për veprat penale në fushim kompjuterike.

- 24.9% e të anketuarve (6.3% + 18.6%) janë përgjigjur se kanë kryer ose nuk e dinë nëse kanë kryer ndonjëherë vepër penale në jetën e tyre, shifër kjo relativisht e lartë më të cilin duhet punuar për t'i aftësuar që të njohin krimin kompjuterik.

- Sulmet me viruse, vjedhjet e identitetit dhe mashtrimet kompjuterike janë kërcënimet më të përhapura ndaj të anketuarve.

- Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve (22.6%) kanë përjetuar pasoja të krimeve kibernetike më shumë në formën e humbjes së të dhënave kompjuterike (23.6%), vjedhje të identitetit (18%) si dhe forma të tjera të pasojave (59.9%).

- Të anketuarit nuk kanë kërkuar asistencë pranë autoritetit kryesor kombëtar të sigurisë kibernetike në rastet e përjetimit të pasojave nga krimet kibernetike. Gjithashtu, konsiderohet jo i vogël edhe numri i të anketuarve që nuk e njohin fare atë institucion.

- Të anketuarit nuk ndjehen të sigurt në aktivitetet e tyre të ndryshme në hapësirën kibernetike në masën nga 21.2% deri në 47.1%.

- Në një numër të konsiderueshëm (47%) të anketuarit nuk ndjejnë “aspak” përgjegjësi apo ndjejnë “pak” dhe “disi” përgjegjësi për sigurinë kibernetike në vendin e tyre të punës.

- 83% e të anketuarve nuk janë trajnuar për sigurinë kibernetike në vendin e tyre të punës dhe vetëm 22.5% e të anketuarve që janë trajnuar, kanë përfituar nga ky trajnim për sigurinë kibernetike. Ky tregues, relativisht i lartë tregon se vetë organizatat punuese nuk e vlerësojnë sigurinë kibernetike..

- Tre fazat procedurale që garantojnë një sinergji korrekte dhe efektive, nëpërmjet instrumenteve të analizës, zbatimit të procedurave dhe mbrojtjes së të gjithë infrastrukturës informatike janë ATIP (Konstatim teknik informatik paraprak), POPC (Plan operativ për mbrojtjen kibernetike), PODI (Procedura operative e mbrojtjes informatike).

- Është punuar me analizën e sistemeve biometrike që shërbejnë për të lejuar ose mohuar një subjekt të aksesojë një zonë të caktuar të lidhur me të. Këto sisteme operojnë me anë të procesit të identifikimit dhe verifikimit, dhe përbëhen nga

karakteristika të shumta biometrike unike që duhet të ruhen nga mekanizma mbrojtës; nëse nuk mbrohet, informacioni mund të vidhet, përdoret, klonohet dhe kjo përbën bazën e sulmeve dhe mashtrimeve kibernetike. Për këtë arsye sugjerohet të aplikohet siguria me shumë nivele, në bazat e të dhënave biometrike dhe konkretisht:

- Përfshirja e modeleve sintetike në sistemet biometrike po vlerësohet sot si një ndër mekanizmat më të fuqishëm mbrojtës të sigurisë. Kjo skemë e re e mbrojtjes së modeleve, funksionon me anë të blloqeve të modeleve që u krijuan në bazë të metodës së projekcionit të rastësishëm, që më pas lidhen për të krijuar modelin e plotë dhe me anë të vetisë së padallueshmërisë, duke bërë të mundur ndërtimin e disa profile sulmuesish, duke konsideruar më shumë një sulmues që ka njohuri të plota mbi sistemin.

- Për të siguruar rezultatin janë përdorur dy teknika klasifikimi: një në bazë të klasifikimit njerëzor dhe një mbi klasifikimin automatik. Janë aplikuar skema të mbrojtjes së modeleve biometrike, duke shtuar dhe një mekanizëm i ri “karrem” që ka qëllim t’i çojë sulmuesit në rrugë të gabuar. Sistemet biometrike me anë të ‘karremit’ kanë vetinë e padallueshmërisë, të pajisura me modele të vërteta dhe modele sintetike. Këto ndërthuren aq mirë sa është e pamundur që një sulmues të dallojë një model të vërtetë, nga një model sintetik. Ky sistem mbrojtës ka rezultuar efikas.

- Sistemet e kamerave të sigurisë (CCTV) ose siç njihen ndryshe videoregjistruesit digjital (DVR), kanë të instaluar programet e tyre përkatëse për eksportimin e pamjeve filmike nga *hard disku* apo memoria ku ato ruhen. Metodadat dhe teknikat e rekomanduara, të prezantuara në konferencë, për rikuperimin e pamjeve filmike, aplikohen vetëm në rastet kur kopjimi (eksportimi) i pamjeve filmike nga këto pajisje është i pamundur apo kur kërkohet për pamje filmike të fshira (edhe pse pajisja është funksionale apo një program kompjuterik që lexon file *system*-in e hard diskut të tyre është i disponueshëm). Por:

- Kjo metodë rikuperimi duhet përdorur me mjaft kujdes. Një gabim i vogël në dekodimin e saktë të metadatave apo në shkrimin e *script*-eve, mund të çojë në mosdetektimin, e për pasojë mosrikuperimin, e pamjeve filmike me interes, edhe pse ato akoma ekzistojnë në hard disk (të fshira ose jo) apo në nxjerrjen e pamjeve të gabuara, apo me *metadata* të gabuar.

- Edhe në Shqipëri janë evidentuar disa forma të mashtrimeve për përfitime materiale *online*, të cilat janë të bujshme dhe në botë, si më poshtë vijon:

- “Scam online” (mashtrimet *online*), ku përfshihen dyqane *online* në internet, në kontrollin e postës tuaj elektronike; në kontrollin e medieve tuaja sociale.

- “Spaming - email spam”, skanimi i individëve të ndryshëm, ose i kompanive të ndryshme; nga vjedhja e listave të postimeve në internet, si p.sh. shitja e listave e email-ve për *spam*, me para virtuale: dikur me LR tani me *Bitcoin*, *Etherum*, etj.,

- “Phishing” është postë elektronike që ngjan sikur është nga ndonjë burim që njihet mirë (për shembull bankë ose dhënës i shërbimeve të internetit) me të cilën kërkohet të vërtetohen të dhënat personale, me qëllim marrjen e informacioneve të përdoruesit.

- “Skimming”, janë aparate që shfrytëzohen për mbledhjen e paautorizuar së të dhënave nga kartat për pagesë, edhe atë së të dhënave që gjenden në shiritin magnetik të kartës për pagesë dhe të dhënave të PIN-it të kartës, ku forma më e njohur është klonimi I të dhënave të kartave bankare nëpërmjet bankomatit.

- Kërcënimet më të rrezikshme për Shqipërinë në vazhdim parashikohen:

- Bashkëpunimi i hakerëve dhe grupeve kriminale të trafikimit të drogës, apo të

ndonjë forme tjetër kriminale, pasi kjo teknologji do t'ju mundësojë lehtësisht pastrimin e parave dhe realizimin e transaksioneve tepër komplekse për të u hetuar.

- Kryerja e mashtrimeve *online* nëpërmjet aplikacionit 'Blockchain' në smartphone.

- Pastrimi i parave, nëpërmjet numrit të madh të ueb-faqeve *online* që ofrojnë lojëra fati, kazino, poker, slote, etj. me anë të kriptovalutave.

- Pastrimi i parave me anë të fushës pornografike, duke rritur numrin e ueb-faqeve për komunikim *online videochat*, me mundësi pagese me anë të kriptovalutave.

- Që prej vitit 2018 janë në modë Bitcoin, Ethereum, Reeples, Litecoin, etj. të cilat, nëse i marrim në përgjithësi, numri i tyre i kalon mbi 2000 kriptovaluta duke përfshirë edhe ato *coins* dhe *tokens*.

- Qëllimi i *hacker*-ve të sotëm është prodhimi i parasë digjitale me anë të energjisë elektrike (*bitcoin*, *ethereum*) pa pasur nevojë të falsifikojnë paranë, me anë të energjisë elektrike, duke realizuar një mundësi të artë për prodhimin e parasë digjitale, që shtyn ata për gjetjen e rrugëve më të mira për vjedhjen e energjisë elektrike, me qëllim uljen e kostos.

- Diskutimet e sotme në fushën e kibernetikës kanë në fokus informacionet e mbledhura nga burimet e hapura, të cilat nuk kërkojnë kosto sa mund të kërkonte përdorimi i një burimi të klasifikuar, mund të përdoren në procedurat ligjore pa rrezikuar ekspozimin e aseteve të ndjeshme të inteligjencës, përdoren në mënyrë të gjerë dhe informojnë në masë publikun, si dhe nëpërmjet informacionit dhe hetimit të tyre, sigurohet një kontekst dhe ndërjegjësim që është kritik për të kuptuar agjendën globale të sigurisë.

- Sot, vlerësohet se hetimi i burimeve të hapura ofron mbi 90% të informacionit të përdorur nga institucionet ligjzbatuese, por dhe me një vlerë të padiskutueshme në aspektet e sigurisë kombëtare.

- Po bëhet thirrje për një paradigme të re të inteligjencës, e cila do të mbizotërohet nga informacioni i burimeve të hapura dhe nga një bashkëpunim ndërsektorial i inteligjencës, që përfshin një rrjet të gjerë të aktorëve publik dhe private, që mendohet të ketë edhe dëme të mëdha, tek të gjitha burimet e tjera për mbledhjen e analizën e informacionit.

- Në epokën e internetit është zhvilluar abuzimi nëpërmjet rrjeteve sociale, ku është më së shumti shqetësuese pornografia e fëmijëve në internet, që ka marrë formën e një krimi global, që ka përkufizime e juridiksione të shumëfishta për shkak të decentralizimit të internetit, aftësisë për të transmetuar imazhe menjëherë nëpër botë dhe disponueshmërisë së smartfonëve dhe pajisjeve të tjera mobile për fëmijët dhe ata që do t'i shfrytëzonin ato.

- Asnjë strukturë e vetme nuk ka trajnimin e plotë, fuqi punëtoare, burime të mjaftueshme dhe mandat ligjor për të ndërhyrë në mënyrë efektive në rastet e abuzimit të fëmijëve.

- Një ndërhyrje efektive do të ishte përmes formimit të një ekipi për mbrojtjen e fëmijëve, që do përfshinte profesionistë nga policia, drejtësia penale, puna sociale, arsimi, institucione shtetërore dhe partnerë që punojnë dhe kujdesen për sigurinë *online* të fëmijëve, duke kuptuar e vlerësuar rolet e ndryshme, përgjegjësitë, pikat e forta, dobësitë, bashkëpunimin dhe duke koordinuar përpjekjet e gjithsecilit për t'u ofruar fëmijëve një internet të sigurt.

« Përfundime e rekomandime të Konferencës së III-të shkencore ndërkombëtare »

Policimi dhe Siguria nr.14, 2019

- Çdo qytetar, punonjës, kompani, institucion etj. duhet të plotësojë bazat e sigurisë, duke kryer hapat e mëposhtëm:
 - të mbajë sistemin, bazën e të dhënave (*database-in*) dhe antivirusin të përditësuar;
 - të trajtojë punonjësit për sigurinë që duhet dhe masat që duhen marrë;
 - të konfigurojnë *firewall*-et që të identifikojnë portat dhe *host*-et specifike, që të mund të aksesojnë të dhënat apo informacionet;
 - të krijojnë *password* të fortë dhe me karaktere të ndryshëm, si dhe ta ndryshojnë shpesh;
 - të bëjnë *backup*-e, në mënyrë të rregullt dhe shpeshherë;
 - të kontrollojnë sistemin në mënyrë të përhershme, për aktivitete të dyshimta nga përdorues të ndryshëm.

Lidhur me përfundimet e mësipërme të seksionit të dytë “Hetime profesionale të krimeve kibernetike” të konferencës janë dhënë rekomandimet si më poshtë:

- Çdo institucion shtetëror/privat duhet të sigurojë infrastrukturën e duhur mbrojtëse të rrjetit/sistemeve me të cilat punon, duhet të punësojë profesionistët e kualifikuar për të mundësuar mbrojtjen e rrjetit/sistemeve dhe duhet të trajtojë vazhdimisht stafin e punonjësve për të rritur nivelin e njohurive rreth krimeve e sulmeve kibernetike dhe mënyrave parandaluese.
 - Duhet të hartohet një strategji kombëtare në lidhje me burimet e hapura që do të koordinojë këtë veprimtari në nivel politik, do të përcaktonte rolet, përgjegjësitë dhe strukturat ndërvepruese për të gjitha institucionet e interesuara, si:
 - Krijimi i një grupi pune, ndërinstitutional dhe krijimi i një strukture të posaçme për burimet e hapura, për të shqyrtuar ndërveprimet e mundshme midis agjencive të ndryshme qeveritare.
 - Krijimi i një qendre/strukture që do të fokusohet tek burimet e hapura, dhe e cila do të ishte e detyruar të ofronte informacionin e marrë në të gjitha degët e qeverisë dhe në të njëjtën kohë të koordinojë me burimet e klasifikuara, e vendosur brenda një kuadri ekzistues të sigurisë kombëtare dhe të mbetet e pavarur nga ndikimi i ndonjë departamenti qeveritar.

Kjo qendër/strukturë mund të ngarkohet me:

- mbështetjen e të gjitha shërbimeve, qofshin ato sekrete apo jo;
- evidentimin e zhvillimeve të reja në teknologjinë e informacionit
- sigurimin e mjeteve dhe teknologjive më të përshtatshme për agjencitë qeveritare, mjetet dhe teknologjitë më të përshtatshme;
- shfrytëzimin e informacionit dhe informimin e aktorëve joqeveritarë, të cilët nëse cenohen indirekt, cenojnë sigurinë kombëtare etj.;
- hulumtimin për praktikatat më të mira në mbledhjen, menaxhimin, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit;
- ofrimin e trajnimeve;
- kryerjen e paralajmërimeve në lidhje me çështje sensitive, por dhe aktivitete hetimore afatgjata, pa qenë i nevojshëm krijimi i materialeve procedurale;
- kombinimin e stafin të përhershëm (specialistët e hetimit, analistët e informacionit, etj.) bashkë me stafin nga agjencitë e ndryshme qeveritare, me qëllim

koordinimin dhe veprimin e menjëhershëm dhe efikas në raste kur ai nevojitet.

- Duke parë specifikat e veçanta të kriptovalutave, shteti shqiptar duhet të miratojë ligje të veçanta me natyrën e punës së kriptovalutave, sidomos në luftimin e pastrimit të parave me anë të kriptovalutave. Duhet marrë në konsideratë fakti se kjo teknologji avancohet me shpejtësi në krahasim me kohën që kërkon miratimi i ligjeve.

- Duke marrë parasysh tendencën e hakerave sot për prodhimin e parasë digjitale nëpërmjet vjedhjes së energjisë elektrike, Shqipëria apo Kosova duhet të marrin masa për sa i përket raportit të taksave duke nxjerrë sa më parë ligje për tatimin e këtyre prodhimeve, si dhe për avancime në teknologjinë e detektimit të tyre, me anë të pajisjeve detektor.

- Për shkak të rrezikut mashtrimeve *online* me anë të *smartphone*, rekomandohet që shteti shqiptar, por edhe shtete të tjera, të shohin hapësirat ligjore për të mundësuar lejimin e kontrollit të *smartphon*-ëve të personave të dyshuar ose me të kaluar kriminale, gjatë kalimit të kufijve ose në ndonjë kontroll policor, nëse kanë të instaluar aplikacionin “Blockchain”.

- Të aplikohet siguria me shumë nivele, në bazat e të dhënave biometrike, pasi aty pretendohet se ndodh zanafilla e vjedhjes, zëvendësimit apo klonimit së të dhënave me anë të së cilave realizohet mashtrimet, sulmet dhe krimet kibernetike.

- Bazuar në rezultatet e zbulimit të mekanizmit të mbrojtjes së sigurisë mbi përfshirjen e modeleve sintetike në sistemet biometrike, rekomandohet që kjo metodë t’i nënshtrohet studimeve të mëtejshme, lidhur me perceptimin vizual dhe proceset e klasifikimit të kujtesës njerëzore, për pamje në dukje jo të rregullta, siç rezultojnë të jenë pre-imazhet.

- Rekomandohet që përdorimi i programeve për përmirësimin e cilësisë së pamjeve filmike të përfuara nga pajisjet CCTV dhe DVR, duhet të bëhet vetëm nga specialistë me njohuri të posaçme dhe përvojë në këtë fushë. Përdorimi i gabuar i këtyre filtrave apo teknikave, çon në shtim apo heqje elementësh nga videoja apo fotografia, apo degradim të pamjes në vend të përmirësimit të saj. Ato janë efektive vetëm kur detaji është i fiksuar, pra gjendet në video ose foto, dhe rekomandohet që në të ardhmen nevojiten disa filtra apo teknika për ta bërë të identifikueshëm apo më të qartë.

- Për qytetarët dhe punonjësit, rekomandohen të ndërmerren hapat e mëposhtëm për të garantuar për një shkallë më të lartë të sigurisë për mbrojtjen nga krimet kibernetike në kompjuterët apo pajisjet mobile:

- Antivirus: kontrolli i përditësimeve dhe funksioneve të skanimit në kohë reale.
- *Antispyware*: kontrolli i përditësimeve dhe funksioneve të skanimit në kohë reale

- *Firewall*: verifikimi i instalimit dhe funksionimit të duhur sipas procedurave të kontrollit të qasjes duke verifikuar të gjithë trafikun që kalon përmes tij.

- Nënshkrimet digjitale dhe kriptografia: verifikimi i mekanizmave për të mbrojtur dokumentet dhe të dhënat e ndjeshme nga qasja e paautorizuar.

- “Backup”: verifikimi i rikuperimit korrekt së të dhënave dhe ruajtja e tyre sipas kohës dhe metodave të përcaktuara.

- Sistemi i zbulimit të ndërhyrjeve (IDS): verifikimi i funksionalitetit të sistemeve softuerike dhe *hardware* për të identifikuar qasjen e paautorizuar në kompjuterë.

- Rrjeti i zbulimit të ndërhyrjeve në sistem (NIDS): verifikimi i teknologjisë së informacionit, *software* apo *hardware*, i dedikuar për të analizuar trafikun e një ose më

« Përfundime
e rekomandime
të Konferencës
së III-të
shkencore
ndërkombëtare »

Polici
dhe
Siguria
nr.14, 2019

shumë segmenteve të një LAN-i, me qëllim të zbulimit të anomalive në rrjedhat e ndërhyrjeve të mundshme kompjuterike.

- Sistemi i autentifikimit [vërtetimit]: verifikimi dhe testimi i softuerit për vërtetim të sigurt.

C. Përfundime të sesionit të III-të të Konferencës “Aspekte ligjore, ekonomike e psikosociale të krimeve kibernetike”.

- Termi “krim kibernetik” është terminologji më shumë profesionale se sa juridike. Ky term përfshin përdorimin e kompjuterëve në ndihmë të autorëve për realizimin e veprave penale tradicionale si dhe veprat penale të cilat janë plotësisht produkte të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

- Vetëm pas 6 vitesh të ratifikimit të “Konventës për krimin kibernetik”, Kuvendi i Shqipërisë miratoi paketën ligjore për ndryshimin e Kodit Penal duke përfshirë për herë të parë veprat penale kompjuterike, të cilat nuk janë të grupuara apo të vendosura në një seksion më vetë, por janë të shpërndara nëpër seksionet ekzistuese në varësi të objektit juridik të mbrojtur.

- Juridiksioni ndërkombëtar kibernetik është metoda më efikase dhe më e shpejtë për të parandaluar krimet kompjuterike ndërkombëtare, duke rritur mundësinë për ndjekje penale dhe ndëshkim të autorëve të tyre, duke i dhënë kompetencë të gjitha gjykatave anembanë globit, të drejtën të merren me transaksionet në hapësirën kibernetike, mosmarrëveshjet ose krimet kibernetike, siç është edhe terrorizmi kibernetik. Kjo sepse:

- Në nivelin ndërkombëtar janë marrë masa për lehtësimin dhe bashkëpunimin ndërmjet juridiksioneve të ndryshme deri në nivel policor. Në Interpol dhe Europol janë krijuar struktura të posaçme vetëm për hetimin e krimeve kompjuterike duke lehtësuar procedurat e shkëmbimit të informacioneve.

- Legjislacioni i BE-së synon të shtyjë shtetet anëtare të marrin masat e posaçme që të ketë një kufizim të numrit të krimeve të kësaj natyrë, por nuk parashikon se cilat janë këto masa ku duhet të mbështeten shtetet anëtare në mënyrë që të arrihen rezultate pozitive në parandalimin dhe uljen e numrit të kësaj veprave penale.

- Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, në sesionin e 109-të, më 8 nëntor 2001, miratoi “Konventën për krimin kibernetik”, e cila u hap për nënshkrim në Budapest, më 23 nëntor 2001, në konferencën ndërkombëtare për krimin kibernetik. Hartuesit e kësaj konvente iu përgjigjën situatës së ndryshimeve të mëdha të globalizimit të hapësirës kompjuterike.

- Në disa raste legjislacioni nuk ja ka lehtësuar punën policisë, pasi fenomenet e reja të sulmeve kibernetike, por edhe keqpërdorimi i sistemeve kompjuterike nuk ka qenë plotësisht i parashikuar në dispozitat ligjore. Ndërkohë që zbulimi dhe parandalimi i sulmeve kibernetike është në fokusin e PSH.

- Shteti shqiptar ka ndërmarrë masa organizative dhe legjislative të rëndësishme, në parandalimin dhe goditjen e krimeve kompjuterike. Por teknologjia ecën me ritme shumë të shpejta dhe kjo gjë kërkon që legjislacioni dhe strukturat përkatëse shqiptare, të jenë të përditësuara me situata e reja për një përgjigje efikase ndaj kërcënimeve kibernetike. Kjo sepse:

- Në fushën juridike për krimet kompjuterike ka ndryshuar koncepti i ndjekjes penale mbi bazën e vendit të ngjarjes. Hapësira kibernetike me zhvillimin e teknologjisë

ka sjell heqjen e kufijve shtetëror për ndjekjen penale.

- Hapësira kibernetike ka cenuar marrëdhënien ndërmjet veprimeve ligjore (*online*) dhe vendndodhjes fizike të përdoruesve të kësaj hapësire.

- Me ritmet e shpejta të digitalizimit në Shqipërisë, dita ditës konstatohen boshllëqe në dispozitat ligjore, që nuk i parashikojnë këto forma të reja të kriminalitetit kibernetik.

- Nga praktika e punës së oficerëve të policisë që kanë referuar në këtë konferencë, është konstatuar se shumë nga ndërhyrjet në sisteme kompjuterike, nuk kallëzohen në organet ligj zbatuese.

- Një vepër penale ka një natyrë ndërkombëtare në qoftë se kryhet në më shumë se një shtet, ose kryhet në një shtet, por pjesa thelbësore e përgatitjes, planit, drejtimit ose kontrollit është ndërtuar në një shtet tjetër, ose kryhet në një shtet, por në të është përfshirë një grup kriminal i organizuar, i cili angazhohet në aktivitete kriminale në më shumë se një shtet, ose kryhet në një shtet, por pasojat thelbësore i ka në një shtet tjetër. Karakteri transnacional i krimit kompjuterik e zhvendos juridiksionin e një shteti për të ushtruar ndjekjen penale për këtë krim. Kjo sepse:

- Ndryshimi i kriminalitetit kompjuterik, ka nxjerrë mangësi në të drejtën penale materiale dhe në atë procedurale, duke krijuar sfida të reja, ku më kryesorja është përcaktimi ligjor, për të rregulluar konfliktin ndërmjet sovranitetit dhe juridiksionit, në hapësirën kibernetike pa kufij.

- Aftësia për të hyrë në të dhëna kompjuterike, të cilat gjenden në juridiksione të tjera, në mënyrë të shpejtë, është një aspekt i rëndësishëm i hetimeve penale moderne.

- Dimensionin transnacional që ka fituar sot krimi kompjuterik, karakterizon çdo veprimtari hetimorë që, edhe kur zhvillohet ende në nivel lokal, priret të marrë tipare përtejterritoriale, bashkëpunimi ndërkombëtar përfaqëson një parakusht për çdo veprimtari të përbashkët lufte.

- Ligji nr. 48, i 18 marsit 2008, ratifikon “Konventën e Këshillit të Evropës mbi krimin kibernetik” e cila ka përfaqësuar marrëveshjen e parë të veçantë ndërkombëtare mbi këtë çështje. Miratimi i këtij ligji të ri, ka dhënë një mundësi për të përshtatur Kodit Penal me krimet kompjuterike pas kontributeve të ligjit 547/1993, që ishte ndërhyrja e parë në këtë çështje.

- Konventa e Budapestit është bosht orientues ku mbështetet prokuroria shqiptare në trajtimin e krimit kompjuterik. Veprat penale kompjuterike përfshijnë jo vetëm veprimet me kompjuterë, por edhe krimet që lidhen me ndërhyrjen në të dhëna personale kryesisht në rrjetet sociale si edhe në rrjetet e gjëra teknologjike.

- Kërkimet ndërkufitare të pambuluara nga Konventa nuk janë “as të autorizuara, as të përjashtuara”.

- Kriteret e caktimit të juridiksionit të parashikuara nga konventa “Për krimin në fushën e kibernetikës”, në raste të caktuara të krimit transnacional, mund të mos jenë të mjaftueshme për të përcaktuar se cili shtet pale ka juridiksion. I tillë është rasti i veprave penale të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike që ndodhen në territorin e një vendi, ndërsa pasojat e krimit vijnë në territorin e një vendi tjetër.

- Legjislacioni shqiptar për sigurinë kibernetike, i përmbahet përgjithësisht atij ndërkombëtar, si në frymë ashtu edhe në përmbajtje, ku në fushën e së drejtës penale, është në përputhje me adoptimet e kërkuara në Konventën e KE-së për Krimin Kibernetik dhe Protokollin shtesë të saj.

- Legjislacioni penal shqiptar, në fushën e krimit kibernetik, vlerësohet të jetë

« Përfundime
e rekomandime
të Konferencës
së III-të
shkencore
ndërkombëtare »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

një legjislacion bashkëkohor dhe përgjithësisht në përputhje me Konventën për Krimin Kibernetik (Konventa e Budapestit), e cila është edhe akti ndërkombëtar më i rëndësishëm aktualisht për krimin kibernetik.

- Me ligjin nr. 8888, datë 25.4.2002, vendi ynë ratifikoi Konventën e Budapestit për Krimin Kibernetik, duke marrë kështu përsipër, detyrimin për ta bërë atë, pjesë të legjislacionit të brendshëm.

- Ligji nr. 9262 i datës 29.7.2004 “Për ratifikimin e protokollit shtesë të konventës për krimin kibernetik, për penalizimin e akteve me natyrë raciste dhe ksenofobe të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike” sërish është reflektuar në Kodin Penal përkatësisht në ligjin nr. 9859, datë 21.1.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995”.

- Tregtia ilegale me materiale të papërshtatshme seksuale, sot është një nga më të përhapurat, e ndoshta më rekreative e shfrytëzuesve të rrjeteve kompjuterike. Pornografia online është një dukuri tejet e popullarizuar dhe fitimprurëse.

- Rregullimi ligjor është aspekti i parë ku qeveria shqiptare ka fokusuar punën, përmendim këtu: ratifikimin e Konventës së Krimit Kibernetik, protokolleve shtesë të tij dhe reflektimin e këtyre angazhimeve të ndërmarra në legjislacionin e brendshëm konkretisht amendimet e Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit Penal; Ratifikimin e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve; parashikimet e draft-strategjisë agjenda digjitale lidhur me masat mbrojtëse për internetin për fëmijët në shkolla, etj.

- Për periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2017 janë regjistruar gjithsej 347 vepra penale të “Mashtrimit kompjuterik” dhe janë pezulluar 303 procedime që zënë 87 % të gjithë regjistrimeve. Kjo tregon edhe një here vështirësinë shumë të madhe të hetimit të kësaj vepre penale.

- Gjykatat, deri tani e kanë trajtuar hapësirën kibernetike si “vend fizik” për të justifikuar zbatimin e ligjeve tradicionale që rregullojnë aspekte civile dhe penale. Edhe brenda një juridiksioni, sot ka vështirësi për përcaktimin e “vendit” të krimit. Kompetenca tokësore e gjykatave është e përcaktuar mbi bazën e krimit tradicional. Mosmarrëveshjet në lidhje me kompetencën e gjykatave në Shqipëri, i zgjidh Gjykata e Lartë. Gjithashtu:

- Si në shembullin e Shqipërisë, Gjykata e Kasacionit, në Itali ka qenë në vështirësi për të përcaktuar kompetencën e gjykatave në lidhje me gjykimin e veprave penale të ndërhyrjes së paautorizuar në sistemet kompjuterike, duke e trajtuar hapësirën kompjuterike si një vend dhe duke konsideruar se autoritetet kompetente për gjykimin e një ndërhyrje të paautorizuar në një sistem kompjuterik është gjykata e vendit në të cilin kanë ardhur pasojat e krimit.

- Në Shqipëri apo vende të tjera, vështirësia në përcaktimin e kompetencës brenda një shteti shtohet shumëfish në marrëdhëniet ndërkombëtare, ku mungon një gjykatë e posaçme e cila do të vendoste kompetencën për gjykimin e rasteve që lidhen me sistemet kompjuterike.

- Në të drejtën civile, një kontratë nuk mund t'i mohohet zbatimi vetëm se është elektronike ose nënshkruar në mënyrë elektronike. Sipas legjislacionit shqiptar kontratat elektronike janë të vlefshme sipas kufizimeve përkatëse. Në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve kontraktuese me kontratë elektronike legjislatori ka qenë në vështirësi për të bërë një rregullim të plotë të zgjidhjeve se tyre.

- Në legjislacionin shqiptar janë evidentuar disa vështirësi për trajtimin e krimit kibernetik dhe konkretisht:

- Ndërsa në Europë iniciativat legjislative në drejtim të krimit kibernetik, kanë

nisur në vitet 1970, në vendin tonë dispozitat e para penale në fushën e teknologjisë, në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, janë parashikuar më datë 24.1.2001 me ligjin nr. 8733, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, me të cilin u parashikuan si vepra penale: “Ndërhyrja në transmetimet kompjuterike”, parashikuar nga neni 192/b, si dhe, “Përdorimi i paligjshëm i teknologjisë së lartë”.

- Edhe pse Shqipëria është ndër të parat vende që ka ratifikuar Konventën e KE-së për krimin kibernetik në vitin 2002, e kundërta ka ndodhur me situatën ligjore dhe me ngritjen e institucioneve përgjegjëse, për të luftuar këtë lloj kriminaliteti. Adaptimet e kërkuara nga konventa, për ligjin penal të brendshëm, si në atë material edhe në atë procedural, janë bërë vetëm në vitin 2008.

- Adaptimet e bëra në ligjin material penal shqiptar, janë pothuajse identike me rastet e identifikuar në Konventën e KE-së për krimin kibernetik dhe Protokollin shtesë të saj, por në disa dispozita nuk janë paraqitur rezerva ligjore, si në rastin e Pornografisë me të mitur.

- Ka dispozita të Konventës së Budapestit apo elementë objektivë dhe subjektivë të dispozitave të caktuara, të cilat nuk janë parashikuar si të tilla, në legjislacionin e brendshëm, duke e vënë në vështirësi ligjzbatuesin shqiptar mbi dispozitën së cilës do të duhet t’i referohen, në rastin konkret.

- Është evidentuar se tek ligjzbatuesi shqiptar ka vështirësi për të kuptuar dispozitat kompjuterike, për shkak të karakterit teknik të tyre. Pothuaj të gjitha dispozitat kompjuterike kanë në përbajtjen e tyre elemente teknike, elemente të cilat është e rëndësishme të kuptohen drejt, duke qenë se lidhen drejtpërdrejt me anën objektive të veprave penale konkrete dhe për pasojë, me vetë ekzistencën e tyre.

- Të dhënat e përdoruesit, vlerësohet se nuk kanë të njëjtën natyrë me përbajtjen e komunikimeve kompjuterike, pasi ndryshe nga këto të fundit, ku individ i ushtron jetën e tij private, ato, pra, të dhënat e përdoruesit, paraqesin rrethana që shërbejnë për identifikimin e personit, apo të lidhjes që ai ka krijuar me internetin. Për këtë arsye, vlerësohet i papërshtatshëm, kufizimi ligjor sipas të cilit administrimi i këtyre të dhënave, duhet të autorizohet vetëm nga gjykata.

- Diskrecioni i parashikuar për ISP të huaja, për dorëzimin, ose jo, së të dhënave kompjuterike, është një parim që nuk i përgjigjet nevojave të hetimit të krimit kompjuterik.

- Lejimi i përgjimit të komunikimeve ndërkombëtare kompjuterike, edhe pse zhvillohet ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera, nuk cenon sovranitetin e këtyre të fundit.

- Dispozita procedurale mbi sekuestrimin e provave kompjuterike, duhet të plotësohet, duke kufizuar kryerjen e veprimit vetëm për të dhënat të cilat janë memorizuar në territorin e Shqipërisë.

Lidhur me përfundimet në mbyllje të sesionit të III-të të Konferencës “Aspekte ligjore, ekonomike e psikosociale të krimeve kibernetike”, janë dhënë rekomandimet si më poshtë:

- Nevojë për adoptimin/hartimin e një ligji të veçantë për krimin kibernetik dhe sigurinë kibernetike (TIK), ku të jenë të evidentuara të gjitha format e tij si më poshtë:
- Duhet të forcohen në nivel ligjor dhe në nivelin penal, procedural instrumentet

« Përfundime
e rekomandime
të Konferencës
së III-të
shkencore
ndërkombëtare »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

që lejojnë hetimin dhe ndjekjen penale të personave që abuzojnë me TIK-un për kryerjen e veprave penale.

- Lufta kundër krimit kibernetik kërkon një qasje gjithëpërfshirëse që përfshin zhvillimin, zbatimin dhe rishikimin e masave teknike, ligjore, strukturore dhe sociale, me ndërtimin e strukturave të specifikuara organizative për të adresuar këtë problematikë në shkallë kombëtare si Byro Qendrore e Hetimit në Krimin Kibernetik dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenet 7, 8 dhe 18 të Direktivës për Mbrojtjen e të Dhënave.

- Shihet e nevojshme ndryshimi i koncepteve mbi territorin dhe juridiksionin e lidhur me hapësirën kibernetike, duke e konsideruar këtë hapësirë, si një formë të re të jurisprudencës ndërkombëtare si më poshtë:

- Duke marrë parasysh karakterin ndërkombëtar të krimit kibernetik, duhet të rishikohen kriteret e përmendura nga konventa për krimet kibernetike, për të përcaktuar se cili shtet-palë ka juridiksion, në rastet kur veprimi kryhet nga një shtetas i huaj jashtë territorit dhe pasoja vjen në territorin e një shteti tjetër.

- Komuniteti shkencor duhet të marrë në konsideratë propozimin dhe hartimin e një projektudhëzimi në lidhje me adoptimin e qasjes ndaj ndërhyrjes ndërkufitare, madje vlerësohet e nevojshme hartimi dhe një protokoll shtesë i konventës kundër krimit kibernetik, mbi kufijtë e ndërhyrjes ndërkufitare.

- Duhet të ndërtohen institucione të drejtësisë, prokurori dhe gjykata, me juridiksion ndërkombëtar, të cilat do të parandalonin e lehtësonin hetimin e krimeve në fushën kompjuterike.

- Rekomandohen specializime të strukturave përkatëse ligjzatuese, por edhe fuqizimin e këtyre strukturave me teknologjinë e përditësuar në fushën e krimeve kompjuterike.

- Legjislatori shqiptar, duke marrë parasysh natyrën e Konventës së Budapestit, duhet ta bëjë atë, pjesë të legjislacionit të brendshëm, me të gjitha parashikimet ligjore të kësaj konvente, përveç rezervës ligjore të paraqitur në momentin e ratifikimit. Shembuj janë në dispozitat e pornografisë me të mitur, falsifikimet kompjuterike, mashtrimet kompjuterike, etj. Për këtë:

- Duhet hartuar një studim i veçantë në lidhje me dokumentin e Konventës së KE-së për krimin kibernetik që i është bashkëlidhur ligjit për miratimin e saj, sa i përket përputhshmërisë së këtij dokumenti me origjinalin e konventës dhe përkthimin e saj.

- Për të kuptuar më mirë dispozitat kompjuterike, rekomandohet të ketë përkufizime të qarta në legjislacionin e brendshëm, pasi janë vërejtur probleme lidhur me terminologjinë. Duke parë karakterin ndërkombëtar të krimit kompjuterik, termat teknike duhet të “përkthehen” në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për të gjithë, dhe të jenë të unifikuara apo të gjithëpranuara. Për këtë duhet:

- Ndërhyrje dhe ndryshime në terminologjinë e përdorur në legjislacion, për sa i përket kuptimit të termave “krim kompjuterik” dhe “krimi kibernetik”.

- Rekomandohen në vazhdim ndryshime në ligjin e mbrojtjes së konsumatorit virtual, në Kodin Penal dhe në të drejtën civile lidhur me aspekte të krimit kibernetik. Për këtë:

- Rekomandohet që në amendimet e ardhshme të ligjit 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, i ndryshuar, të parashikohet një krë kushtuar krimit kibernetik dhe rikuperimit të dëmeve.

- Në rast të bërjes së Kodit të ri Penal, siç është diskutuar disa herë publikisht, do

të ishte e nevojshme përfshirja e veprave penale të krimit kibernetik në një ndarje të veçantë, seksion më vete në kreun III, sipas ndarjes në kodin aktual.

- Në të drejtën civile duhet të rishikohet nga legjislatori, vlefshmëria e kontratave dhe e nënshkrimit të tyre *online*.

- Duke qenë se kemi të bëjmë me institucione relativisht të reja të ndjekjes penale dhe hetimit të krimit kibernetik, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë përzgjedhjes dhe trajnimit të personelit të punësuar, si për nga aftësitë e specialitetit në fushën e kibernetikës, por veçanërisht të aftësimin të tyre profesional në drejtim të procedimit penal dhe sigurimit të provave për këto lloje krimesh.

- Lidhur me veprimet (shit-blerjet) *online* rekomandohet:

- Në blerjet *online*, është më mirë që të bëhen blerje me kartë të krediti, se sa me kartë debiti sepse me kartë krediti, mundësia e kthimit së të hollave nga ndonjë mashtrim, është më e madhe në krahasim me blerjet me karta të debitit të cilat i marrin të hollat drejtpërdrejtë nga llogaria jonë bankare.

- Sugjerohet që të dhënat tona të ndjeshme, si detajet e kartës së kreditit, asnjëherë mos t'i shkruajmë në një ueb-faqe e cila nuk përdor nivelin e sigurisë "https".

- Konsumatorët duhet të përdorin serverë të sigurt në realizimin e transaksioneve *online*.

- Në strategjitë e drejtuesve të bizneseve, duhet të jenë në plan të parë edhe masat për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit financiar të kompjuterizuar, krijimi i sistemeve mbrojtëse si dhe auditimi i vazhdueshëm i sigurisë kompjuterike. Për këtë:

- Në suksesin e përdorimit me efikasitet dhe të sigurt të informacionit financiar të kompjuterizuar, të organizatës së biznesit, merr një rëndësi të dorës së parë përzgjedhja e softuerëve dhe harduerëve, që të sigurojnë një përdorim të sigurt dhe afatgjatë të informacionit financiar të kompjuterizuar.

- Drejtuesit e organizatave të biznesit duhet t'i kushtojnë rëndësinë e duhur ruajtjes dhe miradministrimit të informacionit financiar dhe kontabël, të kompjuterizuar, sepse gjithnjë ka nevojë për përmirësim të marrjes së masave efektive dhe të nevojshme, në funksion të mirëmenaxhimit të organizatës.

- Është e nevojshme, që shoqëritë ofruese të shërbimit të internetit, në respektim të detyrimeve ligjore që normojnë veprimtarinë e tyre, të ndërmarrin masat e nevojshme për përmirësimin e infrastrukturës teknike, me qëllim që të mundësojnë ruajtjen e të dhënave të pajtimtarëve, apo përdoruesve të internetit.

- Rekomandohet që kompjuteri prej të cilit bëjmë blerje, të jetë i sigurt. Ai duhet të përdorë antivirus të ndryshëm si dhe duhet të jetë i përditësuar, si dhe gjatë përdorimit të bankomatit, të vendosim dorën gjatë kohës kur shtypim kodin tonë, e jo ta pëshpëritim atë me zë, pasi pajisjet e përdorura nga keqbërësit shpeshherë kanë edhe mikrofonta.

- Tregtarët duhet të krijojnë sisteme të sofistikuar dhe të fuqishme për të parandaluar sa më shumë aktivitetin e mashtruesve kompjuterike, si dhe për të rritur sigurinë gjatë kryerjes së transaksioneve *online*. Gjithashtu:

- Konsumatorët duhet të mirë-edukohen rreth metodave dhe mjeteve që duhet të përdorin dhe si ti përdorin ato në mënyrë që të realizojnë transaksione të sigurta *online* dhe njëkohësisht të ruajnë të paprekura të dhënat dhe informacionin e tyre personal.

- Rekomandohet ndërmarrja e politikave ndërgjegjësuese për konsumatorët në lidhje me rrezikshmërinë nga kërcënimet *online* dhe pasojat që krimi kibernetik sjell tek të ardhurat ekonomike të tyre.

« Përfundime
e rekomandime
të Konferencës
së III-të
shkencore
ndërkombëtare »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

D. Disa përfundime lidhur me aspektin ekonomik-financiar, social dhe në sistemin e edukimit dhe informimit qytetar.

- Krimet kibernetike kanë pasur ndikim në aspektin ekonomik e financiar, si dhe në veprimet e transaksionet bankare nëpërmjet sistemeve teknologjike *online*, duke shkaktuar dëme të mëdha ekonomike bizneseve e institucioneve qeveritare në botë e në Shqipëri.

- Një studim i Qendrës për Inovacionin e Qeverisjes Ndërkombëtare, në bashkëpunim me OKB- në, pohon se konsumatorët në mbarë botën po bëhen më të kujdesshëm ndaj transaksioneve në internet për shkak të rritjes së krimit në internet dhe shkeljeve të privatësisë.

- Rezulton se në Shqipëri, përfaqësuesit e biznesit e konsiderojnë rrezikun e informacionit kontabël dhe financiar të kompjuterizuar, si rrezik serioz eventual dhe shumica e specialistëve të financës dhe të kontabilitetit, janë shprehur për njohuri jo të mjaftueshme për llojet e krimeve kompjuterike në ekonomi, dhe për specifikat e tyre, ndërsa specialistët e sektorit të IT-së, u shprehën për njohuri të mjaftueshme për krimin kompjuterik.

- Siguria e informacionit financiar të kompjuterizuar është shumë e rëndësishme për vlerësimin e organizatës së biznesit dhe e ndërvarur me performancën financiare të saj. Gjithashtu cilësia e internetit dhe shkalla e informatizimit ndikojnë në cilësinë e sigurisë së informacionit financiar të kompjuterizuar.

- Ka lindur dhe është zhvilluar koncepti i konsumatorit virtual, i cili realizon blerje si dhe kryen pagesa drejtpërsëdrejti nga interneti. Kontratat elektronike janë kontratat tipike, me palë shitës dhe blerës, që nuk e njohin njëri – tjetrin, por kryejnë transaksione financiare, dhe kjo ka shkaktuar problematika në fushën e mbrojtjes së të drejtave konsumatorëve.

- Krimit kibernetik dëmton bizneset, të cilët tregtojnë në përputhje me rregullat ligjore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi në vende të ndryshme, duke sjellë në jo pak raste falimentimin e këtyre bizneseve.

- Investimi i bankave tregtare në kërkim dhe teknologji rrit ndjeshëm edhe përdorimin dhe sigurinë, në përdorimin e shërbimeve *online*, dhe për më tepër, *E-Banking*. Vihet re nga studime dhe raporte që përdorimi sa më i ulët i shërbimeve *E-Banking*, lidhet me mungesën e besimit të përdorimit të transaksioneve *online*. Kjo sepse:

- Konsumatorët përdorin bankomatët, POS терминаlet dhe internetin për blerje *online*, dhe të investojnë *online*. Shumica e konsumatorëve si dhe bizneset në ditët e sotme përdorin, karta krediti ose debiti, për tërheqje parash dhe për të bërë pagesa të ndryshme *online*, duke mos parashikuar rreziqet të cilat ju kanosen gjatë kryerjes së këtyre shërbimeve.

- Klonimi i kartave bankare bëhet në ATM, kur aty vendosen disa pajisje të cilat bëjnë leximin e shiritit magnetik si dhe një pajisje tjetër, që vendoset mbi pjesën ku shtypet *pin code*. Pasi i sigurojnë të dhënat, ato të dhëna dekodohen dhe bëhen funksionale dhe kartat janë të gatshme për përdorim. Ato mund të përdoren për blerje *online* si dhe për transferime të ndryshme të parave, si për shembull në *Western Union*, *Money Gram* etj.

- Në rastin e krimit kibernetik është e vështirë të garantohen të gjitha të drejtat

e konsumatorëve, sepse është e vështirë të gjendet burimi i hakimit, personit/personave që e kanë kryer këtë krim duke e bërë të pamundur procesin e dëmshpërblimit të konsumatorëve.

- *E-Banking* është një nga prirjet dhe inovacionet e fundit në Shqipëri, që është adoptuar më së miri si një shërbim i ofruar nga bankat tregtare për përhapjen e produkteve elektronike nëpërmjet ATM (*Automatic teller machines*), pagesave elektronike dhe mobile *banking*, që ndikojnë në sigurinë e klientit.

- Gjatë vitit 2017 ka filluar projekti i *swift*-it (“client security program”), i cili synon rritjen e sigurisë së informacionit (pagesave).

- Duhet pasur kujdes nga ato ueb-faqe të cilat ofrojnë çmim shumë më të ulët se sa ueb-faqet e tjera. Mbase arsyeja e këtij çmimi kaq të ulët është se, pasi të keni bërë blerjen, ju vjen me postë një produkt joorigjinal, i vjedhur ose asgjë fare.

- Kompjuteri/pajisja me anë të së cilit bëhet blerja *online*, duhet të jetë e sigurt pasi nëse kompjuteri/pajisja është i infektuar, një kriminel kibernetik diku në botë, mund të identifikojë shtypjet e butonave në tastierë dhe mund të marrë gjithashtu informacionet tjera të rëndësishme.

- Lidhja e kontratave elektronike B2C ka nxitur përhapjen e krimit kibernetik. Nëpërmjet hapësirës kibernetike, hakerat përvetësojnë të dhënat personale dhe informacione private të konsumatorëve, duke u shkaktuar këtyre të fundit dëme ekonomike, si dhe humbjen e besimit.

- Edukimi, trajnimi dhe aftësimi i personelit për përdorimin e shfrytëzimin e mjeteve kompjuterike si dhe në të njëjtën kohë trajnimi dhe aftësimi i tyre për Mbrojtjen Kibernetike, ka bërë të mundur realizimin e programeve të edukimit dhe trajnimit të personelit si brenda vendit, gjithashtu dhe në kuadër të ndihmës dhe bashkëpunimit me vendet aleate të NATO-s. Për këtë rekomandohet:

- Sensibilizim dhe informim i fëmijëve/adoleshentëve nëpër shkolla të arsimit 9-vjeçar dhe shkollat e mesme, me anë të praktikave më të mira për njohjen e rreziqeve të sulmeve kibernetike dhe mënyrat e ruajtjes së vetes dhe parandalimit.

- Institucionet e niveleve të ndryshme (organizatat) shtetërore apo private, janë duke implementuar konceptet e mikromësimi (*eLearning*) që lidhet me teknikat praktike të së mësuarit me anë të trajnimeve afatshkurtra kryesisht nëpërmjet teknologjisë, kompjuterit, celularit. Kjo është risi e procesit të edukimit me anë të teknologjisë dhe për teknologjinë.

- Në Kosovë vërehet se qytetarët që bien viktimë të keqbërësve në internet, nuk kanë njohuri të mjaftueshme për rreziqet gjatë përdorimit të internetit.

- Në Kosovë po ashtu, duke marrë parasysh kërkesat për asistim nga njësitet e ndryshme policore, vijmë në përfundimin, se edhe zyrtarët policorë nëpër njësite të ndryshme, nuk kanë njohuri të mjaftueshme kur kemi të bëjmë me rastet që kryhen përmes kompjuterit apo internetit.

- Nga anketimet kanë rezultuar si hapa të domosdoshëm për të parandaluar rritjen e rasteve të krimeve kibernetike në masën mbi 94%: trajnimet e duhura të oficerëve të zbatimit të ligjit që punojnë në fushën e krimit kibernetik; rritja e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë; shtimi i numrit të oficerëve të zbatimit të ligjit që punojnë në fushën e krimit kibernetik; ndryshimet e duhura ligjore; ndryshimet e duhura strukturore; rritja e bashkëpunimit publik-privat në këtë fushë; përfshirja e njohurive mbi veprat penale kompjuterike në programet shkollore si dhe ashpërsimi i dënimeve ndaj autorëve të këtyre veprave penale

« Përfundime e rekomandime të Konferencës së III-të shkencore ndërkombëtare »

Policimi dhe Siguria nr.14, 2019

- Krimi kompjuterik dhe kërcënimi kibernetik vazhdojnë të gjejnë përhapje në Shqipëri ndërmjet të tjerave dhe për shkak të mangësive të theksuara të ndërgjegjësimit/sensibilizimit dhe të edukimit të kategorive shoqërore e shtresave shoqërore me rrezikun e përdorimit të pakontrolluar e të pasigurt të internetit e të teknologjisë së informacionit e komunikimit.

- Sfidat më të mëdha për Shqipërinë për kërcënimet kibernetike:
- Përdorimi i telefonave celular.
- Shërbimet qeveritare *online/E-government*.
- Sulmet kundër infrastrukturës, që mund të jenë shembuj të terrorizmit kibernetik, nëse kanë pasojë mjaft të rënda.

Lidhur me përfundimet në trajtimin në aspektin ekonomik-financiar, social dhe në sistemin e edukimit dhe informimit qytetar, në këtë sesion të konferencës, janë dhënë rekomandimet si më poshtë:

- Ndërgjegjësimi dhe edukimi i mbarë shoqërisë shqiptare me një kulturë të re digjitale është thelbësore në arritjen e një niveli të mbarëpranuar shoqëror për përdorim të sigurtë të internetit, duke ndikuar në reduktimin e rreziqeve, sulmeve, mashtrimeve apo krimeve. Për këtë:

- Në nivel ekzekutivi duhet të rritet bashkëpunimin me ISP-te si dhe duhet të rritet numri i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit, në lidhje me rreziqet e internetit dhe të sigurisë në internet.

- Të organizohen sa më shumë fushata sensibilizuese dhe trajnime për kërcënimin dhe sigurinë kibernetike, të cilat duhet të jenë periodike, intensive si edhe të përgatitura për të qenë të asimilueshme nga audienca të ndryshme dhe nëpër mjete të ndryshme të komunikimit, nisur kjo nga shkalla e përdorimit të teknologjisë nga këto kategori.

- Të ndërgjegjësohen dhe të bashkëpunohet mes aktorëve shtetërore e jo shtetërorë, medieve dhe publikut, për mos rënë pre e spiunazhit kibernetik.

- Të rritet niveli i njohurive dhe kulturës së klientit/konsumatorit virtual në Shqipëri për përdorimin e këtyre sistemeve dhe për njohjen e rreziqeve, me qëllim parandalimin dhe ruajtjen e sigurisë së tyre.

- Të mundësohet shpërndarje dhe publikim i informacionit në faqet zyrtare të internetit të institucioneve mbi rreziqet e hapësirës kibernetike dhe nxjerrje e udhëzimeve dhe këshillave për një siguri minimale me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe sigurisë së përdoruesve të thjeshtë.

- Ndërgjegjësim më i madh i përdoruesve të teknologjisë me faktin se duhet të denoncojnë rastet kur konstatojnë një mashtrim, sulm, falsifikim, krimi kibernetik, ashtu siç do të bënin për çdo lloj forme të krimit.

- Krijimi i një mjedisi më të sigurt *online* për fëmijët, të cilët janë target-grupi më i sulmuar në pornografinë dhe abuzimin seksual në botën virtual *online*.

- Duhet të vazhdohet me ndërgjegjësimin e prindërve për rolin e tyre të pazëvendësueshëm dhe kujdesin prindëror në mjedisin *online*, rritja e vëmendjes të shkollës, industrisë, organizmave të tjerë jo qeveritarë etj.

- Të punohet për të hartuar e organizuar një Sistem European Trajnimi dhe Edukimi në fushën kibernetike dhe të sigurisë kombëtare e ndërkombëtare.

- Të mundësohet koordinim të qeverisë shqiptare, Ministrisë së Arsimit dhe kompanive private për të investuar në kurikula mësimore, programe trajnimi bazë dhe

trajtime të vazhdueshme profesionale në fushën e kibernetikës me qëllim shtimin e njohurive në këtë fushë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të nivelit të ekspertizës. Për këtë:

- Të mundësohet përmirësimi i edukimit mbi sigurinë kibernetike për fëmijët, të cilët duhet të përgatiten për ambientin e ri digjital e për përdorimin e pajisjeve, dhe për lundrimin në mënyrë sa më të sigurt e të ndërgjegjshme në botën digjitale.

- Qeveria të ndërmarrë iniciativa dhe të hartojë programe për edukimin dhe ndërgjegjësimin e përdoruesve të TIK. Këto programe do përfshijnë të gjithë nivelet e administratës publike si: specialistët IT, administratorët e sistemeve dhe TIK, etj. Ky proces do të garantojë përdorimin, ngritjen dhe ofrimin e shërbimeve digjitale të administratës në mënyrë të sigurt dhe të besueshme.

- Rekomandohet që në sistemin arsimor, në nivelet e arsimit parauniversitar dhe atij universitar, të realizohen rishikim të kurikulave ekzistuese dhe vlerësime për futjen e programeve edukative dhe fushatave të informimit rreth informatikës. Për këtë:

- Të rishikohen kurikulat mësimore në të gjitha nivelet arsimore, për parandalimin e krimit në internet; në menaxhimin e sigurisë kibernetike; në rritjen e ndërgjegjësimin të publikut të gjerë; në ligjet dhe politikat mbi krimin kibernetik dhe në rreziqet dhe efektet e krimit kibernetik.

- Të rishikohen e të plotësohen kurikulat mësimore në arsimin 9-vjeçar dhe të mundësohet përfshirja e programeve për fushën e kriminalitetit kibernetik, sulmet e rreziqet e hapësirës dhe sigurisë kibernetike.

- Universitetet publike dhe private të hartojnë programe mësimore dhe kurrikula për lëndën e re mësimore “Siguria kibernetike” e cila duhet të përfshihet në drejtimit “bachelor” dhe master në shkencat teknologjisë së informacionit, sigurisë, juridike, ekonomike, shkencave politike, shkencave sociale, marrëdhënieve ndërkombëtare, administratës publike, etj.

- Të hapen programe të studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në fushën e krimit kibernetik, si dhe një programi rajonal në këtë fushë.

- Rishikim i kurikulave në Akademinë e Sigurisë për fushën e krimeve dhe sigurisë kibernetike, me qëllim edukimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të zbatimit të ligjit.

- Bazuar në praktika të vendeve të tjera, rekomandohet të zhvillohen programe të dedikuara në kërkim të talenteve, shoqëruar me edukimin e brezave të ardhshëm të profesionistëve të aftë. Për këtë:

- Të hartohet një program i ngjashëm me modelin italian *CyberChallenge* IT, që të mundësojë thithjen e të rinjve për t’u trajnuar e shkolluar në këtë fushë dhe ta integrojë këtë me tregun e punës në Shqipëri.

- Të planifikohen dhe të investohet për më shumë trajtime, specializime dhe kualifikime të vazhdueshme të kapaciteteve njerëzore në fushën e sigurisë kibernetike, duke përfshirë stafin e punonjësve dhe ekspertët në këtë fushë. Për këtë duhet:

- Përditësimi i kurikulave arsimore dhe të trajnimeve të institucioneve të administratës publike dhe kompanive private mbi sigurinë kibernetike me qëllim krijimin, trajnimin e forcimin e kapaciteteve njerëzore për sigurinë kibernetike dhe sulmet kibernetike *online*.

- Të ofrohen trajtime të posaçme për oficerët e zbatimit të ligjit që punojnë në fushën e krimit kibernetik.

« Përfundime e rekomandime të Konferencës së III-të shkencore ndërkombëtare »

Polici dhe Siguria nr.14, 2019

- Të trajnohen vazhdimisht punonjësit e Policisë së Shtetit që punojnë në strukturat e hetimit të krimit kibernetik, me qëllim përmirësimin e shkallës së hetimit të tyre.

- Të mundësohet trajnim i vazhdueshëm për ekspertët TIK në procesin e *Digital Forensics* (proces i zbulimit dhe i interpretimit së të dhënave elektronike), për ekspertët e terrenit nga Policia e Shtetit që do të parandalojnë e dokumentojnë shkeljet ligjore, si dhe të punohet për rritjen e performancës së organit të akuzës (prokurorisë), gjyqësorit (gjykatat) dhe të thellohet bashkëpunim kundër krimit kibernetik.

- Të thellohen kërkimet shkencore në fushën e krimeve kompjuterike e sigurisë kibernetike, me qëllim që shteti shqiptar të ketë të dhënat dhe informacionet e nevojshme shkencore, për të krijuar një qasje më të mirë të rrezikut ndaj sigurisë kibernetike dhe evidentimin mangësive, me qëllim përmirësimin e politikave të sigurisë kibernetike, duke rritur ndërgjegjësimin e politikëbërësve kryesorë, aktorëve në fushën e industrisë, publikut të gjerë, si dhe gjetjes së mënyrave kreative për të tërhequr vëmendjen e medieve dhe publikut mbi këtë fushë. Për këtë:

- Të mblidhen periodikisht komunitetet akademike, për të punuar mbi kërkimin shkencor dhe përmirësimin e kurikulave në lidhje me sigurinë kibernetike dhe politikat e internetit; identifikimit të infrastrukturës kritike dhe infrastrukturës së informacionit kritik të vendit dhe të rajonit; bashkëpunimin ndërmjet industrisë dhe qeverisë mbi problematikat dhe politikat e sigurisë kibernetike, si dhe gjetjen e zgjidhjeve teknike.

- T'i kushtohet rëndësi rolit që ka siguria bankare për financat dhe ekonominë e vendit.



« Përfundime
e rekomandime
të Konferencës
së III-të
shkencore
ndërkombëtare »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

Sekreti hetimor dhe e drejta për informim



■ **MSc. Besnik SHEHAJ**
Akademia e Sigurisë
besnik.shehaj@asp.gov.al

Abstrakt

Në legjislacionin penal e më gjerë, ekziston një korpus përgjithësisht i mirë i normave që rregullojnë marrëdhëniet juridike për ruajtjen, administrimin, shfrytëzimin, deklasifikimin dhe publikimin e informacionit të klasifikuar sekret shtetëror, sekret hetimor apo sekret profesional, si dhe për të drejtën e informimit apo për mbrojtjen e të dhënave personale. Por, në praktikën e zbatimit të ligjit, konstatohen raste kur ndodhin keqkuptime, keqinterpretime, shkelje apo, për më keq, abuzime, si rrjedhojë e të cilave shkaktohen dhunim i të drejtave themelore kushtetuese, pasoja të dëmshme për dinjitetin, jetën dhe pronën e shtetasve, cenim i integritetit të organeve ligjzbatuese, deformime në funksionimin e shtetit ligjor, veçanërisht gjatë procesit penal, ku është fokusuar ky artikull. Si pasojë, disa ngjarje të rënda kriminale të ndodhura në vendin tonë janë bërë shpesh objekt i debateve të ashpra publike në mediet elektronike e të shkruara, kryesisht midis krahëve të politikës, analistëve apo gazetarëve dhe përfaqësuesve të Policisë e Prokurorisë. Por dëmi më i madh në këto raste i shkaktohet procedimit penal për këto ngjarje, kur nga publikimi i akteve e veprimeve të caktuara hetimore apo zbulimi i identitetit të personave nën hetim rrezikohet seriozisht vlefshmëria e provave të grumbulluara, ndodh largimi dhe fshehja e autorëve të dyshuar, intimidohen subjektet dhe organet e procedim, politizohen ngjarjet dhe rrethanat, si dhe korruptohen palët në proces. Pse ndodhin këto gjëra dhe si mund të shmangen?

Në këtë artikull synohet pikërisht t'i jepet përgjigje këtyre pyetjeve, nëpërmjet analizës së kundërshtisë midis: detyrimit për ruajtjen e sekretit hetimor dhe të drejtës për informim gjatë veprimtarisë parandaluese dhe hetimit të veprave penale nga punonjësit e Policisë apo organet e procedimit. Duke interpretuar dhe ballafaquar normat juridike mbi të drejtën për informim me ato për ruajtjen e sekretit hetimor jemi përpjekuri të nxjerrim disa nga shkaqet, faktorët relevantë, pasojat e dëmshme, si dhe format e mënyrat që ndikojnë në përkeqësimin apo mbarëvajtjen e marrëdhënies ndërmjet këtyre dy kaheve të procedimit penal, pra e thënë në mënyrë metaforike për të vendosur "paqe" ose ekuilibër të arsyeshëm midis të drejtës për informim dhe ruajtjes së sekretit hetimor.

Fjalëkyçe:

sekret shtetëror, sekret profesional, sekret hetimor, e drejta për informim, mbrojtje e të dhënave personale, publikim i sekretit hetimor.

Shehaj, B.
« Sekreti hetimor dhe e drejta për informim »

Policimi dhe Siguria nr.14, 2019

1. Hyrje

Dihet se *sekreti hetimor* është një faktor kyç në procedimin penal, sidomos në fazën e hetimit paraprak, kur faktet dhe rrethanat e ndodhjes së veprës penale janë në proces verifikimi e të provuari, por edhe për të respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë për personat nën hetim. Por në komunikimet publike, jo gjithmonë respektohen normat ligjore që rregullojnë mënyrat e administrimit, përdorimit dhe komunikimit të akteve e veprimeve procedurale gjatë hetimit të veprave penale.

Disa ngjarje kriminale janë bërë shpesh objekt i debateve të ashpra publike, kryesisht midis krahëve të politikës, analistëve, gazetarëve dhe përfaqësuesve të Policisë e Prokurorisë. Këto debate, jo vetëm nuk e zgjidhin situatën, por për më tepër lënë përshtypje negative në publik, ndërsa emocionet e pjesëmarrësve jo rrallë herë triumfojnë ndaj arsyes. Kështu ata, duke u përpjekur të bëhen sa më të besueshëm ose për të demaskuar kundërshtarët, publikojnë fakte dhe rrethana për ngjarje kriminale apo persona të dyshuar si të implikuar në këto ngjarje, të siguruara nga burime jo të autorizuar.

Duke analizuar kuptimin ligjor dhe veçoritë për secilin nga llojet e sekretit që aplikohet në Republikën e Shqipërisë, por jo vetëm, si dhe nëpërmjet ballafaqimit të tyre me kuptimin dhe veçoritë e të drejtave themelore kushtetuese, siç janë *e drejta për informim* dhe *mbrojtja e të dhënave personale*, në këtë punim synohet të evidencohen disa mangësi gjatë realizimit të këtyre të drejtave e detyrimeve ligjore, veçanërisht në komunikimet publike, si dhe të propozohen disa rregullime normative e institucionale në këto fusha. Në fokus të kësaj analize do të jetë *sekreti hetimor*, pasi është pikërisht ky lloj sekreti që zbulohet më shpesh, pa dashje apo me qëllim, duke dëmtuar ndonjëherë në mënyrë të pariparueshme procedimin penal.

Shehaj, B.
« Sekreti
hetimor
dhe e drejta
për informim »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

Metoda e përdorur është ajo e analizës dhe interpretimit formal-juridik të legjislacionit përkatës, shqyrtimit të vendimeve gjyqësore si precedent, krahasimit dhe sintezës të statistikave kriminale, ballafaqimit me eksperiencën ndërkombëtare dhe nxjerrjes së deduksioneve.

2. Kuptimi për sekretin

2.1 Sekretin shtetëror

Etimologjia e fjalës “*sekret*” rrjedh nga fjala latine “*Secretus*”¹, që ka kuptimin “i ndarë”, “i fshehtë”. Të njëjtin kuptim ka ky term edhe në fjalorin e gjuhës shqipe, ku përkufizohet si “*diçka që mbahet e fshehtë; diçka që duhet ta dinë vetëm disa njerëz...*”². Ndërsa në kuptimin formal-juridik, përkufizimi i termit është dhënë në nenin 2 të ligjit përkatës, ku thuhet: “*Sekretin shtetëror*” do të thotë informacion i klasifikuar sipas këtij ligji, ekspozimi i paautorizuar i të cilit mund të rrezikojë sigurimin kombëtar”³. Më tej ligji sqaron se: “*Sigurim kombëtar*” do të thotë mbrojtja e pavarësisë, integritetit territorial, rendit kushtetues dhe marrëdhënieve me jashtë të Republikës së Shqipërisë”⁴.

Në vlerësimin e këtij studimi, si përkufizimi dhe sqarimi i dhënë në këtë ligj për sekretin shtetëror nuk janë të plotë ose jo shumë të qartë, pasi termi i referohet informacionit të klasifikuar për nevoja të sigurimit kombëtar, pra vetëm për “*mbrojtjen e pavarësisë*”, “*integritetit territorial*”, “*rendit kushtetues*” dhe “*marrëdhënieve me jashtë*”, duke e ngushtuar shumë sferën e veprimit të ligjit, përkatësisht ruajtjes së sekretit shtetëror. Njëkohësisht këto përcaktime të fushave të veprimit të ligjit, që janë të papërkufizuara plotësisht edhe në literaturën juridike shqiptare, lënë shteg për interpretime subjektive gjatë zbatimit nga autoritete përkatëse si, p.sh.: çfarë përfshihen në rendin kushtetues, a nënkuptohet brenda këtij nocioni juridik edhe termi “rend publik”, që ka interes të veçantë në këtë studim, apo mbrojtja e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë; në marrëdhëniet me jashtë a nënkuptohen ekstradimet, letër-porositë gjatë procesit penal; me mbrojtje të integritet territorial a përfshihet menaxhimi i integruar i kufirit; në mbrojtjen e pavarësisë a përfshihet edhe ruajtja e personaliteteve dhe institucioneve kushtetuese, etj.?

Në legjislacionin penal shqiptar, përveç termit *sekretin shtetëror* ndeshim gjithashtu termat “*sekretin hetimor*” dhe “*sekretin profesional*”, për të cilët nuk jepet ndonjë shpjegim, përkufizim ose sqarim, por as në ligjin për informacionin e klasifikuar. Atëherë si duhen kuptuar dhe aplikuar këto lloje sekreti në praktikën e përditshme, kur me kushtetutë është njohur “*e drejta për informim*” apo kundrejt saj “*mbrojtja e të dhënave personale*”?

Duke analizuar si fillim elementët përcaktues ligjorë për secilin nga llojet e sekretit, do ta kemi më të lehtë të bëjmë dallimin ndërmjet tyre, për rrjedhojë të deduktojmë saktë se kur duhet aplikuar njëri apo tjetri dhe si duhet të ruhet raporti me të drejtën e informimit apo mbrojtjen e të dhënave personale.

Nga ligji për *sekretin shtetëror* mund të nxjerrim këta elementë përcaktues për këtë lloj sekreti:

- është sekretin shtetëror, pra i aplikueshëm vetëm nga institucionet shtetërore ose me

¹ <https://en.oxforddictionaries.com/definition/secret> (Oxford University 2018).

² Fjalor i shqipes së sotme 2002, f. 1169 (Akademia e Shkencave e RSh 2002).

³ Ligj nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekretin shtetëror””, i ndryshuar, neni 2.

⁴ Po aty (Kuvendi i RSh 2017).

autorizim të një autoriteti shtetëror;

- përhapja e paautorizuar rrezikon *sigurimin kombëtar*;
- është *i klasifikuar* në katër nivele, sipas përcaktimeve në ligj;
- ka *rregulla të përcaktuara* me ligj për klasifikimin, përdorimin, ruajtjen dhe deklasifikimin;

- ruajtja e tij bëhet nëpërmjet *masave të sigurisë*;

- zbatohet parimi i “*nevojës për njohje*”;

- *tregimi i tij dënohet* sipas Kodit Penal;

- për përcaktimin e sekretit shtetëror “*nuk do të përdoret asnjë term tjetër*”;⁵

- “*Ky ligj zbatohet për të gjitha institucionet shtetërore, qendrore ose të varësisë, për organet e drejtësisë, prokurorisë dhe/ose personat juridikë/fizikë, personat me imunitet, kur për ushtrimin e detyrave të tyre duhet të kenë akses në informacionin e klasifikuar ‘sekret shtetëror’*”.⁶

Në vijim të sa theksuam më sipër, është me interes t’i referohemi edhe nenit 10 të ligjit⁷ për sekretin, në lidhje me ndalimet për klasifikimin e informacionit: “... kur ai bëhet më qëllim që:

- të *fshehë dhunimin e ligjeve, paefektshmërinë apo gabimet e administratës*;

- t’i *privojë të drejtën e njohjes një personi, organizate apo institucioni*;

- të *pengojë apo të vonojë dhënien e informacionit që nuk kërkon mbrojtje në interes të sigurimit kombëtar*”.

2.2 Sekreti profesional

Ky lloj i sekretit është i shprehur nga Kodi i Procedurës Penale, pa dhënë një përkufizim të tij, por tërthorazi, sipas nenit 159, kuptohet se detyrimin për ruajtjen e këtij lloj sekretit e kanë: përfaqësuesit e besimeve fetare, avokatët, përfaqësuesit ligjorë, noterët, mjekët, obstetër, kirurgët, farmacistët dhe të tjera profesione që ligji ja njeh këtë të drejtë.⁸ Pra kjo e drejtë e këtyre profesioneve rrjedh nga statutet apo aktet që rregullojnë funksionimin e tyre, si p. sh. statutet e komuniteteve fetare apo Betimi i Hipokratit, Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë, etj.

Kuptimi ligjor për *sekretin profesionale*, për të gjitha fushat e veprimtarive ku ai aplikohet, mund të nxirret nga interpretimi teorik i nenit 159 i Kodit të Pr. Penale të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 295/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, ku mund të dallojmë këta elementë përcaktues:

- ushtrohet nga persona fizik ose juridik publik e privat;

- nuk është informacion i klasifikuar, sipas ligjit për sekretin shtetëror;

- ruajtja e tij bëhet sipas kodit etik të shërbesës ose profesionit;

- zbulimi i tij dënohet me ligj;⁹

- përfshin edhe sekretin tregtar industrial.

Në literaturën juridike apo praktikën e përditshme është i dallueshëm ndryshimi midis kuptimit për “sekretin shtetëror” nga “sekreti profesional”, por problemi lind kur i referohemi Ligjit nr. 8839, datë 22.11.2001, “Për grumbullimin, administrimin dhe

Shehaj, B.
« Sekreti
hetimor
dhe e drejta
për informim »

⁵ Po aty, parag. II i nenit 3

⁶ Po aty, neni 1/1

⁷ Po aty, neni 10

⁸ Kodi i Pr. Penale i RSh, neni 159 (Kuvendi i RSh 2018)

⁹ Kodi Penal i RSh, neni 295/a, parag. III (Kuvendi i RSh 2018)

ruajtjen e informacionit të klasifikuar policor”, ku rezulton se: *“Informacioni i klasifikuar policor cilësohet ‘sekret profesional’ ...”*¹⁰, që për nga emërtimi ka ngjashmëri me termin *“sekret profesional”* të shprehur në nenin 159 të Kodit të Pr. Penale, por në përmbajtje është i ndryshëm, pasi vetë ky ligj jep kuptimin: *“...informacioni i klasifikuar policor konsiderohet...çdo material që ka të dhëna, të cilat lidhen me veprimtarinë e policisë, në veçanti me:*

a) rendin, sigurinë publike dhe me parandalimin e luftën ndaj krimit, me të dhëna që lidhen me strukturën organike të policisë, të personelit, me veprimtaritë që lidhen me teknikat e gjurmimit policor dhe të sigurisë publike;

b) shërbimin e ruajtjes së kufirit shtetëror, organizimin dhe kryerjen e operacioneve policore, si dhe sigurimin e personaliteteve të larta shtetërore”¹¹

Nga vëzhgimi i korpusit të akteve ligjore e nënligjore që normojnë punë me dokumentacionin klasifikuar sekret shtetëror nuk gjejmë ndonjë dispozitë që shfuqizon ligjin për informacionin e klasifikuar policor, por në praktikën e përditshme dhe në aktet nënligjore në fuqi rezulton se informacioni policor trajtohet dhe klasifikohet sipas niveleve të sekretit shtetëror(!?) dhe konkretisht citojmë: *“...të dhënat/informacionet e marra nga burimi i informacionit policor, punonjësi i Policisë së Shtetit...i klasifikon...në një nga nivelet e informacionit të klasifikuar ‘sekret shtetëror’ (Tepër sekret, Sekret, Konfidencial ose i kufizuar)...”*¹².

Ndonëse nuk është në fokus të këtij studimi, për mendimin tonë vlen të theksohet fakti se, informacioni i klasifikuar policor duhet të trajtohet si “sekret shtetëror”, pasi në konceptin e sigurisë kombëtare¹³, sipas Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, konsiderohet si: *“rreziqe të nivelit të parë dhe të dytë...korrupsioni dhe krimi i organizuar...sulmet kibernetike...sulm terrorist...radikalizmi fetar...”*¹⁴ kur dihet se këto lloje veprimtarie kriminale ndiqen nga Policia e Shtetit. Studiues të ndryshëm nënvizojnë gjithashtu faktin se *“termi ‘siguri kombëtare’...përmban sigurinë apo rendin brenda vendit dhe sigurinë nga jashtë.”*¹⁵ apo se *“në të gjitha doktrinat e sigurisë kombëtare, rendi dhe siguria publike është një komponent i rëndësishëm...”*¹⁶. Nga ana tjetër trajtimi i këtij lloji informacioni të klasifikuar si “sekret profesional” bie ndesh me dispozitat përkatëse në Kodin e Pr. Penale dhe Kodin Penal, që ja atribuojnë këtë të drejtë profesioneve të “lira” si: përfaqësuesve të besimeve fetare, përfaqësuesve ligjorë, avokatëve, noterëve, mjekëve, gazetarëve, etj.

2.3 Sekretet hetimor

Ky lloj sekretit është me interes të veçantë për studimin tonë, pasi shpesh herë nëpërmjet zbulimit apo, më keq, publikimit të tij abuzohet nga politikanët dhe mediet e ndryshme, duke sjell pasoja direkt në mbarëvajtjen e hetimeve, shkeljen e lirive dhe të drejtave të individit, cenimin e integritetit të personave që kryejnë hetime, pasoja të

Shehaj, B.
« Sekretet
hetimor
dhe e drejta për
informim»

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

¹⁰ Ligjit nr. 8839, datë 22.11.2001, “Për grumbullimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar policor”, neni 3 (Kuvendi i RSh 2001)

¹¹ Po aty, neni 2

¹² Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 56/1, datë 27. 05. 2013 “Për përdorimin e burimeve të informacionit, marrjen, administrimin, verifikimin dhe vlerësimin e të dhënave”, Kreu II, pika 3 (Ministri i Brendshëm 2013)

¹³ shih parag. I, nëntitulli I.1 i këtij punimi

¹⁴ Ligj nr. 103/2014 datë 31.7.2014, “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”, Shtojca C (Kuvendi i RSh 2014)

¹⁵ Bajram Yzeiri, Arjan Selita, Albert Dervishi. “E drejta e Policisë”, faqe 27 (Bajram Yzeiri 2004)

¹⁶ Bilbil Memaj, Hasan Shkëmbi. “Policimi dhe Çështje të Sigurisë” (Bilbil Memaj 2018)

padëshiruara për personat e dëmtuar, deformim në dhënien e drejtësisë, etj.

Si në literaturën juridike shqiptare dhe legjislacionin penal nuk gjejmë një përkufizim për “*sekretin hetimor*”, por vetëm referim të termit në disa dispozita të kodeve përkatëse penale të Republikës së Shqipërisë, nga ku mund të dallojmë këto elementë karakteristike:

- janë aktet dhe veprimet në një *procedimi penal*;
- konsiderohen sekret “*sipas përcaktimeve që bën organi procedues*”;¹⁷
- mbeten të tilla *deri në përfundim të hetimit paraprak*, por edhe më tej kur e

kërkon organi procedues;

- aktet hetimore janë sekrete *derisa i pandehuri të mos ketë marrë dijeni për to*;¹⁸
- edhe pse mund të njihen nga personat e përfshirë në procesin penal, *nuk mund të publikohen pa lejen e prokurorit*;

- zbulimi i tyre *dënohet* me ligj;

- kur përbajnë *fakte “sekret shtetëror”*, trajtohen *sipas rregullave të ligjit përkatës*.¹⁹

Duke krahasuar elementët formal-juridik të përmendur për “*sekretin shtetëror*” me këto të mësipërme për “*sekretin hetimor*”, rezulton një dallim i qartë midis këtyre kategorive të sekretit, duke filluar nga objekti i marrëdhënies së mbrojtur në secilin rast, ku për sekretin shtetëror është mbrojtja e sigurisë kombëtare, ndërsa për sekretin hetimor është ruajtja e fshehtësisë së akteve e veprimeve procedurale hetimore gjatë ndjekjes penale. Gjithashtu dallimi ka të bëjë edhe me mënyrën e administrimit, përdorimit, klasifikimit, deklasifikimit, afatet e ruajtjes, etj. në secilën nga këto kategori, pasi në rastin e sekretit shtetëror kemi rregulla të detajuara të përcaktuara me akte ligjore e nënligjore, ndërsa për sekretin hetimor ato janë të ndërvarura nga vullneti i organit procedues apo afatet procedurale të hetimit dhe gjykimit.

Por me të drejtë lind pyetja se a mund të konsiderohet sekreti hetimor si sekret shtetëror?

Në kuptimin formal-juridik përgjigjja është kategorike negative, pasi ka një dallim të qartë midis këtyre dy lloje të sekretit, që janë të shprehura dukshëm në legjislacionin penal dhe atë për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror në Republikën e Shqipërisë.

Kështu në nenin 160 të Kodit të Pr. Penale, thuhet: “*Nëpunësit shtetërorë, nëpunësit publikë dhe të ngarkuarit me një shërbim publik janë të detyruar të mos dëshmojnë për faktet që janë sekret shtetëror*”²⁰, pra ky i fundit prevalon mbi sekretin hetimor.

Ndërkohë që sipas nenit 161 të këtij kodi, përjashtohen nga ruajtja si *sekret shtetëror* të dhënat ose dokumentet që lidhen me vepra penale, të cilat synojnë përmbyshjen e rendit kushtetues.²¹ Pra në këto raste prevalon e drejta e organit procedues për t’u njohur me informacionin e klasifikuar sekret shtetëror që ka të bëjë me sigurinë kombëtare.

Edhe në Kodin Penal del i qartë dallimi midis këtyre kategorive të sekretit, pasi ato trajtohen në nene më vete, dhe konkretisht nga neni 294 “*Tregimi i sekretit shtetëror nga personi që i është besuar*”²², neni 295 “*Tregimi i sekretit shtetëror nga shtetasit*”²³ dhe neni 295/a “*Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete*”²⁴

¹⁷ Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda. *Procedura Penale, Komentar*, Tiranë 2003, f. 180 (Halim Islami 2003)

¹⁸ Kodi i Pr. Penale, neni 279, pika 1.

¹⁹ Në Ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, neni 1/1 thuhet: “*Ky ligj zbatohet për të gjitha institucionet shtetërore, qendrore ose të varësisë, për organet e drejtësisë, prokurorisë dhe/ose personat juridikë/fizikë, personat me imunitet, kur për ushtrimin e detyrave të tyre duhet të kenë akses në informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”*.”

²⁰ Kodi i Pr. Penale, neni 160, pika 1.

²¹ Po aty, neni 161, pika 1.

²² Kodi Penal i R.Sh., neni 294.

²³ Po aty, neni 295.

²⁴ Po aty, neni 295/a.

Shehaj, B.

« Sekretin hetimor dhe e drejta për informim »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

Ndërsa në legjislacionin për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror, dallimi kuptohet nga përmbajtja e nenit 1/1 të cituar më sipër (Footnote19).

Përgjithësisht rezulton se ka një kuptim dhe zbatim të saktë të ligjit sa i përket trajtimit të çështjeve të lidhura midis sekretit shtetëror dhe sekretit hetimor, por moskuptimi, shkeljet apo abuzimet me trajtimin e sekretit rezultojnë më shpesh kur pretendohet për realizmin ose zbatimin e të drejtës për informim, për mbrojtjen e të dhënave personale, për publikimin e akteve apo të dhënave hetimore, etj.

3. E drejta e informimit dhe sekretit hetimor

3.1 E drejta e informimit

E drejta për informim është një e drejtë themelore e përcaktuar drejtpërsëdrejti nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ku thuhet: “*E drejta e informimit është e garantuar...Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore*”²⁵. Po ashtu kjo e drejtë është e sanksionuar në disa prej kodeve si ai i Procedurës Penale, i Procedurave Administrative, i Punës, etj., si dhe rregullohet me një ligj të veçantë siç është Ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ku përcaktohen në mënyrë të detajuar të drejtat e individit për të marrë informacion nga autoritetet publike, procedurat që ndiqen, detyrimin e autoritetit për të informuar, afatet dhe formën e komunikimit, si dhe ndëshkimet administrative në rast shkelje të parashikimeve në këtë ligj. Në nenin 3 të këtij ligji thuhet: “*Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet...Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.*”²⁶.

Por kjo e drejtë nuk mund të jetë e pakufishme, siç kuptohet apo interpretohet në ndonjë rast, sidomos kur bëhet fjalë për informacione sensitive, pasi, siç e ka të shprehur edhe Kushtetuta, ligji për të drejtën e informimit parashikon kufizime të kësaj të drejte “*në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton...të drejtën për një jetë private; sekretin tregtar; të drejtën e autorit; patentat...sigurinë kombëtare, parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale; mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare ose ndërqeveritare...*”, etj.²⁷

Këto dy kundërshti të shprehura në këtë ligj specifik, por edhe në tërësinë e legjislacionit, shpesh janë objekt konfliktesh midis individëve apo enteve të interesuar për informimin publik me autoritetet shtetërore që kanë detyrimin për të bërë informimin, aq më tepër kur ndonjë herë është e vështirë të ndahet qartësisht e drejta e njëjës palë nga ajo e palës tjetër. Një zgjidhje indirekte, që mund të merret për analogji edhe për raste të tjera, është dhënë nga vetë ligji për të drejtën e informimit, kur për rastet e kërkesës për informim mbi çështje që janë të mbuluara nga sekretit shtetëror autoriteti publik është i detyruar të shqyrtojë nëse informacion i kërkuar ka kaluar kohën e deklasifikimit ose në të kundërt duhet të jap informacion për pjesën e pa mbuluar nga ky sekret.²⁸

Shehaj, B.
« Sekretit
hetimor
dhe e drejta për
informim »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

²⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 23, pika 1 dhe 2. (Kuvendi i RSh 2016).

²⁶ Ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, neni 3, pikat 1 dhe 2. (Kuvendi i RSh 2017).

²⁷ Po aty, neni 17, pikat 1 dhe 2.

²⁸ Po aty, neni 17, pika 5.

Në të njëjtën linjë është shprehur edhe Gjykata e Lartë e Italisë, në një nga vendimet e saj për një çështje konflikti për sekretin hetimor dhe të drejtën e informimit, duke theksuar: “Gjykata... riafirmoi rëndësinë e të drejtës për t’u informuar, por duke qenë se ky aspekt paraqet një garanci paraprake për zbatimin e shtetit demokratik, u theksua domosdoshmëria e fshehtësisë në fushën gjyqësore...”²⁹

Kësaj logjike i përmbahet edhe profesori i të drejtës Penale në Universitetin e Firences, Roberto Bartoli, kur thekson se: “...një ekuilibër mes të drejtës për informim dhe të drejtës për reputacion (mbrojtjen e të dhënave – shën. B. Sh.) mund të arrihet rast pas rasti, pasi çështjet kryesore janë të lidhura me shkeljen e konfidencialitetit, e cila duhet të parandalohet jo vetëm dhe jo aq shumë duke rritur ndëshkimet, por ...duke penguar paqartësinë në marrëdhëniet midis gjyqësorit dhe shtypit. Prandaj, *shtypi duhet të lejohet të ketë qasje të lirë në veprime që nuk mbulohen më nga sekretet...*”³⁰

3.2 Mbrojtja e të dhënave personale

Kjo e drejtë themelore është e njohur në aktet ndërkombëtare mbi të drejtat universale të njeriut, ashtu dhe nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë. Kështu p. sh. në nenin 63 të Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” thuhet: “Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës *mund t’i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij...kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces...*”³¹

Ndërsa, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 35 të saj shprehet: “Askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij... Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.”³²

Edhe ligji specifik³³ në tërësinë e tij garanton të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale, duke dhënë edhe përkufizimin: “*Të dhëna personale* është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social”³⁴. Më tej ligji jep edhe përkufizimin për termin “*përhapje*”, duke e konsideruar si të tillë: “... komunikimi i informacionit për të dhënat personale palëve të papërcaktuara, në çfarëdo forme, edhe përmes vënies në dispozicion ose konsultimit”³⁵.

Nga ana tjetër legjislacioni Shqiptar garanton mbrojtjen e të dhënave personale deri në dënim penal të personave që i përhapin ato³⁶ në mënyrë të paautorizuar ose jo ligjore, veçanërisht gjatë ose dhe pas përfundimit të procesit penal.³⁷

²⁹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 348, datë 20 korrik 1990. (Gjykata Kushtetuese Italiane 1990)

³⁰ Roberto Bartoldi. *Tutela penale del segreto processuale e informazione: per un controllo democratico sul potere giudiziario*. (Bartoli 2017).

³¹ Konventa Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, amenduar me Protokollin nr. 11, neni 63. (Këshilli i Evropës 2010).

³² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 35, pikat 1 dhe 2.

³³ Ligj nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (Kuvendi i RSh 2017).

³⁴ Po aty, neni 3, pika 1.

³⁵ Po aty, neni 3, pika 20.

³⁶ Po aty, neni 39.

³⁷ Kodi i Pr. Penale, neni 104.

3.3 Publikimi i sekretit hetimor

Rastet kur dhe si duhet bërë publikimi i akteve dhe veprimeve të mbuluara nga *sekreti hetimor* janë të shprehura qartësisht në Kodin e Pr. Penale dhe duket se janë unike në legjislacionet procedurale penale të vendeve demokratike, pasi i gjejmë pothuajse identike në kodet e procedurave penale të shumë vendeve të tjera të BE-së e më gjerë.

Kështu në nenin 103 të Kodit të Pr. Penale të Republikës së Shqipërisë, kur flitet për rastet e ndalimit të publikimit të sekretit hetimor, theksohet se:

- ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre *nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv*;

- ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve josekrete *deri në përfundimin e hetimeve paraprake*;

- “ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor *kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura*.

- ndalohet publikimi *i gjeneraliteteve dhe i fotografive së të pandehurve dhe të dëshmitarëve të mitur, të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale*³⁸.

Ky nen është po thuajse identik me nenin 114 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Italisë³⁹ dhe në ngjashmëri me nenin 85 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës⁴⁰.

Nga ana tjetër shkëlja e ndalimit të publikimit dënohet administrativisht⁴¹ dhe penalisht⁴², sa për faktin e zbulimit të sekretit hetimor, ashtu dhe për faktin e përhapjes së të dhënave të mbrojtura personale. Vlen të theksohet gjithashtu se neni 295/a i shtuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, që dënon zbulimin e sekretit hetimor, është i ngjashëm me nenin 379 i Kodit Penal të Republikës së Italisë, i ndryshuar⁴³ dhe nenin 400 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës⁴⁴.

3.4 Mediet dhe sekretit hetimor

Pasi analizuam dy kundërshtitë kryesore që kanë të bëjnë me *të drejtën për informim* dhe *ruajtjen e sekretit hetimor* mund të dallojmë qartë kufirin midis këtyre të drejtave me kahe të kundërt, por me rëndësi të njëjtë në raport me të drejtat themelore të njeriut, në mënyrë që të vendoset një ekuilibër i arsyeshëm në çdo rast të realizimit të tyre në përditshmërinë e zbatimit të ligjit.

Si në rastin e sekretit shtetëror edhe në rastet e aplikimit të sekretit hetimor, legjislacioni në Republikën e Shqipërisë u njeh të drejtën personave fizik ose juridik vendas, të huaj apo pa shtetësi të njihen me: informacionin që prodhojnë ose mbahet nga autoritete publike, “*çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik*”⁴⁵, me përjashtim të disa kufizimeve të përcaktuara

Shehaj, B.
« Sekreti
hetimor
dhe e drejta për
informim »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

³⁸ Kodi i Pr. Penale, neni 103, pikat 1-4.

³⁹ Kodi i Pr. Penale i Republikës së Italisë, i ndryshuar, neni 114. (Republika e Italisë 2018).

⁴⁰ Kodi i Pr. Penale i Republikës së Kosovës, neni 85. (Republika e Kosovës 2012).

⁴¹ Kodi i Pr. Penale, neni 104, pika 1.

⁴² Kodi Penal, nenet 294 – 295/a.

⁴³ Kodi Penal Italian, i ndryshuar, Art. 379-bis. (Republika e Italisë 2018).

⁴⁴ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 400 (Republika e Kosovës 2012).

⁴⁵ Ligji nr. 119/2014 Për të drejtën e informimit, Neni 2, pika 2.

me ligj.

Kjo e drejtë e shtetasve përkthehet në detyrim për çdo organ administrativ, i parashikuar në legjislacionin në fuqi: për procedurat administrative, organet ligjvënese, *gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli*, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj, shoqëri tregtare me pjesëmarrje të shtetit, çdo person fizik apo juridik që i është dhënë e drejta me ligj për të ushtruar funksione publike, etj.

Mediet e shkruara ose elektronike, që kanë për mision informimin e publikut, e shfrytëzojnë në maksimum këtë të drejtë në funksion të linjës së tyre redaksionale, duke bërë publike informacione që, jo rrallë herë, kanë ndikim negativ në procesin penal, sepse kanë të bëjnë me fakte e prova të administruara në një proces hetimi paraprak apo dhe në gjykimin me dyer të mbyllura, duke mos përjashtuar dhe faktin e publikimit të paautorizuar të dhënave personale. Të njëjtën praktikë ndjekin ndonjë herë edhe forcat politike, duke dalë me deklarime publike apo dhënë njoftime për shtyp, që përmbajnë informacione të mbuluara nga sekreti hetimor.

Me të drejtën për informim spekulojnë edhe subjekte të tjera, por në këtë studim u ndalëm tek mediet dhe subjektet politike, pasi publikimet e bëra prej tyre përbëjnë shqetësimin kryesor dhe më ndikues për sa i përket zbulimit të sekretit hetimor. Rasti “Stela” është më flagrant, kur nga publikimi në media i të dhënave identifikuese për një shtetase në rolin e bashkëpunëtores së drejtësisë, gjatë gjurmimit dhe hetimit të një grupi kriminal nga Drejtoria e Policisë Vlorë, erdhi për pasojë vrasja e saj.

Përveç rrezikimit të jetës, shëndetit, dinjitetit dhe pronës së subjekteve pjesëmarrëse në procesin penal, publikimi i akteve apo veprimeve hetimore sjell për pasojë që autorët e dyshuar të marrin masa për të zhdukur provat ligjore, intimiduar ose korrumpuar organet proceduese, largimin e tyre për t’ju fshehur drejtësisë, ndërmarrjen nga ana e tyre e akteve të tjera kriminale, etj.

Por dëmi më i madh i shkaktohet hetimit penal kur ai politizohet me akuza të ndryshme nga subjektet politike, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në cenimin e parimeve “të paanësisë” dhe “prezumimit të pafajësisë” gjatë hetimit paraprak. Mentaliteti i së kaluarës diktatoriale për paragjykimin e veprimtarisë kriminale mbi bazën e dyshimeve, të tipit “*tablo sinoptike*”, është akoma prezent, ndonjëherë tej caqeve të gjykimin të arsyeshëm. Kjo luftë e pandershme kthehet shumë shpejtë në boomerang, pasi demokracia funksionon mbi bazën e parimit të rrotacionit të pushtetit politik. Tipik i tillë është rasti “Balili”, ku forcat politike në vend akuzojnë njëra tjetrën për mbështetjen që i kanë dhënë personit nën hetim, i dyshuar për veprimtari kriminale në trafikimin e drogës.

Në disa raste, në këtë luftë pa principe, përfshihen edhe organet e procedimit, duke zbuluar informacione të hetimit tek persona konfidencial, për të krijuar kredo politike ose mbuluar paafësinë e tyre në zbulimin e të vërtetës. Të tilla veprime janë kryer në të ashtuquajturat çështje: “Habilaj”, “Toyota Yaris”, “Babale”, etj., të kohëve të fundit, ku përfshihen si të dyshuar politikanë të ndryshëm.

Një fakt interesant lidhur me publikimin e sekretit hetimor rezulton edhe nga analiza e statistikave për veprat penale kundër sekretit të referuara në prokurori për tregim apo zbulim të sekretit⁴⁶, ku në periudhën 2010 – 2017 janë regjistruar gjithsej 27 raste, prej të cilave 20 të tilla të parashikuara nga neni 295/a i Kodit të Procedurës Penale (Tabela 1).

Shehaj, B.
« Sekreti
hetimor
dhe e drejta
për informim »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

Tabela 1

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Gjithsej
Neni 294									
Tregimi i sekretit shtetëror nga personi që i është besuar	0	0	0	0	1	0	1	1	3
Neni 295									
Tregimi i sekretit shtetëror nga shtetasit	0	0	0	1	0	0	0	0	1
Neni 295/a									
Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete	1	1	4	2	3	3	4	2	20
Neni 296									
Humbja e dokumenteve sekrete	0	0	0	0	1	0	1	1	3
Total	1	1	4	3	5	3	6	4	27

Këto shifra, dëshmojnë jo vetëm për ndjeshmëri të ulët nga opinioni publik, për t'i denoncuar këto lloj veprash penale, por, mbi të gjitha, për mungesë përgjegjësie nga organet proceduese, duke mos vlerësuar sa duhet rrezikshmërinë dhe duke toleruar njëherësh praninë e shtuar të tyre, edhe pse janë shkaktuar jo pak herë dëme të pariparueshme për procesin hetimor.

Akoma më e zyrtë duket situata, kur në përfundim të hetimit të këtyre veprave penale janë dërguar për gjykim vetëm 3 të pandehur, nga të cilët vetëm 2 për zbulim të akteve ose të dhënave sekrete (Tabela 2).

Tabela 2

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Gjithsej
Tregimi i sekretit shtetëror nga personi që i është besuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Tregimi i sekretit shtetëror nga shtetasit	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete	0	0	0	0	1	0	1	0	2
Humbja e dokumenteve sekrete	0	0	0	0	0	0	1	0	1
Total	0	0	0	0	1	0	2	0	3

Mendimi jonë është se në të gjitha rastet kur konstatohet publikimi pa autorizimin e organeve proceduese i akteve të mbuluara nga sekretet hetimor, por dhe në tërësi i atyre të grumbulluara gjatë fazës së hetimit paraprak, përbën detyrim për këto organe që t'i referojnë apo regjistrojnë si vepra penale me iniciativë, pasi janë krime që ndiqen kryesisht. Ky është detyrim ligjor i pa ekuivok, i shprehur shumë qartë në nenin 103 i Kodit të Procedurës Penale (faqe 10, seksioni II.3) dhe nenin 295/a i Kodit Penal, zbatimi i të cilëve duhet bërë edhe për efekt të parandalimit të këtyre veprave penale.

Për të pasur një lidhje sa më harmonike midis nenit 103 i Kodit të Pr. Penale dhe

nenit 295/a i Kodit Penal, si nga përmbajtja e dispozitave përkatëse ashtu dhe për një kuptim më të drejtpërdrejtë në zbatim të tyre, mendojmë se ligjvënësi duhet të kishte marrë në konsideratë faktin e “*ndalimit të publikimit*”, siç shprehet neni 103 i Kodit të Pr. Penale, edhe në paragrafin e katërt të nenit 295/a i Kodit Penal, ku parashikohet zbulimi i akteve nga “*persona të tjerë që kanë dijeni për të dhëna për procedimin penal*”. Janë pikërisht këta persona që përgjithësisht bëjnë publikimin e akteve apo të dhënave të hetimit, duke spekuluar me faktin se në vijim të përmbajtjes së këtij paragrafi përfshihet klauzola “*...që janë paralajmëruar nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore për moszbulimin e tyre...*”.

Ky kusht bie ndesh me ndalimin e parashikuar nga neni 103 i Kodit të Pr. Penale, që nuk i jep asnjë të drejtë organit procedues të paralajmëroi, lejoj apo ndaloj moszbulimin e akteve. Prandaj, në rregullimet e mundshme që mund t’i bëhen këtij neni (295/a i KP), duhet hequr klauzola e mësipërme, pasi prania e saj mbingarkon organet e procedimit me detyrime të panevojshme dhe i lë shteg abuzimit me të drejtën e informimit nga persona të tretë që publikojnë akte ose të dhëna nga hetimi. P. sh. një zgjidhje e përshtatshme do të ishte riformulimi i këtij paragrafi në ngjashmëri me paragrafin e tretë të po këtij neni.

4. Përfundime

Në sintezë të këtij punimi mund të dalim në disa përfundime me interes jo vetëm nga ana studimore, por edhe për nevoja të përmirësimit të akteve ligjore në këtë fushë, si dhe zbatimin e tyre nga organet e procedimit penal apo më gjerë.

Në vlerësimin e këtij studimi, si përkufizimi dhe sqarimi i dhënë për sekretin shtetëror në ligjin përkatës nuk janë të plotë ose jo shumë të qartë, pasi termi i referohet informacionit të klasifikuar për “*mbrojtjen e pavarësisë*”, “*integritetit territorial*”, “*rendit kushtetues*” dhe “*marrëdhëniet me jashtë*”, duke e ngushtuar sferën e veprimit vetëm në këto fusha, për të cilat nuk gjejmë një përkufizim të saktë teorik ose juridik.

Në legjislacionin penal shqiptar, përveç termit sekret shtetëror ndeshim gjithashtu termat “*sekret hetimor*” dhe “*sekret profesional*”, për të cilët nuk jepet ndonjë shpjegim, përkufizim apo sqarim, por edhe në ligjin për informacionin e klasifikuar.

Në Ligjin nr. 8839, datë 22.11.2001, “Për grumbullimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar policor”, ende në fuqi, rezulton se: “*Informacioni i klasifikuar policor cilësohet “sekret profesional” ...*”, kur ndryshe kuptohet termi “*sekret profesional*” nga përmbajtja e nenit 159 të Kodit të Pr. Penale, gjë që sjell pështjellim dhe paqartësi për organet ligjzbatuese.

Duhet të ketë një lidhje më harmonike midis nenit 103 i Kodit të Pr. Penale dhe nenit 295/a i Kodit Penal, si nga përmbajtja e dispozitave përkatëse ashtu dhe për një kuptim më të drejtpërdrejtë në zbatim të tyre sa i përket termit “*ndalim të publikimit*” i akteve apo të dhënave sekret hetimor.

Nga mediet dhe në deklaratimet e subjekteve politike ndodh që publikohen, jo vetëm të dhëna nga aktet apo veprimet procedurale gjatë hetimit paraprak, por edhe vetë aktet e administruara, duke mos marrë në konsideratë sekretin hetimor, prezumimin e pafajësisë dhe ndalimin e publikimit nga Kodi i Pr. Penale.

Konstatohet mefshtësi dhe pasivitet nga organet e procedimit kur ndeshen me raste të publikimit të akteve e veprimeve procedurale, që ndalohen të publikohen gjatë hetimit paraprak, kur dihet se ato përbëjnë vepra penale që ndiqen kryesisht.

Shehaj, B.
« Sekreti hetimor dhe e drejta për informim »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

5. Rekomandime

Nisur dhe bazuar në përfundimet e mësipërme, mund të sugjerojmë edhe disa rekomandime, si vijon:

Së pari, ligji për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror duhet rishikuar sa i takon termit “*sigurim kombëtar*”, pasi ky term jo vetëm nuk përshtatet me ndërtimin morfologjik të konceptit “*siguri kombëtare*”, por ndërkohë është objekt i një akti tjetër normativ specifik që bën rregullimin në tërësi e kompleks të veprimtarisë në fushën e sigurisë kombëtare, siç është ligji për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare⁴⁷.

Së dyti, është e nevojshme që në rastin më të parë të ndryshimeve ligjore në ligjin për informacionin e klasifikuar ose ligjin për Policinë e Shtetit të shprehet qartë në një dispozitë më vete shfuqizimi i Ligjit nr. 8839, datë 22.11.2001, “Për grumbullimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar policor”, si dhe klasifikimi i këtij lloji informacioni si sekret shtetëror.

Së treti, duhet organizuar një fushatë e gjerë me të gjitha format e edukimit masiv për kuptimin, rëndësinë dhe zbatimin e sekretit hetimor nga të gjithë subjektet e procedimit penal, por veçanërisht përfaqësuesit e medieve dhe subjekteve politike, në kuadër të veprimtarive për mbrojtjen e të drejtave themelore, siç janë ato për prezumimin e pafajësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Së katërti, organet e procedimit duhet të referojnë apo fillojnë menjëherë çështjen penale për çdo rast flagrant i publikimit të akteve e veprimeve procedural në kundërshtim me parashikimet e neneve 103 dhe 279 të Kodit të Procedurës Penale.

Së pesti, në rast ndryshimesh në Kodin Penal, nga ligjvënësi duhet marrë në konsideratë riformulimi i paragrafit të katërt i nenit aktual 295/a në ngjashmëri me paragrafin e tretë të këtij neni, ku parashikohet direkt referimi tek neni 103 i Kodit të Pr. Penale, si dhe duke hequr kushtin e paralajmërimit të personave të tretë nga organi procedues.

⁴⁷ Ligj nr. 103/2014 datë 31.7.2014, Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë

Bibliografi

1. Akademia e Shkencave e RSh. *Fjalor i shqipes se sotme*. Bot. i dytë i ripun. Tiranë: TOENA, 2002.
2. Bajram Yzeiri, Arjan Selita, Albert Dervishi. *E drejta e Policisë*. Tiranë: Akademia e Policisë "Arben Zylyftari", 2004.
3. Bartoli, Roberto. *Tutela penale del segreto processuale e informazione: per un controllo democratico sul potere giudiziario*. Diritto Penale Contemporaneo, 3 2017.
4. Bilbil Memaj, Hasan Shkëmbi. *Pollicimi dhe Çështje të Sigurisë*. Tiranë: Geer, 2018.
5. Gjykata Kushtetuese Italiane. *Vendimi Nr. 348/1990*. 1 Gusht 1990. <https://www.cortecostituzionale.it/actionSchedaPronuncia.do?anno=1990&numero=348> (qasja Nëntor 06, 2018).
6. Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda. *Procedura Penale, Komentar*. Tiranë: Morava, 2003.
7. Këshilli i Evropës. *Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore*. Qendra e Botimeve Zyrtare. Qershor 2010. <http://www.qbz.gov.al/botime/Permledhese%20e%20akteve%20nderkombetare%20per%20Drejtisine.html> (qasja Nëntor 12, 2018).
8. Kuvendi i RSh. *Kodi i Procedures Penale*. Vers. i ndryshuar. Qendra e Botimeve Zyrtare. 2018. <http://www.qbz.gov.al/Kode/Kodi%20i%20Proc.Penale-2018.pdf> (qasja Tetor 15, 2018).
9. —. *Kodi Penal*. Vers. i ndryshuar. Qendra e Botimeve Zyrtare. 2018. <http://www.qbz.gov.al/Kode/Kodi%20Penal-2017.pdf> (qasja Tetor 15, 2018).
10. —. *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*. Vers. i përditësuar. Qendra e Botimeve Zyrtare. Gusht 2016. <http://www.qbz.gov.al/Kushtetuta%20me%20pjese/Kushtetuta-2017.pdf> (qasja 17 Tetor, 2018).
11. —. *Ligj nr. 103/2014 Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë*. Qendra e Botimeve Zyrtare. 1 Shtator 2014. http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/137-2014.pdf (qasja Tetor 19, 2018).
12. —. *Ligj nr. 8457, datë 11.2.1999, Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"*. Qendra e Botimeve Zyrtare. Tetor 2017. <http://www.qbz.gov.al/botime/Permledhese%20per%20informimin.pdf> (qasja Tetor 19, 2018).
13. —. *Ligj nr. 9887, datë 10.03.2008, Për mbrojtjen e të dhënave personale*. Qendra e Botimeve Zyrtare. Tetor 2017. <http://www.qbz.gov.al/botime/Permledhese%20per%20informimin.pdf> (qasja Tetor 19, 2018).
14. —. *Ligj nr. 119/2014, Për të drejtën e informimit*. Qendra e Botimeve Zyrtare. Tetor 2017. <http://www.qbz.gov.al/botime/Permledhese%20per%20informimin.pdf> (qasja Tetor 18, 2018).
15. —. *Ligj nr. 8839, datë 22.11.2001, Për grumbullimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar policor*. 22 Nëntor 2001. http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2001/PDF-2001/57-2001.pdf (qasja Tetor 28, 2018).
16. Ministri i Brendshëm. *Udhëzim Nr. 56/1 "Për përdorimin e burimeve të informacionit, marrjen, administrimin, verifikimin dhe vlerësimin e të dhënave"*. Tiranë: Ministria e Brendshme, 27 Maj 2013.
17. Oxford University. *Oxford Dictionaries*. 2018. <https://en.oxforddictionaries.com/definition/secret> (qasja Tetor 20, 2018).
18. Prokuroria e Përgjithshme. *Raporte të Prokurorit të Përgjithshëm*. vjetorë, Tiranë: Prokuroria e Përgjithshme, 2010-2017.
19. Republika e Italisë. *Codice di Procedura Penale*. Vers. i ndryshuar. Altalex. 30 Tetor 2018. <http://www.altalex.com/documents/news/2013/11/12/atti-disposizioni-generalis> (qasja Tetor 31, 2018).
20. —. *Codice Penale*. Vers. i ndryshuar. Altalex. 26 Tetor 2018. <http://www.altalex.com/documents/news/2014/09/30/dei-delitti-contro-l-amministrazione-della-giustizia> (qasja Tetor 31, 2018).
21. Republika e Kosovës. *KODI NR. 04/L-082 KODI PENAL*. Gazeta Zyrtare Nr.19. 13 Korrik 2012. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2834> (qasja Tetor 29, 2018).
22. —. *KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURES PENALE*. Gazeta Zyrtare Nr. 37. 28 Dhjetor 2012. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2861> (qasja Tetor 31, 2018).

Shehaj, B.
« Sekreti
hetimor
dhe e drejta
për informim »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

Armët e lehta të zjarrit



■ **Prof. Asc. Dr. Qetsor ORHAN***
qetsor.orhan@asp.gov.al
Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit

Abstrakt

Fillesat e lindjes së armëve të zjarrit dhe karakteristikat e evoluimit të tyre, përbëjnë objektin kryesor të këtij punimi nëpërmjet të cilit mund të nxirren përfundime shumë të rëndësishme mbi investigimin e karakteristikave specifike të armëve të zjarrit në periudha të ndryshme të historisë. Lindja e armëve të zjarrit është e lidhur me lindjen e barutit që siç dihet e ka origjinën nga Kina e largët gjatë shekullit të 9-të. Baruti kinez u transportua më pas në Lindjen e Mesme, Afrikë dhe prej andej erdhi në Evropë. Armët e zjarrit në vendin tonë janë përdorur gjerësisht, por sipas studiuësit Riza Drishti, në gjysmën e dytë të shekullit të XIV dhe konkretisht në vitin 1364 u dukën për të parën herë armët e zjarrit të dorës, të cilat më vonë do të quhen armët e këmbësorisë¹.

Studiuësit e forenzikës janë vazhdimisht duke u përpjekur për të dhënë më të mirën për procesin gjyqësor dhe si të tillë kanë nevojë për baza të fuqishme dhe të besueshme të njohurive brenda disiplinave të tyre të ndryshme. Njohja e armëve të vjetra të cilat vazhdojnë të qarkullojnë ende sot në forma nga më të ndryshmet do të jetë një burim i vlefshëm për punonjësit e policisë të cilët merren me hetimin duke ndihmuar sadopak në thellimin e njohurive të këtij karakteri.

Fjalëkyçe:

armët e lehta të zjarrit, evoluimi i armëve të zjarrit, pushkë, pistoletë, vjaska.

Orhani, Q.
« Armët
e lehta
të zjarrit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

56

*Përgjegjës i departamentit të formimit të përgjithshëm & Juridik
¹ Riza Drishti. *Armët dhe armëtarët shqiptarë*. Tiranë 1976, faqe 24.

1. Hyrje

Sipas të dhënave të shumta nga autorë të ndryshëm mendohet se paraardhësi i drejtpërdrejtë i armës së zjarrit është *ushta e zjarrit*. Prototipi i ushtës së zjarrit u zbulua në Kinë gjatë shekullit të 10-të e cila është paraardhësi i të gjitha llojeve të armëve të zjarrit. Pamja më e hershme e njohur e një armë me barut është ilustrimi i një zjarri në një flamur mëndafshi në mesin e shekullit të 10-të nga Dunhuang në vitin 1132 (Figura 1.a).



Figura 1. a) Heshtë/Ushtë zjarri. shekulli i 10-të. b) Skulpturë e shekullit XII. c) Harta e Provincës Sichuan.

Po kështu në një skulpturë në një shpellë në Sichuan, shfaqet një armë e hershme që daton në shekullin e 12-të, të një figure kineze që mbante një bombardier me flakë dhe një gjyle që dilte prej tij (Figura 1.b).

Gjithashtu ka teori të tjera që tregojnë se baruti erdhi në Evropë nëpërmjet Rrugës së Mëndafshit përmes Lindjes së Mesme, ashtu sikurse ekziston edhe një teori tjetër që

Orhani, Q.
« Armët
e lehta
të zjarrit »

Polici
dhe
Siguria
nr.14, 2019

baruti u soll në Evropë gjatë pushtimit mongol në gjysmën e parë të shekullit të 13-të rreth vitit 1340².

Në vendin tonë po të mbështetemi në të dhënat që disponohen për përdorimin e armëve të zjarrit nga principatat feudalo-shqiptare dhe shkëmbimin reciprok në mes mjeshtrëve zejtarë, sidomos gjatë shekujve XII, XIII, XIV, kryesisht në Raguza të Dubrovnikut, nga Gjergj Balsha i Shkodrës, del se baruti me tym edhe tek ne është përdorur në armët e zjarrit nga mesi i shekullit të XIV.³

Zeja e punimit të barutit në vendin tonë u përhap shpejt, Mati me fshatrat e tij mbeten qendra më e madhe e prodhimit të barutit, pavarësisht se më vonë filloi të prodhohej barut edhe në qytetin e Shkodrës e të Janinës, sepse Mati ka qenë prapavija më e vjetër e qendrës shqiptare, ku prodhohej baruti i zi, që nga shekulli i XV dhe deri në vitin 1939.

Sipas studiuesve lloji më i hershëm i armës së zjarrit ka qenë thjesht një “*top i vogël*” prej hekuri ose bronzi i punuar, i vendosur në një bazament metalik ose prej lëkure. Këto armë u vendosën nga pjesa fundore e një tyte të mbushur me pluhur, e cila komunikonte nëpërmjet një vrime të vogël në pjesën e poshtme të tytës, e quajtur si vrima e kontaktit, ndezja e së cilës realizohej me një hekur të nxehtë apo duke e ndezur atë me mjete të tjera, e cila më pas si rezultat i presionit të krijuar fluturonte ngarkesën kryesore të pluhurit, me të cilin mbushej tyta, duke krijuar kështu armën e parë të zjarrit.

Realizimi i ndezjes nëpërmjet një mekanizmi të thjeshtë, ishte me të vërtetë përparimi i parë më i madh në ndërtimin e pistoletës të së ardhmes, pasi kjo mundëonte arritjen e synimit për konsolidimin e armëve të zjarrit.

Tek *musketi* që u shfaq si një armë e lehtë e paviaskuar në Evropën e shekullit të 16-të, (mendohet në Spanjë) fillimisht si një variant i rëndë i *arkabusit*, i aftë për të depërtuar karocatat e rënda, shohim një mekanizëm shkrepjeje më të sigurt i cili në forma më të avancuara ka shoqëruar deri në ditët tona armët e lehta, armë e cila sipas të dhënave kronikale dhe relatorëve të ndryshëm është shfaqur edhe në vendin tonë në shek. XVII, kryesisht në pjesën veriore të vendit.

Me lindjen e armëve të strallit të cilat vazhduan të përdoren për pothuajse 200 vjet derisa nga viti 1807 ministri skocez, Alexander John Forsyth, revolucionarizoi ndezjen e barutit duke përdorur një kompleks shumë të ndjeshëm me përbërjen e fulminantit të zhivës i cili si rezultat i goditjes realizonte shpërthimin dhe ndezjen e sigurt të mbushjes së barutit.

Në ekspozitën e madhe të hapur në Londër në vitin 1851 nga Lefauchaux, kemi prodhimin e parë të fishekut, një nga armët më të hershme që përdori një fishek të vetëm ishte “*arma e zogjve*”, në të cilin raketa dhe astari u mbajtën së bashku në një kuti ose këllëf tunxhi.

Arma “Dreyze” ishte një pushkë ushtarake me gjilpërë, e njohur si arma kryesore e këmbësorisë e ushtrisë Prusiane, të cilët e pranuan atë për shërbim në 1841 si modeli prusian “Dreyze” 1848⁴. Ajo ishte pushka e parë që përdori veprimin e shkarkimit të gazrave për të hapur dhe mbyllur dhomën e fishekut në mënyrë mekanike dhe që u fut gradualisht në shërbimin prusian, pastaj më vonë në forcat ushtarake të shumë shteteve

Orhani, Q.

« Armët
e lehta
të zjarrit »

Polici
dhe
Siguria

nr.14, 2019

58

² Wikipedia. History of the firearm; <https://www.americanfirearms.org/gun-history/>

³ Idriz Ajeti. *Konferenca e II-të e Studimeve Albanologjike*. Tiranë 1969, vëllimi 3, f. 117-118.

⁴ Brian J. Heard *Handbook of Firearms and Ballistics: Second Edition* 2008. Faqe 9.

të tjera gjermane.

Pak kohë para vitit 1855, Smith dhe Wesson prodhuan revolverin e parë për të cilët përdorën fishekun i cili ishte i kalibrit 0.22" (inch) i montuar me mentesha e cila mundësonte që mulliri i saj të hiqej gjatë ngarkimit dhe shkarkimit të armës. Edhe pse një hap i madh përpara, ai ishte i përshtatshëm vetëm për armët me presion të lartë dhe kalibër të vogël, pasi për kalibrat më të mëdhenj se 0.22 inç, ka rezultuar në dështime.

Sistemi qendror i zjarrit, ishte një moment historik i madh në zhvillimin e armëve dhe municioneve. Në qendër të municionit, vetëm kupën e gjilpërës duhej të ishte mjaft e butë për t'u grisur nga kunji. Gëzhoja në këtë mënyrë mund të bëhej nga një material më substancial i cili do të vepronte si një tub gazi për presione shumë më të larta sesa mund të arrihej me municionet e armëve.

Sipas konsullit anglez, pranë Ali Pashës, W. Leake⁵, shkruan R. Drishti, se "Armëtarët shqiptarë kishin famë për mjeshtërinë e tyre edhe jashtë kufijve të Shqipërisë, po kështu sipas tij edhe në atë të Bushatllinjve në Shkodër, ka pasur punishte për prodhimin e plotë të pushkëve dhe pistoletave".

2. Evolimi i armëve të zjarrit

Përdorimi i "topit të dorës" si armë kalorësie u shfaq në 1449 në dorëshkrimet e Marianus Jacobus. Ku tregohet një ushtar me një armë të tillë, të montuar në një pirun të bashkangjitur në pjesën e sipërme të shalës.⁶ Ajo që është interesante të theksohet ka të bëjë me përdorimin e shiritit të shalës prej të cilit mund të ketë prejardhjen origjina e fjalës "pistoletë", pasi fjala e hershme e kalorësisë për këtë pjesë të shalës quhej "pistallo" (Figura 2.c.).

Për herë të parë përmendja e armëve të zjarrit në Rusi është gjetur në kronikën "Sofijski vremennik", ku thuhet se gjatë mbrojtjes së Moskës 1382 nga Hordhia e Artë e Tokhtamyshit, moskovitët përdorën armë zjarri të quajtura *tyufyaki* (òþîÿèè), të cilat ishin me origjinë lindore; kjo fjalë rrjedh nga gjuha turke tufak⁷.



Figura 2. a) Pamje e vjetër e topit të dorës, nga "Belli Fortis", b) Top i dorës nga dinastia Yuan kineze (1271-1368). c) Skicë e hershme e "topit të dorës"

Këto armë të hershme mund të konsideroheshin pak a shumë si armë psikologjike, por duke qenë shumë të ngadalta dhe shumë të vështira për tu përdorur, sidomos po t'i shtojmë kësaj edhe efektet e motit të keq si, shiun ose lagështirën, të cilat kishin një efekt shumë negativ në ruajtjen e mbushjes dhe duke e bërë kështu të pamundur ndezjen dhe

⁵ Riza Drishti. *Armët dhe armëtarët shqiptarë*. Tiranë 1976, faqe 31.

⁶ Shënim: Skica është marrë nga Brian J. Heard *Handbook of Firearms and Ballistics: Second Edition* 2008.

⁷ Wikipedia. *History of the firearm*. "Firearms in Russia".

përdorimin e saj.

Një lloj tjetër i armëve të zjarrit ndër më të vjetrat e mbijetuar deri më sot, është “topi i dorës” nga dinastia kineze, Yuan (1271-1368)⁸ (Figura 2.b.).

Përdorimi i tyre i parë është vështirë të konstatohet me siguri, por sipas studjuesit britanik Brian J. Heard një numër i vogël i rasteve janë raportuar në Spanjë midis 1247 dhe 1311, ashtu sikurse ka të dhëna të tjera të përdorimit të topave të dorës në qytetin belg të Ghent-it, si dhe në Gjermani në 1313. Një nga ilustrimet më të hershme në lidhje me përdorimi i “topave të dorës” shfaqet në një afresk të shekullit të XIV në Palazzo Publico, Sienna, Itali⁹ (Figura 2.a.).

Proporcioni i nitratis të potasit u rrit për të maksimalizuar fuqinë shpërthyesë. Për t'i bërë ballë më mirë kësaj force shpërthyesë, letra dhe bambuja prej të cilave u bënë fillimisht tytat e armëve të zjarrit u zëvendësuan me metal. Në këtë periudhë u shfaqën tri tiparet themelore të armës: tyta prej metali, baruti me nitratis të lartë dhe predha që tërësisht mbyll grykën e zjarrit, në mënyrë që ngarkesa me barut të ushtrojë potencialin e saj të plotë.

Rreth fundit të shekullit të 14-të në Itali, u krijuan armët (topat e dorës) më të vogla dhe portative me dorë ose *schioffi*, duke krijuar kështu efektin e parë të armëve personale të zjarrit. Në fund të shekullit të 15-të, Perandoria Osmane përdori armë zjarri si pjesë e këmbësorisë së saj të rregullt.

Realizimi i ndezjes nëpërmjet ndezësit ishte saktësisht i njëjtë me “topin e dorës” me të vetmin ndryshim që, një pjesë e mbushjes do të përdoret për të ndezur ngarkesën e mbushjes së barutit, e cila u mbajt në një formë të lakuar në anën e kornizës, ose në formën e gjarprit siç quhej ndryshe.




Figura 3. a) Skica e montimit të ndezësit. b) Musket gjerman me “serpentin lock”.

Ky mekanizëm i thjeshtë është realizuar dhe është regjistruar gjatë epokës së Henryt të VIII-të, i cili mbretëroi nga viti 1509 deri në vitin 1547, e cila u shfaq gjatë betejave nga kalorësia e tij të cilët ishin të armatosur shumë me armë të tilla, armë e cila është e shfaqur në Kullën e Londrës.¹⁰ E meta kryesore e kësaj arme ishte se gjatë ndeshjes ajo kërkonte një proces të ngadaltë, ndezje pas ndezje si rezultat, ajo ishte pak e përdorshme për sulmin e papritur ose në kushte me lagështirë ose me shi (Figura 3.a).

Musketi i parë erdhi si një variant i “matchlock”, i cili u zhvillua në Evropë rreth vitit 1475. Arkabus u përdor në raportet relativisht të larta në Hungari nën mbretin Matthias Corvinus (1458-1490). Nga mesi i shekullit të 16-të, ky lloj i musketit doli jashtë përdorimit pasi lindën forca të rënda të blinduara të cilat e përballonin më së miri forcën e tij, kështu që musketi u hoq nga përdorimi në shekullin e 19-të, duke u quajtur

⁸ Wikipedia. *History of the firearm*

⁹ Brian J. Heard *Handbook of Firearms and Ballistics*: Second Edition 2008.

¹⁰ Brian J. Heard *Handbook of Firearms and Ballistics*: Second Edition 2008, faqe 3.

pushkë në terminologjinë moderne, të cilat përdornin fishekët e armëve të zjarrit, të futur nga Casimir Lefauchaux në 1835.




Figura 5. a) Pamja e një musketeri nga Jacob van Gheyn's. (1608) b) Modeli Springfield 1861. c) pushka Musket 1863.

Arma me strall (Flintlock) avancoi sistemin e ndezjes në një mekanizëm të thjeshtë i cili siguronte një shkëndijë duke goditur një copë stralli me pjatën e çelikut. Guri i strallit mbahej në nofullat e një rrahësi të vogël i cili godiste fort pllakën e çelikut, (shih figurën 6.a) si rezultat i saj krijohej një tufë shkëndijash të cilat binin mbi mbushjen duke shkaktuar ndezjen e pluhurit ndezës i cili përmes vrimës së kontaktit depërtonte brenda, duke ndezur kështu ngarkesën kryesore dhe shkarkimin e armës.

Ashtu sikurse në shumicën e sistemeve të armëve, është shumë e vështirë për të identifikuar një datë të saktë për futjen e këtij sistemi, por ka mendime se është përdorur në mes të shekullit të gjashtëmbëdhjetë deri në fillim të shekullit të shtatëmbëdhjetë, bazuar kjo sipas një patente për revolverët e lëshuar në vitin 1661¹¹ (Figura 6).




Figura 6. a) Çarku ose arma e strallit. b) Prodhim suedez mes shekulli të XVII. c) Pushkatar me musket me "Flintlock" në Mali.

Revolucionarizimi i ndezjes së barutit çoi në krijimin e fulminantit të zhivës, e cila kur goditet nga një çekiç, prodhon një shkëndijë të fortë të mjaftueshme për të ndezur ngarkesën kryesore të pluhurit në tytë¹² (Figura 7).

¹¹ Brian J. Heard Handbook of Firearms and Ballistics: Second Edition 2008, faqe 6.

¹² Brian J. Heard Handbook of Firearms and Ballistics: Second Edition 2008. Faqe 6.

Orhani, Q.
« Armët
e lehta
të zjarrit»

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

Me këtë shpikje, u krijuan bazat e nevojshme për lindjen e fishekut. Pasi ky lloj i ndezjes mori pak kohë për të përsosur mënyrat e aplikimit të saj. Nga 1807 deri në 1814, janë shpikur një gamë e gjerë sistemesh për aplikimin e goditjeve dhe për sistemin e mbushjeve, duke përfshirë nga shishet e parfumit, pilulat, tubat deri tek kapakët e letrës.



Figura 7. a) Sistemi i kapakëve të goditjes. b) Pistoletë me "Flintlock"

Forma e fundit në formën e kupës goditëse u pretendua nga një numër i madh shpikësish por, (sipas autorit Brian J. Heard) ndoshta i atribuohet Joshua Shaw, një anglo-amerikan që jetoi në Philadelphia në 1814¹³.

Në këtë sistem, kupa e goditjes ishte brenda kutisë së fishekëve ndërsa një kunj, i cili mbështetej në kupën e goditjeve, u vendos në anën e fishekut. Goditja e kunjit me çekanin e armës e çoi atë tek mbushja e përbërë duke shkaktuar shpërthimin e saj dhe kështu ajo ndizte ngarkesën kryesore (Figura 8).

Kjo armë ishte ndër më të njohurat e saj, midis viteve 1890 dhe 1910 dhe ishte akoma në përdorim në Evropë deri në vitin 1940, sigurisht me pëlqimin e Anglisë nga 1914 duke qenë pothuajse të paarritshme deri në vitin 1935¹⁴.




Figura 8. a) Sistemi i veprimit të kunjit. b) Sistemi Rimfire.

Ndërsa sistemi i mësipërm ishte një hap i rëndësishëm përpara, ai kishte një numër të metash, jo pak prej të cilave kishin të bënin me tendencën e mos shkarkimit nëse kunji kishte defekte.

Pushka e zjarrit "Dreyze" përdori fishekun i cili përfaqësonte një kasetë të vetme që përmbante plumbin, kapakun dhe mbushjen e barutit të zi. Plumbi, i cili ishte i mbyllur brenda kutisë së letrës, kishte kapsollën të lidhur me fundin e tij. Pjesa fundore e letrës ishte mbështjellë duke i lidhur të gjitha së bashku. Para se gjilpëra të mund të godasë kapsollën, ajo duhej të kalonte më përpara përmes barutit dhe të godiste kapsollën. Vendosjeje e kapsollës mbrapa kishte për qëllim që të jepte djegie më të plotë të mbushjes. Për fat të keq, kjo çonte në dëmtime të rënda të gjilpërës, e cila pastaj bëhej e pa përdorshme duke e bërë pushkën të padobishme. Megjithatë, kjo ishte një hap i madh

¹³ Brian J. Heard *Handbook of Firearms and Ballistics*: Second Edition 2008. Faqe 7.

¹⁴ Brian J. Heard *Handbook of Firearms and Ballistics*: Second Edition 2008. Faqe 7.

përpara në prodhimin e pushkës moderne (Figura 9.a).

Data e saktë për shpikjen e kësaj arme zjarri është e vështirë të konstatohet, megjithëse ekziston një patentë e lëshuar në vitin 1861 prej qendrës Daws (Figura 9.b).




Figura 9. a) Sistemi i zjarrit Dreyse gjilpërë. b) Sistemi qendror i zjarrit. c) Viaskat e armëve.

Ndoshta asnjë shpikje e lidhur me armët e zjarrit nuk ka ndikuar aq shumë në parimet e zhvillimit të armëve të zjarrit, se sa prodhimi i fishekëve qendrorë. Edhe pse i shpikur rreth vitit 1860, parimet janë ende të njëjta dhe përdoren në çdo lloj arme zjarri nga pistoletat më të vogël e deri tek armët me kalibër më të madh të artillerisë.

Lindja e viaskave, të cilat i japin një rrotullim stabilizues plumbit, duke e mbajtur atë gjatë gjithë trajektos në një drejtim dhe që zvogëlojnë çdo tendencë që ai të largohet nga linja e drejtë e fluturimit, përbën padyshim një ngjarje shumë të rëndësishme në evolucionin e armëve të zjarrit (Figura 9.c).

Disa studiues caktojnë shpikjen e tytës me vjaska në Gaspard Kollner, një punishte e Vjenës, në shekullin e XIV. Të tjerë përcaktojnë vitin 1520 dhe ja atribuojnë atë Augustus Kotter të Nurembergut.

Armët gjermane që mbajnë stemën e perandorit Maksimilian i I-rë dhe që u prodhuan midis 1450 dhe 1500 kanë viaska spirale dhe janë në fakt armët më të hershme të identifikuar¹⁵.

Forma e kanalit gjithashtu ndryshon katrore e rrumbullakët, trekëndore, me shtiza dhe madje edhe në formë presje që hasen. Numri aktual i kanaleve duket të ketë më pak efekt krahasuar me efektin stabilizues të viaskave.

Greener në 1835 prodhoi plumbin e parë të shtrirë, pjesa e pasme e të cilit përmbante një fish çeliku.

Në 1854, Whitworth mori patentën e sistemit të parë shumëkëndor në shpimin e tytës, i cili tejkaloi shumicën e problemeve dhe ishte jashtëzakonisht i saktë.

Revolveri është një armë me një bllok rrotullues që përmban një numër cilindrash të qitjes, që mund të rreshtohen vazhdimisht dhe të shkarkohen përmes një gryke të vetme zjarri.

Samuel Colt ose Colt, pavarësisht pretendimeve të tij për shpikjen e revolverit, nuk është autori i shpikjes së tij, pasi format më të hershme të revolverit datojnë qysh në kohë e Mbretit Charles I, para vitit 1650, ashtu sikurse kemi edhe një armë tjetër edhe më të hershme e prodhuar gjatë mbretërimit të Henrit të VIII disa kohë para vitit 1547¹⁶.

Patenta origjinale e Coltit, e datuar 1835, trajtoi rrotullimin e bllokut të cilindrave,

¹⁵ Brian J. Heard *Handbook of Firearms and Ballistics*: Second Edition 2008. Faqe 11.

¹⁶ Brian J. Heard *Handbook of Firearms and Ballistics*: Second Edition 2008. Faqe 15.

Orhani, Q.
« Armët
e lehta
të zjarrit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

por që ishte shumë produktive në treg, derisa patentat origjinale u zhvilluan më 1850. (Figura 11.a.) Pas kësaj, tregu ishte i hapur me Dean-Adams në 1851, Beaumont në 1855 dhe Starr dhe Savage në 1865, të gjithë duke sjellë dizajnë të rinj.

Një mori ndryshimesh ndoqën dizajnët e Smith, Wesson dhe Colt, por pak ka ndryshuar që atëherë në të vërtetë mekanizmi bazë i revolverit, përveç pamjeve të përmirësuara, metalet më të mira të cilat lejojnë presione më të larta, duket se pak mund të bëhet për të përmirësuar efikasitetin e planeve themelore të Smith-Wesson dhe Colt.




Figura 11. a) Revolveri Colt. b) Pistoleta vetëmbushëse (Colt 1911 model A1).

Pistoleta vetëmbushëse. Parimi i pistoletës vetëmbushëse ishte hedhur shumë kohë më parë, është raportuar në historinë e Birche të Shoqërisë Mbretërore në vitin 1664 se një mekanik kishte pasur një pretendim për të realizuar një pistoletë që mund “të xhironte shpejt dhe të ndalonte sipas dëshirës”.

Dizajni i parë i suksesshëm komercial ishte nga një amerikan, Hugo Borchardt. Në pamundësi për të financuar dizajnin e tij, ai e mori atë në Gjermani për ta prodhuar atje. Ishte ky dizajn i cili u modifikua pak nga Luger për t’u bërë pistoletë e parë ushtarake vetëmbushëse në Gjermani¹⁷.

Në 1893, Bergman prodhoi një numër të tërë të pistoletave, njëra prej të cilave në vitin 1897, 8mm “Simplex”, është me interes të veçantë pasi fisheku u bë 0,32” fishek pistolette automatike (ACP).

Më 1898, fabrika gjermane e DWM (Deutsche Waffen - and Munitionsfabriken) solli modelin e parë të pistoletit të famshëm Luger në kalibrin 7.65 mm “Parabellum”, e cila në vitin 1904, u bë e disponueshme edhe në 9 mm, si kalibër i miratuar për pistoletat e shërbimit gjerman.

Në 1897, John Browning, më i madhi nga të gjithë arkitektët e armëve të vogla amerikane,

prodhoi patentën e tij të parë e cila u prezantua si Modeli 1900 Colt 0.38” automatik.

Llojet e pistoletave. Ekziston një konfuzion i jashtëzakonshëm për sa i përket emërtimit të pistoletave si; pistoletë, revolver, pistoletë vetëmbushëse, pistoletë automatike, sipas funksionimit dhe përdorimit ato i klasifikojmë në tri lloje themelore: pistoletë me një goditje të vetme, pistoletë rrotulluese dhe vetëmbushëse.

Pistoleta me një goditje të vetme. Shumica dërrmuese e pistoletave të vetme janë 0,22” LR (kalibër të gjatë) dhe janë të destinuara për përdorim të synuar. Në përgjithësi,

¹⁷ Brian J. Heard *Handbook of Firearms and Ballistics: Second Edition* 2008. Faqe 16.

tyta është varur në kornizë me disa mekanizma të mbylljes për ta mbajtur atë në vend gjatë kohës së mbylljes. Për zhbllokimin, e tytës rrotullohet (ulët) poshtë duke lejuar që gëzhoja e zbrazët të dalë dhe të freskohet me fishekun e radhës.

Pistoleta rrotulluese. Në një pistoletë rrotulluese ose revolver, municioni mbahet në një cilindër në pjesën e pasme, fundore të tytës, ku çdo fishek ka dhomën e vet. Tërheqja e çekanit rrotullon cilindrin nëpërmjet një mekanizmi, për të sjellë fishekun e ri në linjë me tytën. Tërheqja e këmbëzës pastaj lëshon çekiçin i cili godet kapsollën e fishekut. Një nga llojet më të hershme të pistoletës rrotulluese vetëmbushëse me një gjuajtje të vetme, e cila përdor këtë lloj mekanizmi është Modeli Single Action Colt i 1873¹⁸ (Figura 13).

Pistoleta vetëmbushëse. Në këtë lloj arme, municioni gjendet në një depo (krehër) me një sustë të lëvizshme të vendosur brenda kornizës së saj. Tyta e armës është e rrethuar nga një rrëshqitës me një bllok të integruar që mbahet në folenë e fishekut, në pjesën e prapme të tytës nga një sustë e fortë. Tërheqja prapa e saj lejon fishekun e radhës të futet në pjesën e pasme të folesë së fishekut. Ky veprim gjithashtu ngre mekanizmin e shkrehjes. Në fund të lëvizjes së tij mbrapa, susta e lëvizshme shkon përpara duke mbyllur një cikël të plotë, ndërsa në pjesën e pasme të tytës e furnizon atë gati për qitje (Figura 14).

Meqë veprimi është vetëm vetëmbushës, presioni mbi këmbëzën e shkrepjes duhet të hiqet dhe pastaj të ri-tërhiqet për të vazhduar një raund tjetër.

Pushkët. Mekanizmat e pushkëve mund të grupohen në mënyrë të përafërt në: pushkë me një të shtënë të vetme, pushkë me mekanizëm të shulit, pushkë vetëmbushëse dhe pushkë me mekanizëm pompimi (pushkë me ajër).

Pushkë me një të shtënë të vetme. Në një armë, tyta mund të vendoset në një skelet, duke lejuar që tyta gjatë rënies poshtë realizon ngarkimin dhe shkarkimin, ose mund të ketë një formë të folesë së fishekut e cila gjatë tërheqjes ose rrëshqitjes poshtë ekspozon fundin e folesë së fishekut.

Pushkë me mekanizmin e shulit. Në armët me shul, kemi rrëshqitjen dhe rrotullimin e shulit deri në pjesën fundore më të zgjeruar të tytës, i cili në thelb është i njëjti parim si në një shul të përdorur për të kyçur një derë. Shtytja e shulit përpara sjell përputhjen e shulit me folenë e fishekut në fundin e tytës dhe realizon goditjen e kunjit. Rrotullimi i shulit e mbyll plotësisht atë duke mos lejuar kthimin mbrapa (Figura 15.a).

Pushkë me mekanizëm pompimi (pushkë me ajër). Në pushkët me presion ajri, blloku i goditjes është i bashkangjitur, nëpërmjet shufrave drejtuese, në një ballë të lëvizshëm. Gjatë tërheqjes mbrapa pjesa e përparme, mekanizmi i mbylljes së bllokut goditës në tytë është i lëshuar.





Figura 15. a) Pushkë me mekanizëm shuli. b) Pushkë me mekanizëm pompimi (pushkë me ajër).

¹⁸ Brian J. Heard *Handbook of Firearms and Ballistics*: Second Edition 2008. Faqe 20.

Duke tërhequr pjesën e përparme në shtrirjen më të thellë të udhëtimit të saj, pastaj duke e shtyrë atë përpara, shtyhet fisheku i zbrazët (gëzhoja) dhe një fishek i ri futet në dhomë dhe mekanizmi është i ngrëhur (Figura 15.b).

Armët e gjahut. Mekanizmat tek armët e gjahut janë në thelb të ngjashme me ato të pushkëve, me një të shtënë të vetme, me mekanizëm të shulit, vetëmbushëse dhe pushkë me mekanizëm pompimi (pushkë me ajër). Tytat mund të pozicionohen mbi njëra tjetrën, ose përkrah njëra tjetrës.

Në kalibrat më të vegjël, domethënë 0.22 “9 - mm dhe 0.410”, herë pas here ndeshen pistoletat të dyfishtë. Kombinimet pushkë/armë gjahu janë të njohura në Evropë dhe mund të përbëhen nga një tytë arme gjahu dhe një tytë pushke (stërvitje/manovre), dy tyta armë me një tytë pushke (stërvitje/manovre) ose dy tyta pushkë dhe një tytë armë gjahu (gjithashtu i quajtur edhe stërvitje).



Figurë 16. Armë gjahu me mbivendosje.

3. Historiku i armëve të zjarrit në Shqipëri

Armët e zjarrit në Shqipëri kanë qenë të lidhura kryesisht me prodhimin e lëndëve të para sidomos me prodhimin e barutit me tym dhe nxjerrja dhe përpunimi në vend i hekurit, bakrit, plumbit, arit dhe argjendit.

Përdorim mjaft të gjerë për kohën marrin armët e zjarrit sidomos në ushtrinë e Skënderbeut, kështu në rrethimin e pare të Krujës në maj të viti 1450, brenda kalasë ku mbroheshin shqiptarët nën komandën e Vrana Kontit, kishte 30 topa të vegjël dhe pushkë me fitil (skiopets) për një pjesë të madhe të garnizonit¹⁹. Sipas Marin Barletit, pushkët e përdorura nga shqiptarët në ushtrinë e Skënderbeut quheshin me termat e kohës në gjuhën latine; *sklopus*, nga venedikasin *skiopets*, nga spanjollët *eskopetes* dhe rusët *pishçal*.

Sipas të dhënave kronikale dhe relatorëve të ndryshëm të cilët informojnë se në shek. XVII populli që banonte në pjesën veriore të vendit, ishte i armatosur me *arkebuza* (Figura 17.a).

Kështu p.sh. udhëtari turk i shek. XVII, E. Çelebia kumton se në Kurvelesh kryengritësit shqiptarë (rreth 20 000 veta), ishin të pajisur me pushkë me fitil²⁰.

Sipas të dhënave që disponon Arkivi Historik Shtetëror i Tiranës, ekzistojnë tre kodikët e esnafit të punimit të kasave (kondakçinjve të Elbasanit) të viteve 1696, 1709

Orhani, Q.
« Armët
e lehta
të zjarrit »

Polici
dhe
Siguria
nr.14, 2019

¹⁹ F. S. Noli, *Vepër e cituar* faqe 44.

²⁰ Riza Drishti, *Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike* 28 - 30 Qershor 1976, Tiranë, 1977.

dhe 1799; si dhe statuti i armëtarëve (dyfekçinjve) të këtij qyteti, i cili i përket vitit 1854.




Figura 17. a) Skicë e arkebuzit shek. XVII. b) Karafilja shqiptare. Shek. XVIII

Në armatimin personal, qoftë të ushtarit të ushtrive feudale shqiptare, apo të çdo banori të armatosur, në shek. XVII-XIX, bënin pjesë: pushka e gjatë (karafilja figura 17.b.) ose pushka e shkurtër (karabina) dy pistoleta (kobure), jatagani, dy vezme, vajmbajtësja, thupra (harbia) dhe brezi i mbajtjes së armëve (silahu). Pushka e gjatë shqiptare, e cila prodhohej e zbukurohej edhe në vend, nga autorët turq quhej: «karafilja me çarik e gur stralli e tipit shqiptar» (*Arnaud gari çabmaelli karanfil tufenki*), ndërsa tek shumë autorë të tjerë të huaj e gjejmë të emërtuar thjesht «arnautka» apo «paftalia»²¹.

Kjo armë, në fakt, ka qenë përmirësimi i mëtejshëm i pushkës me fitil, i mushketës dhe i arkebuzit, të përdorura në vendin tonë gjatë shek. XV-XVII. Me spikatjen e çarkut me goditje dhe gur stralli, rreth vitit 1630, pushka e gjatë filloi dhe vazhdoi të prodhohej nga armëtarët shqiptarë gjatë shek. XVII-XIX. Po kështu Sami Frashëri, duke shkruar për Elbasanin theksonte se brenda në qytet punoheshin tytat e pushkëve, të cilat pëlqeheshin shumë nga shqiptarët.

Armët shqiptare, për shtresat e pasura, zbukuroheshin nga argjendarët të cilët, jo vetëm zbukuronin tërësisht kasën e armës, por edhe punonin e zbukuronin vezmen, vajmbajtësen dhe, më vonë, thuprën metalike.

Karakteristikat dalluese të pushkës shqiptare ishin këto: gjatësia nga 2.7 m. deri 2.31 m. Më vonë nga 1.97 m, deri në 1.47 m. Pesha arrin te nga 3.5 në 2.5 kg. Fyelli i tytës ishte i lëmuar. Mbushja bëhej nga gryka. Pesha e barutit të prodhuar në vend (Mat) afërsisht ishte 25 gram dhe mbështillej në një fishek prej letre. Predha prej plumbi ishte e rrumbullakët dhe peshonte rreth 50 gram. Kalibri në fillim ishte mbi 20 mm. e pastaj u zvogëlua deri në 17 e më vonë në 13 mm., por këto asnjëherë nuk kanë qenë të njëllojta. Shpejtësia praktike e qitjes arrinte nga një e shtënë në 2 minuta deri në dy të shtëna në minutë. Largësia më e madhe e hedhjes së plumbit arrinte nga 300-600 hapa (nga 213-426 metra)²². Çmimi i një pushke të gjatë në Elbasan në shek. XIX lëkundej nga 500-1000 grosh.

Krahas pushkëve të gjata rreth vitit 1875, arma që fitoi popullaritet të madh në vendin tone ishte *huta* ose *martina*. Ajo ka qenë një nga llojet e para të pushkëve me mbushje nga pjesa e pasme e tytës, me një fishek metalik. Përdorim dhe prodhim të gjerë ajo mori sidomos në kohën e Lidhjes së Prizrenit (1878 -1881) dhe pas saj. Nga autorë të ndryshëm ajo njihet me emra të ndryshme si: *huta* shqiptare e Elbasanit, e Tetovës, e Prizrenit dhe e Gjakovës, në vartësi nga vendi ku punohej.

Huta kishte këto karakteristika: gjatësia nga 1.3 m. deri në 1.24 m., pesha 4.1 kg., kalibri 11.43 mm., pesha e plumbit 31.1 gram; shpejtësia fillestare e plumbit 416 m. sek.

²¹ Riza Drishti, Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike 28 - 30 Qershor 1976, Tiranë, 1977.

²² Riza Drishti, Po aty, Tiranë, 1977.

Orhani, Q.
« Armët
e lehta
të zjarrit »

Policiimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

Largësia më e madhe e hedhjes së plumbit arrinte deri 1200 hapa (852 metra). Mekanizimi i shkrepjes i përkiste sistemit të bllokut të shulit, i cili ulej poshtë me dorë, me anën e një leve²³.




Figura 20. Huta e Elbasanit dhe e Tetovës Shek. XIX

Përveç armëve të krahut u punuan edhe u zbukuruan në vend disa lloje të armëve të brezit, pistoleta (kobure) të njohura me emërtime të ndryshme si: calina, tapanxha, kalemtushe, verdha, gjarpnusha, karbresha, lezhjane, latune Dibre, serme etj.

Sipas autorit Riza Drishti në Konferencën Kombëtare të Studimeve Etnografike, Zija Shkodra, në librin «Esnafët shqiptarë» shkruan se në Prizren, nga mesi i shek. XIX, prodhoheshin afro 27 pistoleta në ditë, të cilat gjenin shitje jo vetëm në tregun ballkanik, por deri në tregjet më largëta të Azisë së Vogël, të Persisë dhe të Egjiptit.²⁴

4. Shenjat e provës

Shenjat e provës janë shenja, pulla, stampa, që aplikohen në pjesë të ndryshme të një arme gjatë dhe pas prodhimit për të treguar se arma është e sigurt për t'iu përdorur me municionin për të cilin është projektuar.

Në Angli, në Londër dhe Birmingham firmat e provës u krijuan (respektivisht në 1637 dhe 1813,) nga Royal Charter për të mbrojtur publikun nga shitja e armëve të pasigurta. Një numër vendesh të tjera si; Austria, Belgjika, Kili, Çekosllovakia, Finlanda, Franca, Gjermania, Hungaria, Italia, Republika e Irlandës, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar kanë krijuar edhe firmat e tyre të provës dhe me marrëveshje në nivel konsullor janë marrë masa reciproke për të pranuar reciprokisht shenjat e tyre të provës²⁵.

Ekzistojnë gjithashtu një numër vendesh që kanë një sistem të veçantë klasifikimi ushtarak për armët e shërbimit, të cilat gjithashtu nuk pranohen nga firmat evropiane të provave komerciale. Prandaj, armët që mbajnë shenjat ushtarake të provave duhet të jenë të provuara komercialisht përpara se ato të mund të shiten ligjërisht në ato vende.

Ekzistojnë në thelb tri lloje provash: prova provizore, prova përfundimtare dhe riprovimi.

- *Prova e përkohshme*; është vetëm për armët e gjahut në fazat e hershme të prodhimit. Ky lloj i provës është projektuar për të parandaluar prodhuesit nga puna e vazhdueshme në boshllëqet e tytave të cilat mund të kenë defekte të fshehura të padukshme.

- *Prova përfundimtare*; zbatohet për të gjitha armët dhe tregon se arma është testuar me një mbingarkesë të caktuar. Në përgjithësi, kjo kërkon një trysni prej 30 deri në 50% më të madhe se standardi i municioneve.

Orhani, Q.
« Armët
e lehta
të zjarrit »

Polici
dhe
Siguria
nr.14, 2019

68

²³ Riza Drishti, Po aty, Tiranë, 1977

²⁴ Riza Drishti, Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike 28 - 30 Qershor 1976, Tiranë, 1977

²⁵ Brian J. Heard Handbook of Firearms and Ballistics: Second Edition 2008. Faqe 32.

- *Riprovimi*; është një test shtesë që mund të zbatohet në një farë mënyre pas një riparimi ose ndryshimi të armës.

Shenjat e provës mund të jenë një ndihmë shumë e vlefshme për hetuesit e armëve të zjarrit, pasi ato mund të japin informacion për moshën, historinë dhe vendin e origjinës së një arme.

Shumë vende kanë specifika të veçanta nga legjislacioni i armëve, për armët 'antike' që konsiderohen të tilla mbi 100vjeçare.

Për të komplikuar më tej çështjen, janë prodhuar riprodhime moderne të disa prej armëve të vjetra, të cilat shpesh janë pothuajse të padallueshme nga origjinalet. Në këto raste, e vetmja shenjë e provës është metoda e saktë e përcaktimit të datës së prodhimit të riprodhimit të një arme.

5. Përfundime

1. Armët e zjarrit të prodhuara në vendin tonë kanë ndjekur të njëjtin rritëm me vendet e tjera, duke nxjerrë më në pah karakterin e shqiptarit si armëdashës, i cili i ka prodhuar dhe përdorur ato vetëm për mbrojtjen e vendit të vet.

2. Shenjat e provës mund të jenë një ndihmë shumë e vlefshme për hetuesit e armëve të zjarrit, pasi ato mund të japin informacion për moshën, historinë dhe vendin e origjinës së një arme.

3. Duke ndjekur evoluimin e armëve të zjarrit shohim se që të gjitha pa përjashtim bazohen mbi parimin bazë, të shfrytëzimit të energjisë që çlirohet nga djegia e mbushjes së saj.

4. Njohja e armëve është e lidhur ngushtë me karakteristikat kryesore të përdorimit të tyre duke shmangur ngjarjet e jashtëzakonshme që mund të lindin si rezultat i mosnjohjes së tyre.

Referenca

1. Brian J. Heard, (2008) *Handbook of Firearms and Ballistics*. Printed in Singapore by Markono Print Media Pte Ltd.
2. Blackmore, H. (1965) *Guns of the World*, Batsford Press, London.
3. Blair, C. (1968) *Pistols of the World*, Batsford Press, London.
4. Hoyem, G. A. (1981) *History and Development of Small Arms Ammunition*, I – III, Armory Press, Missoula, MT, USA.
5. HMSO (1929) *Textbook of Small Arms*, His Majesty's Stationery Office, London.
6. Mathews, J. H. (1962) *Firearms Identification*, I, II & III, University of Wisconsin Press, Madison.
7. Smith, W. H. B. (1968) *Book of Pistols and Rifles*, Castle Books, New Jersey. (1970) *Book of Rifles*, Castle Books, New Jersey.
8. Riza Drishti, *Armët dhe armëtarët e shqiptarëve*. Tiranë 1976.
9. Zija Shkodra, *Esnafët shqiptarë*, Tiranë 1973, faqe 58.
10. *Historia e Shqipërisë*, vëllimi I, Tiranë, 1959, f. 403-404, vëll. II, Tiranë 1965, f. 53-55)

Orhani, Q.
« Armët
e lehta
të zjarrit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

Falsifikimi i dokumenteve cenon funksionimin normal të institucioneve shtetërore dhe publike



■ **MSc. Osman QYSTRË**
osman.qystri@asp.gov.al
Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Abstrakt

Përfundimi se falsifikimi i dokumenteve zyrtare cenon funksionimin normal të institucioneve publike dhe private, ka zënë vend kudo në administratë. Me qëllim thellimin e luftës kundër krimit të organizuar, garantimin e performancës së lartë në gjurmimin dhe hetimin e veprave penale të falsifikimit të dokumenteve; përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë gjumuese dhe hetimore; rritjen e integritetit të strukturave policore në luftën kundër krimit, bazuar në filozofinë e parandalimit të krimit nëpërmjet policimit të orientuar nga inteligjenca dhe informacioni kriminal; krijimin e një kulturë bashkëkohore të menaxhimit policor të çështjes; ndërtimin e partneritetit të vazhdueshëm të strukturave ligj zbatuese, organeve të drejtësisë dhe faktorëve të tjerë publikë dhe privat në zbulimin, dokumentimin dhe goditjen e autorëve të veprave penale të falsifikimit përben një kërkesë në rritje. Analiza dhe studimi i veprave penale të "falsifikimit të dokumenteve", vjen si detyrim ndaj rritjes së vazhdueshme të këtyre krimeve; intensifikimit të veprimtarisë së krimit të organizuar edhe në fushën e falsifikimit të dokumenteve zyrtare; riaktivizimit të vazhdueshëm të grupeve kriminale me precedentë penalë në sferën e falsifikimeve. Ato janë refleksion i ndryshimeve të bëra në mesin e vitit 2017, në Kodin e Procedurës Penale¹; i reformimit dhe ristrukturimit të strukturave policore të luftës kundër krimit të organizuar Maj 2017. Ndërsa vetingu në organet e drejtësisë dhe strukturat e Policisë së Shtetit, krijimi i SPAK, BKH, organizimit të task forcë dhe strukturave qendrore dhe vendore të hetimit e bëjnë të domosdoshëm analizën e thelluar dhe studimin e specializuar të këtij krimi.

Fjalëkyçe:

falsifikimi i dokumenteve, statistikat zyrtare, evidentimi dhe zbulimi i falsifikimeve, autorët pjesëmarrës.

Qystrë, O.
« Falsifikimi i dokumenteve cenon funksionimin normal të institucioneve shtetërore dhe publike »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

1. Evoluimi i veprave penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare në vitet 1994-2017

Në vështrim të situatës kriminale në vend dhe sidomos veprave penale të krimit ekonomik dhe financiar konstatojmë se krimi i falsifikimit të dokumenteve, ashtu si dhe krimi i organizuar shqiptar shoqëroi ndryshimin dhe zëvendësimin e sistemit totalitar me atë pluralist dhe demokratik. Nga njëra dekadë në tjetrën, krimi i falsifikimit të dokumenteve shënoi vetëm rritje, ndonjëherë edhe tej kufijve normalë. Si pasojë e nevojës së “tregut kriminal” për dokumente false, grupet kriminale që janë specializuar e perfeksionuar në falsifikime, intensifikuan veprimtarinë e tyre keqbërëse, përsosën format dhe metodat dhe shfrytëzuan më së miri arritjet e teknologjisë dhe globalizmit. Në vitin 1994 shënoheshin ___ vepra penale në fushën e krimit ekonomik dhe financiar, ndërsa në vitin 2017 u regjistruan 719 vepra penale, vetëm në fushën e falsifikimit të dokumenteve.

Disa nga faktorët që ndikuan në rritjen e vazhdueshme të krimeve të falsifikimit të dokumenteve mendojmë se janë:

- Kalimi nga një politikë e ashpër penale në diktaturë, në një politikë të brishtë penale në demokraci, mbi të gjitha lëvizja e lirë e njerëzve nga një vend i izoluar drejt vendeve me demokraci të konsoliduar, u duk sikur i dha hapësirë elementëve keqbërës me këtë tendencë të rrezikshme kriminale. Hapësirat e lëna bosh gjatë riorganizimit të institucioneve shtetërore, para hartimit të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale

¹ Ligji nr 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (miratuar me datë 30.3.2017, hyrë në fuqi me datë 01.08.2017).

Barjami, XH.

« Falsifikimi i dokumenteve cenon funksionimin normal të institucioneve shtetërore dhe publike »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

në vitin 1995, bënë që të lulëzonin grupet kriminale që merreshin me veprimtari keqbërëse në fushën e falsifikimit të dokumenteve.

-Institucionet shtetërore të dobëta në formim dhe ndryshim të vazhdueshëm, me nëpunës me edukim dhe përvojë të pamjaftueshme; me infrastrukturë të pakët, me paga të ulëta, me mjete teknike minimale, që nuk i përgjigjen me forcën e duhur veprimtarisë kriminale ishin dhe mbetën shtigje që ia lehtësuan veprimin në shkelje të ligjit, kontingjenteve të këtij lloj krimi.

-Kriza ekonomike shqiptare, tranzicioni i gjatë, e shoqëruar me nivel të lartë papunësie, shkallë të lartë in-formaliteti, migrim i paligjshëm (kërkesat e vazhdueshme për azil në perëndim), moszbatimi i rregullave bazë në hyrje-dalje në territorin e Republikës së Shqipërisë e kanë favorizuar këtë lloj krimi.

-Zhvillimi i jashtëzakonshëm i teknologjisë dhe globalizimi i ekonomisë i kanë dhënë forcë lirisë së lëvizjes, qarkullimit të mallrave, ideve dhe projekteve, për pasojë kanë intensifikuar përdorimin e teknologjisë nga strukturat e krimit të organizuar, për falsifikimin e dokumenteve, fitimi nga të cilat është i konsiderueshëm.

- Pandëshkueshmëria ose dënimi minimal nga organet e drejtësisë, krijuan hapësira të nevojshme dhe ia lehtësuan punën strukturave kriminale për të zhvilluar veprimtarinë e tyre keqbërëse në përmasat që ka marrë sot.

- Korrupsioni i organeve të drejtësisë; pagat e ulët e strukturave të Policisë së Shtetit në përgjithësi, ndonjëherë dhe mungesa e vullnetit institucional për ta goditur këtë lloj krimi; ndryshimi i vazhdueshëm i strukturave policore që merren me gjurmimin dhe hetimin e këtyre veprave penale; mungesa e besimit të komunitetit tek institucionet ligjzbatuese, janë një shteg prej ku përfitohet nga strukturat kriminale në falsifikimin dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuara.

- Ndryshimet e vazhdueshme të strukturave kundër krimit ekonomik dhe financiar, lëvizjet e pareshura të specialistëve të gjurmimit dhe hetimit, niveli i pamjaftueshëm profesional i specialistëve të saj, ndonjëherë dhe mosplotësimi i organikave ndikojnë jo pak në evidentimin dhe zbulimin e këtyre krimeve.

- Mashtrimet në fushën e taksave dhe të doganave, realizuar nga kompani fiktive të regjistruara me dokumente identiteti të rreme, përgjithësisht vjedhur ose falsifikuar, të cilat hyjnë në tregti dhe “zhduken” ose “falimentojnë” kur vjen koha e pagimit të taksave, janë nxitje për krimin e organizuar, që ta shtrijnë aktivitetin e tyre kriminal edhe në fushën e falsifikimit të dokumenteve.

Si në Evropën Juglindore, edhe në Shqipëri besohet se krimi ekonomik, mes tyre edhe falsifikimi i dokumenteve përbën një kërcënim serioz për ekonominë dhe shoqërinë tonë, për funksionimin normal të administratës shtetërore apo publike. Këto lloj veprash penale cenojnë marrëdhënie juridike të caktuara, që lidhen me funksionimin normal të shtetit dhe administratës së tij të sistemit arsimor; të sistemit shëndetësor; procesin e lëshimit apo përdorimit të kartave të identitetit, pasaportave, vizave nga organet e caktuara shtetërore ose private; saktësinë e plotësimit dhe përdorimit të akteve të gjendjes civile nga punonjësit e saj, etj. Gjurmët e falsifikimit duken kudo, në të gjitha fushat e veprimtarisë shtetërore dhe shoqërore, aq sa nga komuniteti i gjerë perceptohet si fenomen ose si dukuri me përmasa të paimagjinueshme, nga më të përhapurat në këto tre dekada të fundit, prej të cilave rrezikohemi jo pak si shoqëri.

Në veprimtarinë kriminale të falsifikimit të dokumenteve, ndikojnë dhe një serë faktorësh specifikë, më së shumti ekonomikë dhe socialë, por dhe administrativë e

teknikë që hera-herës dominojnë ambientin shqiptar, në stade të caktuara të zhvillimit të shoqërisë, e “sëmurë” në segmente të caktuara të saj.

- Papunësia, një nga plagët më të rënda të kësaj shoqërie, ndikon më së shumti, jo vetëm në gjetjen e rrugëve dhe mundësive për të lëvizur me dokumente false, drejt vendeve me mundësi punësimi por dhe shtigje kriminaliteti. Nga autorët e veprave penale të falsifikimit të dokumenteve në dhjetë vite, 62.9% e tyre ishin të papunë, ose të paktën përkohësisht të papunë. Papunësia, shoqëruar me nivelin e ulët ekonomik, pagat minimale në ndërmarrjet publike apo private, janë nxitje, kërkesë, “nevojë” edhe për këtë lloj krimi.

- Arsimi i pamjaftueshëm e nxit individin e paformuar të kërkojë e realizojë rrugë të lehta, për të siguruar të ardhura. Nga 1954 autorë falsifikimesh ose 31% e tyre ishin me arsim fillor dhe tetëvjeçar, gati një e treta e tyre. Niveli i ulët arsimor, shoqëruar me punët e “rëndomta” që ata kryejnë, e bëjnë këtë kategori personash të bien më lehtë në grackën e grupeve kriminale të falsifikimit. Prej nga nisin kalvarin e gjatë të trafikimit, emigrimit të paligjshëm dhe kërkesave për azil në vendet perëndimore.

- Mentaliteti tolerues në shumë ambiente të shoqërisë sonë. Ku më shumë e ku më pak ka hedhur rrënjë mendimi, ideja, praktika se falsifikimi i dokumenteve, ndihmon individë të caktuar, me gjendje të dobët ekonomike, të realizojnë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e jetës së tyre, prandaj institucionet ligj zbatuese duhet ti tolerojnë. Sipas tyre, asnjë dëm nuk i vjen shtetit shqiptar, nga individë që me dokumente false, si certifikata personale e familjare; diploma arsimore; pasaporta biometrike; leje drejtimi mjeti, kombëtare dhe ndërkombëtare; raporte dhe epikriza mjekësore; vërtetime banimi, “prova” gjakmarrje, të dhëna personaliteti, emigrojnë jashtë vendit, ku sistemohen me punë e banim dhe përmirësojnë jetën e tyre dhe familjarëve.

- Bashkëpunimi i dobët mes strukturave policore dhe organeve të drejtësisë si dhe mos funksionimit si duhet e sistemit të menaxhimit të çështjes, janë një mur i ngritur dhe që pengon jo pak luftën kundër krimit të organizuar, trafikut dhe migracionit të paligjshëm.

- Bashkëveprimi i pamjaftueshëm mes agjencive të zbatimit të ligjit; institucione të pa konsoliduar që në mënyrë të vazhdueshme i nënshtrohen reformimit; janë një dritare edhe për zhvillimin e aktivitetit kriminal të falsifikimit të dokumenteve zyrtare.

- Koordinimi i përciptë i veprimtarisë gjurmuese dhe hetimore, mes strukturave vendore dhe qendrore të policisë ia ka lehtësuar veprimin kriminal kontingjenteve më tendencë falsifikimi i dokumenteve zyrtare.

2. Statistikat krimit të falsifikimit të dokumenteve zyrtare në vitet 2008-2017, analiza e elementëve të tyre kryesorë

Gjatë dhjetëvjeçarit 2008-2017, në shkallë vendi kanë ndodhur 5647 vepra penale të falsifikimit të dokumenteve, nga të cilat janë zbuluar 5361 ose rreth 95.0% e tyre. Kjo tregon se niveli i veprimtarisë gjurmuese dhe hetimore të strukturave të krimit ekonomik e financiar, në vende dhe në qendër ka arritur nivele të konsiderueshme zbulueshmërie, si rezultat edhe i menaxhimit e drejtimit më profesional të këtyre strukturave, në hierarkinë e tyre.

Barjami, XH.

« Falsifikimi i dokumenteve cenon funksionimin normal të institucioneve shtetërore dhe publike »

Policimi dhe Siguria nr.14, 2019


a-Për çdo vit të dhjetëvjeçarit të fundit, veprat penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare në tersi, në mënyrë tabelore dhe grafike paraqiten si më poshtë:

Viti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	SHUM
V. P. Evide.	691	440	389	622	622	481	439	517	727	719	5647
V. P. Zbulu.	686	434	386	600	572	459	422	484	680	638	5361
Zbulu %	99.3	98.6	99.2	96.5	91.9	95.4	96.1	93.6	93.5	88.7	95.0
% VP e Vitit/Shumës	12.2	07.8	06.9	11.0	11.0	08.5	07.8	09.1	12.9	12.7	

Nga një vështrim i jashtëm i evidentimit dhe zbulimit të veprave penale të falsifikimit të dokumenteve në këto dhjetë vite rezultojnë disa pamje të saj, që reflektohen me kurbë që herë ulet dhe herë ngrihet. Herë ulet numri i veprave penale, por rritet zbulimi i tyre; herë ngrihet numri i veprave penale, por ulet zbulimi i tyre. Po ta specifikojmë këtë gjendja paraqitet e tillë: në vitin 2008, nga 691 falsifikime të evidentuara, u zbuluan 686 prej tyre, ose 99.3%; në vitin 2009 nga 440 falsifikime, u zbuluan 434 e tyre ose 98.6%; në vitin 2010 nga 389 falsifikime, u zbuluan 386 e tyre ose 99.2%; në vitin 2011 nga 622 falsifikime, u zbuluan 600 prej tyre ose 96.5%; në vitin 2012 nga 622 falsifikime, u zbuluan 572 e tyre ose 91.9%; në vitin 2013 nga 481 falsifikime, u zbuluan 459 e tyre ose 95.8%; në vitin 2014 nga 439 falsifikime, u zbuluan 422 e tyre ose 96.1%; në vitin 2015 nga 517 falsifikime, u zbuluan 484 e tyre ose 93.6%; në vitin 2016 nga 727 falsifikime, u zbuluan 680 e tyre ose 93.5 %; në vitin 2017 nga 719 falsifikime, u zbuluan 638 e tyre, ose 88.7%.

Po ti analizojmë sasinë e falsifikimeve të ndodhura dhe përqindjen e zbulimit të tyre për çdo vit të dhjetëvjeçarit rezulton se gjatë vitit 2010 janë evidentuar 389 falsifikime, numri më i vogël i veprave penale të ndodhura në harkun e një viti, ndërsa gjatë vitit 2016 janë evidentuar 727 falsifikime, sasia më e madhe e këtyre krimeve ndodhur gjatë një viti. Kjo ka ardhur edhe nga puna e kujdesshme që kanë bërë strukturat kundër krimit ekonomik e financiar për evidentimin, gjurmimin dhe hetimin e krimeve të falsifikimit. Gjatë vitit 2008 janë zbuluar 99.3% e veprave penale të evidentuara, që përbën nivelin më të lartë të zbulimit të krimeve, ndërkohë që gjatë vitit 2017 janë zbuluar vetëm 88.7% e tyre, e kjo përbën nivelin më të ulët të zbulimit të krimeve. Ndërsa gjatë viteve të tjera zbulimi i krimeve vërtitet nga 91.3%-99.2%.

b- Sipas llojit, veprat penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare për periudhën dhjetëvjeçare, në mënyrë tabelore dhe grafike paraqiten si më poshtë:



Vështrimi grafik dhe statistikor na çon në përfundimin se falsifikimi i dokumenteve, parashikuar nga neni 186 i K.P., zë numrin më të madh të këtyre krimeve të ndodhura në dhjetëvjeçarin e fundit, plot 2755 ose 48.9 % e tyre; falsifikimi i dokumenteve të identifikimit, pasaportave dhe vizave, parashikuar nga neni 189 i K.P., fiks 1158 ose 20.5 % e të evidentuarave në dhjetë vite; falsifikimi i akteve të gjendjes civile, parashikuar nga neni 191 i K.P, janë evidentuar 901 ose 16 % e të evidentuarave në një dekadë; falsifikim i vulave, stampave dhe formularëve, parashikuar nga neni 190 i K.P. janë evidentuar 559 ose rreth 10 % e veprave penale të evidentuara në vitet 2008-2017.

Ndërkohë që falsifikimi i dokumenteve të shëndetit, të dokumenteve shkollorë, prodhimi i mjeteve për falsifikim, parashikuar nga nenet 187, 188, 192 të K.P. zënë një vend të vogël, që arrijnë rreth 4% veprave penale të evidentuara në 10 vite. Por nisur nga perceptimin i publikut, sidomos për këto vepra penale, arrijmë në përfundimin se falsifikimi i dokumenteve shkollorë dhe shëndetësorë, si dhe prodhimi i mjeteve për falsifikim nuk paraqesin realitetin.

Numri i regjistruar në statistikat tona, nuk i përgjigjet situatës kriminale në vend. Bazuar edhe vetëm në hetimet, ndalimet, arrestimet dhe dënimet që realizojnë dhe japin strukturat homologe apo autoritetet e drejtësisë penale, në vendet fqinjë dhe më përtej tyre, tregon se këto vepra penale janë më të shumta në numër, më të organizuara në prodhim, më të rrezikshme në teknika, më problematike dhe me pasoja sociale që sjellin.

ç- Sipas mënyrës së zbulimit të veprave penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare, për periudhën 2008-2014 paraqitet si më poshtë:

- Nëpërmjet RFI-së janë zbuluar dhe goditur autorët e 78 veprave penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare ose 2.3 % e numrit të përgjithshëm të veprave penale të zbuluara në 7 vite. Ndërmjet të tjerave, këto shifra tregojnë edhe për nivelin e ulët të punës së strukturave të gjurmimit dhe hetimit të krimit të falsifikimit, për përdorimin e RFI, numrin e pakët të tyre, cilësinë shumë të dobët të rrjetit etj.

-Nga të dhënat e burimeve konfidenciale janë zbuluar dhe goditur autorët e 921 veprave penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare ose 25.8 % e numrit të përgjithshëm të veprave penale të zbuluara në 7 vite. Kjo flet për rëndësinë që kanë të dhënat dhe informacionet e burimeve konfidenciale që shfrytëzohen nga specialistët e gjurmimit dhe hetimit të krimit ekonomik e financiar, normuar dhe specifikuar në udhëzimin 56/1 të vitit 2013², në zbulimin dhe goditjen e autorëve të veprave penale të falsifikimit.

-Duke qenë në procedim policor, janë zbuluar dhe goditur autorët e 77 veprave penale të falsifikimit të dokumenteve ose 2.2% e numrit të përgjithshëm të veprave penale të zbuluara në 7 vite. Kjo tregon edhe për punën e pamjaftueshme që është bërë dhe bëhet nga specialistët e hetimit të krimit ekonomik e financiar në vende për marrjen, përpunimin dhe verifikimin e informacioneve policore; çeljen dhe ndjekjen e dosjeve të gjurmimit; përdorimin e metodave speciale të hetimit për krimin e organizuar etj.

- Shërbimet e policisë kanë zbuluar dhe goditur autorët e 843 veprave penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare ose 23.6% e numrit të përgjithshëm të veprave penale të zbuluara në 7 vite. Kjo tregon se shërbimet e policisë kanë një rol të pa zëvendësueshëm në zbulimin dhe goditjen e krimit të falsifikimit. Nga këtu arrijmë në

² Udhëzimi i Ministrisë të Brendshme Nr. 56/1, datë 27.05.2013 "Për përdorimin e burimeve të informacionit, marrjen, administrimin, verifikimin dhe vlerësimin e të dhënave".

Barjami, XH.
« Falsifikimi i dokumenteve cenon funksionimin normal të institucioneve shtetërore dhe publike »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

përfundimin se strukturat e gjurmimit dhe hetimit të krimit të falsifikimit duhet të bashkëpunojnë ngushtësisht me njëri-tjetrin, të bashkërendojnë veprimet dhe harmonizojnë praktikatat e tyre për kontrollin dhe goditjen e kontingjentit me tendencë falsifikimin e dokumenteve.

- Nëpërmjet rrugëve të tjera janë zbuluar dhe goditur autorët e 1645 veprave penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare ose 46.1% e numrit të përgjithshëm të veprave penale të zbuluara në 7 vite. Një fakt i rëndësishëm që tregon se sa pak është punuar e punohet me inteligjencën profesionale, me informacionin policor, me gjurmimin, dosjet dhe fashikujt e të dhënave që bëjnë fjalë për veprimtari keqbërëse në formën e falsifikimit të dokumenteve.

d-Gjendja e autorëve pjesëmarrës në kryerjen e veprave penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare paraqitet si vijon.

Gjatë këtij dhjetëvjeçari, në kryerjen e 5637 veprave penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare kanë marrë pjesë 6310 autorë, nga të cilët 202ose 3.2% e tyre kanë vepruar në bashkëpunim me njëri-tjetrin; 109ose 1.7% e tyre janë ndjekur me Procedim Policor; 85 kanë qenë përsëritës në të njëjtën krim; ndërsa 36 kanë qenë më shtetësi të huaj. Në fakt shifrat e mësipërme, nuk janë të plota, ato nuk shprehin realitetin kriminal. Arsyet janë të shumta, së pari teknike, por edhe organizative e profesionale. Specialistët të hetimit të krimit ekonomik e financiar, që hetojnë krimet e falsifikimit të dokumenteve konkludojnë se falsifikatorët janë përsëritësit më të mëdhenj të krimit. Shumica e tyre e kthejnë falsifikimin në profesion, në mënyrë jetese, në veprimtari profesionale fitimprurëse, nga e cila nuk heqin dorë edhe gjatë kohës së dënimit. Edhe aty, nëpërmjet dokumenteve false, tentojnë të dalin nga burgu me “leje” të drejtorit, që në fakt e hartojnë vetë, ose nëpërmjet lidhjeve të tyre kriminale.

Nga tërësia e autorëve të veprave penale, 3318ose 52.6% e tyre janë pjesëmarrës në kryerjen e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve, parashikuar nga neni 186 i K.P.; 1096ose 17.4 % e tyre janë pjesëmarrës në kryerjen e veprës penale të falsifikimit të letrave me vlerë, pasaportave dhe vizave, parashikuar nga neni 189 i K.P.; 973ose 15.4% e tyre janë pjesëmarrës në kryerjen e veprës penale të falsifikimit të akteve të gjendjes civile, parashikuar nga neni 191 i K.P.; 628ose 9.9% e tyre janë pjesëmarrës në kryerjen e veprës penale të falsifikimit të vulave dhe stampave, parashikuar nga neni 190 i K.P., etj.

Sipas moshës, autorët e falsifikimit janë: 578 ose 9.2% e tyre janë të moshës deri në 25 vjeç; 2479 ose 39.3% e tyre janë të moshës 25-45 vjeç; 3253 ose 51.5% e tyre janë të moshës mbi 45 vjeç. Sipas seksit, janë: 1231 ose 19.5% e tyre janë femra; 5079 ose 80.5% e tyre janë meshkuj. Sipas arsimit autorët e veprave penale të falsifikimit të dokumenteve janë: 182 ose 2.9% e tyre me arsim fillor; 1772 ose 28.1% e tyre me arsim 8-9 vjeçar; 3134ose 49.6% e tyre me arsim të mesëm; 1222 ose 19.3% e tyre me arsim të lartë. Sipas punësimit autorët pjesëmarrës janë: 626 ose 9.9% e tyre punonin në sektorin shtetëror; 1712 ose 27.1% e tyre ishin punonjës të sektorit privat; 3972 ose 63% e tyre ishin të pa punë. Sipas masave të marra ndaj autorëve të veprave penale të falsifikimit të dokumenteve janë: 503 ose 8% e tyre ishin arrestuar; 152 ose 2.4% e tyre ishin ndaluar; 5564 ose 88.2% e tyre u ndoqën në gjendje të lirë; 91 ose 1.4% e tyre ishin larguar nga vendi i krimit, nga të cilët vetëm 26 u shpallën në kërkim në shkallë vendi.

3. Përfundimet që dalin nga analiza e shifrave të këtij krimi

Mbështetur në studimin e gjendjes së këtyre veprave penale, në analizën që i bëmë të dhënave statistikore paraqitur në mënyrë tabelore apo grafike, bazuar në punën e bërë dhe rezultatet e arritura nga strukturat përgjegjëse të investigimit dhe hetimit të krimit ekonomik e financiar në DVP në qarqe, mbështetur në risitë dhe ndryshimet e pritshme pas krijimit të BKH, SPAK, Task Force, Strukturës Qendrore dhe Vendore të hetimit të krimeve arrijmë në disa përfundime specifike, të cilat mund të shihen me kujdes nga strukturat dhe specialistët përkatës të këtyre krimeve:

1. Krimi i falsifikimit të dokumenteve zyrtare që nga viti 1994 kur u krijuan sektorët e hetimit të krimeve, pas vitit 1995 kur hyri në fuqi KP dhe KPP, dhe sidomos pas ndryshimeve të bëra në vitin 2004 dhe 2007, ka ardhur vazhdimisht në rritje. Ndërkohë që numri i autorëve, sidomos i përsëritësve është rritur, duke e kthyer këtë lloj krimi në fenomen të dëmshëm për funksionimin normal të administratës publike dhe private. Ata janë në shumicë të moshës deri në 45 vjeç, me arsim të mesëm dhe të lartë, me punë në sektorin publik ose privat. Kështu ka ndodhur edhe me strukturat policore që janë marrë me gjurmimin dhe hetimin e tyre, por kjo jo gjithmonë ka çuar në goditjen me efektivitet të këtyre veprave penale.

2. Në zhvillimin dhe përhapjen e krimeve të falsifikimit të dokumenteve zyrtare kanë ndikuar një sërë faktorësh ekonomikë dhe socialë, politik dhe administrativë, organizativë dhe teknikë, menaxhues dhe profesionalë. Të tillë si papunësia, pagat e ulëta, krizat politike dhe sociale, riorganizimi i vazhdueshëm i strukturave policore, ndryshimet e personelit, bashkëpunimi i dobët me organet e drejtësisë, bashkërendimi i pamjaftueshëm me organet e zbatimit të ligjit, kërkesa e pamjaftueshme nga drejtuesit policorë etj.

3. Numri i veprave penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare zbuluar me veprimtari gjurmuese apo metoda speciale hetimi është akoma shumë e vogël, ndërsa autorët e këtyre krimeve të ndaluar apo të arrestuar zënë një përqindje të pa konsiderueshme, në raport me autorët pjesëmarrës në vepra penale, të cilët në shumicë janë ndjekur në gjendje të lirë.

4. Pavarësisht të dhënave statistikore ku përsëritësit zënë një vend të papërfillshëm, specialistët e fushës në DVP theksojnë se falsifikatorët e dokumenteve janë perfeksionuar aq sa e kanë kthyer falsifikimin në profesion dhe është shumë e vështirë të dallosh falsifikimin e dokumenteve të kryer prej tyre. Në disa raste, në pikat e kalimit kufitar janë kthyer mbrapa shtetas me dokumente të rregullt, dhe kanë kaluar shtetas me dokumente të falsifikuara.

5. Megjithatë krimi i falsifikimit të dokumenteve zyrtare konkurron me krimet e mashtrimit, shpërdorimit të detyrës, vjedhjes nëpërmjet shpërdorimit të detyrës, bashkëpunimi midis strukturave të hetimit dhe gjurmimit të këtyre krimeve ka qenë i pamjaftueshëm. Kjo u vu re sidomos në krimin e mashtrimit realizuar nga L M nëpërmjet kompanisë “A.... - IM”, hetimi rreth të cilës kishte filluar nga prokuroritë e rretheve gjyqësore në Gjirokastrë, Pogradec, Korçë, Elbasan, Shkodër, Tiranë, ku strukturat e hetimit të Policisë së Shtetit në qendër dhe në vende, vepronin të segmentuar dhe të pavarura nga njëri tjetri, duke e çuar zbulimin dhe goditjen e autorëve të tyre afër dështimit.

6. Pavarësisht rezultateve në rritje të Policisë së Shtetit në goditjen e krimit të

Barjami, XH.

« Falsifikimi i dokumenteve cenon funksionimin normal të institucioneve shtetërore dhe publike »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

organizuar, akoma nuk bëhet e mundur informimi i saj, për pasojë edhe e specialistit të gjurmimit apo hetimit

për ecurinë e procesit të hetimit dhe dënimit të falsifikatorëve. Në shumicën e rasteve nuk merret dijeni nëse ka filluar apo jo hetimi nga prokuroria për referimet e kryera nga policia. Nëse është hetuar çfarë provash janë siguruar. Nëse hetimi është pushuar dhe përse. Ose si ka vijuar sigurimi i provave për të ndaluarit dhe arrestuarit. Sa dhe për çfarë veprash penale është dënuar i dyshuari nga gjykata përkatëse, etj.

7. Ashtu si dhe me krimin në tërësi, edhe për veprat penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare, veprimtaria e strukturave përkatëse policore është përqendruar në veprimet administrative dhe hetimore, në vend që të mbështeten në veprimtarinë për investigimin e krimit, ose gjurmimin, identifikimin, përdorimin e metodave speciale për kërkimin e provës, shfrytëzimin e burimeve të organizuara të informacionit policor, për të arritur në dokumentimin dhe goditjen e elementëve keqbërës. Prej vitesh janë rritur informacionet nga ZQKI Tirana, Zyra Kombëtare Europol Tirana, Sektori i Oficerëve të Ndërlidhjes, që bëjnë fjalë për hetime, arrestime, ndalime të shtetasve shqiptarë në vende të ndryshme të Evropës, Amerikës dhe Kanadasë, pasi përdorin dokumente identifikimi (të huaja apo të vendit tonë) të falsifikuara, brenda ose jashtë vendit, nga grupe të caktuara kriminale.

8. Individët apo grupet kriminale të falsifikimit të dokumenteve, në procesin e veprimtarisë së tyre kriminale kanë shfrytëzuar zhvillimin dhe modernizimin e teknologjisë, sidomos për falsifikimin e dokumenteve biometrike të identifikimit, ku kërkohet edhe specializim i veçantë. Specializimi, përqendrimi, vazhdimësia, dënimet e ultë, shfrytëzimi i teknologjisë janë kushte suplementare për kontingjentin e këtyre krimeve, të cilët, në disa raste, duke qenë edhe në burg kanë tentuar të arratisen nga burgu, duke prodhuar dokumente të falsifikuara.

9. Dosjet e drejtimit të veprave penale të falsifikimit të dokumenteve, janë formale. Në to gjenden pak analiza, studime dhe përgjithësime, ndërsa aktet procedurale si vendime të prokurorit për mosfillimin e hetimit, pushimin e tyre, dërgimin e akuzës në gjyq apo vendime gjyqësore të formës së prerë thuhet mungojnë.

10. Në vitet zgjedhore, në përgjithësi vërehet një ulje e numrit të veprave penale të falsifikimit të dokumenteve zyrtare, krahasuar si me vitin paraardhës ashtu dhe me vitin pasardhës. Kjo, edhe për arsye të uljes së tempit, ndryshimit të ritmeve, mungesës së përgjegjësive së specialistëve dhe strukturave të krimeve kundër falsifikimit të dokumenteve.

5. Rekomandime për përmirësimin e punës së strukturave policore

Bazuar në përfundimet e arritura, ku mbizotëron fakti se krimi i organizuar mbetet një sfidë që kërcënon ekonominë shqiptare dhe integritetin e vendit në BE, ndërkohë që eksperiencia e policisë shqiptare në luftën kundër këtij krimi është ende e pakonsoliduar; në përputhje me legjislacionin policor dhe qëllimin e këtij studimi, në interes të strukturave policore që merren me gjurmimin dhe hetimin e krimeve të falsifikimit të dokumenteve zyrtare rekomandojmë:

1. Të thellohem në luftën kundër krimit të organizuar; parandalimin e krimit të falsifikimit të dokumenteve, nëpërmjet policimit të orientuar nga inteligjenca dhe informacionit policor, duke e konsideruar inteligjencën si kyçin e suksesit të specialistëve

të gjurmimit policor dhe hetimit procedural. Rritja e kapaciteteve të RFI, burimeve konfidenciale, kontrollit dhe vëzhgimit sekret do ta bënte strukturën më intuitive, më parandaluese.

2. Të përmirësohet menaxhimi i burimeve njerëzore, me rritjen e kapaciteteve investigative dhe integritetin e strukturave të gjurmimit dhe hetimit të krimit ekonomik e financiar (falsifikimi i dokumenteve), duke hequr dorë nga ndryshimet shpeshhta, lëvizjet e pa motivuara, ndryshimet e vazhdueshme strukturore, reformat e pathemelta, ndërhyrjet politike dhe politizimin e specialistëve të antikrimit.

3. Përmirësimi i bashkëpunimit dhe bashkëveprimimit mes strukturave ligj zbatuese me njëra tjetrën; forcimi i koordinimit me organet e drejtësisë dhe aktorët e tjerë të administratës publike, në luftën kundër krimit ekonomik e financiar me synim parandalimin edhe të krimeve të falsifikimit të dokumenteve.

4. Krijimi/realizimi i modelit/sistemit të menaxhimit policor të çështjes (polici-prokurori-gjykatë) me qëllim shfrytëzimi i të dhënave të sistemit në të gjitha fazat e hetimit, gjykimit dhe dënimit të autorëve të veprave penale.

5. Përmirësimi i cilësisë së statistikave të kriminalitetit, ku të gjejnë vend elementët e domosdoshme për një analizë të arrirë, teknike, profesionale, juridike dhe shkencore. Mbi të gjitha, krahas të tjerave në çdo kohë specialistët e krimeve, menaxherët dhe drejtuesit e strukturave të gjurmimit dhe hetimit të krimeve të marrin informacionin e duhur për veprat penale sipas llojit, vendit (qytetin, rrethin, qarkun) ku kanë ndodhur, metodat specialet të gjurmimit dhe hetimit, mënyrat e goditjes së veprimtarisë kriminale, moshë, arsimit, punësimi, profesioni, organi referues, (mosfillimi, procedimi, pushimi, rifillimi i procedimit), dënimi nga gjykata etj.

6. Përmirësimi i performancës së strukturës policore të hetimit të krimit ekonomik e financiar; menaxhimi dhe drejtimi më profesional i tyre sidomos në vitet zgjedhore, me qëllim që në ato vite rezultatet e punës për evidentimin, zbulimin dhe dokumentimin e veprave penale të falsifikimit të dokumenteve të vijnë në rritje të vazhdueshme dhe përmirësim të përhershëm.

Bibliografi

1. Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë.
2. Ligji nr 35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (miratuar me datë 30.3.2017, hyrë në fuqi me datë 1.8.2017).
3. Ismet Elezi. E drejta Penale Pjesa e Posaçme, Tiranë 2005
4. Vlerësimi i Riskut të Krimit të Organizuar. (Fondacioni "Shoqëria e Hapur për Shqipërinë" Tirane 2015. Fabian Zhilla dhe Besfort Lamallari.
5. Projekti Rajonal CARPO "Raporti mbi Gjendjen e Krimit të Organizuar dhe Krimit Ekonomik ne Evropën Juglindore", Strazburg-Gusht-2006.
6. Udhëzimi i Ministrisë së Brendshme Nr. 56/1, datë 27.5.2013 "Për përdorimin e burimeve të informacionit, marrjen, administrimin, verifikimin dhe vlerësimin e të dhënave".
7. VKM nr. 663, datë 17.7.2013 "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit ", për vitet 2013-2020 dhe planit të Veprimit për vitet 2013-2016.
8. Grupet kriminale, me tendencë "Falsifikimi i dokumenteve zyrtare", viti 2015.
9. Informacionet e ardhura nga sektorët e krimit ekonomik e financiar në DVP.
10. Statistikat e krimit ekonomik e financiar për vitet 1994-2017, nxjerrë në strukturën përkatëse të DPPSh.
11. Analizat vjetore të Drejtorisë për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Financiar, në Departamentin e Hetimit të Krimit të Organizuar dhe Krimit e Rënda në DPPSh.

Barjami, XH.
« Falsifikimi i dokumenteve cenon funksionimin normal të institucioneve shtetërore dhe publike »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

Alen Pinkerton, legjendë e policisë amerikane



■ Prof. Asc. Dr. Stavri SINJARI
sinjari.s@gmail.com

Abstrakt

Polici shquar, që ka vend në historinë e mendimit policor është edhe Alen Pinkertoni, i policisë amerikane. Roli i tij në polici konsiston në sukseset e një agjencie private, me statusin e luftës kundër krimit, zbulimin, hetimin e deri asgjësimit të kriminelëve të rrezikshëm. Në kushtet e nevojës për qetësi e siguri publike, kur për periudha kohore disave krimi i kishte duart pothuajse të lira dhe kishte sfiduar ligjin në Amerikë, Pinkertoni si drejtues policie e themelues i një agjencie detektive, punoi e veproi duke u vlerësuar si polic i madh, legjendë e i pagabueshëm. Polici i vijës së ashpër, porzbulojmë njeriun e drejtë, të guximshëm, me përvojë që sjell risi për punën e policisë, i cili shkruan, trajnon dhe jep porosi e përvojë për policët e detektivët e rinj. Lexuesi, studentët e punonjësit e Policisë do mund të njohin një tjetër figurë të njohur të policisë amerikane, që mori famën përtej kontinentit ku punoi.

Fjalëkyçe:

agjenci detektive, emigrant, hetim, grabitje, lufta civile, investigim, punë inteligjente, abolicionizmi.

Sinjari, S.
« Alen
Pinkerton,
legjendë e
policisë
amerikane »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

1. Hyrje

Alen Pinkerton ka vendin e vet midis policëve më të mëdhenj të kohërave, ka bërë histori me punën e tij dhe ka lenë gjurmë të vlefshme për organizatën e policisë. I ashtuquajtur “Polici legjendë” i SHBA, i shekullit të XIX, ia kushtoi pothuajse gjithë jetën e tij policisë, shërbimit të sigurisë ndaj njerëzve dhe aksionit në luftën kundër kriminalitetit. Jo më kot i kanë vënë nofkën “blackstrap”- “*shiriti i zi*”.¹ Themelues e udhëheqës i një agjencie private të sigurisë, një force policore investigative ose detektive, të inspiruar sipas modelit Vidok², agjenci që vazhdon punën e vet edhe sot, pas njëqind e shtatëdhjetë vjetësh, me të njëjtin emër në SHBA.

Polici i hekurt, i përkushtoi gjysmëshekulli punës së zbulimit e hetimit të krimit si dhe ruajtjes së rendit duke u ndeshur drejtpërdrejt me kriminelë e banda të armatosura mjaft të rrezikshme e të përhapura në kontinentin e ri. Kur ai jetoi e punoi koha e ngjarjet historike ishin fundamentale për SHBA, nga më të vështirat në histori. Vendi rrezikonte ose ishte pothuaj i ndarë, kur jugu skllavopronar tentoi ndarjen dhe çoi drejt një lufte civile. Krimi e pasiguria ishin shtuar nga bandat kriminale, që vepronin lirshëm e nuk mund të përballoheshin dot nga forcat qeveritare të sigurisë, ende të paorganizuara. Policia³ ishte pothuaj inekzistente, e pafuqishme përballë egërsisë së krimit, që merrte shumë jetë, sulmonte e grabiste bankat, trenat, pasuritë e kompanive të mëdha, shtetin, individin, kudo kishte mbjellë frikë e pasiguri.

Sinjari, S.
« Alen Pinkerton, legjendë e policisë amerikane »

Polici
dhe
Siguria
nr.14, 2019

¹ Shenjë dalluese për guxim e vepra.

<http://www.pbs.org/wgbh/americanexperience/features/james-agency/>

² Stinjari, S. “E. F. Vidok në Francë: Revista”, *Polici dhe Siguria*, nr. 11, (60-80) Tiranë 2018.

Amerikës i duheshin njerëz të talentuar e me vizion, burra trima e me vullnet. Kësaj kohe i përket presidenti historik më i shquar Abraham Linkoln, i cili pas fitores së luftës civile Veri-Jug, ka meritën e ruajtjes së Unionit të shteteve Amerikane-USA, me heqjen e ligjit e praktikës së skllavërisë në Jug, që i hapi rrugën prosperioritetit dhe ëndrrës amerikane. Pikërisht, në këtë periudhë shfaqet Alen Pinkertoni, të cilit në fushën e rendit e sigurisë i përket një nga kurorat e policisë.

Duke u nisur pothuajse nga hiçi, për rreth katër dekada deri ditën e fundit të jetës, ai iu përkushtua me sukses organizimit e përgatitjes së një force policore ligjzbatuese, të agjencisë private detektive, "Pinkerton". Kryesisht brenda kësaj agjencie përmblihet puna e përkushtimi i Alenit ndaj policisë, në vazhdim nga familja e tij.

Si shumë të tjerë policë të mëdhenj, A. Pinkerton ka kontributin e vet origjinal, me disa veçori të përcaktuara nga koha, traditat Amerikane dhe personaliteti i tij. Këto duhen parë e vlerësuar objektivisht, për ta njohur më mirë këtë figurë policore, konsideruar legjendë i SHBA, i cili i parapriu kësaj policie që pas disa dekadash hyri në fazën më të lartë të modernizimi të saj, me të madhin August Wollmer.⁴

E së fundi, rreth legjendës Pinkerton nuk mund të lemë pa konsideratë edhe kontributin individual të tij në botime, librat e shkruar prej tij që shërbejnë sot jo vetëm për njohjen e kësaj figure, por edhe për të mësuar rrugëtimin e gjatë të policisë moderne Amerikane.

Kur agjencia "Pinkerton" në vitin 2000 i dhuroi Kongresit Amerikan një bibliotekë me libra të kësaj agjencie me moshë njëqind e pesëdhjetë vjeçare, me vlerë mbi një milion USD, zëdhënësi i kësaj agjencie tha: "Ne jemi të nderuar që Biblioteka e Kongresit i konsideron arkivat tona të jenë me rëndësi historike dhe jemi krenarë të ndajmë detajet e kaluara të organizatës sonë me kombin".⁵

2. Emigrimi në Amerikë

Alen Pinkerton lindi më 25 gusht të vitit 1819, në periferi të Glasgout në Skoci. Në vazhdim të traditës familjare punoi si prodhues fuçish. Ky zanat ishte i trashëguar nga prindërit siguronte të ardhura të mjaftueshme dhe ishte mjaft i përshtatshëm për mundësitë e tij, në provincën ku lindi e jetonte bashkë me familjen. I ati, një ish-rreshter policie e la shpejt, në varfëri dhe me një shkollë të pambaruar, me arsimim autodidakt. Në rrethinat e qytetit të zhurmshëm të Glazgout kaloi qetë rininë e tij deri kur u përfshi dhe u klasifikua në një lëvizje radikale politike, që njihet në histori si "lëvizja çartiste"⁶.

Për shkak të këtyre bindjeve radikale, në vitin 1842 doli një urdhër arresti për të dhe e bëri të pamundur qëndrimin e tij në Skoci. Prandaj, që në hapat e para, familja Pinkerton emigroi në Shtetet e Bashkuara. U vendosën në shtetin Illinois, në Çikago, ku Aleni filloi punë në një fabrikë prodhimi fuçie, por për pak kohë. Shpejt me intuitën e vet e kuptoi se me zanatin e vet, do të ishte më mirë e me fitime të dilte më vete, me familjen e tij si prodhues privat. Për këtë qëllim u transferua në një qytet të vogël të quajtur Dundee, dyzet milje nga Çikago. Në një vend si Amerika, çdo mundësi ishte më e mirë se në Evropën e asaj kohe, e po se po se në Skocinë e tij.

Me të vërtetë, shumë shpejt cilësia e çmimi i produkteve të skocezit Pinkerton, falë

Sinjari, S.
« Alen
Pinkerton,
legjendë e
policisë
amerikane »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

³ E organizuar mbi baza territori, konteve, si urdhri sherif etj. SHBA ndoqi modelin Anglez.

⁴ Shih "Policimi dhe Siguria" nr.2, Tiranë, "A. Wollmer-babai i Policisë moderne Amerikane".

⁵ Pinkerton Spokesperson (po aty).

⁶ Në Irlandë në vitin 1840, lindi si lëvizje punëtoare për kërkesa ekonomike.

përvijës që kishte nga atdheu i mëparshëm, e bëri atë dhe firmën e tij numrin një në tregun vendas dhe ia rriti shumë fitimet. Kjo e nxiti të zgjerojë edhe më tej prodhimin, duke u vendosur në një ishull lumor, ku mund të gjente lëndë të parë me shumicë, që i ulte koston dhe i shtonte fitimin. Brenda një kohe të shkurtër ai fitoi kontrollin e tregut dhe u shndërrua në një biznesmen të suksesshëm, të pasur, të kënaqur dhe askujt, as vet atij nuk i kishte shkuar ndonjëherë ndërmend se jeta e tij do të merrte rastësisht një drejtim tjetër.

3. Nga biznesi në polici

Polici i ardhshëm dhe i famshëm Pinkerton, ende i zhytur në problemet e biznesit të tij privat, të paktën deri në tre dekadat e para të jetës së tij nuk ishte marrë ndonjëherë me problemet e sigurisë. Ai nuk ishte bërë akoma polic dhe në objektivat e tij nuk gjendet ndonjë dëshmi nëse ka pasur dëshirë për tu bërë polic, pavarësisht se ishte bir i një rreshteri të varfër policie, i cili u nda shpejt nga jeta duke e lënë vetëm me të ëmën, që në moshë të vogël.

Sikurse në shumë raste e shembuj në historinë e mendimit policor, njerëz të shquar të policisë moderne janë bërë rastësisht pjesë të organizatës së policisë⁷.

Një rastësi e tillë e takoi fatin e Alen Pinkertonit me policinë. Ngjarja zuri fill nga biznesi që ai kishte nisur. Fabrika e tij prodhonte fuçi druri dhe kishte nevojë për lëndë drusore, të cilat gjendeshin me shumicë në një zonë të lumit që kalonte pranë qytetit Dunde, ku banonte. Për këtë qëllim, familja me banim e biznes u zhvendos në ishullin e lumit Fox, duke u udhëhequr si gjithmonë nga përfitimi prej afërsisë së lëndës së parë. Një ditë, duke u marrë me punën e përditshme për grumbullimin e lëndëve drusore, vuri re disa shenja që tregonin se në këtë ishull, herë pas here vinin edhe disa njerëz të tjerë, por jo për qëllime biznesi apo peshkimi; diçka jo e zakonshme i tërhoqi vëmendjen Alenit. Ndoqi për pak kohë lëvizjet e tyre dhe dyshoi për një bandë kriminale, që përdorte ishullin e pabanuar si strofullin e vet për vepra kriminale.

Bazuar në intuitën e vrojtimet jo zyrtare individuale, mbasi krijoi bindjen se aty fshihej një veprimtari e paligjshme, ai nuk hezitoi të njoftonte autoritetet policore, natyrisht Sherifin lokal, i cili pas një bashkëpunimi me Pinkertonin, i arrestoi gjithë anëtarët e bandës, duke i dhënë fund një organizate nga më të rrezikshmet në ato anë. Kjo ngjarje për të do të ishte e artë, do ti jepte një tjetër drejtim punës e jetës së tij. Do fillonte pikënisja e famës së një detektivi të talentuar policie. Bashkë me suksesin e policisë lokale për shpartallimin e një bande falsifikatorësh erdhi vlerësimi për rolin e Alen Pinkertonit në këtë operacion. Përveç se u bë “hero” nga autoritetet lokale, do ti bënin edhe një ofertë të papritur. Rast fatlum për emigrantin skocez. Iu bë propozimi të futej në polici, madje të drejtonte një forcë policore. Në vitin 1846 Alen Pinkerton u emërua zëvendës shef policie për Kane County⁸ dhe pak më vonë u bë detektivi i parë policor i Çikagos.

4. Agjencia kombëtare detektive “Pinkerton”

Për ta bërë më të qartë për lexuesin shkakun e ngritjes së shpejtë në karrierën

⁷ R. Peel në Angli, F. Vidok në Francë etj.

⁸ Kane County- qark në Illinois, me një popullsi prej 515 269, zona e qarkut ishte 524 kilometra katrorë. Qytetet e saj më të mëdha janë përgjatë lumit Fox.

Sinjari, S.
« Alen Pinkerton, legjendë e policisë amerikane »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

policore të një emigranti, siç ishte Pinkerton, duhet njohur konteksti historik i kohës kur ai jetoi e punoi. Gjatë shekullit XIX, shtetet kryesore perëndimore më të zhvilluar, po ridimensiononin fushën e sigurisë kombëtare, po ndërmerrnin masa thelbësore për organizimin, reformimin, konsolidimin e policive të tyre, si në formë edhe në koncept. Përvoja e përbashkët grumbullohej, studiohej e përshatej me kushtet e legjislacionin e secilit vend. Fryma e ndryshimeve të mëdha në organizimin e funksionimin e Policisë, kishte filluar në Europë. Anglia, Franca, Austria, etj. po hidhnin hapat e para të modernizimit të organizatave policore, ku theksojmë dy momente më të rëndësishëm.

Së pari, në Angli, një zyrtar i madh i shtetit, Sr. Robert Peel, modeloi dhe riorganizoi Policinë Metropolitane, MET, e cila u dekretua në 1829. Në themel të saj u vendosën disa parime, që morën mbështetjen e gjithë policive kudo e njihen si parimet *piliane* të policimit, të cilat mbeten bazë edhe sot për policinë moderne⁹.

Së dyti, në Francë, një ish i dënuar, Eugen Fransua Vidok, kishte themeluar e drejtuar për herë të parë një polici detektive e cila u dekretua si kombëtare, të "Surete National", dhe krahas saj krijoi edhe të parën polici dedektive private në histori, të cilat i drejtoi vet⁹.

Këto ngjarje të mëdha për policinë në përgjithësi nuk mund të kalonin pa ndikim në policinë amerikane, duke u adoptuar në formën e kohës e duhur. Ashtu si ngjarjet e mësipërme, edhe personi që do mund ti konvertonte në botën amerikane këto risi të organizimit të Policisë, erdhi në momentin e duhur, pra ngjarjet dhe individit njëkohësisht. Alen Pinkerton fare rastësisht luajti një rol protagonist në këtë proces të gjatë e gjithëpërfshirës për historinë e SHBA. Filloi si agjent detektiv e shef policie, më pas krijues e drejtues i një agjencie private sigurie, gjatë disa dekadave që përfshijnë gjysmën e dytë të shekullit XIX, saktësisht nga viti 1846 deri në vitin 1884. Puna në Agjencinë e vet, nga shërbimet në një qytet të vogël kaloi në gjithë Çikagon, u zgjerua në nivel kombëtar për një numër të madh shërbimesh. Prandaj vlen të analizohet e të vlerësohet në masën se në çfarë drejtimi dha kontribut ai për policinë moderne në përgjithësi.

A. Pinkerton mund të krahasohet me policët e mëdhenj të kohëve, me pasardhësin e tij në SHBA A. Wollmer, me të tjerë personalitete të policisë moderne, jo nga madhështia se sa nga specifika që ka secili prej këtyre figurave. Nëse shumë prej tyre ishin vizionarë e reformatorë, Pinkertoni ishte polic i aksionit. Edhe vet rrugëtimi i tij në polici, pati si pikënisje një aksion, siç ishte zbulimi e shpartallimi i një bande, gjë që e vendosi atë menjëherë nga sherif në krye të policisë së një qyteti.

Gjithashtu, Pinkertoni vendosi të kontribuojë në polici në një rrugë tjetër. Edhe pse pati mjaft sukses si drejtues i policisë së Kontesë në Kane, apo në Cook me seli në Çikago, ai u tërhoq. Pas katër vjetësh, në vitin 1850 bashkë me vëllanë vendosi të themelojë një agjenci detektive private me emrin "Pinkerton". Kjo agjenci nga vet specifikimi i emrit të saj "detektive", kishte detyra të mirëfillta policie, madje më gjerë se sherifët e policitë lokale. Ajo mund të investigonte, ndiqte, arrestonte, të shpartallonte e madje të asgjësonte kriminelët e grupet kriminale të çdo lloji. Agjencia gjurmonte e ndiqte vrasësit e urdhëruesit e tyre, arrestonte grabitësit e vjedhësit e spikatur, ofronte shërbim e masa sigurie të pasurisë nga grabitjet, nga vjedhjet, për kompanitë, për bizneset e mëdha e për individët. Hapi i parë i agjencisë u lidh me emrin Alen Pinkerton, si detektiv hero në perceptimin publik, që u promovua mbas shpartallimit të bandës në ishullin e lumit Fox e disa sukseseve të tjera. Që kur ishte sherif në Kane e Çikago, pas disa sukseseve që

Sinjari, S.
« Alen
Pinkerton,
legjendë e
policisë
amerikane »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

⁹ *Policimi dhe Siguria*, nr. 7. (96-107), Tiranë 2017; *Policimi dhe Siguria*, nr. 11 (60-80), Tiranë 2018.

pasuan, Alen mori namin sikur zbulonte gjithçka dhe zgjidhte çdo problem. Serioziteti në zgjidhjen e çështjeve, puna korrekte me tarifa fikse, parimet dhe etika e përcaktuar me rregullore të brendshme të kësaj agjencie, ishin të tjera shtysa për sukseset e saj.

Këto shërbyen si trampolinë, që u pasua me vërshimin e një numri të madh porosish e problemesh për zgjidhje. Fillimisht bizneset, publiku, madje më pas vet qeveria, iu drejtuan kësaj agjencie, për zgjidhje çështjesh e kryerje shërbimesh të posaçme të fushës së sigurisë.

Kjo rritje e vullshme e shërbimeve të Agjencisë u stimulua në radhë të parë nga vakuumi i sigurisë i krijuar në shtetet amerikane. Nga ana tjetër, duke shfrytëzuar disa kontrata biznesi të vëllait të vet me disa kompani të mëdha, Agjencia lidhi disa shërbime shtesë mjaft të rëndësishme me këto kompani, për mbrojtjen e sigurinë e trenave nga grabitjet e bandave, për rrjetin e letrave dhe shërbimeve postare, në çështjet e ruajtjes së rendit e ndërmjetësisë me punëtorët në rastet e grevave, porosi qeveritare etj.

Si rrjedhojë puna e Agjencisë nga fundi i vitit 1850 u rrit dhe u zgjerua shumë. Agjencia me *Pinkertonasit* u konfirmua përfundimisht si forcë policore private e veçantë dhe më autoritare në Illinois. Ajo tashmë ndërmerre punë të shumta për investigim e zgjidhje të çështjeve ligjore kundër shkelësve të ligjit, me interes shtetëror e privat.

Pra, Agjencia Pinkerton u zgjerua në përmasat e një agjencie kombëtare sigurie në madhësi, në territor dhe në përmbajtje. Rrjeti i agjentëve "Pinkerton" filloi të përhapet jashtë kufirit të Illinois, në shtetet e tjera Amerikane. Numri i çështjeve dhe shumëllojshmëria e problemeve i kalonte të gjitha përvojat e pritshmëritë e një agjencie tradicionale të sigurisë. Krahas krimeve të jetës, grabitjeve e sigurisë së bizneseve ajo përfshiu edhe shërbime të tjera. Ruante personalitetet, siguronte objektet e institucionet si private edhe shtetërore, ishte shoqëruese e përgjegjëse për sigurinë e presidentit, mblidhte informacione të rëndësishme kombëtare. Mbi bazën e punës inteligjente me rrjetin e vet të agjentëve të fshehtë, arriti të menaxhonte grevat antiqeveritare që në atë kohë ishin përhapur e ishin në rritje, krimet e mjedisit, shërbimin e letrave e pakove postare ku vjedhja e grabitja ishte më tepër e përhapur.

Organizata Pinkerton ofroi ndaj kompanive në mbarë Amerikën shërbime inteligjente në kundërzbulim, siguri të brendshme, hetim, si dhe shërbime të zbatimit të ligjit për biznesin privat, sindikatat e qeverinë. Kontratat e lidhura me ndërmjetës qeverinë e SHBA, sidomos me "American Railway Express Company", do e shndërronte "Pinkerton Agency" në organizatën private policore më të fuqishme në SHBA, aq sa numri i agjentëve të punësuar prej saj do t'ia kalonte edhe Forcave të Armatosura Amerikane?! Hekurudhat dhe zyra e postës, dy biznese më të fuqishëm në atë mjedis të paligjshëm, u bënë shpejt dy nga klientët më fitimprurës të agjencisë. Prandaj Pinkertoni ambicioz filloi rekrutimin e detektivëve më të mirë për agjencinë e vet dhe filloi ta zgjerojë atë me një numër të madh agjentësh profesionistë¹⁰. Atij i kishte dalë nami si "tmerri i keqbërësve" prandaj detektivët profesionistë pranonin me dëshirë të punonin nën drejtimin e Pinkertonit në agjencinë e tij. Madje ai nuk hezitoi të punësonte edhe agjente femra si Kate Warne në 1856. Kjo agjente e lindur, shumë shpejt tregoi talent e aftësi në shërbime të veçanta për Agjencinë. Ajo mund të penetronte e të zgjidhte situata mjaft të vështira. Në një rast vjedhje, e kamufluar, pas një "komunikimi të ngrohtë" me gruan e grabitësit, ajo arriti të mblidhte informacionin e nevojshëm për

Sinjari, S.
« Alen Pinkerton, legendë e policisë amerikane »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

85

¹⁰ Agjentë profesionistë në atë kohë nuk dilnin nga shkolla apo kurse, por kuptoheshin ata që vinin nga ushtria, që kishin kaluar përvojë luftimesh ose me përvojë në shërbime policore si sherif etj.

kapjen dhe kompensimin e pasurive të vjedhura prej tij. Sidomos roli i saj në rastin e shpëtimit të President Linkolnit nga një atentat i përgatitur nga agjentët e Jugut në vitin 1861 ishte vendimtar dhe u bë objekt tregimesh policore në mediet e shkruara.

Agjenci të tjera detektive natyrisht që kishte shumë në SHBA. Ajo që e bënte më të kërkuar Agjencinë Pinkerton ishte fama e mirë në krahasim me të tjerat. Gjithashtu, kjo agjenci ofronte një shumëllojë shërbimesh në krahasim me të tjerat, që nga roje e garant pasurish, kapje grabitës trenash e deri shërbime të profilit ushtarak. Veç të tjerash, kjo agjenci serioze vazhdonte të vepronte me tarifat më të ulëta, praktika pune të respektueshme nga publiku, gjë që ia rriste më tepër reputacionin Pinkertonit.

Shumica e shteteve Amerikane të asaj kohe njiheshin ndryshe si “Perëndimi i egër”, dhe në to kishte uri për qetësi, nevojë për siguri dhe integritet. Filmat e librat e Western me kauboj, pasqyrojnë më së miri amullinë e kësaj periudhe. Ardhja e pareshtur e emigrantëve nga gjithë bota, të skllëvërve nga Afrika e rëndonin akoma situatën. Po shtohet edhe rreziku i copëtimit nga shkëputja e Jugut skllavopronar, gjë që kishte ndikim negativ për respektimin e autoritetit të Ligjit të Konfederatës në gjithë territorin. Krahas kësaj edhe policitë lokale vepronin brenda në qytete, ndërsa në zonat rurale pushteti pothuaj nuk ndihej e ligji nuk mund të zbatohet. Kompanitë e mëdha që vepronin në mbarë Federatën nuk kishin garanci për sigurimin e biznesit dhe pasurive të tyre. Ky u bë shkak që dy kompanitë e mëdha, të Hekurudhave dhe shpërndarjes postare, ti ofronin bashkëpunim Agjencisë Pinkerton. Këto i dhanë një shtytje të fuqishme punës dhe fitimeve, e ngritën në shkallë vendi shumë lart famën e Alenit.

Rritja e profilit të Agjencisë Pinkerton u finalizua me vendosjen e Logos historike të shoqëruar me një slogan të saj, të cilat ende mbeten deri në ditët e sotme, si shenja dalluese të saj. Si logo e kësaj agjencie detektive, u zgjodh një sy i hapur, bardh e zi, që shoqërohet me sloganin e famshëm “*ne kurrë nuk flemë*”. Kuptohet domethënia e këtij simboli. Nga njëra anë syri nënkupton profilin e saj si agjenci inteligjente, që sheh, vrojton, heton gjithçka të fshehtë e të maskuar, që ka të bëjë me sigurinë e paligjshmërinë dhe nga ana tjetër, shpreh besueshmërinë e garancinë që të ofron si organizatë që nuk pushon asnjëherë, sepse gjithmonë është në shërbim të publikut dhe vendit të vet. Këto simbole përligjinin punën e madhe të Pinkertonit që e themeloi dhe që arriti të quhej agjenci me përmasa kombëtare. Agjencia i zgjidhte me sukses të gjitha çështjet që merrte përsipër apo i ngarkoheshin nga shteti, sado të rrezikshme e të vështira të ishin, në një kohë të shkurtër. Kjo ia shtoi famën asaj dhe padyshim Alen Pinkertonit deri në përmasat e një legjende.

Si shpjegohet një rritje kaq e shpejtë e agjencisë “Pinkerton”? Cili ishte roli i krijuesit të saj Alen Pinkerton?

5. Thurja e legjendës Pinkerton

Pinkertoni i përket asaj plejade të policëve të shquar që kontributin e vet në këtë fushë e ka investuar më tepër si veprim. Ai ishte veprues, polic i aksionit në radhë të parë, pastaj i mendimit dhe këshillave. Punët e tij në Agjenci ishin operacionale, hartim planesh, gjurmime, hetime, arrestime kriminelësh, përlëshje me banda grabitësish, zgjidhje çështjesh me ndërmmjetësim, ruajtje pasurish e objektesh me rëndësi, ruajtje të rendit, mbajtje ekuilibri të ligjit në protestat apo grevat e punëtorëve sidomos në kompanitë e mëdha. Pinkertoni punoi deri në fund të jetës si detektiv e drejtues policor, kryesisht i Agjencisë private Pinkerton, prandaj vepra e tij nuk mund të ndahet nga jeta

e kësaj agjencie. Kjo dhe fama e tij u ndihmuan edhe nga kushtet specifike të organizimit e performancës së policisë Amerikane të asaj kohe. Duhet theksuar se në SHBA-n e shekullit XIX policia shtetërore ishte krejt e decentralizuar, nuk mund të ushtronte dot autoritetin e saj jashtë juridiksionit të qyteteve. E ndërsa krimi gërshetohej e përhapej në territor, policia nuk kishte kompetenca jashtë qyteteve ku ishte ngjuar, ishte pothuaj e izoluar. Për rrjedhojë, ky lloj policimi e tkurte punën e policisë dhe krijonte boshllëk. Politet lokale nën administrimin e drejtimin e pushtetit vendor nuk mund të ndërvepronin me njëra tjetrën, nuk mund të këmbenin dot informacionet, e për më tepër nuk mund ta çonin hetimin deri në fund. Pikërisht kjo arsye imponoi ndryshime ligjore, veçanërisht miratimin e Ligjit për krijimin e agjencive private të sigurisë nga vet bizneset, me kompetenca eksterritoriale. Shtetet e Bashkuara miratuan ligje që u jepnin shumë autoritet e kompetenca korporatave të biznesit, për të krijuar forcat e tyre private të policisë ose për t'u lidhur me agjencitë policore private ekzistuese. Agjencia Pinkerton ishte nga më të parat agjenci që përfitoi nga Ligji i ri dhe prandaj mundi ti zgjerojë shërbimet e veta gradualisht në mbarë SHBA.

Mendimet e idetë e A. Pinkertonit për organizimin, reformimin e policisë janë të pranishme në disa shkrime të tij që konkretizohen në botime librash, tregimesh reale, esesh, këshillash, intervistash. Në to ai përshkruan punën e tij dhe të Agjencisë, me stilin më afër me zhanrin e romaneve e tregimeve policore të tipit “Arsen Lupen” se sa si analiza e rekomandime për policinë e policimin. Prandaj rreth figurës e veprës së tij ka vlerësime të ndryshme, përveç lavde e fryrje ashtu edhe kritika e minimizime të rolit të tij.

Pinkerton punoi katër dekada, deri në fund të jetës si detektiv e drejtues. Por, në dyzet vitet e tij si udhëheqës i forcës policore që krijoi, Pinkertonit iu desh të përleshje me kriminelë, banditë, grabitës, thyerës të ligjeve nga më të rrezikshëm në Amerikën e asaj kohe dhe pothuajse në të gjitha doli fitimtar. Duhet të shtojmë edhe faktin e rëndësishëm se ai punoi dhe kontribuoi me Agjencinë në një periudhë të vështirë për vendin, që përfshin edhe periudhën e vështirë të Luftës Civile¹¹ ku puna inteligjente e informacionit të fshehtë ishte shumë e rëndësishme.

Disa ngjarje të spikatura ia rritën famën agjencisë e Pinkertonit si detektiv i madh e legjendë, sikurse edhe disa teprime dhe dështime që ia tronditën prestigjin e fituar. Megjithatë, më në dukje këto vlera shihen në disa ngjarje ose shërbime të Pinkertonit në vitet që drejtoi e punoi si kryedetektiv i Agjencisë.

Një nga sukseset e mëdha të Agjencisë Pinkerton vlerësohet zbulimi i një vjedhje të madhe në kompaninë, “Adams Express Company”¹². Pinkertoni arriti të zbulojë rrjetin e gjerë të vjedhësve dhe ti kthejë kompanisë një shumë prej 700 mijë USD, mjaft e madhe në atë kohë. Kompania prestigjioze iu drejtua agjencisë për një deficit të madh parash në arkën e llogarive të saj. Kjo “justifikohej” prej disa administratorëve si humbje prej grabitjeve të pësura ose si gabime në dokumentacion nga disa drejtues e punonjës të saj. Pinkertoni u mor vet me hetimin e kësaj vjedhje. Shqyrtoi disa pista. Mbasi hetoi pistën e grabitjeve që ende nuk kishte marrë rrugën e zgjidhjes, me llogaritarët e vet kontabël analizoi bilancet dhe i lindi dyshimi se mungesa e parave dhe mallrave vinin nga vjedhja brenda Kompanisë. Nëpërmjet agentëve të vet të maskuar e penetruar në

Sinjari, S.
« Alen
Pinkerton,
legjendë e
policisë
amerikane »

¹¹ Lufta Civile (1861 - 1866) midis Veriut industrial dhe Jugut skllavopronar, përfundoi me fitoren e Veriut dhe për rrjedhojë u pasua me heqjen e skllavërisë.

¹² Kompani e madhe menaxhuese fondesh, më se 160 vjeçare, me emrin e ri “Fondi i Burimeve Natyrore Adams”, prej muajit mars të vitit 2015. Ky fond është fondi më i vjetër i mbyllur.

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

zyrat e administratës së Kompanisë, gjurmimit dhe hetimit të pandërprerë, hap pas hapi, ai mblodhi informacionin e nevojshëm dhe provat që vinin para përgjegjësish një numër punonjësish dhe drejtues të administratës së kësaj Kompanie të cilët pasi u arrestuan pranuan bashkëpunimin në rrjet në këtë vjedhje kaq të madhe.

Një ngjarje që “vulosi” reputacionin dhe famën e Pinkertonit ishte zbulimi i komplotit për vrasjen e presidentit Abraham Linkoln, në shkurt të vitit 1861. Gjatë një rasti rutinë të hetimit në një vjedhje në hekurudhë, ai mori një informacion se komplotistët e Jugut kishin përgatitur një plan për vrasjen e presidentit të SHBA, në Baltimor, pikërisht gjatë një ndalese mitingu me përkrahës të tij. Me paralajmërimin e Pinkertonit, itinerari i presidentit Linkoln u ndryshua. Një rol shumë të rëndësishëm në këtë operacion luajti detektivja femër Kate Warne, e cila u maskua dhe e shoqëroi presidentin duke e hequr si motra e tij. Operacioni përfshiu ndryshimin e linjës së trenit, ndryshimin e orarit duke udhëtuar si pasagjerë natën në një vagon të thjeshtë udhëtarësh, shkëputjen e linjave të kabllove telegrafike, ruajtjen në fshehtësi të identitetit të presidentit dhe kalimin e rrezes së rrezikut, duke e çuar Linkolnin shëndosh e mirë në kryeqytet.

Pinkerton gjatë punës me Kompaninë e Hekurudhave ishte njohur me ish-avokatin Abraham Linkoln, i cili fatmirësisht për të, do të bëhej President i SHBA. Kjo ngjarje¹³ ia forcoi mjaft suportin politik. Gjatë Luftës Civile, presidenti Linkoln punësoi Agjencinë Detektive Pinkerton për të organizuar një lloj “shërbimi sekret”, për të marrë e mbledhur informacion ushtarak mbi Konfederatën. Ai ishte kreu i shërbimit Informativ të Unionit dhe agjentët e tij privatë ishin në numër më të madh se gjithë agjentët e ushtrisë. Pinkerton edhe aty tregoi profesionalizëm të lartë në këtë detyrë. Ai lëvizi e punoi si agjent i fshehtë deri në përfundim të Luftës Civile, në vitin 1866. Guximi dhe aftësitë e Alen Pinkertonit gjatë Luftës Civile arritën në atë cak sa ai krijoi një maskim e një pseudonim, si *majori EJ Allen* dhe veprroi gjatë asaj periudhe nën këtë pseudonim pa rënë në sy. Detyrat që iu ngarkuan agjencisë Pinkerton gjatë Luftës Civile konvertohen të njëjta me ato që i ngarkohen sot FBI-s dhe CIA-s. Shërbimi Informativ Pinkerton ishte paraardhësi i shërbimit sekret të SHBA. Puna e tij hodhi bazat për krijimin e Shërbimit Sekret Federal sot FBI.

Më vonë, kur të botonte librat e tij nën shembullin e detektivit të famshëm francez Vidok¹⁴, ai do të shkruante¹⁵: “*Detektivi duhet të jetë i guximshëm, i fortë dhe i aftë të punojë, në sezon dhe jashtë sezonit, për të përmbushur objektivat e tij për të panjohurat, si një objekt absorbues... i aftë për të dalluar të vërtetën nga obligimi moral ideal dhe nga supozimet e paverifikuara*”. Pinkertoni ndonjëherë me agjentët e vet vepronin si truprojë e Presidentit Linkoln, natyrisht sepse ai përveç reputacionit, gëzonte besimin e plotë të Presidentit dhe përkrahjen e tij.

Lartësimi i profilit të tij dhe për rrjedhojë edhe i Agjencisë Kombëtare private që drejtonte, ia lehtësoi shumë kontaktet me mediet e publikun dhe ia shtuan përkrahjen ndaj punës e figurës së tij. Koha e valëve të pakontrolluara të dhunës e krimit i shndërroi shpejt *Pinkertonasit* në heronj. Vetëdija publike i ndiqte me vëmendje dhe tashmë ishte krejt pro bëmave të tyre. Ky perceptim pozitiv i promovuar edhe nga e gjithë fuqia mediatike e kohës, shtypi, librat, romanet, sidomos ato policore, etj. do fryheshin me trimëritë dhe çudirat e A. Pinkertonit, gjë që e shndërroi atë me të vërtetë në një legjendë policie amerikane.

Sinjari, S.
« Alen
Pinkerton,
legjendë e
policisë
amerikane »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

¹³ Fakti që asnjë komplotist nuk u arrestua më pas hodhi dyshime rreth sajimit të këtij komploti nga Pinkerton.

¹⁴ “E. F. Vidok-detektivi i madh i policisë Revista “Policimi dhe Siguria”, Nr. 10, Tiranë prill 2018.

¹⁵ *The Molly Maguires and Detectives, 1877.*

Pinkertoni ishte në kahun pozitiv edhe për sa i përket ideve e botëkuptimit të tij. Ai ishte përkrahës i abolicionizmit, kundërshtar i skllavërisë dhe bëri shumë vepra të guximshme duke ndihmuar skllavërit që arratiseshin nga Konfederata e Jugut, duke përballuar transportin e sigurinë e tyre në zonat jashtë rrezikut, deri në Kanada kur ishte e nevojshme.

Dalëngadalë, shtimi pamasë i punëve, spektri i gjerë i problemeve e shërbimeve që ofronte Agjencia Pinkerton e çoi biznesin e nisur prej tij në lartësinë më të madhe të mundshme, jo thjesht të një agjencie formale por në përmasat e një perandorie të vërtetë biznesi, e shtrirë në gjithë Konfederatën. “Syri që sheh gjithçka e nuk fle” u bë i njohur edhe përtej kufijve të SHBA deri në Europë e më gjerë.

Por njëkohësisht prej aty do të shfaqeshin edhe simptomat e madhësisë. Në disa veprime, të punës së tyre, *Pinkertonasit* kalonin caqet e ligjit, bëheshin më të egër e të ashpër se duhej. Dhuna e ekzagjeruar nuk ishte i vetmi apo mjeti më i preferuar për publikun, sidomos kur përcillej me viktima të panevojshme. Madje akoma më tepër, në raste grevash të punëtorëve për të drejtat e tyre dhuna e përdorur ishte e tepruar dhe e pa pranueshme. Admirimi i publikut filloi të lëkundej ndaj veprimeve të tejskajshme të agjentëve që Aleni vet i drejtonte. Sidomos ndikuan dy ngjarje që e tronditën reputacionin e tij.

Njëra prej tyre i përket fillimit të vitit 1874. Banda “*Vëllezërit Xhejms*”¹⁶, e njohur për grabitjet e krimet, kishte plaçkitur një tren, pronë e kompanisë *Adams Ekspres*, e cila i kërkoi Agjencisë Pinkerton të hetonte rastin e ti rikthehej pasuria e grabitur. Pinkertonasi i agjencisë me emrin Jozef, që u dërgua në banesën e Xhejmsëve, u vra sapo hyri në shtëpinë e tyre. Ishte paralajmëruar hapur nga banditët që të mos merrej me ta se ndryshe do ta vrisnin cilindo që do guxonte të hynte në banesë apo do merrej me ta. Vrasja bëri shumë bujë sepse Agjencia nuk kishte pasur asnjë rast të kësaj natyre, një kundërpërgjigje kaq të ashpër, pothuaj dështim. Kjo ngjarje e shtoi frikën publike nga kjo bandë. Më e rëndësishmja, ishte një sfidë e vërtetë, që vinte në provë prestigjin e Agjencisë që nuk kishte njohur dështim deri në atë moment. Pinkertonit iu desh të fliste publikisht për rastin në fjalë, duke treguar forcë dhe autoritet. Ai foli, gazetat botuan vendimin e tij bombë: “...ne nuk merremi me llafe, por veprimë. *Vëllezërit Xhejms duhet të vdesin*”. Ishte një deklaratë e hapur, e guximshme dhe mjaft e qartë. Sfidat me bandën Xhejms ishte pranuar, sapo kishte filluar lufta e vërtetë. Për publikun e shtypin e kohës, vëmendja ndaj kësaj ndeshje ishte maksimale.

Plasi një “tifo” publike e paparë e padëgjuar ndonjëherë. Kush do të fitojë? Sa e famshme ishte Agjencia për shërbimet, po kaq në sensin e kundërt, forcës e egërsisë, ishte edhe banda e vëllezërve Xhejms. Në veçanti kryetari i bandës Xhesi Xhejms, i shquar për mizoritë e tij vihej ballë për ballë legjendarit Alen Pinkerton. Tashmë sfida ishte pranuar, të dy palët zbritën në arenë, kishte nisur një duel për jetë a vdekje midis ligjit dhe krimit. Pinkertoni hartoi një plan asgjësimi të bandës që si hap të parë do fillonte me goditjen e rrufeshme në strofullin e tyre dhe arrestimin e kapove Xhejms, në fermën ku banonin bashkë me familjet. Pinkertoni me qëllim e la në “qetësi” për një kohë të gjatë bandën, sigurisht studiointe veprimet e Xhejmsëve. Zbatimi i operacionit filloi në befasi, mbas afër një viti nga ngjarja. Me agjentët e vet të armatosur dhe disa vendas simpatizantë të tij, rrethoi fermën ku banonte Xhim Xhejmsi me vëllezërit,

¹⁶ Xhesi, Frank, Jakob ishin vëllezërit që krijuan bandën më të famshme në Misurin perëndimor shek XIX. Kjo bandë, grabiste banka, trena, vriste, mashtronte dhe u bë legjendë. Xhesi quhej një tip “*Robin Hud*” se gjoja grabiste për të ndihmuar të varfrit. Mbas vrasjes së tij nga një anëtar i bandës në 1882, banda filloi të shpërbëhej.

Sinjari, S.
« Alen Pinkerton, legjendë e policisë amerikane »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

mbasi u informua se ata ndodheshin brenda në banesë. Kur iu afruan shtëpisë sipas planit, hodhën nga dritaret disa mjete ndezëse tymuese për ti nxjerrë banditët jashtë që aty. Por fati s' ishte me pinkertonasit, sepse ndodhi diçka krejt e paparashikueshme, një aksident fatal që shënoi dështimin e operacionit. Njëra nga ndezëset që u hodh në banesën e banditëve, padashur shpërtheu, duke vrrarë aksidentalisht njërin nga fëmijët e tyre të moshës tetë vjeç e duke plagosur zonjën e shtëpisë. Përveç të tjerave, as Xhejmsët nuk ndodheshin në shtëpi, ndoshta ishin informuar për aksionin. Aleni u detyrua të tërhiqej me turp nga hakmarrja ndaj Xhejmsëve, e mbi të gjitha mori një goditje të madhe e të pariparueshme mbi vete. Kjo bëri që ta ndërpresë ndjekjen e kësaj bande duke ulur në sytë e publikut reputacionin e tij legjendar, si Alen Pinkertoni i madh dhe i pagabueshëm. Sigurisht, bashkë me të edhe agjencia që drejtonte.

Më e keqja erdhi më pas. Opinioni u kthye kundër *Pinkertonasvet* me kritika e sulme mediatike, ndaj metodave të tyre të ashpra e deri në mbrojtje të banditëve.

Legjenda Pinkerton filloi të jepte disa shenja venitje nga shkëlqimi i mëparshëm. Një tjetër ngjarje gjithashtu ndikoi negativisht në reputacionin e Agjencisë Pinkerton e do të thellonte akuzat, shpifjet e sulmet ndaj saj, kur Pinkertoni s' ishte gjallë. Kjo lidhet me shërbimet e Agjencisë ndaj Kompanive të mëdha në fushën e menaxhimit të grevave e të protestave të punëtorëve ndaj tyre, sigurisë e ndërmjetësimit me sindikatat. Që kur ishte Aleni kishte dyshime se Agjencia e pinkertonasve vepronte në interes të firmave e kompanive të mëdha gjatë grevave, në ndërmjetësimin me sindikatat, jo në dobi të punëtorëve. Ata konsideroheshin më tepër si agjentë të punëdhënësve se sa ndihmës të sindikatave punëtoare. Kjo u vërtetua sidomos në një grevë të vitit 1892, nga punëtorët e Kompanisë së shkrirjes së Hekurit e Çelikut në Pensilvani. Gjatë zhvillimit të grevës, treqind pinkertonasit e paguar për sigurinë u sollën me brutalitet ndaj grevistëve duke humbur kontrollin e shkaktuar viktima. Greva u shndërrua në një përleshje të dhunshme me tulla, gurë, me armë e madje me dinamit. Në përfundim të "betejës" u vranë dhe u plagosën një duzinë njerëzish¹⁷, nga të dy palët, punëtorë grevistë dhe agjentë pinkertonas.

Kjo ngjarje e paprecedentë, bashkë me të tjera që shtypi kishte filluar ti publikonte, morën dhenë dhe prestigji i Agjencisë Pinkerton¹⁸ u ul shumë, aq sa solli pasoja kryesisht në dy drejtime kryesore:

së pari, u vu në diskutim nëse duheshin lejuar agjencitë të menaxhojnë marrëdhëniet e punës, shkurt u propozua dhe u ndryshua ligji për shërbimet e Agjencive private duke kufizuar një numër të konsiderueshëm të numrit të këtyre shërbimeve sidomos me sindikatat e grevat;

së dyti, tashmë diskutohej prestigji i vet Alen Pinkertonit edhe pse në këtë ngjarje ai nuk ishte gjallë. Pinkertonasit filluan ti quajnë me ironi "*pinksa*" apo "*banditë të punësuar*". Edhe pse Agjencia mbijetoi dhe rikuperoi imazhin e vet, është ende në ditët tona nga më të njohurat në SHBA, këto ngjarje u stampuan në kujtesën publike. Prej atëherë, personaliteti i Alen Pinkertonit mori më tepër dritëhije.

Ai konsiderohet nga analistët e policisë si polic i vijës së ashpër, i tejkallimit të dhunës. Në karrierën e tij të gjatë dhe të larmishme ai u quajt patriot dhe tradhtar, polic i

Sinjar, S.
« Alen
Pinkerton,
legjendë e
policisë
amerikane »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

¹⁷ Beteja pasuese me grevistët çoi në vdekjen e shtatë agjentëve Pinkerton dhe nëntë punëtorëve të çelikut. Pinkertonasit janë përdorur si roje në firmat e qymyrit, hekurit e lëndës drusore në Illinois, Nju Jork, Pensilvani dhe Virxhinia Perëndimore, si dhe në grevën e madhe të hekurudhave të vitit 1877, ruajtës rendi pas djegies së Çikagos në vitin 1871. Organizata u quajt "Pinks" në mënyrë ironike nga kundërshtarët e saj.

¹⁸ Në këtë kohë A. Pinkertoni nuk ishte gjallë.

jashtëligjshëm dhe oficer i madh policie, mbrojtës e lirisë dhe mosrespektues i të drejtave, një aktivist politik i majtë që luftonte për gjendjen e punëtorëve dhe një punëmarrës i paguar nga bosët, një emigrant...dhe një prodhues fuçish. Por mbi të gjitha, ai ishte një detektiv.

Për një kohë të gjatë pinkertonasit u konsideruan në opinion si krahu i armatosur i bizneseve të mëdha. Dritë-hijet e punës së tyre mbetën dhe u reflektuan në biografinë e Pinkertonit. Ato analizohen nga specialistët e jetëshkruesit dhe mbi të gjitha, me personazhin e tij, u bënë objekt i librave policesk nga shkrimtarët e të gjitha kohëve.

Këto ngjarje dhe të tjera disfata në luftë me krimin, bandat e kriminelët më të rrezikshëm, nuk mundën t'ia errësonin meritat, kontributin e respektin që i ka ruajtur koha deri në ditët tona Alen Pinkertonit¹⁹, jo vetëm në SHBA, por në gjithë botën.

6. Alen Pinkertoni dhe policimi

Alen Pinkerton ishte një polic i madh i kohës, kur jetoi e punoi me agjencinë që ai krijoi. Veç ngjarjeve, që dëshmojnë për rolin e tij në sigurinë publike e trajtimin e çështjeve të rënda kriminale, për të njohur më mirë rolin e tij në fushën e policimit duhen marrë në konsideratë shkrimet e tij, librat që botoi vet, krahas çfarë shkruhet rreth tij nga jetëshkruesit.

Midis librave jo të pakët të Pinkertonit, si më të përmendur janë: tregimi i tij për udhëtimin e Linkoln në Uashington, në 1861; *“Molly Maguires and Detectives”* (1877); *“Thieves Professionals and Detective”* (1881); *“Spy of the Rebellion”* (1883); *“Bank robbers and Detectives”* (1883); *“30 years a detective”* (1884)... etj. Librat që shkroi vet janë një imitim i frymëzuar nga puna e detektivit francez E. F. Vidok - i cili gjithashtu shkroi shumë libra. Kjo ndoshta i ka dhënë shkas një pjesë të biografëve që të aludojnë për autorësinë e këtyre shkrimeve, sikurse për idhullin e tij francez. Por, nuk ka rëndësi se janë ose jo të shkruara nga autori në kopertinë. Rëndësi ka, sipas thënies, se çdo libër është një dije e re për atë që e lexon. Përmbajtja e tyre nuk ka dyshim se lidhet me ngjarje reale të policit Alen Pinkerton i cili vet thotë se ato përmbajnë vetëm të vërteta. Ai, ndryshe nga paraardhësi, nuk përshkruan vetëm ndodhitë e punës tij si detektiv, por edhe përgjithëson punën e policit, jep porosi në formën e këshillave të vlefshme për cilindo person që hynë në organizatën e policisë.

Meritat e A. Pinkertonit në policim lidhen me konceptin e organizatës policore që krijoi, me njerëzit që duhet të hyjnë e shërbejnë në polici, mënyrat e hetimit të rasteve të krimit, me disa parime të punës së organizatës policore me karakter detektiv privat etj.

Për policinë e SHBA-s ishin të pazakonta detektivet femra. Ishte Aleni që nisi rekrutimin e tyre në agjencinë e vet sepse sipas tij, ato mund të mbledhin më lehtë informacione në situata specifike. Ai e vlerësoi shumë agenten e parë femër K. Warne, e konsideronte të pazëvendësueshme në agjenci duke i bërë vlerësimin maksimal asaj.

Më vështirë ishte punësimi i personave të komunitetit afro-amerikan, në kohën kur u desh një luftë e civile për ta hequr me ligj skllavërinë, por jo diskriminimin si praktikë e mentalitetit²⁰. Pinkertoni i pari rekrutoi në organizatë të parin agjent shërbimi inteligjent

¹⁹ Pasi Alen Pinkerton vdiq në vitin 1884, kontrolli i agjencisë ra në dy djemtë e tij, Robert dhe William. Kompania vazhdoi të rritet nën drejtimin e tyre, dhe nga 1890, arriti në 2.000 detektivë dhe 30.000 rezerva, - më shumë burra se ushtria e Shteteve të Bashkuara. Frika se mos agjencia mund të kthehej si një ushtri mercenare private, shteti i Ohajos i nxori jashtë ligjit Pinkertonasit.

²⁰ Pas tre dekadash do të vinte në krye të policisë amerikane A. Wollmer i cili do të bënte kthesë rrënjësore.

Sinjari, S.
« Alen Pinkerton, legendë e policisë amerikane »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

me ngjyrë në SHBA, agjentin Xhon Skobell²¹.

Pinkertoni arriti në vitin 1870 të krijojë bazën më të madhe në botë për të dhënat e autorëve dhe historitë e ngjarjeve kriminale. Ky fond, mbi teknikat e kriteret e njohura nga Franca e Anglia, për shembull sistemi MO²², arriti një volum sa mbushi një bibliotekë të madhe penale, që i përdori më pas E. Huveri²³ për Byronë Federale të Hetimeve-FBI. E veçanta e metodës së Pinkertonit ishte mbledhja e shkrimeve e gazetave, thëniet e përshkrimeve të ndryshme që ndihmonin hetimin, identifikimin e personave, si shenjat e veçanta, armët që përdornin, metodat e punës, jetën dhe mjedisin e autorëve të veprave kriminale. Kjo mënyrë që njihet si “*Gallery Rogues*²⁴” konsiston në krijimin e një koleksioni të pasur tipash, të bashkëpunëtorëve të tyre, ekspertizave të ndryshme, një sistem i centralizuar që shërben për identifikimin kriminal, duke përdorur madje për herë të parë edhe fotografinë për këtë qëllim. Ai nuk arriti ta përfundojë një gjë të tillë, por ky koleksion dhe metoda e punës do të bëheshin bazë e kartotekës së FBI-s në të ardhmen. Këto dosje sot janë perfeksionuar nëpërmjet teknologjisë moderne kompjuterike.

Në librat që botoi ka përcjellë mesazhe për njerëzit e detektivët e rinj. Për rekrutimin e punonjësve të Agjencisë përpunoi një kod etik, i ngjashëm me rregulloret e ditëve tona në polici, ku përcaktohen kriteret e cilësi që duhet të ketë çdo i punësuar në të. Ai që njihet si kodi Pinkerton, është një shembull për rregulloret e pranimit të detektivëve dhe policëve të ardhshëm, sipas natyrës së organizatës.

Kodi Pinkerton nuk matet me parimet e policimit, të hartuara nga Robert Pil në Angli. Ato janë më tepër detyra e kriteret që kanë vlerë praktike në një organizatë policore. Kodi i tij është i ndërtuar në formë deontike²⁵, në ato drejtime që e mbrojnë punën detektive, agjencinë dhe agjentët e saj nga komprometimi. Në të përfshihen urdhra për mos bërjen kompromis me kriminelët, mos pranimin e rryshfeteve dhe të shpërblimeve për punën e kryer. Për një agjenci private këto janë po kaq të rëndësishme sa dhe puna që ata kryejnë. Në rregullat “Pinkerton” nuk u lejohej agjentëve të divorcoheshin dhe të bënin skandale që tërhiqnin vëmendjen e publikut dhe medie, sepse këto e dëmtonin shumë imazhin e tyre dhe të agjencisë që ata mund të përfaqësonin.

Edhe pse agjencitë e sigurisë ishin disa dhe në konkurrencë me njëra tjetrën, ai porosiste që me to duhet kemi partneritet sepse kështu i shërbehet më mirë ligjit. Bashkëpunimi e partneriteti me agjencitë lokale të zbatimit të ligjit vjen nga natyra e punës dhe rëndësia e saj. Informacioni nuk duhet të jetë pronë private nëse bëhet fjalë për të zbuluar e eliminuar një krim apo kriminel të regjur e të rrezikshëm.

Ndonëse Aleni punoi sa jetoi, deri në vitin 1884, dy djemtë e tij Robert dhe William, e vazhduan dhe lartësuan punën e tij.

Ende në SHBA, kjo agjenci mban emrin e krijuesit të saj dhe ka përhapje të konsiderueshme.

Sinjari, S.
« Alen
Pinkerton,
legjendë e
policisë
amerikane »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

²¹ Për agjentët zezakë, që ndihmonin forcat e Unionit përdorej termi “*Dispeçerat e zeza*”. Ata njihnin terrenin dhe lëviznin pa u vënë re; sipas gjeneralit Li, të Virginias, “Burimi kryesor i informacionit për armikun është përmes zezakëve tanë”. Ata ndihmuan shumë me informacione reale gjatë Luftës Civile.

²² Modus Operandi- sistem të dhënash që bazohet mbi gjërat që përsëriten, të ngjashmet, në veprimet kriminale.

²³ John Edgar Hoover, 1895-1972, drejtor i Byrosë Federale të Hetimeve (FBI) nga 1924 deri 1972, ndërtoi një agjenci me shumë efektivitet. Krijoi skedarin më të madh në botë me gjurmë gishtash; përdori vëzhgimin e mbledhjen e informacionit për të grumbulluar informacione të dëmshme dhe i mbajti të dhënat nën kontrollin e tij personal. Përdori posedimin e këtyre dosjeve sekrete për të mbajtur veten si drejtor i FBI-së dhe ishte në gjendje të frikësonte edhe presidentët duke kërcënuar se do të zbulonte informacione të dëmshëm rreth tyre.

²⁴ “*Gallery Rogues*”-Galeria e batakçinjëve.

²⁵ Deontike- e prerë, urdhërore.

7. Përfundime

Një skocez familjar e punëtor, një emigrant e biznesmen i ri, një njeri energjik me vullnet të palëkundshëm që me shumë sakrificë familjare arrin të prekë ëndrrën amerikane. Në kulmin e biznesit të tij, kur fare rastësisht bie në gjurmët e një bande kriminale, i vjen oferta të hyjë në polici. Kjo i ndryshon drejtimin e jetës dhe i zbulon disa aftësi të fjetura që e vendosin në një pedestal të ri, në atë të njerëzve më të shquar në polici. Ai do shkruante më vonë: *“Isha në gojën e të gjithëve dhe papritmas u gjeta i thirrur në çdo tremujor për të ndërmarrë çështje që kërkojnë aftësi detektive.”*

Rastësia jo vetëm, por edhe intuita e tij e pagabueshme, guximi, dëshira, vullneti dhe energjia e rritën A. Pinkertonin në lartësinë e policëve më të mëdhenj të kohës. Kjo rastësi ka vepruar pothuajse tek të gjithë njerëzit e shquar. Por ajo nuk vjen vetiu. Ajo vjen dhe e gjen njeriun e duhur në vendin e duhur kur ai rrethohet nga klima politike e profesionale e përshtatëshme. Kështu ndodhi me zgjedhjen e R. Pilit në krye të MET-Londër kur krijoi brigadën e *bobbs-ave* të famshëm; për E. Vidok në krye të “Sûreté Nationale”, i cili erdhi në polici nga ish i dënuar; disa dekada pas Pinkertonit do të ishte A. Wollmer që do bënte një transformim rrënjësor për arsimimin policor në SHBA, i cili erdhi në polici nga zjarrfikës e postier.

Shumica e figurave të shquara në HMP kanë suksese e të meta në punën e tyre, janë njerëz krejt të zakonshëm madje, mjaft të diskutueshëm. Kanë një gjë të përbashkët në veprat e tyre, se kanë bërë diçka të re në raport me paraardhësit. Kanë çarë për herë të parë në një rrugë të panjohur por që ka dhënë fryte e progres në policinë e gjithë vendeve dhe kohërave. Por në veprat e tyre shihen edhe defekte pjesë e natyrshme e suksesit të tyre. Kjo i bën më interesantë dhe më të fuqishëm këta individë, që shpesh i quajmë kontroversë. Gjejmë kritika të tepruara ndaj tyre edhe nga specialistë brenda policisë. Por të zbehësh arritjet, meritat e veprat e tyre pozitive nisur nga ndonjë dështim, veprim apo sjellje të rastësishme, është njëlloj sikur të mos shohësh pyllin mbrapa drurëve - sipas një fjale të urtë. Me Vidokun në Francë kjo filloi për shkak të së kaluarës së tij, pas një dezertimi nga ushtria. Pinkertoni dështoi me bandën e vëllezërve Xhejms për shkak të një aksidenti, që u fry tej mase nga mediet e kohës. Kjo solli tërheqjen e tij nga ndjekja, por banda i shtoi vrasjet e grabitjet deri sa kryetari i saj Xhesi Xhejms u vra nga vet anëtarët e kësaj bande. Sigurisht, tejkalimi i dhunës tashmë nuk është tipar i policisë moderne. Por në kohën e shthurjeve të mëdha, si në kushtet e Luftës Civile para e pas saj në SHBA, sikurse të Revolucionit të përgjakshëm në Francë apo mbas disa protestave të egra në Angli, përgjigja policore e dhunës me dhunë ishte më se e legjitimuar.

Koha ka qenë e mbetet gjykatësi më i mirë për veprën e gjithsecilit. Sot, *Agjencia Pinkerton*, është një nga më të njohurat në SHBA, vazhdon të zgjerohet në gamën e shërbimeve të sigurisë dhe vepron në mbi njëqind vende të botës, gjithmonë duke mbajtur e lartësuar emrin dhe veprën e Alen Pinkertonit²⁶.

²⁶ Shërbim shumë interesant sigurie i Agjencisë Amerikane Pinkerton startoi gjatë Matçit Botëror të Shahut, që po zhvillohet këto ditë në Londër, midis Kampionit të botës, norvegjezit M. Carlson dhe sfidantit amerikan F. Caruana. Federata Botërore e shahut FIDE nënshkroi partneritetin anti-mashtrim me Agjencinë Pinkerton në zhvillimin e garave botërore të shahut të rangut të lartë. Roli i Pinkerton do të jetë për të penguar mashtrimin ose aktivitetet të tjera që ofrojnë avantazh. Firma me bazë në SHBA do të zbatojë masa të tilla si skanimi i detektorëve të metalit, pastrimi i pajisjeve elektronike, ruajtja dhe mbikëqyrja, kontrolltet e skanimit të sfondit dhe mundet, sipas kërkesës së organizatorëve ose komisionit të apelimit, të vendosë testin e detektorëve të gënjeshtërës (poligrafike) nëse mashtrohet ose interferenca e jashtme dyshohet. Para ngjarjes, Pinkerton krijoi një vlerësim mbi mashtrimin në shah që përshkruan strategjitë e zakonshme të mashtrimit, incidentet e dukshme të mashtrimit dhe strategjinë më të mirë për ta luftuar atë.

Sinjari, S.
« Alen Pinkerton, legjendë e policisë amerikane »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

Referenca

1. Works by or about Allan Pinkerton at the Internet Archive.
2. G. Allen Foster, *John Scobell – Union Spy in Civil War*.
3. J. S. Dempsey, L. S. Forst, *An Introduction Policing*, Boston 2016.
4. [http://faculty.ncwc.edu/toconnor/205/205lect04.htm/Police History/ A Brief Guide To Police History/](http://faculty.ncwc.edu/toconnor/205/205lect04.htm/Police%20History/A%20Brief%20Guide%20To%20Police%20History/)
5. Manual për Policimin në Komunitet, SIPU-2015
6. Heywood, Andrew, *Politika*, 2nd edition, Tiranë 2008.
7. Foucault, *Anthropologies of Modernity, Governmentality, and Life Politics*, (red.) Jonathan Xavier Inda, Blackwell Publishing 2005.
8. Alec McHoul and Wendy Grace, *A Foucault Primer Discourse, Power and the Subject*, London and NewYork, Routledge 2002.
9. <https://www.vocabulary.com/dictionary/detective> (mars 2018).
10. <https://www.britannica.com/biography/Allan-Pinkerton>.
11. <http://www.kosovapress.com/sq/lajme/perfundimi-i-luftes-civile-ne-SHBA-para-151-viteve-126838/> (mars 2018).
12. <https://www.britannica.com/topic/police/The-history-of-policing-in-the-West> (mars 2018).
13. <https://www.britannica.com/contributor/Thomas-Whetstone/5819> (mars 2018).
14. https://en.Wikipedia.org/wiki/Allan_Pinkerton (prill 2018).
15. https://en.Wikipedia.org/wiki/John_Scobell.
16. <https://blog.eogn.com/2017/07/25/the-unusual-cause-of-death-of-allan-pinkerton/> (mars 2018).
17. https://en.wikipedia.org/wiki/Black_Dispatches.
18. http://www.americaslibrary.gov/jb/nation/jb_nation_pinkerto_1.html
19. https://sq.Wikipedia.org/wiki/Lufta_Civile_Amerikane.
20. <https://www.britannica.com/biography/J-Edgar-Hoover>.
21. https://books.google.al/books?id=W4TCBAAA_QBAJ&lpg=PA7&pg=PA7&redir_esc=y&hl=en#v=onepage&q&f=false botimi i tetë (qershor 2018).
22. <https://books.google.al/books?isbn=0571279627> (mars 2018).
23. <http://www.adamsfunds.com/about/history/>.
24. Pinkerton Named Official Fair Play Partner (Nov 16 - 1:52 PM).



Sinjari, S.
« Alen
Pinkerton,
legendë e
policisë
amerikane »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

Ndikimi i madhësisë së një shteti kundrejt sigurisë dhe faktorit gjeopolitik



■ **Msc. Qetësor Gurra**
Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit.
qetesor.gurra@asp.gov.al

■ **Msc. Jonida Gurra**
Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit
gurrajonida7@gmail.com

Abstrakt

Në këtë punim do të trajtohet rëndësia e pozitës gjeopolitike të Shqipërisë në vendimmarrjen dhe pozicionimin e shteteve të rajonit dhe më gjerë kundrejt saj. Do të përmenden shkurtimisht përpjekjet dhe serioziteti për të aderuar dhe qenë dinjitoz ndaj organizmave ndërkombëtare. Për të shënjestruar objektin kryesor të këtij referimi do të jepen shembuj të hijshëm të cilët do të demonstrojnë më së miri se vogëlsia e një shteti ndonjëherë kushtëzton epërsinë e shteteve të mëdha ashtu sikurse e kundërta. Nëse diplomacia do të shpалosë zgjuarsi dhe një teknikë të mirëmenduar së paku nëse do të mbartë vështirësi rritja e aksioneve të një shteti, ato pak që mund të gjenden të gëzojnë respektin, konsideratën përkrah rivalëve dhe oponentëve. Në konkludim do të përmenden rekomandime të cilat mund të merren në konsideratë në varësi të rrethanave.

Fjalëkyçe:

pozitë gjeopolitike, epërsi, diplomaci, taktikë, avantazh.

Gurra, Q.
Gurra, J.
« Ndikimi
i madhësisë
së një shteti
kundrejt
sigurisë
dhe faktorit
gjeopolitik »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

1. Hyrje

Vendndodhja e Shqipërisë në qendër të një udhëkryqi natyror të korridoreve të mëdha tranziti në Evropë, e vendos vendin tonë në një pozicion gjeografikisht strategjik. Ajo lidh vendet perëndimore mesdhetare me vendet e Ballkanit dhe të Azisë. Ky pozicion gjeostrategjik në Ballkan dhe Evropë konsiderohet si një portë lidhëse ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit. Gjithnjë historia ka dëshmuar për lakminë që shtetet kanë pasur ndaj territorit tonë aq të vogël, por të pasur me një kompleksitet vlerash dhe benefitesh të mbledhura tok. Luftëra të përgjakshme e deri në ditët e sotme diplomaci të sofistikuar për të arritur qëllime të caktuara në arenën ndërkombëtare.

A mundet një shtet i vogël të mbrojë interesat e saj më të larta pa qenë e nevojshme të mohojë një pjesë të këtyre të fundit për të fituar përkrahje nga shtete të fuqishme. A ka vlerë potenciali i një shteti të vogël? A cenohet lehtësisht siguria e shtetit nga fenomene të ndryshme botërore dhe rajonale? Këto dhe shumë të tjera do të trajtohen në vijimësi duke sjellë shembuj nga shtete të vogla të cilat ja kanë dalë të jenë një shembull shumë i mirë mirëqenieje dhe aleatë të leverdishëm.

Ashtu sikurse do të gjykohet, se sa elastike duhet të jetë vendimmarrja dhe pozicionimi i shteteve të vogla ndaj shteteve të mëdha. Së fundi do të parashtrohen rekomandime dhe konkluzione marrë nga shembuj konkrete dhe zgjidhje alternative të përshtatshme në çdo rast.

2. Gjeopolitika e shteteve të vogla nën petkun ndihmës të shteteve të mëdha

Në gjeopolitikë si në pasuri të patundshme në konsideratë kritike është “vendndodhja, vendndodhja, vendndodhja”. Për një fuqi të madhe, pasuria më e madhe e një vendi

**Gurra, Q.,
Gurra, J.**
« Ndikimi
i madhësisë
së një shteti
kundrejt
sigurisë
dhe faktorit
gjeopolitik »

Policiimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

mund të jetë më shumë koordinata e saj e hartave sesa madhësia e arsenalit apo llogarisë së saj bankare. Gjeografia ka rëndësi kur është fjala për integrimin ekonomik, transportin, shpërndarjen e energjisë dhe sigurisë fizike. Edhe në një botë të digitalizuar, liria për të lëvizur njerëzit, mallrat dhe shërbimet nëpër hapësirë fizike janë një mall i vlefshëm.

Duke njohur rëndësinë e lidhjes së pikave në terren nuk është një argument për sferat e vështira të kontrollit (si gjatë Luftës së Ftohtë) ose për të mbushur botën (si merkantilistët e shekullit të shtatëmbëdhjetë). Nga ana tjetër, duhet të bëhet një rast për ndërtimin e urave midis kombeve të një mendjeje që duan të jetojnë së bashku me siguri në tregti dhe të ndajnë kufijtë paqësorë. Kështu, një shtet i vogël në vendin e duhur mund të jetë shumë i rëndësishëm për një fuqi të madhe. Islanda është një çështje në këtë pikë. Megjithatë nuk ka forca të armatosura, vendndodhja e ishullit e bën kombin një element kyç në sigurinë transatlantike. Kjo është arsyeja që Islanda është përfshirë si një nga dymbëdhjetë anëtarët themelues të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior. Pa dyshim, vendndodhja strategjike e Islandës¹ është shumë më e rëndësishme për sigurinë e SHBA sesa madhësia e shtetit dhe burimet që do të lakmoheshin. Uashingtoni duhet të punojë shumë për ta bërë këtë marrëdhënie dypalëshe edhe më të fortë.

Një pjesë e arsyes që NATO vazhdon të mbajë derën e anëtarësimit të hapur është për shkak se ende nuk janë të përfshira shtete, anëtarësimi i të cilëve do të rriste sigurinë kolektive për shkak të vendndodhjes së tyre. Këto përfshijnë Maqedoninë, Gjeorgjinë, Ukrainën dhe Shqipërinë. Ka shtete në rajone të tjera ku marrëdhëniet dypalëshe më të forta do t'i shërbenin shumë interesave të SHBA. Për shembull, lidhje më të ngushta me Bangladeshin dhe Sri Lankën do të bënin përpjekje të mëtejshme të SHBA për të mbështetur një Indo-Paqësor të lirë dhe të hapur². Në Lindjen e Mesme, pak shtete janë më të vogla se Jordania. Megjithatë, një Jordani paqësorë dhe e begatë është një gur themeli për stabilitetin rajonal dhe ky i fundit është një interes jetik i Shteteve të Bashkuara. Tunizia gjithashtu është një shtet i rëndësishëm për zgjerimin e një ombrellë të stabilitetit rajonal në Lindjen e Mesme më të madhe në Afrikën e Veriut.

Vendet përkrahëse dhe bashkëpunuese bëjnë partnerët më të mirë. Një ndër objektivat themeltare të NATO-s janë aleancat e shëndetshme të shteteve të lira kombëtare. Arsyetimi themelor i aleancës transatlantike është se shtetet e lira kanë të drejtë të bashkëpunojnë për qëllime të sigurisë kolektive. Për të hapur derën e NATO-s kryefjala e kësaj organizme të fuqishme do të ishte: e drejta e popujve të lirë për të zgjedhur të ardhmen e tyre.

Po kështu, arritja e një Indo-Paqësori të lirë dhe të hapur kërkon një derë të hapur për shtetet e një mendjeje të madhe dhe të vogla që ndajnë atë qëllim. Pra, për shembull, edhe pse Shtetet e Bashkuara mbështesin fuqimisht iniciativën diplomatike të njohur si përpjekja "Quad" nga Japonia, Australia, India dhe Amerika për të nxitur lirinë e deteve dhe respektimin e normave ndërkombëtare³ - këta partnerë strategjikë duhet të krijojnë një qilim dashamires për kombe të tjera të interesuara për të marrë pjesë në dialog. Për më tepër, në Lindjen e Mesme, administrata Trump ka hedhur nocionin e një grupi më formal të partneriteteve në të cilat vendet e vogla mund të lidhen lirshëm. Në veçanti, Shtetet e Bashkuara i janë drejtuar anëtarëve të Këshillit të Bashkëpunimit të Bregut të Gjirit, duke ndriçuar vlerën e vendeve që bashkëpunojnë lirisht duke u bashkuar së

**Gurra, Q.
Gurra, J.**
« Ndikimi
i madhësisë
së një shteti
kundrejt
sigurisë
dhe faktorit
gjeopolitik »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

¹ Cooper, A.F. and Shaw, T.2013.The Diplomacies of Small States at the Start of the Twenty-first Century,f. 18.

² Ibid, f. 19.

³ Baldacchino, G. (2013). Thucydides or Kissinger? A Critical Review of Small State Diplomacy", in A. F. Cooper and T. M. Shaw (eds.) *The Diplomacies of Small States*, Houndmills: Palgrave, f. 21.

bashku në kauzën e përbashkët për të mirën e rajonit.

Kombet e vogla mund të jenë kontribuues neto për paqen, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik. Për shembull, një kujtesë e dhimbshme e kohëve të fundit për këtë ishin tre ushtarët e guximshëm çekë që vdiqën kohët e fundit në Afganistan duke e mbajtur barrën së bashku me aleatët e tyre amerikanë. Strategjia e Sigurisë Kombëtare e administratës njihet që Amerika është një fuqi globale me interesa dhe përgjegjësi globale. Zbatimi i kësaj strategjie kërkon një përpjekje të sigurt dhe të qëndrueshme për të mbështetur interesat amerikane dhe për të promovuar stabilitetin në tri rajone kyçe: Evropa, Lindja e Mesme dhe Indo-Paqësori. Edhe me gjithë fuqinë e saj, Amerika nuk mund të jetë mjaft e fortë në të tre vendet gjatë gjithë kohës pa miq të fortë, aleatë dhe partnerë strategjikë. Prandaj, fuqitë e vogla mund të ndihmojnë barrën e barrës duke shtuar aftësi shtesë të rëndësishme. Në Afganistan, për shembull, disa kombe të vogla si Gjeorgjia - mbajnë më shumë se mbajnë peshën e tyre. Një shembull tjetër është Kroacia, e cila kohët e fundit bleu një krah të F-16⁴.

Kjo do t'i japë këtij vendi të vogël një aftësi serioze për të mbështetur misionet rajonale të policisë ajrore. Përveç aseteve ushtarake, vendet e vogla mund të kontribuojnë në krijimin e infrastrukturës. Ata gjithashtu mund të shtojnë rritjen ekonomike rajonale, integrimin si dhe diversifikimin e furnizimit me energji, forcimin e lagjeve në të cilat jetojnë. Për shembull, zhvillimi i Kroacisë për një terminal të lëngshëm të gazit natyror mund të jetë një kontribut i rëndësishëm për sigurinë rajonale të energjisë.

Shtetet e Bashkuara kanë një avantazh të pandarë në lidhje me kompetencat kundërshtarë në partneritet me vendet e vogla. Kina dhe Rusia nuk kanë aleatë. Ata kanë nënshtetësi. Asnjë vend nuk dëshiron të jetë një periferi e Pekinit apo Moskës. Amerika, megjithatë, duhet të përmirësojë lojën e saj. Zakonisht ndiqen taktika të mirëfillta si⁵:

Hapi 1. Vendosja e objektivave, e drejta për miqtë. Në reduktimin e dobësive të miqve, aleatëve dhe partnerëve strategjikë ndaj ndikimeve kontradiktore, objektivat amerikane duhet të përshtaten më pak në nxitjen e rezultateve ose agjendave të veçanta politike (p.sh. promovimi i barazisë së martesës) sesa në arritjen e qeverisjes së mirë të qëndrueshme, institucioneve të forta dhe reduktimit të korrupsionit. Kjo do t'i bëjë partnerët tanë më të qëndrueshëm dhe më të sigurt. Shmangni “ne” ose “ata”. Qëllimi i një strategjie të shtetit të vogël nuk është të përjashtojë konkurrentët kundërshtarë. Për shembull, Amerika nuk mund t'i kërkojë vendeve që të mos bëjnë biznes me Kinën. Në fund të fundit, Shtetet e Bashkuara kanë biznes me Kinën. Qëllimi nuk është që vendet të marrin anët, por të angazhohen dhe t'i ndihmojnë ata të veprojnë në përputhje me interesat e tyre, duke përjashtuar, për shembull, angazhimin ekonomik të dëmshëm për sigurinë kombëtare ose që minon sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë.

Hapi 2. Nxitja e lirisë ekonomike. Kina dhe Rusia mund të blejnë ndikim, sepse në vendet e varfra me qeverisje të dobët, me pak para shkon shumë larg. Mënyra më e mirë për t'i bërë këto shtete më rezistente ndaj ndikimit të keq është ndihmesa që ata të bëhen më të pasur dhe të qeverisur më mirë. Kjo realizohet më së miri duke nxitur lirinë ekonomike.

Hapi 3. Hyrja në Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë (MTL). Marrëveshjet e tregtisë në

⁴ Wivel, A., & Oest, K. J. N. (2010). "Security, profit or shadow of the past? Explaining the security strategies of microstates", Cambridge Review of International Affairs, f. 421.

⁵ Environmental security and small states", in C. Archer, A. Bailes and A. Wivel (eds.) Small States and International Security: Europe and Beyond, 2013, f. 97.

thelb duhet të jenë në lidhje me liberalizimin e tregtisë dhe krijimin e tregjeve më të lira. Dhënia e përparësisë marrëveshjeve me shtetet, ku Shtetet e Bashkuara po kërkojnë miqësi dhe ku shkaku i përbashkët ka kuptim. Amerika, për shembull, duhet të ketë një MTL me Tunizinë.

Hapi 4. Të jenë atje. Në shumë vende të vogla, me mendime të ngjashme, Shtetet e Bashkuara duhet të kryejnë vendimmarrje për të fituar miq, thjesht, sa për të qenë atje. Shumë angazhime amerikane mbështeten në ndihmën e huaj, dhe jo të mjaftueshme, në ndërtimin e marrëdhënieve njeri-njeri dhe të një pranie më të fuqishme nga sektori privat i SHBA.

Hapi 5. Ndërtimi i një akti më të mirë BUILD. Akti BUILD duhet të bënte angazhimin ekonomik, ndihmën dhe promovimin e investimeve të sektorit privat në SHBA për të konkurruar me Kinën dhe Rusinë. Kjo do të ishte shumë e dobishme për zbatimin e një strategjie të shtetit të vogël. Fatkeqësisht, ligji BUILD përmban të meta serioze që mund ta kthejnë atë në një iniciativë tjetër të fryrë, të papërgjegjshme të qeverisë.

Hapi 6. Zgjerimi i shkëmbimeve njerëz-popuj. Një shembull i mirë për vendin ku Amerika ka rënë në këtë fushë është dështimi i qeverisë për të zgjeruar programin e heqjes së vizave që promovon shkëmbimin e turizmit dhe të biznesit midis kombeve. Qëllimi i Shteteve të Bashkuara duhet të jetë i tillë që të përfshijë të gjithë miqtë dhe partnerët strategjikë në këtë program, i cili promovon udhëtime më të sigurta, si dhe inkurajimin e shteteve me prirje për të forcuar lidhjet e tregtisë dhe kulturës.

Hapi 7. Promovimi i institucioneve thelbësore. Sigurisht, është më mirë nëse partnerët e Amerikës janë shoqëri të forta dhe të lira. Një pjesë e strategjisë së shtetit të vogël duhet të ndihmojë mbrojtjen e demokracive nga ndikimet e jashtme keqdashëse. Shtetet e Bashkuara duhet të kërkojnë të sigurojnë qëndrueshmërinë e institucioneve dhe infrastrukturës (si sistemet elektronike të votimit) që janë kritike për miqtë, aleatët dhe partnerët strategjikë të SHBA, të cilët përballen me rreziqe të mëdha. Kina dhe Rusia përdorin të dyja dezinformimet dhe masat aktive për të ushtruar pushtet të mprehtë. Fuqia e mprehtë është një kërcënim strategjik dhe Uashingtoni duhet të ketë objektiva specifike për të kundërshtuar më të këqijat e Kinës dhe ndërhyrjen strategjike të Rusisë.

Hapi 8. Qeverisja/të drejtat e njeriut në vendin e duhur në rendin e ditës. Nga njëra anë, jo të gjitha shtetet e vogla që Shtetet e Bashkuara duhet të bëjnë partnerë janë të lirë nga grindjet e brendshme. Nga ana tjetër, jo çdo herë që Amerika është përpjekur të ndihmojë me çështje të tilla ka ndihmuar. Administrata e Bushit kishte një agjendë të trazuar të promovimit të demokracisë. Obama bëri një fjalim mbresëlënës për lirinë në botën myslimane, e cila u pasua nga përpjekje shumë pak për të çuar përpara çështjen e lirisë në botën myslimane.

Në vend që të përqendrohet eksplicite në promovimin e demokracisë dhe zbulimet e praktikës demokratike (p.sh., zgjedhjet dhe partitë politike), agjenda amerikane duhet të përqendrohet në bazat e lirisë: (a) qeverisja, p.sh., lufta kundër korrupsionit dhe mbrojtja e infrastrukturës dhe institucioneve forcimin e shoqërisë civile dhe (b) të drejtat themelore të njeriut. Amerika duhet të marrë edhe partneritetet e saj. Në disa raste, organizatat joqeveritare (OJQ) bëjnë partnerë të mirë. Në të tjerat, për të qenë të sinqertë, ata krijojnë më shumë probleme sesa zgjidhin. Fondacioni i Shoqërisë së Hapur (OSF) është një rast i rëndësishëm. OSF dhe një nga përfituesit më të mëdhenj të organizatës, George Soros, janë subjekt i një polemike të konsiderueshme. Disa kanë bërë thirrje për sulme ndaj mbështetjes së George Soros për grupe të tilla si “demonizimi i filantropisë”. Ky debat mënjë, ka një pyetje të ndershme për t’u pyetur

**Gurra, Q.
Gurra, J.**
« Ndikimi
i madhësisë
së një shteti
kundrejt
sigurisë
dhe faktorit
gjeopolitik »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

nëse OSF është një përshtatje e mirë për një politikë të jashtme amerikane jopartiake. Në fund të fundit, qeveria e SHBA duhet të sigurojë që partneritetet e saj me OJQ-të janë produktive dhe në përputhje me interesat amerikane.

Hapi 9. Bërja më mirë e diplomacisë publike. Ka pak pyetje nëse Presidenti Trump e sheh komunikimin strategjik si një mjet të rëndësishëm të avancimit të politikave të tij. Por, ai duket se nuk ka shumë interes për të promovuar një narrativë strategjike të madhe për ndonjë gjë, - e lëre më se si të merren me shtetet e vogla. Trump përdor zërin e presidencës për një shumëllojshmëri të qëllimeve taktike afatshkurtra. Qeveria e SHBA nuk mund të mbështetet në fuqinë e selisë së Shtëpisë së Bardhë për të ngjyrosur tregimin se si amerikanët do të bashkohen me shtete të vogla. Diplomacia publike si pjesë e kësaj përpjekjeje, nuk do të funksionojë mirë. Duhet të ketë një strategji të integruar të diplomacisë publike, për të përllogaritur këtë të fundit dhe shumë zëra amerikanë duhet të jenë pjesë e shtrirjes së vogël të shtetit.

Hapi 10. Shiko përtej. Vendet e vogla janë veçanërisht të prekshme ndaj efekteve me qëllimkeqë të iniciativës ruse dhe kineze. Gjë e mirë është se dobësitë e iniciativës po bëhen gjithnjë e më të dukshme. BRI i mungon transparenca dhe sjell me vete korrupsion dhe rritje të borxhit. Kjo krijon mundësi për Shtetet e Bashkuara të shkojnë në ofensivë me fushatat informative që nxjerrin në pah ndikimet joliberalë të Kinës. Në të njëjtën kohë, Uashingtoni duhet gjithashtu të ndihmojë partnerët e SHBA që të identifikojnë rreziqet e influencës ruse dhe investimet ekonomike në sektorët kyç, si energjia; rreziqet që mund të kërcënojnë sigurinë kombëtare dhe qeverisjen e mirë të kombeve të vogla.

3. Pozicionimi gjeopolitik i Shqipërisë në rajon dhe më gjerë

Autori Samuel P. Huntington e konsideron shkallën e ndikimit shoqëror e politik të Perëndimit një prej premisave të procesit të demokratizimit për vendet në tranzicion. Më vonë, Larry Diamond & Marc Plattner do të flisnin për nevojën e angazhimeve ndërkombëtare të këtyre vendeve. Kriteret e Kopenhagenit (Këshilli European 1993) të sanksionuar në nenet 6 (1) dhe 49 të Traktatit të BE-së kërkuan për vendet në tranzicion nxitjen dhe mbështetjen e një ekonomie tregu funksionale, kapacitetin për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut të BE-së, aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit në BE, si dhe rëndësinë, jo vetëm të përfshirjes së “acquis communautaire” në legjislacionin kombëtar, por dhe sigurimin e zbatimit të tij efektiv përmes strukturave të përshtatshme administrative dhe juridike⁶. Më herët, Traktati i Maastrichtit më 1992 kishte të bënte kryesisht me aftësitë menaxheriale për vendet që donin të hynin në Eurozonë, me Kriteret e Konvergjencës. Më pas u përqafuan programe të BE-së, si CARDS (që prej 2001)⁷, Asistenca e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilitet, si një prej instrumenteve kryesore financiare të BE-së për vendet e Ballkanit, MSA, si dhe një sërë programesh të tjera. Asistenca konsistoi në fusha të tilla, si: drejtësia, rendi publik, menaxhimi i kufijve, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, ndërtimi i kapaciteteve administrative, zhvillimi ekonomik e social, mjedisi, burimet natyrore dhe stabiliteti demokratik.

Pas vitit 1990, Shqipëria njohu dhe pranoi rolin e faktorëve ndërkombëtarë në

⁶ Vala e tretë, Tonin Gjuraraj, 2013, f. 12.

⁷ Ibid f. 12.

*Gurra, Q.,
Gurra, J.*
« Ndikimi
i madhësisë
së një shteti
kundrejt
sigurisë
dhe faktorit
gjeopolitik »

Polici
dhe
Siguria
nr.14, 2019

zhvillimet e brendshme, nisjen e reformave të vështira të “imponuara” prej Perëndimit, bashkëpunimin me shtete dhe organizata të huaja, implikimin dhe ndikimin prej ngjarjeve dhe zhvillimeve ndërkombëtare. Vendi u përfshi në procese integruese me BE-në, NATO-n, FMN-në, BB-në, organizata të tjera, si dhe në rrjete të ndryshme globale, brenda kuadrit të marrëdhënieve ndërkombëtare me lidhje shumëpalëshe dhe dypalëshe. Në fakt, sektorët kryesorë të ekonomisë shqiptare, përveç ndërtimit ndoshta, *de facto* kaluan në duart e kapitalit të huaj, veçanërisht sistemi bankar, pjesërisht sektori energjetik, telefonia celulare etj.⁸ Megjithatë, përtej hapjes dhe vendosjes së kontakteve e marrëdhënieve me ndërkombëtarët, disa prej reformave mbetën ende të paplota dhe të paqëndrueshme, kurse tranzicioni i tejzgjatur.

Në këtë kontekst, roli i ndërkombëtarëve, veçanërisht i Perëndimit, gjatë tranzicionit shqiptar meriton një analizë të veçantë. Ka pasur një indiferencë të ndërkombëtarëve për të ofruar zgjidhje të arsyeshme ndaj shumë çështjeve problematike në Shqipëri. Për shembull, të kishte pasur një ndërhyrje më vendimtare të ekspertëve ndërkombëtarë të ekonomisë, të cilët këshillonin qeverinë shqiptare midis viteve 1992–1997, rënia tragjike e skemave piramidale ndoshta mund të ishte shmangur. Po ashtu, komuniteti ndërkombëtar, me shumë zyra dhe ekspertë në Tiranë, ka qenë përgjegjës për kryerjen e përmirësimeve në Kodin elektorale të vendit, megjithatë situata mbeti shpesh e tensionuar midis forcave politike, përfshirë dhe debatin për (mos)balancimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Reforma zgjedhore është nxitur dhe udhëhequr gjithnjë prej OSBE/ODIHR-it, autoritetet dhe ekspertët e saj në Tiranë⁹. Ky ka qenë një disavantazh që ka vonuar procesin e ndryshimit domethënës në vend, zhvillimin dhe progresin drejt integritimit evropian.

Mospërfillja e të huajve ushqueu tek qytetarët shqiptarë një gjendjeje pakënaqësie, pesimizmi dhe mungesë durimi, përforcuar kjo edhe me faktin se ata nuk kishin gëzuar për shumë vite avantazhet e lirisë. Shpresat e shqiptarëve më 1990 ishin të larta, kurse besimi i tyre tek bota perëndimore ishte i fortë, duke krijuar kështu një hendek të madh midis shpresave për një jetë më të mirë dhe sfidave të tranzicionit në vend. Me qëllim zbutjen e pasojave të reformave të ndërmarra, një ndihmë më konkrete dhe më e ndershme nga jashtë ishte, jo vetëm e nevojshme, por dhe e ngutshme. Organizata dhe qeveri të ndryshme ndërkombëtare shprehën përkrahje verbale për demokracinë në Shqipëri, por rrallë përkrahja e tyre u pasua me veprime konkrete. Nuk mund të mohohet roli i OSBE/ODIHR-it sa i takon kontributit për të përmirësuar procesin zgjedhor në Shqipëri, por ambiguiteti i kësaj organizate shkaktoi konfuzion në përcaktimin e statusit të së dyja zgjedhjeve, të përgjithshme dhe lokale. Ka pasur gjithnjë besim më të madh të opinionit publik shqiptar tek NATO e BE, jo dhe aq tek OSBE/ODIHR-i, edhe pse kjo e fundit kishte ndikim të drejtpërdrejtë tek institucioni i zgjedhjeve, si themeli i demokracisë në një vend në tranzicion. Po ashtu, u dallua qartë besimi i palëkundur tek Brukseli, jo tek Tirana dhe institucionet e klasa e saj politike.

Në të gjitha progres-raportet e BE-së, faji pothuajse i vishet tërësisht politikës shqiptare, jo institucioneve ndërkombëtare. Paradoksalisht, ka qenë pikërisht klasa politike, që edhe pse delegjitimohej gjithnjë nga brenda, prej qytetarëve të saj, kërkonte legjitimim nga jashtë dhe kjo, në fakt, “pranohej” nga Brukseli. Përtej përkushtimit verbal për Europën, standardet dhe institucionet e saj, studiuesi Ardian Vehbiu ka të drejtë kur argumentonte se orientimi i elitës politike shqiptare drejt Europës nuk ishte

⁸ Vala e tretë, Tonin Gjuraraj, 2013, f. 13.

⁹ Ibid, f. 14.

për arsye idealiste apo e motivuar filozofikisht, por duke luajtur kartën e integritit në BE, synimi i saj i vetëm ishte të legjitimonte dhe të zgjaste pushtetin e saj.

Megjithatë, BE-ja mbeti aktori demokratizues më i dukshëm i jashtëm, modeli i së cilës mbeti më tërheqës se organizatat e tjera, sepse këto vende janë të stabilizuara dhe demokratike. Përveç kësaj, BE-ja ka edhe kondicionalitetet, në kuadër të përmbushjes së kriterëve të perspektivës për anëtarësim në rrafshin politik, të ndihmës financiare dhe përdorimit të sanksioneve të ndryshme. Fuqia e ndikimit të BE-se qëndron tek europianizimi i institucioneve, strukturave dhe politikës së brendshme shqiptare. Vetëm BE-ja shihet si garanci për demokracinë, me institucionet e saj, si modeli më i mirë i administrimit dhe organizmit institucional e legjislativ. Duke mbështetur BE-në, shqiptarët arritën të kuptonin se mbikëqyrja e Europës nuk cenon sovranitetin e vendit, as dinjitetin e tij, por, përkundrazi, kjo ndikon në zhvillimin e vendit dhe kalimin nga tranzicioni drejt konsolidimit demokratik.

Kur Shqipëria vendosi të mos marrë armët kimike të Sirisë, ajo e futi veten në radhën e vendeve që mund të marrë vendime të pavarura. Ky mund të ishte ndoshta edhe momenti kur nuk duhet të priten më tej favore për çdo gjë, por ato duhet të meritohen. Çmimi i vendimeve që merren në marrëdhëniet ndërkombëtare, ka parasysh edhe pasojat e tij, cilado qofshin ato. Në (mos)dhënien e statusit nuk duket të kenë pasur ndikim SHBA, por anëtarësimi në NATO u akordua, edhe si “dhuratë” për interesa të caktuara, gjë që i kontribuoi vendit në shumë aspekte të zhvillimeve të brendshme demokratike, atyre rajonale e më gjerë. Shqipëria, pas këtyre dy ngjarjeve, përtej luftës së palëve politike, duhet të kuptojë se gjithçka fitohet vetë, por me një lobim të fortë tek ndërkombëtarët që na duan. E njëjta gjë vlen dhe për FMN-në dhe raportet me të, duke mos harruar se ajo “kontrollohet” në një masë të konsiderueshme prej SHBA-së. Në diplomaci, nëse tregohesh i fortë, atëherë duhet t’i dalësh zot vetes.

Që nga 2014 Shqipëria është një shtet kandidat zyrtar për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Përgjigja pozitive ndaj kandidaturës së Shqipërisë për anëtarësimin në BE e ka çuar vendin në një fazë përgatitore për negociatat që kërkojnë mbështetje të mëtejshme për procesin e integritit evropian. Ekziston nevoja për të thelluar njohuritë e popullatës shqiptare rreth procesit të integritit dhe ndikimit të lidhur me anëtarësimin në BE. Me publikime përkatëse dhe diskutime të hapura FES Tirana informon publikun për përparimin në procesin e pranimit.

Kur bëhet fjalë për politikën e sigurimit dhe të mbrojtjes të vendeve anëtare të BE-së, një angazhim i ripërtërirë mund të vërehet brenda Bashkimit Evropian. Tani është një nga prioritetet kryesore të BE-së për të forcuar aftësitë evropiane të sigurisë dhe të mbrojtjes - duke marrë parasysh jo vetëm kornizën e politikave por edhe bazat përkatëse. Në Shqipëri, shohim rëndësinë për të nxitur diskutimet rreth çështjeve të sigurisë përmes një dialogu publik ku përfshihen aktorët përkatës kombëtarë dhe ndërkombëtarë në këtë fushë.

Së fundmi, Shqipëria mund të jetë një lider në rajon kur është fjala për sigurimin e kontributeve konkrete për sigurinë dhe stabilitetin në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

4. Si mund të jenë shtetet e vogla të përshtatura me shtetet e mëdha

Treqind vjetët e fundit të historisë së marrëdhënieve ndërkombëtare u karakterizuan nga lufta midis fuqive të mëdha për të zgjeruar sferat e tyre të ndikimit në pjesë të

**Gurra, Q.,
Gurra, J.**
« Ndikimi
i madhësisë
së një shteti
kundrejt
sigurisë
dhe faktorit
gjeopolitik »

Polici
dhe
Siguria
nr.14, 2019

ndryshme të botës. Objektet kryesore në kuadrin e asaj konkurrence ishin vendet dhe popujt e vegjël që nuk mund të përballonin luksin e pavarësisë dhe prandaj, ata gjithmonë kanë qenë në orbitën e ndikimit të fuqive dhe perandorive të mëdha. Historia tregon se vendet e vogla në zonat e interesit të shteteve më të mëdha shpesh janë kërcënuar me asgjësim të plotë. Pasojat e kolonizimit të Britanisë së Madhe të Irlandës çuan në uri të madhe, e cila vrau më shumë se një milion njerëz. Kontradiktat në Evropë çuan në dy luftërat botërore, duke rezultuar në gjenocidin e popullit armen në Turqinë osmane, si dhe Holokaustin e hebrenjve evropianë të kryer nga Gjermania naziste¹⁰.

Pas disfatës së Rajhut të Tretë, disa iluzione u ngritën për një realizëm të ri që do të merrte parasysh mësimet e luftës tragjike. Megjithatë, as krijimi i Kombeve të Bashkuara me parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe as procesi i dekolonizimit nuk mund të ndryshojë këto rregulla të vështira të luftës midis fuqive të mëdha. Gjatë Luftës së Ftohtë, vendet e vogla u bënë një arenë e betejës ideologjike midis sistemeve komuniste kapitaliste amerikane dhe sovjetike. Luftërat pas vitit 1945 përsëri çuan në shkatërrim masiv dhe asgjësim. Kontradiktat ideologjike të imponuara nga shtetet e konkurrencës rezultuan në luftë civile në shkallë të gjerë në Vietnam dhe Kore. Modelet politike të komunizmit dhe të demokracisë rezultuan të jenë më të rëndësishme se identiteti kombëtar për banorët e pjesëve të ndryshme të këtyre vendeve. Për shumë shekuj, perandoritë krijuan kontradikta të brendshme dhe i manipuluan për nxjerrjen e dobisë. Kombet që ishin në gjendje të mësonin nga historia e tyre dhe të studionin sjelljen e fuqive të mëdha, njihnin nevojën për të forcuar identitetin e tyre dhe lobonin interesat e tyre me mjete dhe metoda të ndryshme.

Teoria e realistëve politikë thotë se një shtet mund të jetë i pavarur nëse krerët e vendeve kryesore në botë e konsiderojnë mendimin e saj. Pas dy luftërave botërore, procesit të dekolonizimit dhe kolapsit të BRSS, u shfaqën shumë shtete të reja që po përpiqeshin të gjenin vendin e tyre në sistemin ndërkombëtar. Disa vende, si Lituania, Letonia dhe Estonia, u bashkuan me Bashkimin Evropian dhe bllokun ushtarak-ushtarak të NATO-s, duke marrë patronazhin e Shteteve të Bashkuara. Udhëheqësit e këtyre kombeve bënë një vendim të arsyeshëm për të dorëzuar sovranitetin e tyre në favor të përqendrimit në nivelin mbikombëtar. Ata e kuptuan mirë se mungesa e burimeve do t'i parandalonte ata të krijonin mjetet e tyre politike, që do t'u lejonin atyre, të mbanin një ekuilibër mes qendrave të ndryshme të pushtetit. Në këtë drejtim, vendet e Baltikut ishin me fat, sepse zgjedhja e tyre nuk sillte shumë rezistencë nga Ruisia, e cila për shekuj ka konsideruar në këto zona një objekt të interesave të saj kombëtare. Shtete të tjera të vogla kanë qenë më pak fatlume. Nga njëra anë, Moska nuk kërkoi të ndërhynte në punët e brendshme të atyre "vëllezërve më të rinj" që shpallnin prioritetet e tyre të politikës së jashtme. Nga ana tjetër, Kremlini tërhoqi vijat e kuqe që këto vende të vogla nuk mund të kalonin.

Rusia nuk e kundërshtoi dialogun e Tbilisit me NATO-n, por shpjegoi qartë se bashkimi me bllokun ushtarako-politik do të nënkuptonte fundin e shtetit gjeorgjian. Në ditët e sotme, Gjeorgjia, Moldavia dhe Ukraina nuk janë në gjendje të marrin një vendim politik për t'u bashkuar me BE apo NATO, duke njohur pasojat e tmerrshme për vendet dhe popujt e tyre. Si një fuqi e madhe bërthamore, Rusia po kërkon të tregojë vendosmërinë e saj dhe t'i detyrojë konkurrentët e saj të njohin sferat e tyre të

Gurra, Q.
Gurra, J.
« Ndikimi
i madhësisë
së një shteti
kundrejt
sigurisë
dhe faktorit
gjeopolitik »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

¹⁰ Rostoks, Toms. "Small States, Power, International Change and Uncertainty." In *Small States in Europe*, edited by Robert Steinmetz and Anders Wivel, 1987, f. 39.

influcencës. Prandaj, nëse ka nevojë të sakrifikojmë interesat e vendeve të vogla dhe popujve, Moska do ta bëjë këtë pa asnjë dyshim ose keqardhje. Në përgjithësi, Shtetet e Bashkuara do të sillen në mënyrë të ngjashme nëse Kuba, Nikaragua dhe Kosta Rika vendosin të bëhen anëtarë të një bashkimi ushtarak dhe politik të mbikëqyruar nga Rusia¹¹. Konkurrenca e ashpër nuk është zhdukur; është vetëm diplomaci që krijon iluzionin e butësisë, barazisë dhe respektit për shtetet e vogla. Kështu, shumë vende të vogla janë objektivisht të privuara nga çdo mundësi për të shmangur përplasjen e interesave të ndryshme në tokën e tyre.

Ekzistojnë gjithashtu shtete pa burime natyrore ose konfiguracion të favorshëm gjeografik, interesat e të cilit, megjithatë, merren parasysh nga fuqitë e mëdha. Për dekada me radhë, vende të tilla si Irlanda dhe Izraeli kanë vendosur në mënyrë aktive potencialin e diasporave të tyre të mëdha në të gjithë botën, duke formuar kombe të përbashkëta transnacionale politike. Shumë ekspertë shpesh gabojnë në barazimin e koncepteve të diasporës dhe kombit kombëtar transnacional.

Në botën shkencore, ka qindra mendime rreth asaj se çka diaspora është dhe si ndryshon nga një komunitet dhe lobi. Në përgjithësi, një diasporë është një grup njerëzish të bashkuar nga tradita të përbashkëta kombëtare, fetare ose kulturore. Siç sugjeron kjo përkufizim, një diasporë nuk duhet të mbledhë së bashku përfaqësuesit e grupeve të veçanta etnike.

Sot, diasporat fetare dhe gjeografike janë ato më aktive. Për shembull, polakët, italianët dhe kubanezët së bashku mund të konsiderohen pjesë e diasporës katolike, ndërsa bullgarët, grekët dhe rumunët përfshihen si në diasporën ortodokse dhe në diasporën ballkanike. Sa për një komunitet, ai bashkon njerëzit me të njëjtën origjinë etnike, pavarësisht nga vendi i tyre i eksodit dhe i fesë. Kështu, një protestant frëng-amerikan i cili u rrit në Teksas dhe një katolik francez që u zhvendos nga Lyon, janë njëkohësisht pjesë integrale e komunitetit francez në Shtetet e Bashkuara. Nga ana tjetër, një komb politik transnacional (TPN) bashkon përfaqësuesit më aktivë të një grupi të caktuar etnik. Një TPN është gjithmonë e lidhur ngushtë me vendin e origjinës, dhe përparësia e saj kryesore është mbrojtja e interesave të saj.

Ka më shumë se gjashtëdhjetë milionë njerëz irlandezë në mbarë botën, ndërsa në Republikën e Irlandës ka vetëm 4.5 milionë banorë të përhershëm. Komunitetet më të mëdha irlandeze janë të përqendruara në Shtetet e Bashkuara. Sipas regjistrimit të vitit 2010, tridhjetë e tetë milionë amerikanë pretenduan origjinën irlandeze, duke përbërë rreth 11 për qind të popullsisë së përgjithshme të vendit. Formimi i grupeve irlandeze të interesit në Amerikë ka një histori të gjatë dhe të pasur, që daton nga themeli i shtetit amerikan. Anëtarët e komunitetit irlandez luajtën një rol të rëndësishëm në ngjarjet kyçe të historisë amerikane: lufta për pavarësi nga Britania, zgjerimi territorial i Shteteve të Bashkuara, fitorja e Bashkimit në Luftën Civile dhe lëvizja për të drejtat civile. Përveç kësaj, irlandezët krijuan ferma të mëdha dhe ndërtuan bimë dhe fabrika, duke nxitur zhvillimin e fuqisë ekonomike amerikane. Faktori i trashëgimisë është bërë një nga komponentët më të rëndësishëm në ndërtimin e kombit irlandez transnacional politik.

Udhëheqësit e komunitetit vazhdimisht kanë përkujtuar publikun e gjerë dhe klasën politike të kontributeve dhe sakrificave të paçmueshme që populli irlandez bëri për të mirën e Shteteve të Bashkuara. Në kohë të ndryshme, populli irlandez i kujtoi udhëheqësit e besëlidhjes së Shtëpisë së Bardhë të Presidentit Andrew Jackson¹² për të emëruar

¹¹ *The Falcon and the Dragon: Commercial Diplomacy and the Sino-Icelandic Free Trade Negotiations*, Reykjavik: Centre for Small States Studies, f. 9-15, 2008.

¹² *Imperialism, Sovereignty and the Making of International Law*, Cambridge: Cambridge University Press, f. 54.

**Gurra, Q.,
Gurra, J.**
« Ndikimi
i madhësisë
së një shteti
kundrejt
sigurisë
dhe faktorit
gjeopolitik »

Polici
dhe
Siguria
nr.14, 2019

irlandezët dhe skocezët me pozicione kyçe të politikës së jashtme si bijtë më të talentuar dhe të përkushtuar të Amerikës. Reklamimi i gjerë i trashëgimisë irlandeze ka çuar në zhvillimin e një qëndrimi të veçantë ndaj Irlandës në mesin e publikut amerikan. Për grupet irlandeze të interesit, ishte e rëndësishme të krijohet një imazh i tillë i atdheut të tyre historik për të balancuar me traditën e ngulitur hamiltoniane, sipas të cilës popujt amerikanë dhe britanikë kanë një fat të veçantë dhe Shtetet e Bashkuara kanë një mision të rëndësishëm si themeli i botës anglo-saksone. Megjithëse përpjekja për të thyer këtë filozofi dështoi, promovimi i përhershëm i markës historike irlandeze ka çuar në perceptimin e irlandezëve si një komb i madh themelues edhe pse janë një shtet relativisht i vogël.

Duke lënë mënjanë të drejtat dhe gabimet e çdo opinionit mbi shtetet e vogla dhe diplomacinë, duhet të thuhet se të gjitha marrëdhëniet janë të ndryshme dhe komplekse. Ndërsa arsyet për angazhimin politik mund të ndryshojnë nga ato për angazhimin ekonomik, ajo që vendos qasja është gjithmonë multifaktoriale. Shpesh është promovimi i interesit vetjak, pasi peshon rreziqet, kostot dhe përfitimet kundrejt vlerësimeve të tjera, si të vullnetit të mirë dhe drejtësisë, ose thjesht faktorëve historikë. Zgjuarsi është që të shohësh veten, atributet e tua si vend, pikat e forta dhe dobësitë, para se të angazhohen me ty të tjerët. Një kompleks superioriteti ka një efekt të fshehtë në marrëdhënie, ndërsa parimi, ndihmesa dhe barazia ofron një bazë për kompromis dhe ndarje. Të gjitha marrëdhëniet kërkojnë një masë kompromisi mbi idealet. Aftësia për të vlerësuar dallimet dhe për të punuar drejt një terreni të qëndrueshëm të mesëm është ajo që vulos lidhjet relacionale. Ndërvlerësia siguron çelësin për të angazhuar, plotësuar dhe rritur njëri-tjetrin. Figurat që mbështeten në peshën e tyre, në çdo mjedis fitojnë respekt. Emri i mirë, i cili është fituar dhe nuk është as i marrë, as i transferueshëm, i shoqëruar me një bilanc të shëndoshë, i jep një status atij entiteti, në biznes ose në politikë. Një vend i vogël me vullnet të mirë mund të vazhdojë të lundrojë në këtë botë të lëvizshme, komplekse dhe të rrezikshme duke qëndruar i pasur, i zgjuar, i rëndësishëm dhe neutral.

5. Konkluzione dhe rekomandime

Me gjithë çka u tha më sipër, një ndërmjetës i ndershëm me respekt dhe admirim të fituar mund të qëndrojë i gjatë dhe të ketë zërin e tij pa marrë parasysh kufizimet fizike. Marrëdhëniet ndërkombëtare janë një lojë e lartë aksionesh - kjo mund të luhet vetëm nga lojtarët më të efektshëm. Nëse nuk jeni Rusia, Kina, ShBA-ja, një lojtar i madh i BE-së shanset janë që ju të mos merrni vëmendjen që meritoni.

Pra, çfarë mund të bëjnë 190 vendet e tjera për të qëndruar të rëndësishme? Siç thotë thënia e vjetër *suhili*, kur dy elefantë luftojnë, bari vuan; dhe, kur dy elefantë bëjnë dashuri, bari gjithashtu vuan. Pavarësisht se çfarë ndodh, shtetet e vogla shpesh bien viktimë e politikës së Fuqisë së Madhe të sistemit ndërkombëtar. Shumica e shteteve të vogla tentojnë të marrin strategji mbrojtëse: të fshehura, detyruese dhe duke kërkuar strehim. Fshehja mund të arrihet përmes mosshtrirjes ose neutralitetit, duke u përpjekur të forcojë institucionet ndërkombëtare, ligjet dhe normat për të kufizuar incidentet ndërkombëtare dhe për të kërkuar strehim kundër rreziqeve financiare ose rreziqeve të sigurisë nëpërmjet institucioneve të tilla si Banka Botërore ose NATO¹³.

¹³ Small states in the European Union', *STJ404M: Small States, Integration, and Globalisation* (Reykjavik, University of Iceland) 24th June, 2014.

Këto strategji, megjithatë, bëjnë shumë pak për të ndihmuar vetë shtetet. Në vend të kësaj, ato kufizojnë shtetet e vogla në *status quo* dhe dominimin nga shtetet më të mëdha me sa më pak ndërhyrje në punët e brendshme të këtyre shteteve. Problemi i vërtetë, pra, nuk është thjesht mbajtja e shtetit të vogël të përshtatur, por pengesa ndaj shtetit që të jetë i përshtatur vetëm si një lloj “lodre” e shtetit “Fuqie e Madhe”. Një aktor që mund të ndërveprojë, ndaj shtetit mbi të cilin sovraniteti mund të zbatohet, do të ishte më i efektshëm se një aktor që vepron vetë dhe që mund të përmbushë sovranitetin e vet.

Në vend të kësaj, argumentohet se shtetet e vogla duhet të aplikojnë ‘strategji të mençura’. Këtu përshkruajnë tre strategji: shteti duhet të përtërijë - të paktën një pjesë, - të zgjidhjes së një problemi të njohur nga të gjithë, ose së paku nga shumica e shtetit që lidhet me problemin; të bëhet bastion i disa çështjeve, duke fokusuar burimet e tyre të kufizuara në temë, apo paraqitet si një ‘ndërmjetësi i ndershëm’ i pavarur nga ‘fuqitë e mëdha’. Në këtë mënyrë, shtetet e vogla mund të krijojnë një pasazh për veten e tyre në sistemin ndërkombëtar, duke mos u mbështetur në punën e shteteve më të fuqishme, por duke marrë iniciativën e tyre dhe duke formuar rrugë të reja dhe inovative.

Për të arritur këtë mund të sugjerohen disa role specifike që mund të marrin këto strategji: lobistë, ndërmjetësues të vetëkërkuar dhe sipërmarrës të normave. Në aspektin e lobimit, ndoshta aktori më i mirë ndërkombëtar për lobim është Britania e Madhe. Duke pasur përparësi natyrore të gjuhës angleze dhe peshën e konsiderueshme të shërbimit diplomatik britanik i jep Mbretërisë së Bashkuar një nxitje të konsiderueshme. Duke lënë mënjandë mundësitë e fuqisë së butë të Britanisë, duhet thënë se edhe Suedia bën një punë fantastike të lobimit për drejtësinë dhe punët e brendshme¹⁴. Ky lloj veprimi ndërkombëtar kërkon edhe një ndërgjegjësim për atë që është në interesin aktual kombëtar - duke qenë i vetëdijshëm se kjo mund të ndryshojë në çdo moment, - dhe një aftësi për të gjetur zgjidhje teknike për çështjet e komplikuar që rrisin çështjet ndërkombëtare.

Në këtë, koha është tepër e rëndësishme. Një shtet i vogël nuk mund të vendosë agjendën ndërkombëtare, aq shumë sa lobistët individualë në një shkallë të brendshme, një shtet lobist duhet të sigurojë që ata të njohin njerëzit e duhur për të kontaktuar në kohën e duhur dhe për të siguruar që ata kanë të drejtën teknike, diplomatike, politike dhe organizative ekspertizën dhe burimet për të kryer, dhe të jenë të gatshëm për t’i investuar këto në interesin kombëtar.

Është e qartë se kjo strategji nuk është e hapur për çdo shtet të vogël. Roli i ndërmjetësit të vetëkënaqur mbështetet në imazhin e ‘ndërmjetësit të ndershëm’ që mbron interesin e përbashkët, ndërsa në të vërtetë arrijnë qëllimet politike. Një shembull i mirë është Norvegjia¹⁵ që po pret marrëveshjet e Oslos. Duke lehtësuar procesin, Norvegjia mund të duket të jetë duke punuar si një ndërmjetës ndërkombëtar duke u përpjekur për të punuar shumë për të punuar në interes të paqes ndërkombëtare, ndërsa në të njëjtën kohë duke rritur në masë të madhe fuqinë e tyre të butë - veçanërisht nëse marrëveshjet kishin qenë të suksesshme në dhënien fund të - konfliktit arab me Izraelin.

Kjo, përsëri, kërkon aftësi të veçanta brenda shtetit. Kërkon një trajtim me përparësi të funksioneve të caktuara shtetërore, përveç kapaciteteve specifike diplomatike, teknike

¹⁴ Corporate Lobbying in the European Union: The Logic of Access, *Journal of European Public Policy*, 9:3, 365-390, 2002.

¹⁵ Norm Entrepreneurs: Scandinavia’s Role in World Politics’, in Ingebritsen et al. (eds.) *Small States in International Relations*, Seattle: University of Washington Press / Reykjavik: University of Iceland Press, 2006.

**Gurra, Q.,
Gurra, J.**
« Ndikimi
i madhësisë
së një shteti
kundrejt
sigurisë
dhe faktorit
gjeopolitik »

Polici
dhe
Siguria
nr.14, 2019

dhe organizative, dhe jo aq motive të dukshme për veprimet e tyre bamirëse. Edhe një herë, është mjaft e qartë se rrethana pengon shumë shtete të vogla që të ndërmarrin një veprim të tillë. Sipërmarrësit normë kërkojnë një fokus të veçantë në fuqinë e butë. Duke luajtur në diskursin ekzistues dhe duke vepruar si një pikë referimi ndërkombëtare për çështje specifike, shtetet e vogla mund të bëhen bastione, duke investuar në çështje specifike me qëllim që të vendosin kufijtë globalë. Shembuj të kësaj janë të dukshme. Ekspertiza e peshkimit në Norvegji dhe njohuria mjedisore e Danimarkës janë parë si bota, pavarësisht ndikimit relativisht të vogël të shteteve]. Marrëveshja preferenciale e Islandës me Kinën mund të shihet si një triumf i vërtetë, dhe ndoshta shembulli më i mirë i një shteti të vogël (Islanda ka rreth 300 000 qytetarë) që ushtrojnë “fuqinë e diplomacisë shumë më tepër se madhësia e saj”. Islanda ka qenë në gjendje të bëjë një marrëveshje shumë të mirë me Kinën, kur shumica do të supozonin se një marrëveshje e tillë do të ishte shumë e deformuar ndaj shtetit më të vogël.

Megjithatë, përsëri, ky nuk është një hap veprimi në dispozicion për të gjitha shtetet e vogla. Natyra e vetë sovranitetit rezulton në mungesën “joperëndimore”, të asaj që Perëndimi shihet të ketë arritur, dhe i vendos këto shtete në një mënyrë të pabarabartë dhe ndoshta të padrejtë, por kjo është e vërteta.

Bibliografia

1. Aaltola, Mika. “Agile Small State Agency: Heuristic Plays and Flexible National Identity Markers in Finnish Foreign Policy.” *Nationalities Papers: The Journal of Nationalism and Ethnicity* 39, no. 2 (2011).
2. Almezaini, Kalid S. *The UAE and Foreign Policy*. New York: Routledge, 2012.
3. Ayoob, Mohammed. “The Security Predicament of the Third World State.” In *The Insecurity Dilemma: National Security of Third World States*, edited by Brian L. Job.
4. Refining Our Understanding of Small State Foreign Policy.” In *Small States in World Politics: Explaining Foreign Policy Behavior*, edited by Jeanne A. K. Hey.
5. Keohane, Robert O., and Joseph S. Nye. *Power and Interdependence*. 3rd ed. New York: Longman, 2001.
6. Rothstein, Robert. *Alliances and Small Powers*. New York: Columbia University Press, 1968.
7. Rostoks, Toms. “Small States, Power, International Change and Uncertainty.” In *Small States in Europe*, edited by Robert Steinmetz and Anders Wivel, 1987.
8. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Vendimi nr. 584 dt.28.8.2003, ndryshuar nga vendimi nr. 201 dt. 29.3.2006.
9. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, vendimi nr. 580 dt.10.09.2004
10. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, vendimi nr. 317 dt.13.05.2005
11. Komunikate e Ministrit të Drejtësisë 8002/1999, (IK.10.) Për menaxhimin e çështjeve që lidhen me harmonizimin e ligjeve, dr. Ibolya David.
12. Manuali i EURALIUS (Misioni i Asistencës Evropiane për Sistemin Gjyqësor Shqiptar).
13. Marrëveshja e Stabilizim Asocimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe Shteteve Abetare nga njëra anë dhe Shqipëria nga ana tjetër.
14. Marrëveshja e përkohshme për tregtinë dhe çështjet e lidhura me tregtinë ndërmjet Komunitetit evropian nga njëra anë dhe Shqipërisë nga ana tjetër.
15. Vendimi i Këshillit 2006/54/EC dt. 30.1.2006 për parimet, prioritetet dhe kushtet në Parlamentin Evropian me Shqipërinë.
16. Vendimi i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, dt. 16.12.2004.
17. Zaimi, Iva, E drejta Evropiane, Tiranë, 2015.



**Gurra, Q.,
Gurra, J.**
« Ndikimi
i madhësisë
së një shteti
kundrejt
sigurisë
dhe faktorit
gjeopolitik »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

Reformimi i mënyrës së fitimit të gradave në Policinë e Shtetit



■ **MSc. Adriatik AGO**
adriatik.ago@asp.gov.al

Abstrakt

Vendimarrja e kohëve të fundit mbi anulimin e konkurrimit për fitimin e gradës policore "Komisar", tregoi seriozitet, përgjegjshmëri dhe reagim të shpejtë nga ana e titullarit të Policisë së Shtetit ndaj konstatimeve, për disa parregullsi apo shkelje të urdhrave që ndërmerren në raste të tilla. Por krahas saj, kjo situatë e krijuar flet dhe për faktin se diçka nuk funksionon në skemën aktuale mbi fitimin e gradave policore. Parregullsitë, të cilat mund të jenë të karakterit organizativ, e pse jo edhe korruptiv, janë në të drejtën e autoritetit për t'i analizuar dhe për të mbajtur qëndrim. Kjo tashmë është bërë e njohur publikisht dhe strukturat e caktuara po kryejnë hetime, përgjegjësitë e të cilave patjetër që do të klasifikohen disiplinore, administrative apo penale. Objekti i këtij shkrimi nuk do të jetë ky shqetësim, por mbështetur nga ky rast pse jo dhe raste të tjera të konstatuara ndër vite, duam të analizojmë kompozimin ligjor mbi mënyrën e fitimit të gradave policore.

Fjalëkyçe:

grada policore, funksioni, hierarkia policore, implementimi i ligjit të gradave, përfitimi i gradës, konkurrimi dhe mënyra e fitimit të gradës.

« Ago, A.
Reformimi
i mënyrës
së fitimit
të gradave
në Policinë
e Shtetit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14 2019

1. Hyrje

Historikisht që nga viti 1991, ligjet organike të policisë kanë pasur skemën e tyre për fitimin e gradave, por shqetësimin më të madhe mbi këtë problem e nxori ligji i vitit 2007, ku sanksionoi se mënyra kryesore e fitimit të saj është nëpërmjet konkurrimit (me përjashtim të gradave të larta), duke ndryshuar konceptin e mëparshëm, që përveç konkurrimit ishte dhe marrja e gradës nëpërmjet emërimit.

2. Problematikat që krijoi ligji i Policisë së Shtetit i vitit 2007

Ky ligj krahas anëve pozitive, i solli organizatës së policisë, dëme të konsiderueshme duke krijuar precedent për dy probleme. E para, lidhet me rekrutimet, ku nëpërmjet njohjes dhe barazimit të arsimit të lartë kryesisht, arsimi ushtarak/civil me atë policor, u rekrutuan shumë individë që nuk kishin arsimin policor duke filluar punë sidomos në nivele drejtuese. E dyta, në momentin e implementimit, u njoh si indikator matës, koha e qëndrimit në detyrë, pavarësisht funksionit që kryhej konkretisht, polic apo oficer (ish-ndarja kryesore midis rolit bazë dhe oficerit të policisë) e cila pasi u vlerësua si vjetërsi, shërbeu në llogaritjen e afateve për dhënien e gradës policore. Produkti që erdhi, një sekretare me vjetërsi 10 vjet, u përkthye në dhënien e gradës *nënkomisare*, ose në thelb *oficere policie*. Kjo ish-sekretare, u emërua në funksionin e inspektorese së krimeve, ose komandante në rend, kufi, pasi “ndriçonte” grada në supet e saj, edhe pse ajo nuk kishte arsimin klasik të lartë policor për këtë funksion. Ose, benefici tjetër ishte, që në momentin e implementimit, punonjësit do të merrnin gradën e vendit të punës. Kjo bëri që disa muaj, javë dhe ditë përpara kësaj faze, të bëheshin emërimet në detyra

Ago, A.
« Reformimi
i mënyrës
së fitimit
të gradave
në Policinë
e Shtetit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

të larta dhe pse nuk kishin koeficientët e duhur, me qëllimin e vetëm që kur të shpallej implementimi i ligjit, grada policore t'i gjente në detyrën e re. Pasoja, u kryen rekrutimet e personave të paragjykuar në detyra të larta policore ndonëse nuk kishin arsimin e duhur. Nga ky koncept morën grada policore një mori njerëzish duke kapërcyer rolet që kishin më parë. Mrekulli ishte dhe fakti se, përfitimet e gradave nga faza e implementimit nuk do të përsëriteshin në të ardhmen. Pas kësaj, do të fillonte skema e konkurrimit. Janë me dhjetëra punonjës në grada të larta që kanë përfituar nga skema e implementimit të ligjit 2007 dhe nuk i janë nënshtruar konkurrimit. Pra, është e hapur shkelja e barazisë juridike në rastin konkret.

Një gjë e tillë u ndje në gjithë strukturën hierarkike të policisë nga qendra në bazë, por më tepër u ndje në vijën e parë të hetimit apo të kontrollit të territorit, ku në funksionin e opgj-së, apo të inspektorit të krimeve, të rendit, kufirit, etj., po punonin ish-punonjësit e policisë që më parë kryenin detyrën në rolin bazë. Sipas kësaj skeme për të mbuluar boshllëkun e krijuar në arsimim, u argumentua se për fitimin e gradës është i mjaftueshëm të kryhet një kurs, dhe nuk ka nevojë për arsim të lartë policor. Kjo periudhë përkon edhe me mbylljen e Akademisë së Policisë, dhe njohuritë merreshin nëpërmjet kurseve, ku çdo gjë bëhej, vetëm shkollë nuk kryhej. Nga kjo doktrinë u krijuar bindja se grada është mbi çdo gjë, dhe po e more atë, ja hodhe, ke fituar detyrën, funksionin, ke perspektivë në karrierë, ndërkohë që asnjëri nuk tregonte interes për arsim e shkollim.

Precedenti i krijuar se grada policore prevalon mbi funksionin, u mbështet edhe nga e gjithë paketa e akteve nënligjore të nxjerrë mbi bazën e ligjit në fuqi, e cila u materializua jo vetëm në tabelën e pagave¹, por kryesore në ndërtimin e strukturave, organigramave, përshkrimeve të posteve të punës, etj.

Prevalimi i gradës mbi funksionin, çorientoi burimet njerëzore, duke emëruar njerëz në struktura që nuk kishin as arsim as kualifikimin e duhur, pasi argumenti i individit ishte: “unë fitova gradën, tani dua funksionin që është shpallur vakant”. Gabimet e bëra që fatkeqësisht vazhdojnë dhe sot, janë aq të shumta sa në jetën e përditshme policore tregohen dhe si anektoda apo ilustronjë analizat që bëhen rëndom në këto raste; p.sh., fiton gradën një që është rekrutuar nga ushtria ose ka punuar në strukturat e ndërhyrjes së shpejtë, etj., dhe për shkak të saj, emërohet në funksione hetimore apo të punës me informacionin policor; fiton gradën dhe emërohet ku janë vendet vakant pa marrë parasysh CV-në e tij, arsimin bazë, kualifikimet, për pasojë punon në Interpol, Europol, polici shkencore, opgj, në strukturat e veçanta, të luftës kundër drogës, trafiqeve, terrorit, etj., mjaft që të ketë përputhje vendi i punës me gradën. Kjo çoi në përzjerje kaotike të burimeve njerëzore, u krijuar klima dhe bindja se me çdo çmim duhet të merret grada se përndryshe të rrezikohet vendi i punës. Vullneti i autoriteteve të asaj periudhe, tregoi qartë se skema e dhënies së gradave midis të tjerave, do të shërbente për futjen në polici edhe të njerëzve nga radhët e klientelizmit partiak apo të infiltrimit të individëve të caktuar. Grada mban peng funksionin, ata që kishin frikë nga arsimi sepse e shikonin si pengese ligjore, e mbyllën atë dhe shpikën teorinë e kurseve ku, mbizotëronte arbitrariteti, formalizmi dhe mungesa e dëshirës për të nxënë.

3. Konformizmi i “Ligjit, 108/2014”

Po ligji i policisë nr. 108/2014, çfarë doktrine përcolli, bëri ndonjë ndryshim, në

¹ Vendimi nr. 1135, datë, 5.8.2008 “Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit”.

raport me skemën e fitimit të gradës? Çuditërisht dhe pse gjendja e mbartur u njoh mirë, pasi u kryen disa analiza nga aktorë të brendshëm dhe ndërkombëtarë, - shifrat dhe faktet ishin të bollshme për reformim e këtij sistemi, - doktrina nuk ndryshoi. Ajo si duket lezetoj emërimet e reja që u bënë mbas rokadës politike qershor 2013 dhe *sanksionoi se e vetmja mënyrë për fitimin e gradës policore është konkurrimi*, duke mbyllur dhe portën e dytë të rekrutimeve në polici dhe duke lënë të drejtën e konkurrimit vetëm për punonjësit e policisë që janë rekrutuar në Kolegjin Policor. Kjo u propagandua si risi dhe u përcoll si masë reformatore. Kompozimi i gradave dhe hierarkisë sipas këtij ligji, të krijon përshtypjen se ruhet sistemi i vlerave, se i jepet përparësi meritokracisë, se merren në konsideratë arsimit bazë, kualifikimet, rezultatet e punës, eksperiencia, vjetërsia apo përpjekjet e njerëzve për të rritur përfomancën e tyre, në thelb nuk është gjë tjetër vetëm vazhdim i frymës së mëparshme pse jo edhe keqësim i saj.

Emërimet në poste të larta në cenim të kriterëve, dhënia e disa gradave në një afat të shkurtër, fitimi i gradës nëpërmjet proceseve gjyqësore, duke shfrytëzuar më parë emërimet, janë gabime të njëjta me të shkuarën, por në forma të ndryshme. Janë ana e kundërt e të njëjtës medalje. Ende vazhdon fryma se karriera mbahet nëpërmjet gradës. Ndryshe nuk ka se si të shpjegohet uria e madhe për të marrë gradën. Kjo uri solli mosrespektim, apo shkelje të urdhrave në rastin e fundit të testimin për gradën “Komisar”. Strukturat e burimeve njerëzore nuk kanë politika për ndjekjen me afate të caktuara të ecurisë në gradë të punonjësit. Shifrat e fryra për vende bosh dhe numri i madh i kandidatëve tregojnë për skemë joracionale, por për ndjekje me hope, me faza dhe me kosto të mëdha. Pse duhet lënë disa funksione të rolit të parë drejtues, (komisar, kryekomisar) për një kohë të gjatë bosh, dhe pastaj të turren me vrap për të marrë gradën. Në këtë taban krijohet dhe paqartësi, mungesë besimi ndaj skemës, flitet lartë e poshtë për korrupsion, bëhen përpjekje për të gjetur lidhje që kanë ndikim në kohën e konkurrimit, etj.

Pra, të gjitha këto boshllëqe, apo premisa për të cenuar vlerat reale të punonjësve i lejon skema e fitimit të gradës, e cila po t’i shtosh dhe subjektivitetin në kohën e veprimeve teknike si banka e pyetjeve, hartimi i testeve, formulimi i çelësit, e të tjera veprime të kësaj natyre, skema e ofruar nga ligji është në cenim të doktrinës për ecurinë në karrierë.

4. Mbi modalitetet e reformimit të skemës së fitimit të gradës policore

Problemi është: a duhet të vazhdohet në këtë mënyrë? Ndryshimet që solli ligji 112/2018 për Policinë e Shtetit, janë për t’u përshëndetur për sa i përket rritjes së kuotës së pranimit nga 1% në 3% për funksione te veçanta. Njëkohësisht, me vlerë ishte edhe çështja e pranimit në polici të shtetasve nga jeta civile, pavarësisht se kriteri i vendosur për mbarimin e ciklit të dytë të studimeve të arsimit të lartë, më duket pak i shtrenjtë për kushtet reale të vendit tonë. Megjithatë, edhe pse kemi një përmirësim të mënyrës së fitimit të gradës policore, ku sipas ligjit të ri, neni 54, pika 1 ndryshon, pasi “*fitimi i gradës bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces aplikimi, verifikimi vlerësimi konkurrues dhe përfundimit me sukses të programit përkatës të arsimit/trajnitimit*”², kjo përsëri nuk ndryshon thelbin.

Përmirësimi edhe në këtë rast, është vetëm në anën e jashtme, pra në sanksionimin

² Ligji 112/2018 neni 7 ndryshon nenin 54, pika 1 e ligjit 108/2014.

Ago, A.
« Reformimi i mënyrës së fitimit të gradave në Policinë e Shtetit »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

e fazave të një procesi konkurrues, por jo se kemi doktrinë të re në fitimin e gradës edhe nëpërmjet emërimit, kur kjo e fundit bëhet gjithnjë në përputhje me kërkesat e ligjit. Ne duhet të pranojmë se skema aktuale e fitimit të gradës policore i përmban të dy variantet edhe me konkurrim edhe me emërim. Kjo shprehet në nenin 53 të ligjit 108/2014, "Dhënia e Gradës"³, ku përcaktohen autoritetet e dhënies së gradave. Çuditërisht ligji në fjalë e anashkalon mënyrën e fitimit të gradave të larta policore. Në qoftë se për gradat nga *nënkomisar* deri në *drejtues i parë*, bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces vlerësimi konkurrues nga një komision gradimi, neni 54 i ligjit, për gradat *drejtues i lartë* dhe *drejtues madhor*, përcakton se kush e jep, por jo se kandidati e fiton atë me konkurrim. Praktika e deritanishme tregoi se këto grada jepen për shkak të emërimit në funksione të larta.

Pra, shtrohet çështja: pse të mos jepen për shkak të emërimit edhe gradat e tjera policore, nga titullari i Policisë së Shtetit, ku krahas konkurrimit në masë, për raste të veçanta dhe në interes të përmbushjes së misionit policor të jepej dhe grada policore nëpërmjet emërimit. Do të ishte me shumë vlerë sanksionimi i kësaj doktrine në ligjin e fundit që solli ndryshimet e reja në Policinë e Shtetit. Jam shprehur dhe në kohën e hartimit të projektligjit /2014, se për të evituar të metat dhe pasojat e krijuara ndër vite, ishte mundësi pozitive që në interes të reformimit të performancës së policisë, të bëhej "një pushim dy-tre vjeçar", duke bllokuar dhënien e gradave dhe, me masa të qarta, të sakta të rishikohen vlerat reale të çdo punonjësi policie, mbështetur në të dhënat e dosjes personale si dhe treguesit e punës për funksionin që mban. Më pas, duke ndërhyrë në ligj, të rregulloheshin të metat e skemës për fitimin e gradës si dhe disa indikatorë që lidhen me të, si ulja apo ruajtja e gradës, por njëkohësisht edhe çelja e së drejtës për rekrutime për në arsimin e lartë policor edhe nga jeta civile.

Doktrina kryesore të jetë fitimi i saj krahas konkurrimit dhe nëpërmjet emërimeve. Duhet të ç'rrenjoset ideja se gradat shprehin pozitën që ka punonjësi në strukturën hierarkike të policisë, e thënë kjo në nenin 52 të ligjit 108/2014⁴. Jo! Pozitën që ka punonjësi në hierarkinë strukturore duhet ta shprehë funksioni. Pikërisht këtu dallohen doktrinën për gradat policore, të cilat ndryshojnë tërësisht nga doktrina e gradave militare. Ka punonjës që fshihen nën petkun e gradës dhe çuditërisht janë ata punonjës me karakter të dobët të paafte, të paarsimuar, parazitë, hipokritë, teknokratë, pse jo edhe të korruptuar. Aktualisht ka disa vende anëtare të BE-së, që kanë modele të ndryshme për fitimin e gradave në polici. E rëndësishme është të kuptohet doktrina sipas së cilës, grada nuk duhet të prevalojë mbi funksionin, ajo nuk duhet ta marrë peng atë. Baza e vlerësimit real të punonjësit të policisë të jetë arsimi, kualifikimi, specializimi dhe detyra konkrete. Ecuria në karrierë të bëhet nga këta indikatorë.

Grada policore të mos konsiderohet si faktor kyç. Ajo të fitohet sipas mënyrave të mësipërme dhe të shërbejë si element i performancës individuale, por jo të kushtëzojë ndërtimin strukturor, organizativ apo të organigramave për funksionet. Të mirëkuptohet roli i Akademisë së Sigurisë në fitimin e gradave; kjo strukturë është ndihmëse, por nuk duhet të ngatërrohet vendi i zhvillimit të konkurrimeve me rolin që mund të ketë në procesin e fitimit të gradës. Ajo nuk duhet të hartojë në sistemin *bachelor* kurikula për gradë, por për funksion. Është i pakuptimtë koncepti, kur shpallet njoftimi për fitimin e gradës nënkomsar, sistemi *bachelor*. Të gjithë institucionet e arsimit të lartë, publike

³ Ligji 108/2014, neni 5.

⁴ Ligji Nr. 108/2014, neni 52, "Për Policinë e Shtetit".

ose jo, certifikojnë e diplomojnë specialistë të fushave sipas objektit, mjek, inxhinier, ekonomist, jurist; arsimi ynë i lartë policor jep gradën nënkomisar dhe nuk i certifikon si specialist të lartë policie. Sa e dhimbshme, aq edhe për të qeshur. Dhënia e gradës policore, me përjashtim të gradave të larta, është e drejtë ekskluzive e autoritetit të Policisë së Shtetit dhe e askujt tjetër. Burimet njerëzore të jenë lider në gjithë procesin e dhënies së gradave pavarësisht nga skema që aplikohet dhe jo të delegojë veprimet në stafin e Akademisë së Sigurisë. Mbroj idenë se ka ardhur koha e fitimit të gradës në konkurrimet brenda strukturave, ku në respekt të specifikave që ato kanë, të hartohen banka e pyetjeve me literaturë profesionale, krahas asaj me karakter përgjithësues dhe formues. Taban pozitiv krijoi për këtë edhe ligji nr 112/2018, ku në 2 të tij, përcakton se neni 19 pika 1, i ligjit në fuqi, ndryshon: “*Policia e Shtetit është unike e centralizuar. . . Ajo organizohet mbi bazë shërbimi e profilizuar në Policinë Kriminale, Policinë për Sigurinë Publike dhe Policinë për Kufirin e Migracionin*”. Kjo do të rrisë egon pozitive, konkurrencën dhe cilësinë e shërbimeve policore.

5. Konkluzione

Menaxhimi, respektimi i hierarkisë, disiplina, etika, raporti dhe ruajtja e ekuilibrit epror/vartës e deri tek realizimi i misionit apo detyrave për çdo post pune, nuk duhet të arrihen për shkak të gradave, por për shkak të ushtrimit të funksionit, të përgjegjësive ligjore dhe të rreshtimit të organizatës nga i pari tek i fundit sipas vlerave profesionale të punonjësve, e materializuar kjo në skemat konkrete strukturore të Policisë së Shtetit. Dhënia e gradës të mos bëhet qëllim në vetvete pasi kjo ide ka dëmtuar rëndë cilësinë e shërbimeve policore, dhe pa kuptuar ndër vite është dëmtuar imazhi i arsimit policor, si çelësi i arritjes së çdo performance me standardet që kërkohen, aq më tepër kur e gjithë administrata publike është përfshirë në realizimin e detyrave që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit të vendit në BE.

Referencat

1. Ligj nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.
2. Ligji 112/2018, Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin “Për Policinë e Shtetit”.
3. Ligji nr. 9749, datë, 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.
4. Rregullorja e Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.9.2015.
5. Vendimi nr. 1135, datë, 5.8.2008 “Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit”

Ago, A.
« Reformimi
i mënyrës
së fitimit
të gradave
në Policinë
e Shtetit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

Roli i strukturave të policimit në komunitet, në përballje me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm



■ **Msc. Roland ALUSHANI**

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit,
roland.alushani@asp.gov.al

Abstrakt

Policimi në komunitet promovon përdorimin e partneritetit midis zbatimit të ligjit dhe komunitetit për të adresuar shqetësimet e sigurisë publike. Qytetarët të cilët janë të angazhuar për zbatimin e ligjit janë një pasuri e vlefshme për çdo strukturë dhe mund të luajnë një rol të madh në kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm. Për shkak se ekstremizmi i dhunshëm ndodh brenda komuniteteve lokale, agjencitë e zbatimit të ligjit përfitojnë më së shumti kur punojnë me komunitetet e tyre për të ndërtuar një marrëdhënie besimi, për shembull, duke angazhuar pjesëtarët e komunitetit dhe duke i informuar ata për çështjet e sigurisë publike siç janë ekstremizmi i dhunshëm në familje. Si rezultat, qytetarët janë më të prirë që të arrijnë tek zbatimi i ligjit dhe të raportojnë aktivitete të dyshimta. Mënyrat në të cilat zbatimi i ligjit dhe komuniteti mund të punojnë së bashku për të përdorur mediet sociale për të ndihmuar në identifikimin, parandalimin dhe përballimin e ekstremizmit të dhunshëm në familje janë dhënë në mënyrë të përmbledhur gjatë këtij materiali. Përballja me fenomenin e analizuar paraqitet e vështirë dhe delikate dhe njëkohësisht ajo është një sfidë e rëndësishme e shoqërisë tonë dhe në veçanti e institucioneve ligjzbatuese, që kanë për detyrë, parandalimin, identifikimin, hetimin, procedimin penal dhe dënimin e autorëve të këtyre veprave penale

Alushani, R.

« Roli i strukturave të policimit në komunitet, në përballje me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm »

Fjalëkyçe:

policimi në komunitet, ekstremizmi i dhunshëm, radikalizmi, siguria publike, media sociale, informimi publik.

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

1. Hyrje

Në librin e tyre 'Siguria dhe parandalimi i krimit' autorët amerikanë O'Block, Donnermeyer, Doeren shprehen se "Krimi dhe dhuna ekstreme shkaktojnë pasoja sociale, ekonomike, shëndetësore dhe psikologjike jo vetëm mbi viktimat, por edhe mbi shoqërinë në përgjithësi. Fenomeni është një problem serioz shoqëror që redukton drejtpërdrejt cilësinë e jetës së individëve dhe komunitetit"¹. Për t'iu përgjigjur këtij problemi, shoqëritë e kanë zhvilluar policimin si një institucion ku policia, ndër të tjera, rekrutohet, stërvitet dhe vendoset. Në mbështetje të kësaj ideje, Morgan shprehet se: "Funksioni parësor i policisë ka të bëjë me parandalimin e krimit dhe kapjen e kriminelëve"².

Tradicionalisht, ruajtja e rendit dhe ligjit në çdo shoqëri ka qenë roli ekskluziv i strukturave të policisë. Gjatë asaj kohe, policia jo vetëm që hasi vështirësi në trajtimin e krimit, por gjithashtu kritikohej për natyrën joprotagoniste të marrëdhënieve me anëtarët e komunitetit. Kjo dukuri ka nxitur një debat të gjerë në mesin e studiuesve. Friedman, për shembull, shprehet se policia nuk mund të ketë sukses në zgjidhjen ose parandalimin e dhunës apo edhe krimit pa ndihmën e komunitetit. Kështu, për të parandaluar me sukses krimin, duhet të ketë partneritet dhe përfshirje në komunitet. Dhe ndoshta ky ishte një reflektim e reagim ndaj këtij zhvillimi që më vonë do të prezantohej si koncepti i policimit në komunitet³. Policimi në komunitet është një ndryshim paradigme i krijuar në themelin e partneritetit të komunitetit në krijimin e një mjedisi të sigurt për të gjithë. Është mënyra e sigurisë ku njerëzit marrin pjesë aktive, ku

Alushani, R.
« Roli i strukturave të policimit në komunitet, në përballje me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

¹ O'Block RL, Donnermeyer JF, Doeren E(1991) *Security and crime prevention*. 2nd edn. US: Butterworth-Heinemann.

² Morgan JB(1996) *The police function and the investigation of crime*. Avebury: Gower.

policia nuk shihet si problem, por si partner në zhvillim dhe ku pjesëtarët e komunitetit janë bashkëprodhuesit e shërbimit të drejtësisë dhe të cilësisë së sigurisë publike.

Ky fakt tregon nevojën e përfshirjes së komunitetit, qeverisë lokale dhe strukturave të policisë për të punuar së bashku për të luftuar krimin. Një arsye për përfshirjen e publikut është besimi se vetëm policia nuk mund as të krijojë as të ruajë komunitetet publike të sigurta. Prandaj, policimi në komunitet është shfaqur si një çështje e rëndësishme në zhvillimin e sigurisë publike për shumë vende në botë. Por edhe në këtë rast vendet perëndimor kanë prezantuar në mënyrë të ndryshme disa forma të policimit në komunitet. Këto forma lidhen me veçoritë specifike të çdo vendi. Pavarësisht kësaj, policimi në komunitet është një fenomen në rritje në mbarë botën.

2. Prezantimi i problemit

Termi policim në komunitet lidhet me një përdorim veçanërisht të kohëve të fundit, por që duket se po kthehet gjithnjë e më popullor në mbarë botën. Termi që përfaqëson edhe modelin ka marrë një mbështetje të gjerë nga një spektër i gjerë që nis nga politikanët, akademikët dhe që jo pak edhe nga mediet. Duket se ka një apel të fortë intuitive për publikun e gjerë. Kjo terminologji e re ka përkufizime të larmishme dhe kështu nuk përfaqëson në vetvete një konceptim të lehtë. Nuk ka unanimitet mendimi mbi atë që përbën policimin në komunitet. Megjithatë, policimi në komunitet, ose thjeshtë, policimi i lidhur me komunitetin, shprehen mjaft studiues e ka origjinën në Angli, dhe përfaqëson një filozofi (një mënyrë e të menduarit) dhe një strategji organizative (një mënyrë e ekzekutimit) që lejon policinë dhe komunitetin të punojnë së bashku për të zgjidhur problemet e krimit dhe dhunës⁴. Në çdo shoqëri policia ndërvepron me komunitetet ku ata i shërbejnë dhe komuniteti mbështetet në polici për të ndihmuar në emergjenca dhe për të frenuar çrregullimin. Policia mbështetet tek komuniteti për të raportuar ngjarjen dhe për të siguruar informata të rëndësishme që janë të nevojshme për të adresuar shqetësimet e komunitetit dhe për të zgjidhur problemin. Në dekadat e fundit, fushëveprimi i kësaj marrëdhënieje është zgjeruar. Policia dhe komuniteti kanë filluar të presin më shumë nga njëri-tjetri, ndërsa ata gjithnjë e më shumë ndërjegjësohen se duhet të punojnë aktivisht si partnerë. Kjo formë e bashkëpunimit është referuar si policimi në komunitet⁵.

Policimi në komunitet në Shqipëri u prezantua zyrtarisht si një politikë në nivel kombëtar në vitin 2005, edhe pse përgatitja për këtë zhvillim ishte orientuar që disa vjet përpara⁶. Në vitin 2004 strukturat e Policisë së Shtetit kishin ndërmarrë trajnime policore në komunitet të mbështetura nga specialistë britanikë në Tiranë. Më pas specialistë nga Policia e Shtetit ishin kualifikuar në vendet e perëndimit për modelin e policimit në komunitet. Ky zhvillim nxiti një interes jo vetëm brenda radhëve të Policisë së Shtetit, por edhe në komunitet aq sa drejtues të lartë filluan të artikulonin ide se si mund të modelohej ky proces për të ndihmuar në adresimin e sfidave të hasura në kontekstin shqiptar.

Realizmi i policimit në komunitet dhe ekstremizmi i dhunshëm. Policimi në komunitet promovon përdorimin e partneritetit midis zbatimit të ligjit dhe komunitetit

Alushani, R.

« Roli i strukturave të policimit në komunitet, në përballje me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm »

Policimi dhe Siguria nr.14, 2019

³ Friedman RR(1992) *Community policing: Comparative perspectives and prospects*. New York: Harvester Wheatsheaf.

⁴ DeguY(2014) *Community Policing or Policing the Community? The Emerging Police Practice*. Prince University

⁵ Jeremy WM (2006) *Community policing in America*.Routledge Taylor and Francis Group, New York.

për të adresuar shqetësimet e sigurisë publike. Qytetarët të cilët janë të angazhuar për zbatimin e ligjit janë një pasuri e vlefshme për çdo strukturë dhe mund të luajnë një rol të madh në kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Për shkak se ekstremizmi i dhunshëm ndodh brenda komuniteteve lokale, agjencitë e zbatimit të ligjit përfitojnë më së shumti kur punojnë me komunitetet e tyre për të ndërtuar një marrëdhënie besimi, për shembull, duke angazhuar pjesëtarët e komunitetit dhe duke i informuar ata për çështjet e sigurisë publike siç janë ekstremizmi i dhunshëm në familje. Si rezultat, qytetarët janë më të prirë që të arrijnë tek zbatimi i ligjit dhe të raportojnë aktivitete të dyshimta. Mënyrat në të cilat zbatimi i ligjit dhe komuniteti mund të punojnë së bashku për të përdorur mediet sociale për të ndihmuar në identifikimin, parandalimin dhe përbalimin e ekstremizmit të dhunshëm në familje përfshijnë si në vijim:

Edukimi i anëtarëve të komunitetit. Anëtarët e komunitetit shpesh janë të pavetëdijshëm për karakteristikat e kalimit nga radikalizmi drejt dhunës, veçanërisht ato që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm në komunitet. Përmes fushatave edukative dhe partneriteteve, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe komunitetet që shërbejnë së bashku me ato, mund të përfitojnë nga mundësitë për të zbuluar dhe ndërhyrë përpara se një individ të bëhet i dhunshëm. Kur edukohen siç duhet, prindërit, mësuesit dhe bashkëmoshatarët do të jenë në një pozicion më të mirë për të njohur shenjat e hershme të kalimit nga radikalizmi drejt ekstremizmit të dhunshëm.

Angazhimi i anëtarëve të komunitetit në çështje të ndryshme. Komunitetet lokale të zbatimit të ligjit mund të përdorin një qasje të gjerë për angazhimin dhe partneritetin e komunitetit në vend që të fokusohen ekskluzivisht në ekstremizmin e dhunshëm. Shpesh agjencitë e zbatimit të ligjit mund të krijojnë besim dhe bashkëpunim duke shfrytëzuar partneritetet dhe angazhimin e tyre rreth çështjeve më të zakonshme të sigurisë publike siç janë siguria në internet ose shqetësimet e prioritetuara brenda komuniteteve lokale. Kjo lloj qasje e tërë komunitetit shpesh siguron një tranzicion të qetë për të diskutuar çështje më delikate, siç është ekstremizmi i dhunshëm në familje. Angazhimi për çështje të ndryshme të sigurisë publike është më delikat në grupe të veçanta, që shpesh ndodhen në një pozitë mbrojtëse, sepse ata jo rrallë e mendojnë veten se janë të dyshuar⁷. Shmangia e rasteve të veçanta do të tregojnë se policia është e shqetësuar për çështje të përbashkëta për të gjitha grupet duke ndërgjegjësuar idenë se zbatimi i ligjit është një e mirë e domosdoshme për të gjithë komunitetin.

Angazhimi i të rinjve. Ekstremistët shpesh përpiqen të rekrutojnë të rinjtë, të cilët ata i shohin si më të prekshëm, për ekstremizëm të dhunshëm. Në të kundërt autoritetet e zbatimit të ligjit përpiqen të angazhojnë të rinjtë në frymë pozitive për të afuara mundësi për tu përballur me mesazhin e ofruar nga ekstremizmi i dhunshëm. Ofrimi i programeve të ndryshme në institucione shkollore apo në organizime komunitare për të rinjtë ndihmojnë në zbatimin e ligjit dhe kompensojnë potencialisht joshjen prej radikalizmit për mjaft kategori të rinjve vulnerabël ndaj rreziqeve.

Në angazhimin mbarëkombëtar për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm nuk është se ka një kuptim të përbashkët dhe një lloj të ndjeshëm nga të gjithë aktorët dhe strukturat sociale, politike etj. Ndër përfaqësuesit nga qeveria, shoqëria civile dhe sektorët e tjerë, një pjesë kanë sugjeruar se problemi qëndron te niveli i varfërisë; të tjerë mendojnë se

Alushani, R.
« Roli i strukturave të policimit në komunitet, në përbalje me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

⁶ Strategjia e Policimit në RSH (2014) Tiranë

⁷ Crowe TD (2000) Crime prevention through environmental design: Applications of architectural design and space-management concepts. 2nd edn. New York:Butterworth-Heinemann.

është pabarazia në të ardhura. Disa fajësojnë mungesën e arsimit; të tjerët janë të shqetësuar rreth radikalizmit në mesin e studentëve të universitetit. Disa drejtojnë gishtin në dështimin e politikave në nivel makro, të tjerët në faktorët e jashtëm. Disa citojnë islamin radikal, të tjerët mungesën e besimit. Realiteti është se aktorët e ekstremizmit të dhunshëm ndryshojnë brenda, si dhe midis vendeve, por edhe me kalimin e kohës. Komunitetet lokale janë më të mira për të kuptuar se çfarë janë këta aktorë, pse ndryshojnë dhe si t'i trajtojnë ato më së miri. Por shumë shpesh këto komunitete jo rrallë përjashtohen nga analizat, hulumtimi akademik dhe politikat dialoguese për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm⁸.

Hapi i parë për angazhimin e komuniteteve është identifikimi i tyre. Aktorët që nxisin ekstremizmin zakonisht përqendrohen në komunitetet më të varfra; aktorë të sigurisë në ato që tashmë janë infektuar nga ekstremizmi. Por fokusi i vërtetë në përpjekjet për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm duhet të jenë ato komunitete që janë më në rrezik për tu përdorur nga ekstremizmi i dhunshëm. Këto nuk mund të jenë as komunitetet më të varfra, as ato në rajonet tashmë të goditura. Një hap i dytë është të kërkosh bashkëbiseduesit e duhur brenda këtyre komuniteteve. Këta mund të jenë mësues të shkollave, përfaqësues fetarë ose individë me peshë. Legjitimiteti mund ose nuk mund të lidhet patjetër me drejtues të zgjedhur. Shpesh partnerët më domethënës janë të rinjtë dhe gratë ndaj fuqizimi i këtyre kategorive është mjaft i rëndësishëm. Hapi i tretë është përpjekja për të ndërtuar besimin. Përpjekjet e qëndrueshme dhe të përsëritura për të luftuar radikalizmin në nivel lokal nuk do të arrihen nëse nuk ka besim ndërmjet komuniteteve të ndryshme, mes komuniteteve dhe organeve të qeverisjes lokale dhe kombëtare, dhe midis të gjithë këtyre aktorëve.

Trashëgimia e "luftës kundër dhunës" është një deficit i konsiderueshëm i besimit. Së katërti, është hapja e potencialit të komuniteteve lokale për të zhvilluar zgjidhje të pëlqyeshme lokale, ndaj kërcënimit të ekstremizmit të dhunshëm. Në shumë momente ekziston një hendek i rëndësishëm financimi. Këto komunitete mund të mos jenë përparësi të dukshme ose prioritetet e sigurisë, por ato gjenerojnë problemet që lindin dhe zhvillohen në komunitet. Një hap i pestë është zgjerimi i sukseseve në nivel lokal. Sigurimi i mbështetjes për iniciativat specifike lokale mund të jap rezultate lokale (ndonëse shfaqja e ndikimit është një sfidë), por rreziku i mungesës së kësaj mbështetje mund të shfaq hendeqe të mëdha të ekstremizmit të dhunshëm.

Të gjitha këto hapa për angazhimin e komuniteteve lokale nuk e ezaurojnë zgjidhjen e problemit. Megjithatë ato mund të sistemohen në mënyrë që ato të mund të aplikohen edhe në nivel kombëtar dhe nivelet e suksesit duhet të gjejnë njohje më të gjerë, ndërkohë që dështimet duhet të pranohen dhe të kuptohen. Por komunitetet lokale janë vetëm një nivel aktorësh që duhet të mobilizohen, mungesa e fondeve është vetëm një nga sfidat me të cilat përballen këto komunitete, parandalimi është vetëm një pjesë e një përgjigje gjithëpërfshirëse ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe trashëgimisë së tij. Ndërsa më lart folëm për disa nga mënyrat që mund të jenë efektive kur policia angazhohet së bashku me komunitetin, më poshtë po ndalojmë në disa nga aktorët që gjithashtu, për të luftuar krimin në mënyrë efektive, komunitetet duhet të konsultohen për problemet me të cilat ata përballen dhe si t'i trajtojnë ato. Përfshirja e publikut paraqet sfida dhe mundësi, por mund të çojë në një besim më të madh në suksesin e

Alushani, R.

« Roli i strukturave të policimit në komunitet, në përballje me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm »

Policimi

dhe

Siguria

nr.14, 2019

⁸ Crowe TD (2000) *Crime prevention through environmental design: Applications of architectural design and space-management concepts*. 2nd edn. New York: Butterworth-Heinemann.

policimit komunitar.

Pjesëmarrësit kryesorë në parandalimin e dhunës dhe ekstremizmit të dhunshëm. Strukturat e policisë në veçanti kanë një rol kyç për të luajtur në punën me publikun dhe komunitetet për të parandaluar dhe kontrolluar dhunën dhe krimin, nëpërmjet policimit të orientuar nga komuniteti dhe qasje të ngjashme që nxisin marrëveshjet bashkëpunuese ndërmjet policisë dhe qytetarëve. Për më tepër, në mjaft vende një vëmendje e veçantë i kushtohet institucioneve juridike për një rol të rëndësishëm veçanërisht në efektet parandaluese dhe edukative.

Roli i medieve sociale dhe teknologjisë së komunikimit. Mjetet e medieve sociale gjithnjë e më shumë po përdoren për të angazhuar publikun në parandalimin e krimit dhe shanset janë që të jenë edhe më dominuese në të ardhmen. Ato ofrojnë potencial të madh për ndryshime pozitive, por gjithashtu paraqesin sfida për sigurinë dhe drejtësinë. Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ka ndikuar rrënjësisht mënyrën se si njerëzit jetojnë, punojnë dhe bashkëveprojnë. Agjencitë e zbatimit të ligjit në mbarë botën bashkëpunojnë, duke përdorur platformat e mediave sociale për të forcuar marrëdhëniet me komunitetet dhe për të komunikuar me publikun për qëllime informuese. Është bërë e zakonshme që zbatuesit e ligjit të përdorin postimet e mediave publike në lidhje me një krim që ka ndodhur ose po ndodh për të marrë informacion të drejtpërdrejtë dhe të dorës së parë për një hetim⁹.

Pjesëmarrja publike dhe kombëtare e vendit. Pjesëmarrja e komunitetit në parandalimin e krimit dhe ndëshkimin e tij përfshin bashkëpunimin aktiv të banorëve dhe organizatave lokale dhe ka një histori të gjatë arritjesh në shumë vende të botës. Qeveritë gjithnjë e më shumë po bashkëpunojnë me komunitetet dhe organizatat e shoqërisë civile për të parandaluar krimin dhe dhunën për të arritur tek segmentet vulnerabël dhe në rrezik të shoqërisë. Në fakt, përfshirja e komunitetit është bërë një komponent thelbësor i parandalimit të krimit në të gjitha llojet e partneriteteve që përfshijnë komunat, policinë, shkollat, shërbimet shëndetësore dhe sociale dhe sektorin privat¹⁰. Komunitetet mund të përfshihen në trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e shkelësve përmes programeve sipas të cilave autorët janë liruar me kusht ose pasi të hyjnë në shoqëri. Mbipopullimi i burgjeve është një problem për shumë vende dhe ka norma të larta rikthimi në mbarë botën, kështu që politikat dhe masat për riintegrimin social dhe rehabilitimin e shkelësve janë vendimtare.

Partneritetet dhe bashkëpunimi me komunitetet, sektori i biznesit dhe organizatat joqeveritare për të punësuar ish të burgosurit janë kritike për zvogëlimin e rikthimit dhe për të ndihmuar në riintegrimin e tyre social. Policimi në komunitet kërkon të ndryshojë marrëdhënien midis policisë dhe komunitetit përmes dialogut. Për të qenë efektive, ajo duhet t'i përgjigjet nevojave specifike të grupeve më në risk, siç janë gratë, të rinjtë, të moshuarit, pakicat etnike, emigrantët, personat e zhvendosur dhe refugjatët. Qasjet përfshijnë patrullimet nëpërmjet patrullave të policisë në sektorë, ndihmës specialistëve të policimit në komunitet, (SPZ), të cilët janë oficerë të vijës së parë, Këshillat Lokale të Sigurisë, zhvillimi i temave të ndryshme të policisë në shkolla dhe universitete dhe aktivitete të specializuara që bashkojnë policinë dhe komunitetin, veçanërisht të rinjtë.

Informimi publik përmes medieve. Media profesionale mund të kontribuojë në një

⁹ Deluca SM, Stone AR (1994) *Police administration: An introduction*. 2nd edn. Upper Saddle River, NJ: Prentice Hall.

¹⁰ Po aty.

Alushani, R.
« Roli i strukturave të policimit në komunitet, në përballje me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

analizë më të mirë të rrënjëve ekonomike dhe sociale të krimit, duke edukuar publikun mbi strategjitë e parandalimit të krimit dhe mbi atë se si të njohin dhe adresojnë faktorët e rrezikut. Sidoqoftë, në mjaft raste mediat mund të ndikojnë edhe negativisht në perceptimet e krimit. Raportimi i njëanshëm ose i pasaktë nuk mund të ndihmojë për të shpjeguar shkaqet themelore të dukurisë¹¹. Nëse mediat mbivlerësojnë një sjellje të dhunshme në një komunitet, kjo mund të ketë ndikimin e vet në komunitet.

Roli i të lënduarve në parandalimin e krimit. Së fundi, viktimat e dhunës mund t'i përballin përgjegjësit me veprimet e tyre. Komunikimi i përvojave të viktimave përmes kanaleve të tilla si sondazhet e viktimizimit, panelet e ndikimit të viktimave dhe mekanizmat e drejtësisë restauruese mund të forcojnë gjithashtu parandalimin e krimit dhe drejtësinë penale. Mbrojtja e viktimave dhe dëshmitarëve të krimit është gjithashtu jetësore. Ata shpesh janë të frikësuar, kërcënuar fizikisht dhe me raste janë vvarë¹². Për të pasur sisteme të drejtësisë penale më efektive, viktimat dhe programet për mbrojtjen e dëshmitarëve duhet të forcohen.

Strukturat tona të policisë përpiqen të reflektojnë standardet bashkëkohore. Të gjitha strukturat e Policisë i kushtojnë një vëmendje të veçantë policimit në komunitet. Në kuadër të hartimit të një strategjie gjithëpërfshirëse afatgjata kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, kjo strategji synon të zgjerojë objektin e vet dhe njëkohësisht edhe aktorët për realizimin e saj. Në radhë të parë synimi është që të ngrihet niveli i besimit dhe rritjes së sigurisë së komunitetit përmes policimit në komunitet¹³. Nga sondazhet e shumta vërehet se ka një 'frenim' apo stepje në procesin e bashkëpunimit midis komunitetit dhe strukturave policore.

Së dyti po bëhen përpjekje për hartimin e një draftstrategjie krijuese dhe novatore komunikimi, si plotësuese e Strategjisë Kombëtare. Kjo strategji do të marrë në konsideratë sfidat kryesore, në rastin tonë lidhet me ndikimin i qëndrimeve dhe sjelljeve kundrejt ekstremizmit të dhunshëm përmes fushatave të përshtatura sipas kontekstit dhe nismave të tjera të komunikimit. Së treti, parandalimi i retorikës së urrejtjes. Në këtë rast edhe pse ne nuk mund të jemi aktori kryesor, pasi ndërgjegjësimi i komunitetit realizohet nëpërmjet një rrugë të gjatë e ku aktorë si familja, shkolla, vetë komuniteti, media etj. do të luajnë një rol parësor.

E përmendëm edhe më lart që media online përditë e më shumë po ndikon në mënyrën e sjelljes së komunitetit, veçanërisht të rinjve ndaj gjetja e mënyrave për të ndjekur angazhimin në internet vërehet si një sfidë e rëndësishme veçanërisht për policimin në komunitet. Zhvillimi i njohurive dhe ekspertizës për të luftuar kundër ekstremizmit të dhunshëm, përmes hulumtimit dhe ndarjes së informacionit si dhe rritja e kapaciteteve profesionale do të jenë angazhime afatgjata. Një nga prioritetet për vitin 2018 është dhe "Parandalimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, i cili do të kryhet përmes policimit në komunitet, bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm vendor, si dhe realizimit të fushatave ndërgjegjësuëse". Për të parandaluar dhe minimizuar këtë fenomen që aktualisht ka marrë një dimension global, duke u nisur nga fakti se strukturat e policimit në komunitet kanë një rol të rëndësishëm në evidentimin dhe parandalimin e tij, nga ana jonë është kërkuar në vazhdimësi ndihma e misioneve

Alushani, R.

« Roli i strukturave të policimit në komunitet, në përballje me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm »

Policimi dhe Siguria

nr.14, 2019

¹¹ Walker S, Walker C, Mc David J(1992) *The Victoria community police stations: A threepoint evaluation*. Canadian Police College.Ottawa.

¹² Morgan J B (1996) *The police function and the investigation of crime*. Avebury: Gower.

¹³ Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 930 datë 18.11.2015 për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.

ICITAP, PAMECA dhe OSBE – së, në trajnimin e efektivave të policimit në komunitet, kryesisht për çështje të evidentimit të elementëve me qëndrime radikale ekstremiste, terroriste etj. Është marrë pjesë në konferencat kombëtare dhe rajonale të zhvilluara “Për ekstremizmin e dhunshëm”, organizuar edhe nga ekspertë të BE – së, ku përveç diskutimeve në këtë fushë, është kërkuar edhe trajnimi i efektivave tona për këtë qëllim. Po ashtu është parashikuar në programin e trajnimit për vitin 2017 dhe 2018, edhe trajnime profesionale të efektivave të policimit në komunitet për çështje të ekstremizmit të dhunshëm.

Në bashkëpunim dhe me drejtues të Akademisë së Sigurisë, drejtorisë së antiterrorit, sektorit të komunikimit me medien, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, u përgatit një material, për zhvillimin e fushatave sensibilizuese, për parandalimin e fenomenit të Radikalizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm. Së fundmi, së bashku me strukturat e tjera të Policisë së Shtetit, kemi përcjell mendimet/sugjerimet tona, për draftplanin e veprimit, hartuar nga Qendra e Koordinimit Kombëtar Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKKEDH), ku kemi përcaktuar detyrimet tona në drejtim të parandalimit të këtij fenomeni.

3. Përfundim

Përballja me fenomenin e analizuar paraqitet e vështirë dhe delikate. Njëkohësisht ajo është një sfidë e rëndësishme e shoqërisë tonë dhe në veçanti e institucioneve ligjzbatuese, që kanë për detyrë, parandalimin, identifikimin, hetimin, procedimin penal dhe dënimin e autorëve të këtyre veprave penale. Koha për tu përballuar me këtë fenomen nuk pret, prandaj përveç takimeve, konferencave, workshop-ëve të zhvilluara dhe që mund të zhvillohen për specifikimin e masave e detyrave për ta parandaluar e luftuar atë, është koha që të gjithë së bashku të bashkëpunojmë e koordinojmë punët me strukturat e policimit në komunitet, në radhë të parë, për të kuptuar nga gjithkush arsyet që të çojnë tek ky fenomen e më pas për ta luftuar atë. Sfidat për të parandaluar e luftuar fenomenin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm nuk janë aspak të lehta, por as edhe të pamundura.

Referenca

1. Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 930 datë 18.11.2015 për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.
2. O’Block RL, Donnermeyer JF, Doeren E (1991) *Security and crime prevention*. 2nd edn. US: Butterworth-Heinemann.
3. Morgan J B (1996) *The police function and the investigation of crime*. Avebury: Gower.
4. Friedman R R (1992) *Community policing: Comparative perspectives and prospects*. New York: Harvester Wheatsheaf.
5. Walker S, Walker C, Mc David J (1992) *The Victoria community police stations: A threepoint evaluation*. Canadian Police College. Ottawa.
6. Degu Y (2014) *Community Policing or Policing the Community? The Emerging Police Practice*. Prince University,.
7. Jeremy W M (2006) *Community policing in America*. Routledge Taylor and Francis Group, New York.
8. Lisa D, Kassaye D (2013) *Securing communities for development: community policing*. National Regional State.
9. Crowe TD (2000) *Crime prevention through environmental design: Applications of architectural design and space-management concepts*. 2nd edn. New York: Butterworth-Heinemann.

Alushani, R.

« Roli i strukturave të policimit në komunitet, në përballje me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

Bibliografi

1. Dokumenti për Sigurinë në Komunitet 2015-2017.
2. Strategjia e Sigurisë Kombëtare 2015
3. Ligji nr. 19/2016 për masat shitesë të sigurisë publike.
4. Braga, Anthony and Bond, Brenda (2008). "Policing Crime and Disorder Hot Spots: a Randomized Controlled Trial." *Criminology* Vol. 46 No. 3, August 2008.
5. Bratton Group, LLC (2013). *District-Based Investigations in Oakland: Rapid and Effective Response to Robberies, Burglaries, and Shootings*.
6. Cordner, G. (2010). *Reducing Fear of Crime: Strategies For Police. Community Oriented Policing Services*. U.S. Department of Justice.
7. Diamond, D. And Weiss, D. (2009). *Advancing Community Policing Through Community Governance: a Framework Document*. Washington, DC: U.S. Department of Justice.
8. US Department of Justice, *Community-Oriented Policing Services*.
9. Goldstein, H (1987). "Toward Community-Oriented Policing: Potential, Basic Requirements, and Threshold Questions." *Crime and Delinquency* Vol. 33 No. 6.
10. Harnett Associates (2006). *Crime Fighting in Oakland: An Assessment of the Oakland Police Department*.
11. Kelling, G. And Moore, K. (1988). "The Evolving Strategy of Policing." *Perspectives on Policing* No. 4. November 1988.

Alushani, R.

« Roli
i strukturave
të policimit
në komunitet,
në përballje
me radikalizmin
dhe
ekstremizmin
e dhunshëm »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019



Alushani, R.
« Roli
i strukturave të policimit
në komunitet,
në përballje
me radikalizmin
dhe
ekstremizmin
e dhunshëm »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

Lidhja e krimit të organizuar me terrorizmin - një rrezik për sigurinë

■ **MSc. Nënkolonel (r) Alqi NIKOLLA**

Specialist Kërkimi për Sigurinë, QDK

Forcat e Armatosura

Abstrakt

Në epokën e globalizimit, marrëdhënia në zhvillim midis krimit dhe terrorizmit paraqet sfida, probleme dhe kërcënime të rëndësishme në mbarë botën. Nuk ka vend në botë që mund të jetë i mbrojtur kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar. Në Evropë ekziston një lidhje midis krimit dhe terrorizmit, ku shoqëri të marginalizuar dhe me ekonomi informale, janë më të prekshëm ndaj radikalizimit. Në vende të tjera, marrëdhënia ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit është shndërruar në një lidhje të ngushtë, në të cilën është bërë gjithnjë e më e vështirë për të nxjerrë një dallim kuptimplotë. Aktivitetet e terroristëve dhe krimit të organizuar shpesh forcojnë njëri-tjetrin, ku terroristët angazhohen drejtpërdrejt ose tërthorazi në aktivitete të krimit të organizuar si trafikimi, kontrabanda, zvatja, rrëmbimi për shpërblësë dhe tregtia e paligjshme e burimeve natyrore për përfitime financiare dhe/ose materiale. Përfitimet e tilla kontribuojnë në minimin e sigurisë shtetërore, stabilitetin dhe zhvillimin social dhe ekonomik, i cili mund të krijojë kushtet për të lulëzuar grupet e organizuara kriminale. Nga ana tjetër, grupet e krimit të organizuar mund të përdorin taktika terroriste, përfshirë përdorimin strategjik të dhunës. Zgjerimi i rrjeteve kriminale transnacionale të përfshira në trafikimin e drogës, armëve, personave dhe mallrave është një nga kërcënimet më serioze për sigurinë ndërkombëtare. Këto rrjete kanë përfituar nga përparimet në komunikim dhe transport, për të zgjeruar shtrirjen e tyre globale. Në shumë raste, kanë konverguar me grupe terroriste dhe aktorë të tjerë të dhunshëm. Përtej kërcënimit që lidhet me vetë trafikimin, këto aleanca transnacionale paraqesin kërcënime të reja të sigurisë. Këto aktivitete janë gjithashtu shtytësit kryesorë të destabilizimit ose kriminalizimit të shteteve të dobëta ku veprojnë këto rrjete, duke krijuar qendra alternative të fuqisë të institucioneve shtetërore si; policia, gjyqësori dhe autoritetet lokale. Në këtë material do të analizojmë pikat e përbashkëta dhe dallimet kryesore midis tyre, për të theksuar lidhjen e tyre dhe krijimin e rrjeteve të tilla dhe në të njëjtën kohë, për të vënë në dukje problemet e sigurisë së terrorizmit dhe krimit të organizuar si kërcënime të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Terrorizmi dhe krimi i organizuar, janë dy forma të ndryshme të veprimtarisë kriminale dhe një kërcënim i njëjtë për sigurinë njerëzore.

Nikolla, A.
« Lidhja e krimit të organizuar me terrorizmin - një rrezik për sigurinë »

Policimi dhe Siguria nr.14, 2019

Fjalëkyçe:

krimi i organizuar, terrorizëm, ISIS, Ballkan, teknologji, grupe kriminale.

1. Hyrje

Historia e njerëzimit ka qenë gjithmonë e shoqëruar me violencë. Krimi ka ekzistuar që kur njerëzit u organizuan për herë të parë në një formë institucionale shtetërore. Së pari u shfaq si një grup i aktiviteteve dhe sjelljeve, të cilat sulmuan dhe rrezikuan vlerat njerëzore, liritë dhe të drejtat themelore, pronën dhe sigurinë. Krimi është zhvilluar me evoluimin e shoqërisë dhe ndryshime të rëndësishme kanë ndodhur në aspektin e organizimit të krimit. Gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, krimi i organizuar dhe terrorizmi u konsideruan si fenomene të veçanta që nuk përbënin një kërcënim ndaj rendit botëror. Pas kësaj periudhe, situata ndryshoi në mënyrë drastike dhe dolën prirje të reja globale që ndikuan në natyrën e këtyre fenomeneve, si dhe financimin e terrorizmit. Globalizimi, i cili ka pasur zgjerim pas rënies së Perdes së Hekurt dhe hapjes së kufijve pas rënies së sundimitarit të Evropës Lindore, solli zhvillimin e shumë sferave të jetës shoqërore. Zhvillimi i vlerave pozitive të shoqërisë mbarte me vete edhe vlera negative.

Në mjedisin pas 11 shtatorit 2001, Shtetet e Bashkuara të Amerikës luajtën një rol dominues në luftën kundër financimit të terrorizmit, duke shpallur “luftën kundër terrorit”, e cila përfshinte ngrirjen e asetëve dhe bllokimin e transaksioneve financiare për individët, organizatat bamirëse dhe asociacionet shoqëruese me terroristët. Ndërsa aktivitetet e tyre për mbledhjen e fondeve u kufizuan ndjeshëm, grupet terroriste u detyruan të zhvilloheshin dhe të gjenin mënyra të reja financimi të aktiviteteve të tyre terroriste, si përfshirja në trafikimin e drogave dhe aktivitete të tjera të paligjshme dhe format e krimit të organizuar. Nga ana tjetër, organizatat kriminale iu përshtatën rrethanave të reja, duke u shndërruar në entitete hibride të fuqishme kriminale me një sistem të brendshëm të financimit, që u mundësoi atyre të angazhohen në aktivitete terroriste me qëllim të rritjes së fitimeve të tyre.

Nikolla, A.
« Lidhja
e krimit të
organizuar
me terrorizmin
- një rrezik
për sigurinë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

Terrorizmi dhe krimi i organizuar janë ndër kërcënimet kryesore globale të kohës sonë. Në 10-12 vitet e fundit ka pasur një rritje të pashembullt në rrjetet globale terroriste dhe organizatat kriminale transnacionale. Kompleksiteti i këtyre kërcënimeve të shekullit 21 reflekton anën e errët të globalizimit, e cila i ka fuqizuar këto grupe që të bashkëpunojnë në mbarë botën në një shkallë të paprecedentë. Marrëdhënia në zhvillim midis krimit dhe terrorizmit paraqet sfida të rëndësishme dhe është një kërcënim në mbarë botën. Nuk ka asnjë vend në botë që mund të jetë i mbrojtur kundër problemeve që rrjedhin nga terrorizmi dhe krimi i organizuar. Krimi i organizuar dhe terrorizmi mund të rrezikojnë sigurinë e vendit si nga jashtë ashtu dhe nga brenda. Krimi i organizuar si një formë e rrezikut për sigurinë e brendshme të një vendi, përhapet edhe në vendet fqinje. Ai përhapet gjerësisht duke u bërë një kërcënim për vendet e tjerë. Terrorizmi si një dorë e zgjatur e krimit të organizuar, duke qenë i motivuar politikisht, është një realitet që ne të gjithë e jetojmë.

Lidhja ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit, apo siç përshkruhet nga disa autorë, “si martesë e përkohshme e lehtësirave; takimi i njëanshëm ose partneriteti afatgjatë”¹ është komplekse dhe e sofistikuar dhe mund të shihet nga aspekte të ndryshme, sidomos kur kjo lidhje merret parasysh në një nivel global, duket se është një kërcënim i madh në pjesë të ndryshme të botës; në veçanti Evropa, ku terroristët dhe kriminelët tani rekrutojnë nga i njëjti mjedis.

Kjo lidhje ndikon drejtpërsëdrejti në sigurinë e vendit dhe paraqet një kërcënim serioz, si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Një parakusht thelbësor për të kuptuar lidhjen ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit është të kuptojmë ato veç e veç. Terrorizmi dhe krimi i organizuar, janë dy forma të ndryshme të veprimtarisë kriminale dhe një kërcënim i barabartë për sigurinë njerëzore. Pavarësisht shumë ngjashmërive operacionale dhe organizative, ato janë ende fenomene të ndara dhe shqyrtimi i karakteristikave, ngjashmërive dhe dallimeve të tyre, është hapi i parë në luftimin e tyre.

Është e rëndësishme që të përcaktohet përkufizimi i saktë i të dy aktivitetëve, kështu që mund të kategorizojmë çdo veprim të kryer. Gjithashtu duhet të zhvillojmë detajet e dallimeve në mes të këtyre aktivitetëve kriminale, si dhe analizojmë ngjashmëritë. Duke bërë sistematikisht ndarjen ndërmjet ngjashmërive dhe dallimeve midis terroristëve dhe kriminelëve, mund të nxjerrim një vlerësim më të mirë se kush janë, çfarë bëjnë, si veprojnë dhe pse bëjnë atë që bëjnë.

2. Lidhja ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit

2.1 Ngjashmëritë

Krimi i organizuar dhe terrorizmi karakterizohen nga ngjashmëri të konsiderueshme, të cilat janë një nga faktorët kryesorë që kontribuojnë në konsiderimin e tyre si të ndërsjellë dhe të ndërthurur.

- *Narkoterrorizmi*, ishte identifikimi i parë i lidhjes ndërmjet terrorizmit dhe krimit të organizuar. Ky term u krijua në fillim të viteve 1980 nga Presidenti i Perusë Fernando Belaunde Terry kur forcat e tij policore po përballëshin me trafikantët e

¹ Crime and Terror in Europe: Where the Nexus Is Alive and Well by Colin P. Clarke. <https://www.rand.org/blog/2016/12/crime-and-terror-in-europe-where-the-nexus-is-alive.html>

drogës të cilët përdornin taktika terroriste për të rritur fitimet, apo terroristët që përdornin drogën për të financuar organizimin dhe operacionet e tyre. Amerika Latine është vendlindja e narkoterrorizmit dhe rajoni është bërë sinonim me këtë term. Trafikimi i drogës u përdor për të çuar përpara objektivat politike të disa qeverive dhe organizatave terroriste, apo siç shprehet Emma Bjornehed, “përpjekjet e trafikantëve të narkotikëve për të ndikuar në politikat e qeverisë nga kërcënimet sistematike ose përdorimi i dhunës”².

- Një karakteristikë tjetër është ajo *financiare*. Veprimet terroriste financohen nga: aktivitetet kriminale, vendet që financojnë direkt terrorizmin, individë që janë mbështetësit për shkak të arsyeve dhe motiveve të ndryshme, ndihma e organizatave të tjera terroriste, dhe një kombinim i të gjitha burimeve mbështetëse të përmendura. Burimet më fitimprurëse financiare janë: trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi i drogës, trafikimi i armëve, trafikimi organeve njerëzore, forma e organizuar e prostitucionit, trafikimi materialeve të rrezikshme, mbetjet nukleare, mbeturinat radioaktive, agjentët kimik dhe biologjik, pastrimi i parave, mashtrimet financiare, etj. Kështu, aktivitetet kriminale të disa organizatave terroriste financohen nga krimi i organizuar, ndërsa disa organizata kriminale që kanë fituar pushtet financiar shfaqin ambicjet politike me ndihmën e terrorizmit.

- Një tjetër ngjashmëri është *profili i ngjashëm* i personalitetit të anëtarëve të tyre. Të dyja entitetet duket se po rekrutojnë anëtarët e tyre nga grupet shoqërore periferike të ekspozuara dhe të ngarkuara nga zhgënjimet shoqërore apo politike. Burgjet janë gjithashtu baza e rëndësishme e takimit për terroristët me krimin e organizuar. Këto vende u mundësojnë terroristëve të rekrutojnë individë për detyra të veçanta si falsifikim dokumentesh apo trafikim të armëve dhe njerëzve. Terroristët që kryen sulmet në trenat e Madridit më 11 mars 2004 ishin kriminelë që u rekrutuan në burg nga terroristët³.

- Një tjetër karakteristikë e përbashkët është *planifikimi* i detajuar dhe *përgatitja* e aktiviteteve të paligjshme të tyre. Të dy grupet kriminale shfaqin një respekt të disiplinës strikte, që përfshin rregulla rigorozë të sjelljes dhe një sistem të brendshëm ndëshkimi. Të dy përdorin të njëjtin lloj taktikash: angazhohen në kontrabandën ndërkuftare, pastrimin e parave, falsifikimin, rrëmbimin, zhvatjen dhe lloje të ndryshme të dhunës.

- Tjetër ngjashmëri është *fshehtësia dhe konfidencialiteti* i aktiviteteve të tyre, përdorimi i dhunës për të arritur qëllimet ose interesa të caktuara. Të dy përdorin dhunën kundër objektivave kryesisht civilë. Ata përdorin taktika të ngjashme si rrëmbimi, vrasja dhe zhvatja. Të dy llojet e kriminelëve funksionojnë në fshehtësi, dhe përdorin infrastrukturë dhe rrjete të korrupsionit të njëjtat (ose të ngjashme) për aktivitetet e tyre.

- Në të dyja llojet e organizatave, *kontrolli i grupit mbi individin* është i fortë. Të dyja përdorin operacione si biznesi i ligjshëm ose organizata bamirëse për të fshehur aktivitetet e tyre dhe pastruar paratë. Sidoqoftë, të dy llojet e kriminelëve duhet të përdorin ekonominë/financat dhe rrjetet e fshehta për të lëvizur njerëzit, mallrat, armët, kontrabandën dhe, më e rëndësishmja, paratë. Terroristët përdorin rrjete ekzistuese kriminale për logistikë, duke përfshirë aktivitetet financiare.

- Disa autorë, që kanë shkruar për këtë lidhje, si Makarenko dhe Thamm,

² Emma Bjornehed - "Narco-Terrorism: The Merger of the War on Drugs and the War on Terror"

³ L. Shelley, "Growing Together, Ideological and Operational Linkages between Terrorists and Criminal Networks". www.fundforpeace.org/www/images/pdf/shelley.pdf

Nikolla, A.
« Lidhja
e krimit të
organizuar
me terrorizmin
- një rrezik
për sigurinë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

interpretojnë ngjashmëritë ndërmjet terrorizmit dhe krimit të organizuar në mënyrë të thjeshtësuar, duke theksuar faktin se këto dy grupe kanë një “armik” të përbashkët: *shtetin*.

- *Teknologjia* është një komponent kyç i terrorizmit dhe veprimtarive kriminale të kryera nga grupe të krimit të organizuar duke u ofruar një shkallë të paprecedent fleksibiliteti. Kjo është veçanërisht e dukshme në lehtësinë me të cilën kriminelët i përshtaten ndryshimeve në shoqëri. Interneti, shumica e platformave *online* dhe kanaleve të komunikimit që mbajnë, kanë pasur një ndikim të madh në shoqëri, duke forcuar dhe transformuar ekonominë, duke nxitur inovacionin dhe duke formuar bashkëveprimin social. *Interneti* dhe hapësira kibernetike janë bërë mjete thelbësore për krimin e organizuar dhe rrjetet terroriste. Ato shfrytëzojnë mjetet e internetit për rekrutimin, propagandën, planifikimin, logjistikën, mbledhjen e fondeve dhe pastrimin e parave. Interneti gjithashtu ka ndihmuar krimet kibernetike të tilla si vjedhjet e identitetit, të piraterisë, mashtrim me kartë krediti etj. Interneti përdoret gjerësisht për të planifikuar sulme terroriste, duke përfshirë objektivat dhe udhëzimet për sulmet/grabitjet, ndërtimin e bombave artizanale dhe operacione të ndryshme.

- Globalizimi gjithashtu ka lehtësuar *transfertat* ndërshtetërore. Pasojat ishin *popullata të mëdha migruese* në vendet e zhvilluara. Këto grupe të popullsisë janë një bazë e mirë dhe një mbështetje për grupet dhe rrjetet kriminale në vendet e zhvilluara. Në shumë raste ata janë stacioni i fundit për para të fituara nga aktivitetet kriminale. Në këtë mënyrë shumë terroristë që përdorin migracionin depërtojnë në një shoqëri shtetërore dhe bëhen bazë dhe mjet për veprimet dhe aktivitetet kriminale të organizatës terroriste. Disa nga rrugët e emigranteve janë të njëjta me ato të trafikut të drogës, gjë që na jep një tablo më të qartë për lidhjen ndërmjet migrimit, krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Ekzistojnë raste të organizatave violente të cilat mbartin të dy karakteristikat si ato kriminale ashtu dhe terroriste. Për shembull, terroristët e Çeçenisë mund të jenë kryesisht të interesuar në krijimin e një shteti të pavarur, por gjithashtu mund të jenë të interesuar në ruajtjen e shkallës së paqëndrueshmërisë në mënyrë që ata të vazhdojnë të angazhohen në aktivitete kriminale jashtëzakonisht fitimprurëse⁴. Po kështu në rastin e Shtetit Islamik në Lindjen e Mesme, lidhja shkon akoma më tej. Organizata rekruton më shumë kriminelë të mëparshëm dhe financohet më shumë nëpërmjet veprimtarive të vogla - jo të organizuara - kriminale sesa grupet e tjera. ISIS bashkëvepron me dinamikën komplekse të autoritarizmit, rebelimit dhe përfaqësimit politik në të gjithë rajonin, duke e bërë gjithnjë e më komplekse për të kuptuar dhe përcaktuar atë.

2.2 Diferencat

Ashtu si në zhvillimin e detajeve të ngjashmërive midis dy aktiviteteve në fjalë, është gjithashtu e rëndësishme për të analizuar edhe dallimet midis tyre.

- Një nga dallimet kryesore midis krimit të organizuar dhe terrorizmit është *motivimi dhe objektivat* që ata kanë. Terroristët veprojnë për qëllime idealiste dhe që synojnë reformimin e realitetit shoqëror. Nga ana tjetër, anëtarët e krimit të organizuar besohet të veprojnë për qëllime të përfitimit personal.

- Në periudhën afatshkurtër, terroristët dhe kriminelët kryejnë krime të njëjta

⁴ Roth, M.P. (2016). Global Organized Crime. Santa Barbara: ABC-CLIO;

për të njëjtat arsye, të paktën sa i përket ngritjes së fondeve. Nëse bëhet fjalë për trafik droge, grabitje bankare ose ndonjë formë tjetër krimi që ofron fitim, ata të dy dëshirojnë të bëjnë para. Dallimi natyrisht qëndron në *planin afatgjatë*. Terroristët duan të bëjnë sulme të profilit të lartë që synojnë të fitojnë publicitet dhe përfundimisht të sjellin njëfarë ndryshimi social dhe politik. Në të njëjtën kohë, ata shpesh besojnë se ata po veprojnë në emër të një grupi të caktuar shoqëror të cilin ata dëshirojnë të mbrojnë ose çlirojnë. Për krahasim, kriminelët duket se janë të shqetësuar pothuajse ekskluzivisht me fitime egoiste dhe nuk kanë interes të dukshëm as në publicitet apo në politikë, përveç nëse mund të përfitojnë financiarisht. Qëllimet e tjera, veçanërisht ato politike, që lidhen me krimin e organizuar ndaj terrorizmit, janë vetëm efekte anësore të aktiviteteve të krimit të organizuar. Pra, *qëllimet politike/ideologjike* të terroristëve paraqesin dallimin kritik midis terroristit dhe kriminelit.

- Një tjetër pikë, në të cilën të dyja ndryshojnë, është në lidhje me *“dukshmërinë”* e aktiviteteve të tyre. Grupet terroriste zakonisht kërkojnë vëmendjen e medieëve ndërsa grupet e krimit të organizuar nuk e bëjnë. Grupet e krimit të organizuar nuk i zbulojnë qëllimet e tyre publikisht, kurrë nuk tregojnë aspiratat e tyre politike haptazi dhe aspirojnë të mbajnë aktivitetet e tyre në mënyrë *“të padukshme”*. Terroristët, nga ana tjetër, jo vetëm që deklarojnë qëllimet e tyre haptazi, por e bëjnë këtë në mënyrë që të fitojnë mbështetje nga grupe të caktuara të njerëzve, në mënyrë që vendosmëria e tyre në përmbushjen e qëllimit të tyre të bëhet e qartë për të gjithë. Organizatat terroriste *pretendojnë përgjegjësinë* për sulme terroriste, ndërsa pjesëtarët e grupeve të krimit të organizuar nuk marrin asnjë përgjegjësi për veprat e tyre kriminale.

- Po kështu ka veçori dalluese në aktivitetin kriminal të ndjekur nga grupe të ndryshme terroriste për sa i përket *faktorëve “historikë dhe kulturorë”*⁵. Terroristët radikalë islamikë kërkojnë *“individë të nivelit të ulët për të kryer aktet kriminale, duke i rekrutuar më pak për aftësitë kriminale sesa për lidhjet e tyre me komunitetet lokale. “Në anën tjetër, “grupet kriminale në përgjithësi rekrutojnë individë posaçërisht për aftësitë e tyre kriminale”*⁶.

- Për sa i përket *anës logjistike*, grupet e krimit të organizuar në përgjithësi hezitojnë të punojnë me grupet terroriste, ose në shitjen e mallrave dhe shërbimeve ndaj tyre. Arsyeja kryesore është se krimi i organizuar frikësohet se çdo shoqëri me grupet terroriste do të intensifikojë shqyrtimin/këqyrjen e kujdesshme të zbatimit të ligjit, duke rrezikuar operacionet e kriminelëve dhe ndoshta edhe mbijetesën e tyre. *“Kriminelët duan të jetojnë për të vjedhur një ditë tjetër; ata nuk janë kandidatë për bombardime vetëvrasëse”*⁷.

- Grupet terroriste nuk janë dakord/nuk përkrahin *fuqizimin e grupeve kriminale* pasi kjo mund të bëjë që ata t'u kthehen atyre. Për më tepër, për arsye kulturore, grupet terroriste islamike dhe të tjera antiperëndimore mund të kundërshtojnë shitjen e filmave amerikanë të piratuar apo simbolet e vetë shoqërisë që dëshirojnë ta zgjedhin. Grupe të tilla si Forcat Revolucionare të Armatosura të Kolumbisë (FARC) dhe Ushtria Kombëtare e Çlirimit të Zapatistas (EZLN) kanë refuzuar të angazhohen në aktivitete kriminale që, edhe pse fitimprurëse, nuk përputhen me agjendën e pastër ideologjike apo politike të grupeve.

⁵ Mark S. Hamm, *Crimes Committed by Terrorist Groups: Theory, Research, and Prevention*, Washington, D.C.: U.S. Department of Justice, Office of Justice Programs, <http://www.ncjrs.gov/pdffiles1/nij/grants/211203.pdf>

⁶ Po aty.

⁷ Jeanne K. Giraldo and Harold A. Trinkunas, “The Political Economy of Terrorist Financing.”

Nikolla, A.
« Lidhja
e krimit të
organizuar
me terrorizmin
- një rrezik
për sigurinë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

- Edhe pse mendohet se terrorizmi dhe krimi i organizuar kanë të njëjtin armik, “shtetin”, marrëdhënia e tyre ndaj shtetit është një tjetër veçori dalluese. Ndërsa terrorizmi karakterizohet nga një konfrontim i vazhdueshëm që me krijimin dhe një përpjekje për të ndryshuar qeverinë, krimi i organizuar është i njohur për infiltrimin e tij, korrupsionin, rryshfetin e zyrtarëve shtetëror dhe antagonizmin selektiv ndaj niveleve të caktuara të qeverisjes. Lidhja ndërmjet krimit të organizuar dhe zyrtarëve të qeverisë duket se është më themelore se ajo midis terroristëve dhe qeverive në shumicën e vendeve.

- Grupet e përfshira në krimin e organizuar shpesh kërkojnë të ruajnë status *quo-n* sesa të ndryshojnë atë. Edhe pse preferojnë që shteti të jetë i dobët dhe i paaftë, po ashtu preferojnë të mos imponojnë ndryshime të mëdha në kushtet ekzistuese të shtetit në mënyrë që aktivitetet e tyre kriminale të vazhdojnë të paprekura. Në këtë rast, është e vështirë të akuzohet krimi i organizuar si kërcënim për sigurinë kombëtare.

- Terrorizmi dhe organizatat kriminale në aktivitetin e tyre shpesh varen nga furnizuesit e njëjtë, mjetet e transportit, infrastruktura dhe burimi i të ardhurave. Kjo jo vetëm që është kusht për bashkëpunim por, ajo gjithashtu mund të çojë në konkurrencë që mund të rezultojë në *mosmarrëveshje apo përplasje të armatosur* midis tyre. Gjobat e përdorur nga terroristët për prodhuesit e drogës, si një shembull i lidhjeve midis drogës dhe terrorizmit, në të vërtetë nuk është një shembull bashkëpunimi por, një shembull i një marrëdhënie klienteliste.

2.3 Kompleksiteti i lidhjes

Siguria kombëtare ka të bëjë me mbrojtjen nga çdo formë kërcënimi që synon të sfidojë sistemet politike, stabilitetin shoqëror, ekonominë, sigurinë ndërkombëtare apo çdo sektor tjetër të shoqërisë. Në vitin 2012, James Clapper, Drejtori i Inteligjencës Kombëtare Amerikane, theksoi se “rritja e subjekteve të krimit të organizuar, si rrëmbimi, kontrabanda dhe financimi i paligjshëm, si dhe lidhjet e tyre me terrorizmin, duhej të konsideroheshin ndër shqetësimet më të ngutshme të sigurisë kombëtare të Shteteve të Bashkuara”⁸.

Terrorizmi dhe krimi i organizuar transnacional nuk mund të studiohen të ndara nga njëri-tjetri. Të dy grupet, kriminale dhe terroriste, po bashkëpunojnë gjithnjë e më ngushtë. Disa grupe shndërrohen në grupe të reja krimi-terroristë që shfaqin karakteristikat e të dyjave. Për një dekadë ata u perceptuan të jenë të nxitura nga motive të ndryshme: terroristët u perceptuan se kishin qëllime politike, ideologjike, fetare ose etnike dhe kriminelë të organizuar kryesisht qëllime ekonomike. Terrorizmi nuk shihej si veprim kriminal, por si një formë e dhunës politike. Sot, shumica e terroristëve janë të angazhuar në një formë të krimit të organizuar dhe një numër në rritje i karteleve të krimit të organizuar po angazhohen në dhunë politike. Trafikimi i drogave është akti më i zakonshëm kriminal që bashkon kriminelët e organizuar me terroristët. Këto grupe janë duke u etiketuar nga zyrtarët e zbatimit të ligjit në terma të tillë të rinj si narkoterroristë, narkoguerilas dhe narkofundamentalizëm⁹.

Përbërja në rritje e krimit dhe terrorit i bën ata më të fuqishëm: terroristët përfitojnë

Nikolla, A.
“Lidhja
e krimit
të organizuar
me terrorizmin
- një rrezik
për sigurinë”

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

⁸ Alda, E. Sala, J. L. (2014) “Links between Terrorism, Organized Crime and Crime: The Case of the Sahel Region Stability.” International Journal of Security & Development, 3(1): 27, p.3.

⁹ West Sands Advisory LLP Project lead: Dr. Tamara Makarenko - Europe’s Crime-Terror Nexus: Links between terrorist and organised crime groups in the European Union.

nga të ardhurat e aktiviteteve kriminale dhe kriminelët e organizuar po përdorin taktika terroriste për të fituar pushtet politik. Në disa raste, grupet kriminale kanë miratuar ideologjinë e grupeve terroriste ose janë shumë mbështetës për motivet e tyre, veçanërisht në rajonet me rritje tensionesh etnike dhe fetare. Të dy grupet po shfaqin veprime të ngjashme operacionale dhe organizative, dhe ndajnë eksperiencën e tyre të kaluar. Admirali James Stavridis, ish komandanti i Komandës Evropiane të SHBA-ve (USEUCOM) dhe Komandanti Suprem i Aleancës së NATO-s në Evropë (SACEUR), ka pohuar se “lidhja midis trafikimit të paligjshëm të drogës duke përfshirë rrugët, përfitimet dhe influencën korruptive dhe terrorizmin radikal islamik është një kërcënim gjithnjë në rritje i sigurisë”.

Lidhja ndërmjet krimit dhe terrorit është për shkak të katër zhvillimeve kryesore: *Globalizimi, Revolucioni i komunikimit përmes internetit, fundi i Luftës së Ftohtë dhe Lufta Globale ndaj Terrorit*. Globalizimi, për shkak të flukseve të tregtisë së lirë dhe reduktimit të pengesave tregtare, si dhe mjeteve të udhëtimit global, ka mundësuar që krimi dhe terrori mund të kryhen në të gjitha anët/skajet e globit, gjatë gjithë kohës. Po kështu fundi i Luftës së Ftohtë reduktoi disponueshmërinë e financimit të shtetit për lëvizjet terroriste dhe kryengritëse, të cilat detyruan terroristët të ndërmarrin aktivitete kriminale për të rritur të ardhurat e tyre. Po ashtu, grupet terroriste dhe të krimit të organizuar po shfrytëzojnë internetin për rekrutimin, planifikimin, operacionet psikologjike, logjistikën dhe mbledhjen e fondeve, pirateria e videove, mashtrimet me kartë krediti, shitja e drogës, zhvatja, pastrimi i parave dhe pornografia.

Rritja e lidhjes së terrorizmit dhe krimit të organizuar po përkeqëson përpjekjet kundër luftës dhe arritjen e paqes në Irak dhe Afganistan. Gjithashtu, Afrika Perëndimore në përgjithësi dhe Sahel në veçanti, janë bërë një qendër e re e trafikimit, e rrezikshme, që bashkon terroristët dhe kartelet e krimit të organizuar në një pjesë të gjerë dhe kryesisht në një hapësirë të paligjshme të tokës.

Rritja e lidhjes së terrorizmit dhe grupeve të krimit të organizuar po sfidon sigurinë ndërkombëtare dhe kombëtare duke dobësuar institucionet demokratike, duke kompromentuar institucionet qeveritare, duke dëmtuar besueshmërinë e institucioneve financiare dhe duke infiltruar ekonominë formale, duke çuar në rritjen e krimeve dhe sfidave të sigurisë njerëzore. Rëndësia e shqyrtimit të lidhjes midis këtyre dy fenomeneve përkon me rëndësinë e luftës kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar. Politika antiterroriste dhe antikriminale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar varet në masë të madhe nga kuptimi i çdo problemi veçmas, si dhe në kuptimin e lidhjeve reciproke të tyre të gjithanshme. Përndryshe, ekziston rreziku i një “bashkimi” teorik të një problemi me tjetrin, i cili në praktikë mund të çojë në probleme në luftimin e këtyre krimeve.

Marrëdhënia në zhvillim midis terrorizmit dhe krimit të organizuar përbën një sfidë të rëndësishme për bashkësinë ndërkombëtare. Përparimi i lidhjes nga një bashkëjetesë e thjeshtë drejt një marrëdhënieje reciproke të dobishme, si dhe linjat mes këtyre veprimtarive që tani po bëhen gjithnjë e më të paqarta, po e bëjnë të vështirë dallimin midis grupeve terroriste “të pastër”, dhe homologëve të tyre kriminalë apo diçka në mes tyre. Duke e njohur këtë prirje, bashkësia ndërkombëtare e ka adresuar lidhjen midis organizatave kriminale dhe terrorizmit në një numër instrumentesh dhe veprimesh. Në vitin 2001, Këshilli i Sigurimit i OKB miratoi Rezolutën 1373, duke kërkuar që të gjitha shtetet anëtare të trajtojnë me përgjegjësi lidhjet e mundshme midis terrorizmit dhe krimit të organizuar. Në vitin 2014, Këshilli

Nikolla, A.
« Lidhja e krimit të organizuar me terrorizmin - një rrezik për sigurinë »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

i Sigurimit i OKB miratoi Rezolutën 2195, “Kërcënimet ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare”, duke u bërë thirrje shteteve që të kuptojnë më mirë dhe të adresojnë lidhjen mes krimit të organizuar dhe terrorizmit si një kërcënim për sigurinë dhe zhvillimin e vendeve. Lidhja konceptuale mes terrorizmit dhe krimit të organizuar është bërë më e qartë nga veprimet e mëtejshme ndërkombëtare. Legjislati specifik ose deklaratat kanë shpjeguar në fusha të veçanta lidhjet teknike.

Pavarësisht nga njohja e përgjithshme e lidhjes midis organizatave kriminale dhe terrorizmit, nuk ka një konsensus mbi *përkufizimet* e terrorizmit dhe krimit të organizuar. Ka një marrëveshje të përbashkët që qëllimi i përgjithshëm i aktiviteteve terroriste përfshin motivet politike nëpërmjet frikësimit, shtrëngimit dhe dhunës drejt një popullate civile dhe/ose një qeverie; ndërsa terrorizmi, do të përkufizohet si përdorimi i paligjshëm i dhunës dhe kërcënimeve, veçanërisht kundër civilëve, në ndjekje të qëllimeve politike. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (United Nations Convention Against Transnational Organised Crime UNTOC) përcakton “grupin e organizuar kriminal” si një “grup i strukturuar prej tre ose më shumë personash, që ekzistojnë për një periudhë kohe dhe veprojnë në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një ose më shumë krimeve të rënda ose veprave penale në mënyrë që të përfitojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një përfitim financiar ose ndonjë përfitim tjetër material. Krimi i organizuar është një krim i rëndë i planifikuar, i koordinuar dhe i kryer nga njerëz që punojnë së bashku në mënyrë të vazhdueshme. Motivimi i tyre është shpesh, por jo gjithmonë, fitim financiar.

Teorikisht, dallimi ndërmjet terrorizmit dhe krimit të organizuar qëndron në objektivat dhe modalitetet e tyre përkatëse. Në përgjithësi, grupet terroriste janë ato që sfidojnë qëllimisht autoritetin shtetëror dhe kërkojnë ndryshime politike nëpërmjet dhunës (ose kërcënimit të dhunës) për shumë arsye, përfshirë ato ideologjike. Për grupet terroriste, mobilizimi i burimeve shihet si një instrument për të arritur qëllimet e tyre, në vend se vetë qëllimi (në vetvete). Ndryshe nga grupet terroriste të cilat në përgjithësi kërkojnë ndryshime politike ose ideologjike, grupet kriminale të organizuara kërkojnë përfitime personale financiare ose materiale si qëllimi përfundimtar i aktiviteteve të tyre.

Pavarësisht nga qëllimet dhe modalitetet/mënyrat e tyre, ka pak mosmarrëveshje, se krimi i organizuar dhe terrorizmi janë identike në atë që ato paraqesin sfida serioze, ndaj legjitimitetit të shteteve, paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Në të vërtetë, ekziston një dallim i theksuar në situatën në Evropë dhe vendet e tjera më të zhvilluara dhe rajonet që vuajnë deri diku nga konfliktet dhe sfidat më të gjera të zhvillimit, veçanërisht aty ku ka mungesë të mekanizmave të sundimit të ligjit dhe institucioneve shtetërore. Në realitet, dinamika e grupeve individuale nxitet nga mjedisi lokal, flukset e disponueshme të burimeve, politikat e shtetit në përgjigje, si dhe ndryshimet në situatën mbizotëruese rajonale dhe ndërkombëtare. Secili grup (si terrorist ashtu edhe kriminal) është unik dhe si pasojë, edhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Shumë shpesh, organizatat terroriste dhe grupet kriminale shihen si entitete monolite, homogjene dhe jo si rrjete komplekse dhe shumëdimensionale. Ndërsa janë vendosur linjat e lidhjeve midis grupeve terroriste dhe krimit të organizuar, natyra, shtrirja dhe thellësia e lidhjeve të tilla është shumë e debatuar. Ndërveprimi mes grupeve terroriste dhe organizatave kriminale nuk është i drejtpërdrejtë, secili rast është kontekst specifik dhe vazhdimisht evoluon.

Nikolla, A.
“Lidhja
e krimit
të organizuar
me terrorizmin
- një rrezik
për sigurinë”

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

3. Rasti i ISIS

Shfaqja e Shtetit Islamik në Lindjen e Mesme është momenti që ngriti vëmendjen ndërkombëtare ndaj terrorizmit. Megjithatë, ky grup famëkeq ka dalë dhe vazhdon të bashkëveprojë me dinamikën komplekse të autoritarizmit, rebelimit dhe përfaqësimit politik në të gjithë rajonin, duke e bërë atë gjithnjë e më komplekse për të kuptuar dhe përcaktuar. Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë (ISIS) është një grup terrorist relativisht i ri, por ka transformuar plotësisht nocionin e një “organizate” terroriste dhe mënyrën në të cilën ajo financon operacionet e saj. ISIS është identifikuar si organizata më e pasur terroriste në botë si pasojë e xhiros vjetore prej rreth 2 miliardë dollarë¹⁰.

Ashtu si me grupet e tjera të identifikuara, ISIS ka financuar aktivitetet e saj përmes një numri aktivitetesh të paligjshme për të zgjeruar operacionet e saj, veçanërisht në Evropë. Hetimet mbi sulmet e fundit në kontinent (veçanërisht në Paris dhe Belgjikë në vitin 2015 dhe 2016) kanë zbuluar bashkëpunimin e gjerë të grupit me organizatat kriminale evropiane për të marrë ose pasaporta të ligjshme evropiane nëpërmjet tregut të zi ose dokumente të falsifikuara për të shmangur zbulimin nga zyrtarët e kufirit dhe të kryejë sulmet e saj. Rrëmbimi dhe trafikimi i qenieve njerëzore kanë qenë burime të tjera financimi për grupin. ISIS ka rritur të ardhura të konsiderueshme përmes pagesës së shpagimit për viktimat e rrëmbyera, që shkojnë nga 20 milionë USD në 45 milionë USD¹¹.

Lëvizja e emigrantëve në të gjithë Lindjen e Mesme dhe Afrikë drejt Evropës ka gjeneruar miliona dollarë të ardhura për ISIS, me fonde që shkojnë jo vetëm për ISIS, por edhe për grupet e lidhura me Al-Kaidën rreth Saharës dhe milicive në Libi. Raportet sugjerojnë se ISIS i detyron me forcë sirianët të largohen nga shtëpitë e tyre në një përpjekje të qëllimshme për të rritur kontrollin e tyre mbi rrugët e kontrabandës, duke nënkuptuar një zhvendosje të prioriteteve nga ideologjike drejt qëllimeve financiare¹².

ISIS gjithashtu gjeneron të ardhura të mëdha nëpërmjet shfrytëzimit të sektorit të naftës dhe gazit, duke marrë pushtet dhe përpunuesit brenda Sirisë dhe Irakut dhe duke kontrabanduar naftë në Turqi, me vlerësime të fitimeve që arrinin deri në 3 milionë dollarë në ditë. Disa raporte tregojnë se këto të ardhura kanë rënë pasi SHBA dhe aleatët sulmuan objektet e naftës ISIS¹³. Përveç naftës, një prirje shqetësuese në rritje është kontrabanda e sendeve antike nga Siria, Iraku dhe Libia. Është vlerësuar se ISIS ka fituar mes 22 dhe 55 milionë dollarë në vit duke taksuar kontrabandistët e sendeve antike, të cilët kanë trafikuar objektet e plaçkitur jashtë Sirisë dhe Irakut¹⁴. Të ardhurat e krijuara nga aktivitetet e tilla përdoren për të mbështetur përpjekjet e rekrutimit dhe për të forcuar aftësitë operationale. Raportet tregojnë gjithashtu se ka një lidhje fitimprurëse të paligjshme midis mafies italiane dhe ISIS. Banda kriminale italiane besohet

¹⁰ <https://www.forbes.com/pictures/gkll45egf/1isis-annual-turnover/#4dab256c2c9d>.

¹¹ FATF Report, Financing of the Terrorist Organization Islamic State in Iraq and the Levant (ISIL) (Feb 2015). <http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/Financing-of-the-terrorist-organisation-ISIL.pdf>.

¹² “Libya: a growing hub for Criminal Economies and Terrorist Financing in the Trans-Sahara”, Policy Brief (May 2015), Norwegian Center for Global Analysis & Global Initiative Against Transnational Organized Crime, <http://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2017/02/2015-1.pdf>.

¹³ *Caliphate in Decline: An Estimate of Islamic State's Financial Fortunes*, The International Centre for the Study of Radicalization and Political Violence (2017), <http://icsr.info/wp-content/uploads/2017/02/ICSR-Report-Caliphate-in-Decline-An-Estimate-of-Islamic-States-Financial-Fortunes.pdf>.

¹⁴ <http://time.com/3857121/isis-smuggling/>.

Nikolla, A.
Lidhja e krimit të organizuar me terrorizmin - një rrezik për sigurinë ►

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

se blejnë objektet e grabitura nga Siria, Iraku dhe Libia në këmbim të një game të gjerë armësh¹⁵.

Siç u përmend më herët, përtej angazhimit në këto aktivitete kriminale të organizuara “tipike” për të financuar operacionet e saj, ajo që e përcakton ISIS nga organizatat e tjera terroriste është promovimi i rekrutimit të gjerë të terroristëve të frymëzuar nga ISIS në mbarë botën dhe veçanërisht në Evropë, me “kosto të ulët” jashtë vendit. Raportet tregojnë se deri në 90% të kompleteve xhihadiste në Evropë përfshijnë një element të vetëfinansimit, shpesh duke kryer krime të vogla¹⁶. Pra, ndërsa krimi i organizuar transnacional “i sofistikuar” mbetet një burim i madh i të ardhurave për ISIS për të kryer operacionet e tij në mbarë botën, ekziston një trend shqetësues i krimit të vogël në shkallë të gjerë i përdorur për të kryer sulme terroriste, duke bërë të mundur që çdo simpatizues ose përkrahës të përfshihet pothuajse pa kufij. Kriminelët evropianë janë një nga objektivat kryesore të ISIS për rekrutimin. “Vlerësohet se 50-80% e evropianëve në ISIS kanë rekorde kriminale - shumë më të larta se al-Kaeda, ku e njëjta statistikë qëndron në rreth 25%. Për shembull, policia federale gjermane zbuloi se dy të tretat e luftëtarëve gjermanë të ISIS kishin prejardhje kriminale, një e treta e të cilëve ishin dënuar më parë¹⁷.

ISIS është i interesuar në aftësitë e kriminelëve të vegjël/pa rëndësishëm, pasi ato mund të jenë të dobishëm në përgatitjen dhe ekzekutimin e sulmeve terroriste. Shumë kriminelë kanë përvojë në shmangien e autoriteteve, janë të njohur me kufijtë e kompetencave të policisë, janë në gjendje të veprojnë nën presion dhe të kontrollojnë emocionet e tyre, shpesh kanë qasje në armë dhe fonde të paligjshme dhe përdoren për dhunë. “ISIS legjitimon mënyrën e jetesës së një kriminelit të vogël dhe madje e lavdëron atë. Në dallim nga shoqëritë evropiane ‘grykuese’, perceptohet se ISIS ofron një jetë të re dhe më të mirë për ata që kanë një të kaluar kriminale, duke i çliruar ata nga disa krime, dhe duke i inkurajuar që të angazhojnë të tjerët”¹⁸. Ndryshe nga al-Kaeda, ISIS nuk kërkon që një anëtar i ri të ketë njohuri fetare, duke e bërë edhe më të lehtë konvergencën. Slogani i tyre i rekrutimit “nganjëherë njerëzit me të kaluarën më të keqe krijojnë të ardhme më të mirë” kapin këtë qasje në mënyrë të përmbledhur.

Në disa raste, është rreziku i qenësishëm/pandarë i botës së krimit që bën ISIS tërheqës për kriminelët e vegjël. “Reda Nidalha, një adoleshent holandez me prejardhje marokene, u largua për në Siri pasi ishte përfshirë në grabitje dhe bashkëpunëtorët e tij të mëparshëm kriminelë, pretendonin se u detyrohej atyre para. Një rekrutues belg i lindur në Marok, Khalid Zerkani, kishte në shënjestër (dhe rekrutoi) 72 belgë të rinj me prejardhje nga emigrantët, shumica e të cilëve kishin një histori të kriminalitetit të vogël.

Ai e bëri këtë duke dhënë legjitimitetin fetar në veprimet e tyre, duke argumentuar se “të vjedhësh nga të pafetë është e lejuar nga Allahu” dhe e nevojshme për të financuar udhëtimin në “zona të xhihadit”¹⁹. ISIS në vetvete është një element kriminalistik, pasi inkurajon të gjithë përkrahësit e tij (madje edhe ata që nuk kanë rekorde të mëparshme

Nikolla, A.
“Lidhja
e krimit
të organizuar
me terrorizmin
- një rrezik
për sigurinë”

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

¹⁵ Al Arabiya News, *Italian mob sells weapons to ISIS in Libya* (Oct. 2016), <http://english.alarabiya.net/en/News/middle-east/2016/10/17/Italian-mob-sells-weapons-to-ISIS-in-Libya-in-exchange-for-looted-antiquities>.

¹⁶ Oftedal, Emilie, *The Financing Of Jihadi Terrorist Cells In Europe*, Norwegian Defense Research Establishment (FFI) (Jan 2015) <http://www.ffi.no/no/Rapporter/14-02234.pdf>.

¹⁷ The crime-terrorism nexus by Florence Gaub and Julia Lisiecka European Union Institute for Security Studies (EUISS) April 2017.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ The crime-terrorism nexus by Florence Gaub and Julia Lisiecka European Union Institute for Security Studies (EUISS) April 2017.

kriminale) që të përfshihen në aktivitete kriminale. Megjithatë, ndërsa krimi zakonisht i paraprin radikalizimit, të dy prirën për të përforcuar reciprokisht njëri-tjetrin. Në përgjithësi, ndërveprimi i krimit dhe terrorizmit shkurton kohën midis radikalizimit dhe veprimit.

4. Një këndvështrim për Ballkanin

Kërcënimet asimetrike të sigurisë për vendet e rajonit ndajnë shumë sfida të përbashkëta të sigurisë që mund të ndikojnë në sigurinë integrale në rajon. Në kohën e sotme, krimi i organizuar dhe terrorizmi vlerësohet si një rrezik real për sigurinë e çdo vendi, por në mënyrë të veçantë, për sigurinë e vendeve me shtete e demokraci të brishta, që s'kanë as traditën as përvojën e duhur për t'u përballur efektivisht me të. Në këtë këndvështrim, për Ballkanin ky fenomen vlerësohet si rrezik kryesor për sigurinë e secilit vend dhe në përgjithësi të gjithë rajonit. Me gjithë progresin e arritur për të ndërtuar një të ardhme të re përmes procesit të integritimit në Bashkimin Evropian, në sytë e ndërkombëtarëve rajoni ynë ende vlerësohet mjaft i brishtë dhe sfidues. E vërteta është se në 20-25 vitet e fundit, në Ballkan ka lulëzuar një "industri e re", që punon me kapacitet të plotë e ajo quhet: "industria e krimit të organizuar". Kjo ka bërë që edhe këndvështrimi i vlerësimit gjeostrategjik të pësojë një ndryshim të madh. Rëndësia strategjike e Ballkanit tashmë shihet në rreziqet që ai mund të eksportojë prej tij. Krimi i organizuar shihet si një ndër rreziqet kryesore. Për këtë arsye lufta ndaj tij ka qenë një ndër drejtimet kryesore të kontributit ndërkombëtar për fuqizimin e institucioneve në vendet e rajonit, por në të njëjtën kohë edhe një ndër kushtet bazë që duhet të plotësojnë qeveritë e vendeve për realizimin e aspiratës së integritimit në BE dhe në NATO.

Po ashtu sipas vlerësimit të ekspertëve, krimi i organizuar përfshihet në kërcënimet kryesore të kohës së sotme për sa i përket sigurisë. Krimi i organizuar shihet si një burim që i ushqen drejtpërsëdrejti këto kërcënime, qoftë atë të konflikteve rajonale dhe ndëretnike si dhe terrorizmin. Si veprimtari antiligjore që ka në themel fitimin e paligjshëm, krimi i organizuar kërcënon stabilitetin e sundimit të ligjit dhe sfidon e kërcënon pareshtur themelet ekonomike e ligjore të shtetit. Krimi i organizuar, me përqendrimin e tij në krimin ekonomik e financiar, është bërë sot komponent me rritje më të lartë në botë. Ky fuqizim i grupeve kriminale të krimit të organizuar dhe tendenca e gjetjes së një partneri të mundshëm të terrorizmit ndërkombëtar është i rrezikshëm, dhe përbën kërcënim kundër institucioneve shtetërore.

Sa i përket terrorizmit, si kërcënimi më i rrezikshëm asimetrik, duhet të theksohet se mundësia e sulmeve terroriste në rajon nuk mund të shpërfilllet. Rajoni mbetet një bazë e rëndësishme logjistike dhe një rrugë tranziti për terroristët dhe ekstremistët në Evropën Qendrore, si dhe në zonat e krizës me qëllim kryerjen e akteve terroriste ose rekrutimit të luftëtarëve të rinj; rajoni gjithashtu shërben si strehë e tyre. Përfshirja e luftëtarëve të huaj nga Ballkani në zonat e konfliktit mund të shihet gjithashtu si një mundësi për një shkëlqje të sigurisë në rajon. Nga kjo perspektivë, ka disa faktorë të mundshëm që mund të ndikojnë në situatën e sigurisë në vendet e origjinës së luftëtarëve në përfshirjen e tyre në konflikte. Pas kthimit të tyre, ka të ngjarë që ata të angazhohen në përhapjen e besimeve ekstremiste, të rekrutojnë anëtarë të rinj dhe të angazhohen në trajnimin ilegal të luftëtarëve të rinj. Ekstremizmi, fetar apo nacionalist, është ende aktiv në rajon në formën e grupeve apo lëvizjeve separatiste. Dallimet politike në disa vende janë faktorë për vazhdimin e aktiviteteve ekstremiste. Këto grupe janë të vendosura të

Nikolla, A.
« Lidhja e krimit të organizuar me terrorizmin - një rrezik për sigurinë »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

imponojnë besime radikale fetare dhe ideologjike dhe si të tilla paraqesin rrezik për sigurinë e vendeve të caktuara.

Krimi i organizuar transnacional është një kërcënim asimetrik i përcaktuar si një kërcënim i përhershëm i sigurisë për rajonin. Ai vazhdon të përhapë ndikimin e tij, ndërsa implikimet e këtyre aktiviteteve ndjehen nga të gjitha vendet e rajonit. Lëvizja e emigrantëve nga Lindja e Mesme, pjesë e Afrikës së Veriut dhe Azisë vazhdon të ndikojë në rajonin e Ballkanit. Ka një rrezik në rritje të infiltrimit të militantëve dhe kriminelëve në vendet e rajonit, gjë që do të jetë një situatë sfiduese sigurie në të ardhmen. Bashkëpunimi i terroristëve islamikë dhe kriminit të organizuar mund të krijonte një kërcënim të madh për sigurinë e rajonit për shkak të disa institucioneve më të dobëta shtetërore, korrupsionit dhe ekonomisë së dobët. Megjithatë janë lloje të ndryshme të veprimtarive kriminale, terrorizmi dhe krimi i organizuar nuk mund të shqyrtohen si subjekte të izoluar dhe të palidhura. Krimi i organizuar dhe terrorizmi veprojnë në nivel global dhe nuk njohin kombësinë dhe kufijtë. Grupet janë të motivuar vetëm nga sundimi i ofertës dhe kërkesës që përfshin strategjitë dhe taktikat e një marketingu efektiv. “Rruga e Ballkanit” u shërben aktiviteteve të paligjshme të dy grupeve të lartpërmendura. Dihet gjithashtu se krimi i organizuar dhe terrorizmi zakonisht zhvillojnë lidhje dhe ndërvarësi që rrisin nivelin e kërcënimit asimetrik. Interesat e kriminit të organizuar mund të lidhen me qëllimet e terroristëve.

Disa pika në Ballkan përdoren në mënyrë operative si pika të rëndësishme të dërgesës për trafikim të paligjshëm, për shkak të flukseve të larta të trafikut rrugor rajonal, që favorizojnë dërgesat e paligjshme për të lëvizur, pa u zbuluar nga autoritetet e zbatimit të ligjit. Këto aktivitete ndihmohen nga rritja e flukseve të migracionit ilegal. Në shumë raste, rrjetet e kontrabandës së migrantëve veprojnë si struktura ligjore të biznesit, si agjencitë e udhëtimit, për të prodhuar dokumente mashtruese që u mundësojnë migrantëve të parregullt të marrin lejet e punës. Këto metoda kanë rezultuar shumë të suksesshme për rrjetet e përfshira dhe përdorimi i tyre mund të rritet më tej në të ardhmen. Rrjedhimisht, rrugët migruese që kalojnë nëpër Evropë, dhe në veçanti përmes Ballkanit Perëndimor, po bëhen më të gërshetuara, dinamike dhe të rrezikshme. Gjithashtu, më shumë migrantë tani kanë gjasa të kalojnë pa u zbuluar. Ballkani Perëndimor nuk konsiderohet vetëm si rajon tranzit, por gjithashtu si një burim i rëndësishëm i tregtisë së armëve të zjarrit në tregun ndërkombëtar të armëve dhe drogës. Rrjetet e transportit në Ballkan përdoren gjithashtu nga grupe militante islamike për mbështetje logjistike.

Niveli i bashkëpunimit ndërmjet terroristëve dhe kriminit të organizuar përcaktohet në shumë raste nga natyra gjeografike e rajonit. Historikisht, siguria e dobët e kufirit, zbatimi i dobët i ligjit, zyrtarët e korruptuar publikë dhe rrjetet e krijuara të kontrabandës kanë lehtësuar shfaqjen e grupeve hibride që kërkojnë në të njëjtën kohë synimet politike dhe maksimizimin e fitimit. *Ekstremizmi në rritje, krimi i organizuar dhe migrimi ilegal në rajon janë kërcënime të sigurisë që mund të ndikojnë në mjedisin e sigurisë.* Vitet e luftës në ish Jugosllavi radikalizuan në mënyrë të pashmangshme shumë lëvizje islamike në rajonin e Ballkanit. Kjo hapi rrugën për krijimin e lidhjeve të reja të ngushta dhe hapësirën për bashkëpunim të mëtejshëm ndërmjet organizatave terroriste të Ballkanit dhe organizatave të ndryshme terroriste në Lindjen e Mesme. Instalimi dhe zgjerimi i fundamentalizmit islamik, kryesisht në Bosnje, Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Turqi dhe Bullgari ishte një produkt i zhvillimeve të reja kërcënuese në rajon. Në këtë kontekst, është e nevojshme të theksohet se kjo është organizuar në një mënyrë specifike

Nikolla, A.
« Lidhja
e kriminit
të organizuar
me terrorizmin
- një rrezik
për sigurinë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

dhe me intensitet të ndryshëm në të gjitha pjesët e Ballkanit. Emëruesi i përbashkët për Ballkanin është që të shërbejë si një portë e hapur, si një urë për transferimin e kërcënimeve të reja të sigurisë nga Lindja e Mesme në Evropë dhe, përmes Evropës, në SHBA.

Sot, krimi i organizuar përbën kërcënimin më të madh për stabilitetin në Ballkan dhe lidhja e etnisë, ekstremizmit dhe kriminalitetit është edhe më e rrezikshme. Kjo kërkon masa më të forta e qasje më të bashkuar për të parë dhe reaguar, si dhe për rritjen e rrjeteve për të forcuar qëndrueshmërinë ndaj këtyre kërcënimeve.

5. E ardhmja

Lidhja në rritje midis kimit të organizuar dhe terrorizmit pritet të jetë një prirje globale e cila vazhdon të kërcënojë sigurinë kombëtare të shumë shteteve. Globalizimi po bën që barrierat gjeografike të bëhen pengesa të papërfillshme në organizimin dhe kryerjen e veprimeve të paligjshme, siç janë falsifikimi i dokumenteve, trafikimi i armëve dhe drogës dhe pastrimi i parave duke hapur mundësi dhe përfitime të shumta për këto lloje organizatash. Globalizimi i siguron kimit të organizuar një gamë të pafundme mundësisht bashkëpunimi. Përfitimet e mëdha për një bashkëpunim të tillë nxisin zhvillimin e lidhjeve më të mëdha ndërmjet grupeve dhe aktiviteteve që përbëjnë një kërcënim të drejtpërdrejtë për sigurinë kombëtare.

Aty ku më parë lidhja mund të karakterizohej si shumë funksionale, me terroristët që përvetësojnë metoda kriminale për të financuar organizatat e tyre, lidhja e së tashmes është me kriminel të vegjël që kanë “gjetur fenë” në burg apo nëpërmjet ndikimit të një imami karizmatik. Në këto kushte, si do të jetë e ardhmja për Evropën? Evropa aktualisht ka vetëm pesë grupe të mbetura në listën e Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të organizatave të huaja terroriste të caktuara dhe shumica e tyre janë kryesisht në gjumë (ETA, the Continuity IRA, the Real IRA, the Revolutionary People's Liberation Party/Front (Turkey) and Revolutionary Struggle in Greece)²⁰. Kështu ka më shumë gjasa që në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, e ardhmja e lidhjes do të duket shumë e ngjashme me të tashmen, veçanërisht me kthimin e luftëtarëve të huaj nga Iraku dhe Siria në vendet e tyre të origjinës në Evropë.

Në pesë vitet e ardhshme pritet të formohet ajo që ish drejtori i FBI James Comey e ka cilësuar si “diasporë terroriste”, të cilën ai beson se do të ndodhë kur luftëtarë të huaj largohen nga Lindja e Mesme dhe do të përpiqen të kthehen në Perëndim²¹. ISIS mund të ketë vendosur qindra individë në Bashkimin Evropian tashmë sipas disa raporteve, duke siguruar një “aftësi të dhunës ndërkombëtare terroriste” efektive për pjesën më të mirë të dekadës së ardhshme. Diaspora pas ISIS ka të ngjarë të ketë më shumë lidhje me botën e kimit evropian se kurrë dhe të jetë e lidhur në rrjet edhe me mbështetjen e vazhdueshme të grupit në përhapjen e propagandës së saj përmes medieve sociale²². E ardhmja e lidhjes do të jetë e ndërlikuar nga avancimet teknologjike, duke përfshirë, shifrimin, monedhat virtuale, evoluimin e printimit 3-D dhe *blackweb*. Përveç kërcënimit të luftëtarëve të huaj të kthyer, vala e tanishme e migrimit ka potencial të

Nikolla, A.
« Lidhja e kimit të organizuar me terrorizmin - një rrezik për sigurinë »

²⁰ <https://www.state.gov/j/ct/rls/other/des/123085.htm> last updated May 2017.

²¹ Josh Gerstein and Jennifer Scholtes, “Comey Warns of Post-ISIS Terrorist ‘Diaspora,’” *Politico*, September 27, 2016.

²² See Rukmini Callimachi, “How a Secretive Branch of ISIS Built a Global Network of Killers,” *New York Times*, August 3, 2016; Jean-Charles.

jetë shumë më e rëndësishme për konfigurimet e ardhshme të një lidhjeje të organizatave kriminale dhe terrorizmit. Përgjigja ndaj lëvizjes së njerëzve nga Afrika dhe Lindja e Mesme në Evropë ka qenë shfaqja e një rrjeti të gjerë dhe rrënjësor të rrjeteve kriminale transnacionale të përdorura për të kontrabanduar dhe trafikuar migrantët që përfshijnë lloje të ndryshme të grupeve dhe individëve. Sipas ish drejtorit të Europolit Rob Wainwright mund të numërojnë deri në 30,000 njerëz²³. Ndërkohë që kontrabandistët ende nuk janë parë të kalojnë kufirin ose të integrojnë krimin dhe grupet terroriste në ndonjë mënyrë thelbësore, ekziston mundësia që rrjetet dhe shoqatat të ndërtohen dhe forcohen përmes trafikimit të njerëzve e mund të kthehen tek mallra të tjera të paligjshme ose veprave penale.

Megjithatë, më e rëndësishme është se nëse emigrantet e rinj nuk janë më të integruar se paraardhësit e tyre, ata mund të bëhen rezerva për rekrutimin nga organizatat kriminale transnacionale dhe organizatave ekstremiste të së nesërme. Emigrantët zakonisht janë të etur të fillojnë një jetë të re në vendet pritëse. Vetëm një pjesë e vogël mund të jenë anëtarë të organizatave kriminale apo të kenë një histori kriminaliteti të nivelit të ulët. Disa emigrantë, veçanërisht ata që nuk fitojnë azil dhe mbeten ilegalisht, nuk do të asimilohen në mënyrë adekuate në vendet pritëse, pavarësisht vëmendjes së përtërirë ndaj politikave publike të hartuara posaçërisht për të adresuar këtë sfidë të jashtëzakonshme. Për kriminelët që kërkojnë të zgjerojnë bazat e tyre të veprimit, emigrantët e sapoardhur që nuk janë të integruar mirë në shoqëri ose në ekonominë e ligjshme dhe që ekzistojnë në skajet e tregut të zi, janë lloji ideal i rekrutëve. Për më tepër, ndërsa komunitete të Diasporës janë zakonisht një forcë për zhvillim pozitiv, elasticitet dhe mbështetje për vendet e tyre të origjinës, një rrjet i gjerë i Diasporës mund të ofrojë gjithashtu funksione mbuluese dhe logjistike që lehtësojnë aktivitetet e paligjshme.

6. Përfundime

Mjedisi bashkëkohor ndërkombëtar i sigurisë krijon mundësi për të zhvilluar lidhjet midis krimit të organizuar dhe terrorizmit. Edhe pse shumë lidhje të tilla kryesisht e kanë origjinën në ambiente të paqëndrueshëm, ato ndikojnë në zhvillimet e sigurisë dhe kështu kontribuojnë në krijimin e dobësive. Duke pasur parasysh natyrën teknike të interpretimit të lidhjes së krimit të organizuar dhe terrorizmit, deri më tani, përgjigjet janë përqendruar kryesisht në adresimin e çështjeve që lidhen me financimin e terrorizmit, duke forcuar masat me anë të cilave mund të fitohen dhe transferohen paratë e paligjshme. Si rrjedhojë, duke parë lidhjen e tyre përgjigjet efektive mund të përshtaten për të adresuar kërcënimet në kontekste të veçanta.

- Në zhvillimin e përgjigjeve ndaj terrorizmit dhe krimit të organizuar, qoftë në nivel lokal, kombëtar, rajonal apo ndërkombëtar, është thelbësore vlerësimi i kushteve në mënyrë që të hartohen strategji efektive të bazuara në hulumtime dhe kërkime. Strukturat/organizatat duhet të forcojnë punën e tyre kërkimore dhe analitike në lidhje me krimin e organizuar dhe terrorizmin si brenda dhe jashtë vendit nga të cilat mund të preken direkt ose indirekt.

- Ndërprerja e rrjeteve kriminale transnacionale kërkon identifikimin e nyjave kritike në organizata dhe përcaktimin se ku operacionet kundër tyre mund të arrijnë

Nikolla, A.
« Lidhja
e krimit
të organizuar
me terrorizmin
- një rrezik
për sigurinë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

²³ Anthony Deutsch, "Europol Tracking 30,000 Suspected People Smugglers," *Reuters*, September 16, 2015.

efektin më të madh. Prandaj, është e rëndësishme të kuptohet struktura dhe operacionet e tyre. Megjithatë, këto nuk kuptohen mirë, rrjetet kriminale janë shumë të ngjashme me organizatat e ligjshme pasi nxiten nga dëshira e përfitimeve financiare.

- Një pikë tjetër e rëndësishme është edhe zvogëlimi i grumbullimit të njerëzve që bien në kategorinë e të qenit të prekshme ndaj rekrutimit kriminal ose terrorist. Grupet e marginalizuara, të përndjekura apo të cënueshme mund të gjejnë një mundësi tërheqëse në bashkimin me grupet terroriste të krimit të organizuar, në kushtet e një pamjaftueshmërie ekonomike, ndjenjat e izolimit ose mungesa e potencialit për përparimin shoqëror si dhe korrupsioni i perceptuar, mosndëshkimi ose pabarazia politike, sociale dhe ekonomike përkeqësojnë më tej këto tendenca. Strategjitë duhet të përqendrohen në angazhimin lokal në mënyrë që të ndërtojnë elasticitetin social nëpërmjet një qasjeje shumë sektoriale, me aktorë nga të gjitha fushat e shoqërisë (përfshirë institucionet e zbatimit të ligjit, sektorin privat, institucionet fetare, arsimin, shoqërinë civile, etj.), për të shkurajuar çdo tregues që përploqet të bëjë terrorizmin dhe krimin e organizuar një alternativë praktike.

- Për të trajtuar këtë fenomen, duhet të lëvizet përtej metodave tradicionale të zbatimit të ligjit për të adoptuar një qasje më delikate të fazave dhe një qasje shumë sektoriale. Kjo nënkupton fillimisht analizimin dhe reagimin ndaj ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet mundësisë së makro faktorëve në të cilët ka më shumë gjasa të krijohet kriminaliteti dhe terrorizmi.

- Parimet e qeverisjes së mirë, antikorrupsioni, lufta ndaj mosndëshkimit, marginalizimit shoqëror dhe përjashtimit, duket se janë kritere për të prishur objektivat strategjike dhe kapacitetet për sistemin e levave të grupeve kriminale dhe terroriste, pavarësisht nga manifestimi i tyre. Programet në këtë fushë do të përfitonin nga një ndërgjegjësim më i madh dhe programim i përshtatur për të adresuar mbështetjen ndaj flukseve të paligjshme.

- Për të adresuar në mënyrë efektive kërcënimin emergjent të aktorëve hibridë të paligjshëm që kombinojnë aspektet e organizatave kriminale dhe grupeve terroriste, një rishqyrtim i mënyrës në të cilën klasifikojmë dhe adresojmë kërcënimet e sigurisë jo-tradicionale mund të jetë i domosdoshëm. Në vend që të përcaktojnë këto kërcënime në kategoritë tradicionale siç janë terroristët apo organizatat kriminale, ato mund të përkufizohen si rrjete që paraqesin kërcënime ndërsektoriale ndaj interesave të sigurisë.

- Ngritja e kapaciteteve të institucioneve të sektorit të sigurisë, duke mbajtur supozimet themelore se kapaciteti teknik në zbatimin e ligjit, kontrollin e kufijve dhe në sistemin e drejtësisë do të shërbejnë po aq mirë për të luftuar edhe grupet kriminale dhe terroriste. Rritja e besimit dhe e bashkëpunimit për të përmirësuar ndarjen e informacionit dhe shkëmbimin e praktikave më të mira në të gjitha nivelet institucionale.

- Duhet të kuptojmë se flukset e paligjshme dhe ideologjitë kriminale dhe terroriste janë kërcënime transnacionale që zhvendosen, bashkëveprojnë, shkrihen dhe fragmentohen, aftësia për të monitoruar dhe kuptuar lëvizjen e këtyre rrjedhave është kritike.

- Rrjetet sociale kanë lehtësuar lidhjen e grupeve dhe ideologji, si në botën kriminale ashtu edhe në lëvizjet globale terroriste. Shoqëria, identiteti dhe lidhshmëria gjithnjë e më shumë po përcaktohen në hapësirën e medieve sociale, në vend të kufijve fizikë të shteteve gjeografike. Kjo ka krijuar një forum të hapur për lidhjen e individëve dhe shkëmbimin e ideve, mallrave dhe shërbimeve përmes të cilave organizata kriminale mund të lulëzojë ideologjikisht. Duke vepruar kështu, mediet sociale janë duke errësuar/

Nikolla, A.
« Lidhja
e krimit të
organizuar
me terrorizmin
- një rrezik
për sigurinë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

mjegulluar kategorizimin e definicionit midis grupeve kriminale, terroristëve, aktivistëve politikë dhe kryengritësve dhe më e rëndësishmja, po i jep legjitimitet akteve të tyre duke tërhequr qytetarët mesatar në këtë spektër.

Është e qartë se mënyra e vetme për të luftuar këto fenomene është bashkëpunimi i ndërsjellët, i cili duhet të përfshijë shkëmbimin e të dhënave, një qasje të përbashkët dhe të unifikuar për të shkëputur lidhjet midis terrorizmit dhe krimit, dhe veprimin e përbashkët të institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare. Për shkak të koordinimit midis tyre, duhet të zbatohet një përgjigje e integruar për të shpërndarë krijimin e një lidhjeje të fortë.

Pavarësisht pikëpamjeve të disa autorëve për mungesën e ndonjë lidhjeje të qartë midis grupeve të organizuara kriminale dhe organizatave terroriste dhe pretendimit se marrëdhënia e tyre është shumë më e rrallë se ajo ndërmjet kriminelëve dhe politikanëve (UNODC, 2005), nuk ka dyshim se krimi i organizuar dhe terrorizmi, lidhjet e tyre të gjithanshme dhe subjektet hibride që vazhdimisht evoluojnë dhe përshtaten me rrethanat e reja, kërkojnë vëmendje të plotë të gjithë bashkësisë ndërkombëtare.

Krimi i organizuar dhe terrorizmi janë ana e errët e jetesës moderne. Vlerësimi ynë na çon në një përfundim se këto dy të këqija ngrenë çerdhet e tyre në vendet e dobëta dhe vendet të tjera që janë duke dështuar. Lidhja midis këtyre të këqijave të mëdha është e fortë dhe do të ndikojë jo vetëm vende të veçanta, por kjo është një çështje globale; një çështje, e cila kërkon rregulla të qëndrueshme dhe të unifikuar, veprime vendimtare dhe të vendosur për parandalimin e tij. Nuk ka asnjë vend të vetëm, i cili do të mund në mënyrë individuale të mbrojë veten dhe të garantojë sigurinë e qytetarëve të saj. Këto janë çështje globale të sigurisë, të cilat nuk duhet të merren parasysh në mënyrë të izoluar, dhe të gjitha aspektet duhet të merren në konsideratë. Lufta kundër tyre në nivel global duhet të jetë vendimtare dhe në frymën e përmirësimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit. Kështu, mësimet e nxjerra në këtë drejtim duhet vazhdimisht të rishikohet dhe të përmirësohet.

Literatura

1. Terrorist Criminal Enterprises - *Financing Terrorism through Organized Crime*; Kimberley L. Thachuk and Rollee Lal, 2018.
2. Terrorism and Organized hate Crime - *Intelligence Gathering, Analysis, and Investigations*. Fourth Edition 2018.
3. *When terrorism and organized crime meet*. Mark Shaw and Prem Mahadevan 2018.
4. Human Security in the Western Balkans (HUMSEC): *The Impact of Transnational Terrorism and Organized Crime on the Peace-Building Process*.
5. Global Initiative against Transnational Organized Crime *Crooked Kaleidoscope Organized Crime in the Balkans* 2017.
6. The European Union (EU) Serious and Organised Crime Threat Assessment (SOCTA) 2017.
7. Angel Rabasa, Christopher M. Schnaubelt, Peter Chalk, Douglas Farah, Gregory Midgett, Howard J. Shatz, *Countering the Expansion of Transnational Criminal Networks*.
8. Michael R. Ronczkowski, *Terrorism and organized hate crime Third Edition*, Intelligence Gathering, Analysis, and Investigations.
9. Florence Gaub and Julia Lisiecka, *The crime-terrorism nexus*, European Union Institute for Security Studies (EUISS) April 2017.



Nikolla, A.
« Lidhja
e krimit të
organizuar
me terrorizmin
- një rrezik
për sigurinë »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

Diplomacia shqiptare, në themel të luftërave për pavarësi, në historinë e betejave intelektuale para 1912-s

■ MSc. FATOS VELIU

■ Prof. Dr. Pëllumb DANAJ

■ MSc. Albana VELI

Abstrakt

Lufta kryengritëse e shqiptarëve kundër Portës së Lartë të Perandorisë Osmane në vitet dhe etapat kohore para pavarësisë së Shqipërisë, ka rendur dhe bashkudhëtuar me të njëjtën rritëm dhe më luftën kolosale diplomatike të patriotëve të shquar të dijes dhe të penës, gjë që ka siguruar ditën e pagëzimit të shtetit në mes të hordhive copëtuese. Më konkretisht dihet se në vjeshtë të vitit 1909, parlamenti turk ndaloi çdo organizatë me karakter kombëtar. Ato lejoheshin vetëm si organizata osmane dhe parashikoheshin masat më të rrepta ndaj patriotëve të armatosur në çetat e luftëtarëve për liri, si dhe ndaj familjeve të tyre. Qeveria turke gjatë atyre viteve edhe pse numëronte ditët e fundit të sajë, kaloi në masat praktike më të rrepta ndaj shqiptarëve. Ajo ndaloi alfabetin latin, mbylli shkollat, vuri taksat dhe shërbimin e detyruar ushtarak për të gjithë. Ajo dërgoi edhe ekspedita për çarmatosjen e shqiptarëve. Por populli shqiptar ishte i pandalshëm në rrugën e vet. Evërteta historike dhe e patjetërsueshme, ashtu siç u theksua më lartë është fakti se paralelisht me këtë agresivitet të pashembullt antishqiptar, porta e lartë osmane u përball me përpjekje titanike të patriotëve të pushkës dhe kryesisht të penës të vendit tonë. Tashmë janë të evidentuar qindra nota dhe referendume drejtuar portës së lartë dhe kancelarive europiane të cilat kanë materializuar dhe kanë bashkërenduar më së miri luftën përgjakëse të 30 mijë kryengritësve dhe i kanë paraprirë ditës së 28 nëntorit 1912. Pra në mënyrë koncize mund të thuhet me krenari kombëtare se pikërisht ajo luftë ka zbritur mbi letrat e referendumeve popullore; mbi protestat ndaj Portës së Lartë; mbi kërkesat ndaj kancelarive të shteteve europiane për t'i pasur në krahë të përpjekjeve tona epokale, për të siguruar të drejtat e grabitura në lumenjtë e gjakut.

Veliu, F.,
Danaj, P.,
Veli, A.

«Diplomacia shqiptare, në themel të luftërave për pavarësi, në historinë e betejave intelektuale para 1912-s»

Fjalëkyçe:

pavarësi, kryengritje historike, diplomaci, luftë patriotike, vlera kombëtare.

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

1. Lufta me penë, krahë historisë së përgjakshme të pishtarëve të patriotizmit shqiptar

Faktet e zbuluara pas studimesh të shumta të bëjnë të ditur faktin e padiskutueshëm historik se luftërat e shumënjuhura të shqiptarëve në të gjithë Ballkanin, por kryesisht në Portën e Lartë të Perandorisë Osmane, e cila ishte në grahamat e fundit të ekzistencës së saj, nuk paskan mbetur vetëm në heroizma kryengritësish, por ato kanë zbritur në tavolinat diplomatike. Ky fakt ka të bëjë me të vërtetën e madhe se shqiptari nuk është udhëhequr vetëm nga pushka, të cilën e ka përdorur më së miri në përshtatje të vlerave të tij patriotike për mbrojtjen e vendit të shenjtë, por krahas saj ka pasur edhe penën, që do të thotë inteligjencën. Pra nuk kemi të bëjmë me një fis barbar dhe shëtitës që kanë ardhur së fundmi në stepat e Europës siç mundohen ta perceptojnë dhe etiketojnë disa koka të nxehta pseudohistorianësh në vendet fqinjë, por me një komb të tërë trim të zgjuar dhe me shumë kulturë. Befasohesh me inteligjencën diplomatike me të cilën shqiptarët e atyre periudhave kanë prezantuar vlerat dhe të drejtat e tyre në kancelaritë jo vetëm të Portës së Lartë, por edhe në ato të së gjitha shteteve europiane. Luftëra të përgjakshme dhe të sakrificave të jashtëzakonshme përballonin çetat e veriut të Shqipërisë kryesisht nga vitet 1907 - deri në 1912, kur u shpall juridikisht mëvetësia e Shqipërisë së përcudnuar në shekuj. Por ndërsa hulumton në arkivat e kohës dhe në mandatet historike të periudhës së fundit sa të vinte dita e 28 nëntorit 1912 të bëhet absolutisht e qartë se ajo luftë aq e përgjakshme dhe heroizmat e paprecedentë të shqiptarëve kundër perandorisë turke nuk do të mund të siguronin kurrë mëvetësinë e shtetit, sidomos nga agresiviteti i pashoq i fqinjëve tanë, në rast se kjo përpjekje dhe sakrificë e pashembullt si as një popull tjetër në Europë, nuk do zbriste edhe në tavolinat diplomatike të kancelarive

*Veliu, F.,
Dana, P.,
Veli, A.*
«Diplomacia shqiptare, në themel të luftërave për pavarësi, në historinë e betejave intelektuale para 1912-s»

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

ndërkombëtare.

2. Diplomacia shqiptare para pavarësisë

Ndjen një krenari të ligjshme dhe është me të vërtetë emocionuese që gjatë një studimi mbi vlerat patriotike të popullit tënd, ndeshesh me atë pjesë të panjohur të historisë së kombit, që është pikërisht lufta diplomatike apo e thënë më vulgarisht, lufta e tavolinës.

Ajo luftë e heronjve të veriut, e cila ka saktësuar absolutisht se kanë qenë nën armë më se 30 mijë shqiptarë të drejtuar nga prijës të tillë si Isa Boletini, Beqir bej Karapiko, Hasan Budakova, Sali Isa, Bajram Daklani nga Gjakova, Idriz Seferi, Sulejman Batusha, Hasan Ferri nga Plava dhe Sadik Hallaqi nga Vuçiterna etj., dhe që ka kthyer në zjarr e flakë zona të tilla të përmendura dhe në raportet e perandorisë dhe të konsujve serb të atyre viteve si Rrafshin e Kosovës, Krahinën e Vardarit, Viset e Vilajetit të Manastirit, Llap-Kaçanik-Prizren-Lumë etj., ka pasur një të veçantë të madhe, se bashkë me udhëheqësit e trimërive në fushat e betejave, në krye kanë pasur edhe udhëheqësit intelektualë, që njiheshin si pishtarët e penës dhe të mendjes. Në Parlamentin turk të asaj periudhe kur shqiptarët ishin në kulmin e zjarrit të luftës kryengritëse ndaj reprezaljeve të dërgatave të perandorisë, nga 26 deputetët shqiptarë, Ismail Qemali, Hasan Prishtina me disa shokë vepruan si grup kombëtar në parlament.

Ata ishin kundër politikës xhonturke të komitetit “Bashkim e Përparim”. Përçarjen fetare të njerëzve të inteligjencës shqiptare ata e goditën me parullat mbarë popullore “*Poshtë klerikalizmi e fanatizmi! Të rrojnë përlindja e kombit shqiptar me gjithë bijat e bijtë e tij!*” Këto ishin parullat e ndezura nga flakët e ideve kombëtare në vitin 1909. Për efekt perceptimi të reduktuar të historisë së këtyre periudhave për vetë hapësirën që kërkon ky punim studimor jam i detyruar të flas në mënyrë shumë të koncentruar por gjithsesi duke mundur të prek detajet më thelbësore të studimit.

Dua të përmend edhe një herë termin “emocion” që e kam përsëritur disi gjatë përshkrimit të këtyre radhëve sepse vetë fakti historik i njohur për kryengritjet e viteve para pavarësisë kombëtare, udhëheqësit e tyre dhe vendet e përfshira, pak kemi qenë të njohur me luftën intelektuale. Më së shumti janë njohur përpjekjet të bëra kryesisht nëpër kongrese si ai i Manastirit për gjuhën shqipe, ai i Prizrenit për bashkimin kombëtar etj., por nuk e kemi ditur se ajo histori ka qenë ndërkohë një histori tepër e ngjeshur me kërkesa diplomatike dhe me qindra e mijëra nota proteste e referendume popullore. Janë mijëra fjali nga më të zgjuarat në diplomaci të cilat kanë zënë vend në këto perceptime shpresore të nisura në çdo zyrë të diplomatike të shteteve potente të Europës.

Në to vihen re edhe alternativat dhe presionet diplomatike që njerëzit e penës shqiptare i dërgonin Portës së Lartë. Nuk ka ngjarje luftarake pa u shoqëruar me veprime shpresore. Nuk ka eveniment dhe pika kulmore të historisë sonë pa u shoqëruar me mandate diplomatike, apo me kërkesa të perceptuara në ritmin e momentit për të përfituar situatën që paraqitej. Janë këto lëvizje diplomatike që kanë bashkërenduar me kryengritjet e përgjakshme të cilat i sollën heronjtë e luftës dhe të penës shqiptare te evenimenti i jashtëzakonshëm i ëndrrës shumëshekullore të mbarë brezave të mëparshëm, atë të mëvetësisë territoriale të shtetit tonë. Për sa theksova pak më lartë, për efekt perceptimi të reduktuar të lejueshmërisë së këtij shkrimi studimor, për ilustrimin e përshkrimit të mësipërm emocional do të përmend në mënyrë shumë të përmbledhur vetëm si data dhe tema të referendumeve, apo të notave diplomatike të lëshuara që nga

Veliu, F.,
Danaj, P.,
Veli, A.
“Diplomacia shqiptare, në themel të luftërave për pavarësi, në historinë e betejave intelektuale para 1912-s”

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

viti 1910 pra dy vjet para pavarësisë. Pas saj, si të rikujtoj të gjitha veprimet diplomatike të detajuara vetëm si çështje deri në vitin 1912, do të mundohem të ndalem më hollësisht pikërisht në muajin Nëntor 1912, pikërisht të atij viti kur u sigurua pagëzimi i shtetit.

Nga këtu vërtetohet se jo një e dy vjet para pavarësisë ka pasur një luftë tepër intensive diplomatike, e cila luftonte e luftonte me një zgjuarsiri të pashembullt që të sillte ditën e shumëpritur. Vetëm në muajin nëntor 1912 që ndanin vetëm pak ditë pavarësinë kombëtare, në drejtime të shumta të zyrave europiane janë nisur dhjetëra telegrame e referendume deri sa erdhi dita fatlume e sakrificës dhe ëndrrës së dhjetëra brezave.

Ato referendume dhe telegrame unë do të mundohem ti përshkruaj jo vetëm si çështje dhe tema objekti për të cilën nënshkruheshin siç do paraqes për vitin 1910, 1911 dhe 1912, por të plotë me të tekstin diplomatik të tyre.

Viti 1910

Konstancë, 18 shkurt 1910

Në emër të shoqërisë së shqiptarëve të Konstancës dhe nënshkruar nga “kryetari avokat Joan Lehoval dhe nga shkronjësi Neofit Simeon” është dërguar protestë drejtuar deputetëve të parlamentit osman kundër orvatjeve për t’i imponuar gjuhës shqipe alfabetin arab¹.

Manastir, 3 prill 1910

U shpallën: Vendimet e Kongresit të dytë të Manastirit i cili zhvilloi punimet më 2-3 prill 1910².

Po atë ditë: Në zbatim të pikës 9 të rezolucionit të miratuara prej “Kongresit të Manastirit”.

3 prill 1910 u shpallën:

Nga “Komiteti kryengritës Liri o Vdekje”. Vlorë, është hartuar:

Programi i kryengritjes kundër sundimit osman për krijimin e shtetit autonom shqiptar

Programi i hartuar siç del nga vula e vënë në fund të dokumentit, është shtypur në shumë kopje nga studentët shqiptarë në Itali dhe është shpërndarë në qytete dhe fshatra të Shqipërisë³.

Memorandumi doli si përgjigje të proklamacionit të Shefqet Turgut pashës.

Në fund të këtij memorandumi thuhet: “Vazhdojnë nënshkrimet e 22 delegatëve të Asamblesë”.

Viti 1911

23 qershor 1911

Gërçe (Malësi e Mbishkodrës)

Memorandumi ose “Libri i Kuq”, siç u quajt në atë kohë i dalë prej Kuvendit të Përgjithshëm të krerëve shqiptarë drejtuar qeverisë xhonturke me kërkesën për krijimin e një province autonome⁴.

Gjirokastër, 21 korrik 1911

*Veliu, F.,
Danaj, P.,
Veli, A.*
«Diplomacia shqiptare, në themel të luftërave për pavarësi, në historinë e betejave intelektuale para 1912-s»

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

¹ Protesta është botuar në gazetën “Shqiptari”, Stamboll, 18 shkurt/3 mars 1910 dhe në gazetën “Bashkimi i kombit”, Manastir, 18 shkurt/3 mars 1910.

² Vendimet janë botuar në gazetën “Bashkimi i Kombit”, Manastir, /7 prill 1910. Po atë ditë vendimet u botuan edhe në gazetën “Korça”, Korçë.

³ “Albania”, Përmbledhje me dokumente, Nr. 2 (1a Parte), 1910.

⁴ Memorandumi është ribotuar me ndryshime të vogla në përmbledhjen me dokumente me titull “Albania”, Nr. 2 (1a Parte), 1920. f. 222-231, (italisht).

Memorandum drejtuar qeverisë xhonturke me kërkesën për vendosjen e një forme të vetme administrimi në gjithë Shqipërinë⁵.

Tepelenë, 18 gusht 1911

Shpallet kërkesa drejtuar qeverisë xhonturke për zbatimin e disa reformave me karakter politik dhe shoqëroro-kulturor në Shqipëri⁶.

Tepelenë, 23 gusht 1911

Përpilohet: Memorandum drejtuar qeverisë xhonturke me kërkesën për njohjen e Shqipërisë si provincë autonome⁷.

Sofje, 14 shtator 1911

Shpallet: Thirrje drejtuar popullit shqiptar për të riorganizuar "Shoqërinë e zezë për shpëtim" dhe për të kërkuar autonominë e Shqipërisë⁸.

Sofje. 30 shtator /14 tetor 1911

Memorandumi është nënshkruar nga 50 krerë të malësorëve të Hotit, Grudës. Kelmendit, Kastratit, Shkrelit, Shalës, Shoshit, Kirit.

Kërkesat iu paraqitën Haxhi Adil beut, ministër i brendshëm i qeverisë xhonturke dhe kryetar i komisionit qeveritar, që vizitoi krahina të ndryshme të Shqipërisë⁹. (9).

14 tetor 1911

Thirrje drejtuar popullit shqiptar për të forcuar bashkimin e shoqërive kombëtare për të mirën e Atdheut¹⁰.

Viti 1912

Podgoricë, 9 shkurt 1912

Në një mbledhje të krerëve të malësorëve në Podgoricë u miratua: Memorandum drejtuar Fuqive të Mëdha me kërkesën për të ndërhyrë pranë qeverisë xhonturke për zbatimin e premtimeve të bëra malësorëve prej saj, më 1911¹¹.

Krasniqe, 19 prill 1912

Miratohet: Kërkesa drejtuar qeverisë xhonturke për t'i njohur Shqipërisë disa të drejta për autonomi¹².

Peshkopi, 1-15 maj 1912

Kërkesa drejtuar komisionit qeveritar xhonturk për t'u njohur shqiptarëve disa të drejta¹³.

Stamboll, 1-16 qershor 1912

Përpilohet: Manifest, drejtuar shtetasve të perandorisë osmane në mbrojtje të të drejtave të popullit shqiptar¹⁴.

**Veliu, F.,
Danaj, P.,
Veli, A.**

«Diplomacia shqiptare, në themel të luftërave për pavarësi, në historinë e betejave intelektuale para 1912-s»

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

⁵ Memorandumi turqisht gjendet në AQH i RSH, fondi "Koleksione arkivore", d. 1 (Mbledhja e Labërisë - Manastiri i Cepos) prej nga edhe është bërë përkthimi. Ai është ribotuar gjithashtu në një varg studimesh shqiptare e të huaja mbi historinë e Shqipërisë.

⁶ Thirrja gjendet në AQH i RSH, Fondi 102, dosja 3, f. 1.

⁷ "Liri e Shqipërisë", Sofje. 30 shtator / 14 tetor 1911.

⁸ Thirrja gjendet në AQH i RSH, Fondi 102, dosja 3, f. 1.

⁹ Është botuar shqip e frëngjisht si broshurë më vete nga gazeta "Liri e Shqipërisë", Sofje. 7/20 tetor 1911 dhe nga gazeta "La Nazione Albanese". Pallagorio (Catanzaro).

¹⁰ Thirrja është botuar "Nga Pleqësija e hëpërhëshme e Komitetit Qendror", në gazetën "Liri e Shqipërisë" 20 tetor 1911.

¹¹ Memorandumi gjendet frëngjisht me HHStA, A PA, A, bashkangjitur raportit të konsullit austro-hungarez në Vlorë, drejtuar Vjenës më 16 shkurt 1912 (prej nga edhe është përkthyer)., AIH, filmi A-232, dosja 50, 1912.

¹² AIH, filmi A-232, dosja 50, 1912.

¹³ Kërkesat ndodhen në HHStA, PA, A, në raportin e konsullit austro-hungarez në Vlorë drejtuar Vjenës më 26 maj 1912. Është botuar gjithashtu në gazetën "La Nazione Albanese" Pallagorio (Catanzaro), të 2 qershor 1912.

¹⁴ Përmbledhja me dokumente me titull "Albania" Nr 2 (1/Parte), 1912, f. 248-252.

10-15 qershor 1912

Kërkesa drejtuar qeverisë xhonturke për krijimin e një province autonome shqiptare¹⁵.

Korfuz, qershor 1912

Proklamatë drejtuar opinionit publik mbi arsyet dhe qëllimet e pjesëmarrjes së studentëve shqiptarë në luftën e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar¹⁶.

Sinjë (Berat), 23 korrik 1912

Shpallet memorandum i drejtuar qeverisë osmane dhe Fuqive të Mëdha me kërkesën për krijimin e një province autonome shqiptare¹⁷.

25-28 korrik 1912

Shpallen kërkesa për njohjen e disa të drejtave kombëtare drejtuar komisionit të dërguar nga Stambolli në Prishtinë për të zhvilluar bisedime me përfaqësuesit e kryengritjes shqiptare¹⁸.

30 korrik 1912

Në emër të "Atdhetarëve të vërtetë të Kosovës" ka dalë Thirrja, në qytetet e vilajetit të Manastirit. Është botuar shqip nga "Shoqëria e Zezë për Shpëtim" dhe është shpërndarë si trakt¹⁹.

Aleksandri (Egjypt), 3 tetor 1912

Thirrje drejtuar atdhetarëve shqiptarë për të ndihmuar shkollat shqipe²⁰.

Tetor 1912

Janë shpallur, vendimet lidhur me qëndrimin që duhej të mbanin shqiptarët me shpërthimin e luftës së parë ballkanike²¹.

Nëntori i vitit 1912,

muaji i fundit para pavarësisë.

Durrës, tetor-nëntor 1912

Nga ana e popullsisë së Durrësit është dërguar,

Protesta drejtuar gazetës "Njue freie presse" në Vjenë kundër pushtimit të Shqipërisë nga ushtria serbe dhe mizorive të saj mbi shqiptarët.

"Protestojmë në emër të Shqipërisë kundra sharjevet dhe kallzimevet të poshtëra që na hodhi z. kryeministër i Serbisë, Pashiq. Protestojmë kundra zaptimit të Shqipërisë dhe vrasjeve të shqiptarëve që po bëjnë serbët në Kosovë. Protestojmë për vrasjet e skllevërve [robërve] të luftës shqiptare. Shqiptarët nuk do të lënë të copëtohet Shqipëria. Po me të shpejtë do vdesin të mbrojnë (do të vdesin për të mbrojtur) vendin e tyre. Tre milionë shqiptarë kërkojnë ndihmën t'Evropës qytetëruar dhe diplomatike evropiane për mbrojtjen të Shqipërisë së pacoptuar"²².

¹⁵ Thirrja gjendet e përkthyer serbokroatisht në AD SPJ SAP, bashkangjitur raportit të konsullatës serbe në Prishtinë drejtuar Belgradit më 16 Qershor 1912. (AIH L831 P39).

¹⁶ Faksimile të e proklamatës është botuar në albumin "Rilindja Kombëtare Shqiptare", Tiranë, 1962, dhe në librin "Historia e Shqipërisë", vëll. II. Tiranë 1965, f. 34.

¹⁷ "Liri e Shqipërisë", Sofie, 29 korrik 1912.

¹⁸ Kërkesat gjenden në AD, SPJ, SAP në raportin serbo-kroatisht të konsullitit serb të Prishtinës, drejtuar Belgradit më 30 korrik 1912.

¹⁹ Thirrja ndodhet e përkthyer serbokroatisht në AD, SPJ, SAP, në raportin e konsullitit serb në Prishtinë, drejtuar Belgradit më 2 qershor 1912.

²⁰ Thirrja gjendet në AQH i RPSH, Fondi Athanas Tashko, dosja 7. dok. 6-9.

²¹ Vendimet janë botuar në gazetën "Koha", Korçë 8 tetor 1912.

²² Thirrja gjendet në HHStA, PA.A, bashkangjitur raportit të konsullitit austrohungarez, në Vlorë, drejtuar Vjenës më 8 nëntor 1912. Gjendet gjithashtu i përmbledhur në serbokroatisht në ADJ, SAP, bashkangjitur raportit të nënkonsullitit serb në Manastir, drejtuar Belgradit më 16 nëntor 1912.

*Veliu, F.,
Danaj, P.,
Veli, A.*
«Diplomacia shqiptare, në themel të luftërave për pavarësi, në historinë e betejave intelektuale para 1912-s»

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

Vjeshtë II 1912 /2

Bukuresht, 5 nëntor 1912

Shqiptarët e Bukureshtit të organizuar në një mbledhje urgjente me nismën e Ismail Qemalit dhe Luigj Gurakuqit për momentet më kritike që kalonte Shqipëria e tyre kur i ishin vërsulur dhe kishin filluar ta kafshonin shtetit fqinj të porsa liruar nga zinxhirët e perandorisë osmane miratuan vendime historike.

Ato u quajtën vendimet e mbledhjes së kolonisë shqiptare të Bukureshtit mbi krijimin e një komiteti drejtues për të marrë në dorë qeverimin e Shqipërisë²³.

Bukuresht 23/5 vjesht e tretë 1912

Këto Vendime pasohen nga nënshkrimet e pjesëmarrësve në mbledhje me Ismail Qemalin në krye.

I. Duke qenë se qeveria ndodhet sot në mosmundje të mbanjë administrimin e vendit, duhet që shqiptarët të përmbledhin fuqitë e veta e të themelojnë një komitet drejtonjës, i cili të marrë në dorë qeverimin e vendit e të përpiqet që kombi shqiptar të mos dalë i mundur e të mos mbetet në çdo pikëpamje, prapa kombevet të tjera.

II. Të bëjmë gati një komision prej shqiptarësh të diturë e të njohurë që të dalin në Europë, kur të jetë nevoja për të mprojtur në faqe të botës së qytetëruar e të qeverivet të mëdha të drejtat kombëtare e vendore të popullit shqiptar.

III. Shqiptarët e Bukureshtit që kurdoherë kanë qenë të parët në luftën kombëtare të zgjedhin një komitet prej disa vetësh, të cilëtë jenë në lidhje me komitetin e brendshëm e me qëndrat e tjera të shqiptarëve të jashtëm e të bëjnë atë që u mundet për t'i ndihur Atdheut në ditën e sotshme²⁴.

Durrës, 12 nëntor 1912

Me iniciativën e Dom Nikollë Kaçorrit, Murat Toptanit, Sali Gjukës, Abdi Toptanit, etj, vetëm dy javë se të zbriste Ismail Qemali në Durrës për të ngritur flamurin e Shqipërisë së pavarur përpiluan një *“Memorandum drejtuar perandorit të Austro-Hungarisë me kërkesë për të përkrahur autonominë ose pavarësinë e Shqipërisë”*:

Madhni,

Shum të vështira e të rrezikshme janë këto dit për ne shqyptarët e për nanën ton Shqypninë, qi të katër shtetet e Ballkanve po e rrahin me e përpi e me e coptue. Na, me sa fuqi kena, mundohen edhe perëndisë i lutemi qi Mbretnia jon të musu [t'i mundë] këta armiq e të na prui [të na mbrojë] prej sish.

Por, për fat të keq, gjasat nuk po na duken fort të mira, e po shohim se shum vende të katër vilajeteve të Shqypnisë, Kosovë, Manastir, Shkodër e Janinë gjjinden ndën kambë të hueja.

Për këtë shkak po marrim lejen m'u sjellë kah Madhnia Jote, si Perandorit të nji Perandorisë së madhe, qi asht ma e afërmja e jon e ka pjesë në Ballkan me Bosnie-Herzegovinë, e me ju lutun qi në çështjet të Ballkanve të merrte parasysh Shqypnin, në mënyrë që kufit e saj mos të bërkiten [të preken] e mos të shtyhen prej kurkuj e qi Shqypnia kështu e pabërkome [e paprekur] e e pavoglueme të ketë nji autonomi të plotë ndën Mbretninë Otomane.

Por, në qoftë se për fat të zi qillon qi kjo Mbretni nuk ka me mujt ma, mbas luftës së sotshme, me sundue në kurrfar mënyre Shqypninë, na nga thelbi i zembrës i lutena

**Veliu, F.,
Danaj, P.,
Veli, A.**
“Diplomacia shqiptare, në themel të luftërave për pavarësi, në historinë e betejave intelektuale para 1912-s”

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

²³ “Shqypeja e Shqypenis”, Sofje, 8 nëntor 1912. Dhe në “Dielli e Flamuri”, Boston, në 22 nëntor 1912. AQH i RSH. Fondi 32, dosja 102.

²⁴ Janë botuar në gazetën “Shqipëri e Re” në Bukuresht, më 8 nëntor 1912.

Madhnisë sate qi Shqypnia prej katër vilajetesh, përmendun sipri, me tre milion e sa shqyptarë, të bahet një mbretni në vehte sikurse të tjerat shtete të Ballkanve, në daç përse shqyptarët jan një komb ma i vjetri na këta, me një gjuhë e me zakone fare të yeçanta e gjaku i tyne nuk mundet me pajtue kurrresi me çdo gjak të kombeve qi janë rreth e rrotull. Në daç përse nuk do t'ishte e drejtë humbja, as voglimi i një kombi shqyptar, i cili nuk asht aspak ma i poshtëm [nuk qëndron më poshtë] se kombet e tjera të Ballkanve si për numër, ashtu për mendë, ai për vjefitën morale, me të cilën, sado qi për një kohë shekujsh shumë të gjatë qe rrahun në çdo krah e në çdo mënyrë prej shumë e shumë tallazesh politike, qindroi në kombësi të vet e në zakone të veta por si një shkamb i fort në mjedis detit; e kjarisht [qartë] e diftojn edhe theroritë e mëdhaja, qi shqyptarët hoqën për rojn [për rrojtjen], qytetërimin e përparimin e kombit të vet në këtë kohë të mrame të turqëvet të rij. Në daç edhe përse na duket se një mbretni shqyptare mban peshën [ekuilibrin] jo vetëm të Ballkanve, por edhe të gjith shteteve t'Evropës, e sidomos në munt m'u ba mbas dishirit ton, një mbretni e paanë (neutre), sikurse Belgji e Zvicera.

Prej gjith këtyne shkaqeve e arsyanave, na e pështesim të tanë shpresën tonë në ma të madhen mirsinë e Madhnisë Tande, për të cilën na e gjith kombi shqyptar ka për të ja u ditun për nder për gjithmonë.

Me shpresë të madhe qi të lutunat tona kan me e bërka zembrën e madhnueshme të Madhnisë Tande, kemi nderjen ma të madhen me vu këtu dyert tona e m'u përmendun.

Shqypni, 12 nanduer 1912²⁵.

Stamboll, 18 nëntor 1912

Dhe në qendër të Perandorisë Osmane, pra në Stamboll në datën që saktëson vetëm 10 ditë para se të bëhej pagëzimi i shtetit shqiptar të pavarur, një përfaqësi njerëzish të shquar e përbërë në më se 40 veta të cilët plotësonin tagrin të flisnin në emër të Popullit Shqiptar midis të cilëve ishin Rasih Dino, Apostol Meksi, Shan Tepelena, Gani Frashëri, Sulejman Delvina, Filip Noga, Mehmet Frashëri, Dervish Hima, Nezir Kemzi, etj., nënshkruan thirrjen qe vijon më poshtë:

Thirrje drejtuar Fuqive të Mëdha për t'i siguruar popullit shqiptar qenien e tij etnike e politike.

Shkëlqesi,

Pasojat e mundshme të luftës që po bëhet ndërmjet katër shteteve ballkanike dhe Perandorisë Osmane, e shqetësojnë me të drejtë popullin shqiptar. Ai shqetësohet nga qëllimi politik që synojnë të arrijnë aleatët, i cili del në pah nga deklaratat e tyre zyrtare e gjysmëzyrtare dhe nga aktet e tyre diplomatike. Kështu ai trembet nga pasojat e një ndryshimi të hartës së Ballkanit në dëmin e tij. Në të vërtetë, ai e ka shumë të qartë, se këtu është fjala jo për gjë, tjetër, por për rregullimin përfundimtar të problemit shekullor të çështjes së Lindjes, por disa shenja e shtyjnë të ketë frikë se të drejtat e tij dhe e ardhmja e tij janë në rrezik të mos merren parasysh dhe ndofta të sakrifikohen nga zgjidhja që do të propozohet.

Përpara kësaj mundësie të rrezikshme për një komb që përbën grupimin etnik më të bashkuar dhe më të rëndësishëm të Turqisë evropiane, të nënshkruarit, në emër të mbarë popullit shqiptar, kanë nderin t'u parashtrajnë kancelarive të nderuara të Fuqive

*Veliu, F.,
Dana, P.,
Veli, A.*
«Diplomacia shqiptare, në themel të luftërave për pavarësi, në historinë e betejave intelektuale para 1912-s»

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

²⁵ Ky Memorandum gjendet shqip në HHStA, PA, A, bashkangjitur raportit që konsulli austro-hungarez në Durrës i drejton Vjenës më 13 nëntor 1912; në AIH, fUmi A-421, dosja 59/6, 1912.

të Mëdha evropiane pikëpamjen shqiptare dhe t'i vënë në dijeni për kërkesat e tyre.

Vendosja e popullit shqiptar në një pjesë mjaft të madhe të territorit ballkanik, që prej lashtësisë më të largët, është një fakt historik e gjeografik, i cili nuk mund të mos kihet parasysh, në qoftë se dëshirohet që çështja e Lindjes të arrijë një zgjidhje të arsyeshme e të qëndrueshme nga pikëpamja politike.

Është e qartë se Fuqitë e Mëdha, të cilat janë të lidhura midis tyre me anë konventash e traktatesh për sa i takon Lindjes dhe të cilat zotërojnë atje interesa të mëdha, kanë të drejtën dhe bile edhe detyrën që të ndërhyjnë në rregullimin e konfliktit të tanishëm, aq më tepër mbasi ai ka të bëjë me çështje që i takojnë të drejtës ndërkombëtare, të cilat nuk mund të lihen pas dore nga asnjëra prej tyre. Së fundi, ana humanitare e çështjes nuk mund t' i lërë ato indiferente.

Nëse është e drejtë që fitorja e armëve t' u sigurojë fitimtarëve disa përparësi, nga ana tjetër, e drejta e pushtimit nuk duhet të mbizotërojë mbi gjithë të tjerat. Pra, gjithë popujt që jetojnë mbi tokën e gadishullit ballkanik kanë të drejta të barabarta për të ekzistuar dhe secilit prej tyre duhet t' i krijohen kushte të barabarta ekzistence. Populli shqiptar, i njohur për luftërat që ai ka bërë në të gjitha kohët, tani dhe në të kaluarën, për pavarësinë e tij dhe për ruajtjen e integritetit të tij, është i bindur se ai është i denjë për nderimin e qeverive evropiane dhe se ai meriton të jetojë.

Prandaj ne deklarojmë se populli shqiptar nuk do të pranojë asnjë ndryshim të statukuosë territoriale në Turqinë evropiane, me një natyrë të tillë që t' i cenojë të drejtat e tij.

Ai nuk do të pranojë asnjë ndërhyrje nga ana e shteteve ballkanike në qeverisjen e vendit, që i përket si trashëgim i lënë nga të parët e tij. Ai dëshiron t' i ruajë zakonet e tij dhe të zhvillohet në kuptimin e koncepteve të tij shoqërore e politike dhe te mbetet zot i fateve të tij.

Duke dëshiruar të bashkëpunojë edhe ai në përparimin botëror dhe të mbajë vendin e vet në gjirin e popujve të qytetëruar, ai kërkon me ngulm nga Fuqitë e Mëdha që ato t' i garantojnë qenien e tij etnike e politike²⁶.

22 nëntor 1912

Protestë kundër synimeve pushtuese të shteteve ballkanike ndaj Shqipërisë

Kolonia e Horës së Arbëreshëve, në rrethin e Palermos, pas afro pesë shekuj jetese në tokën mikpritëse italiane, megjithëse ka ndjekur fatin e atdheut të madh italian në ditë të mira dhe në ditë të këqija, nuk e ka harruar atdheun e saj të prejardhjes, "fatkeqen Shqipëri".

Kjo ruan gjithnjë doket, traditat, ritin ortodoks dhe gjuhën e prejardhjes, dhe ka kontribuar jo pak me lëvruarit e saj të gjuhës shqipe për ta ruajtur atë dhe për zhvillimin letrar të saj. Në çastet më të vështira të jetës shqiptare, kjo ka ndjekur me zemër të dridhur dhe me vëmendje të madhe fatet e kombit fatkeq. Sot që guximi i shteteve ballkanike, të cilët i kanë lënë mënjanë luftërat e tyre për liri e pavarësi, kërkon ta fusë në katastrofën osmane edhe popullin e Skënderbeut, qytetarët e Horës së Arbëreshëve

**Veliu, F.,
Danaj, P.,
Veli, A.**
«Diplomacia shqiptare, në themel të luftërave për pavarësi, në historinë e betejave intelektuale para 1912-s»

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

²⁶ Thirrja gjendet frëngjisht në HHS' A, PA, A; bashkangjitur raportit të ambasadorit austro-hungarez në Stamboll, drejtuar Vjenës më 19 nëntor 1912, dhe me disa ndryshime në gazetën "La Nazione Albanese" botuar më 30 nëntor 1912.

²⁷ Protesta është botuar në gazetën "Atdheu", Konstancë. 4/18 nëntor 1912, dhe me disa ndryshime në gazetën "La Nazione Albanese", Pallagorio (Catanzaro), 25 nëntor 1912 (italisht). Është botuar në gazetën "Atdheu", Konstancë, 27 nëntor 1912.

Ajo është ribotuar italisht gjithashtu në përmbledhjen me dokumente me titull "Albania", Nr. 2, (1 Parte).1920, f. 274.

janë ngritur dhe protestojnë para gjithë botës kundër këtyre lakmive të pabesa. Dhe bota nuk mund të mos i marrë parasysht jetën dhe qenien e një populli. Prandaj po bëjmë protestën që vijon:

Qytetarët e Horës së Arbëreshëve, në orën tragjike që po kalon mëmëdheu, nuk mund të qëndrojnë pa e ndërre thellë klithmën e piklinit që vjen nga vëllezërit shqiptarë të Tejadriatikut.

Po shkelet parimi “Ballkanët popujve të Ballkanit”, në dëm të atdheut të lavdishëm dhe fatkeq të Skënderbeut dhe të Marko Boçarit, i cili ka ngjallur dëshirat dhe lakmitë e pavend të sllavëve²⁷.

Bibliografi

1. *Materiale Arkivore dhe gazeta*
2. AQH i RPSH, Fondi Athanas Tashko, dosja 7. dok. 6-9.
3. AQH i RSH, Fondi 102, dosja 3, f. 1.
4. AQH i RSH, fondi “Koleksione arkivore”, d. 1 (Mbledhja e Labërisë - Manastiri i Cepos)11
5. AQH i RSH. Fondi 32. dosja 102.
6. “Albania”, Përmbledhje me dokumente, Nr. 2 (1a Parte), 1910, “Dielli e “Flamuri”, AQH i RSH. Fondi “Komiteti Qendror Shqiptar”

**Veliu, F.,
Danaj, P.,
Veli, A.**
«Diplomacia
shqiptare,
në themel të
luftërave për
pavarësi,
në historinë
e betejave
intelektuale
para 1912-s»

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

Sistemi demokratik dhe siguria publike



■ **Dr. (proc.) Kozeta LIGEJA**
Universiteti i Tiranës
k.oz.i2006@hotmail.com

Abstrakt

Qëllimi i këtij artikulli është të analizojë rolin dhe funksionimin e politikave të sigurisë publike në një shtet demokratik. Sistemi demokratik nëpërmjet shtetit ligjor funksionon me zbatimin e politikave të sigurisë publike. Qeveritë demokratike kanë për qëllim që të garantojnë mbrojtjen e komponentëve siç janë: qytetarët, territorin, institucioneve publike të një vendi nga kërcënime të ndryshme. Qeveritë demokratike kanë qëllim ruajtjen e mirëqenies së popullsisë së tyre. Sistemi demokratik kontribuon në sigurinë publike të një vendi të caktuar. Në këtë artikull do të analizohet raporti i sistemit demokratik me sigurinë publike. Sa më demokraci të forta të kemi aq më siguri publike të forta do të ekzistojnë. Nisur nga ky përcaktim, vlen të theksojmë vlerën praktike të këtij drejtimi, në shoqërinë e një vendi të caktuar për të vërtetuar hipotezën e ngritur. Qëllimi i këtij punimi është qw përmes provave të analizës teorike, por edhe të rasteve në praktikën shqiptare, për të provuar hipotezën e ngritur. Qëllimi i përgjithshëm i studimit, është kuadri analitik për këtë çështje. Ky artikull do të bazohet në disa metoda studimi. Do të përdoren kryesisht metoda induktive, duke kaluar nga fakte specifike në konkluzione të përgjithshme, metodën e përshkrimit dhe rishikimit të literaturës për këtë çështje.

Fjalëkyçe:

demokracia, siguria publike, qytetarët, institucionet, mirëqenie.

Ligeja, K.
« Sistemi
demokratik
dhe siguria
publike »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

1. Hyrje

Në këtë artikull do të ndalemi tek rëndësia e sigurisë publike në sistemin demokratik. Qasja e kësaj teme ka ardhur si rezultat i përjetimit të ditëve të vështira që vendi ynë po kalon në drejtimin social-politike. E gjitha kjo ndikon tek siguria që ndjejnë qytetarët në vendin e tyre. Duke iu referuar literaturës akademike mund të themi se koncepti i demokracisë ka një trajtesë të gjerë në të. Shumë mendimtarë të kohërave të ndryshme, kanë dhënë pikëpamjet e tyre rreth nocionit të demokracisë. Në këtë punim do të ndalemi tek: Kuptimi mbi demokracinë, kuptimi për sigurinë publike, më tej do të shikojmë si paraqitet siguria publike në një sistem demokratik, kryesisht do të shikojmë një analizë të saj në shtete me një demokraci jo funksionale, si dhe përfundimet e punimit. Metodologjia e punimit është bazuar në disa metoda. Më konkretisht janë përdorur metoda induktive, përshkruese, rishikimit të literaturës përkatëse. Përshkrimi i disa rasteve shqiptare do të jepen si shembuj konkret për të realizuar kuptimin e sigurisë publike.

2. Kuptimi për demokracinë

Literatura akademike kryesisht shkencat politike njohin shumë studiues, politolog, autorë të ndryshëm të cilët kanë kontribuar në kuptimin e demokracisë. Bota akademike njihet emra të njohur që kanë folur me tezat, analizat, qëndrimet e tyre për konceptin e demokracisë. Mendimet e para për demokracinë i kanë dhënë filozofët e qytetërimit të lashtë athinas, si *Aristoteli*, *Platoni* etj. Krahas tyre ka dhe shumë mendimtarë të tjerë siç janë: ekonomisti austriak *Joseph Schumpeter*; politologu dhe akademiku Italian *Giovani Sartori*; profesori i shkencave politike *Robert Dahl*; akademiku amerikan *Samuel*

Ligeja, K.
« Sistemi
demokratik
dhe siguria
publike »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

Huntington; historiani dhe diplomati francez *Aleksi De Tokevil* deri tek politikani amerikan *Abraham Lincoln* e shumë mendimtarë të mëdhenj të kohërave të ndryshme historike kanë dhënë një kontribut të vyer për rëndësinë dhe funksionin e sistemit demokratik.

Kërkesa për të përkufizuar termin e demokracisë dhe për të ndërtuar një koncept me thelb demokracinë, ka hapur shumë diskutime, sidomos në kuptimin dhe kontekstin e sistemit politik. Koncepti i demokracisë, ashtu si shumë koncepte të tjera politike, e ka origjinën në qytetërimin grek¹. Sot, ekziston një bashkëpëlqim mbi kuptimin e termit demokraci. Ai është një term shkencor i fjalorit politik, që vjen nga greqishtja dhe përbëhet nga fjalët *demos* (popull, masa popullore ose qytetaria e plotë) – dhe *kraci* (sundim, ushtrim pushteti), pra sundim ose ushtrim i pushtetit nga populli².

Thelbi i demokracisë sipas *Abraham Lincoln* është: “*një qeverisje e popullit, nga populli për popullin*” Këtu kuptohet se sistemi demokratik e lidh qeverisjen me popullin.

Kështu që demokracia paraqitet në disa forma të saj. Pikërisht këtu buron dhe e drejta qytetare për t’u përfshirë në vendim marrje. Kemi demokraci të drejtpërdrejta që nënkupton qeverisjen e popullit, demokraci përfaqësuese që realizohet përmes të zgjedhurve nga populli). Demokracia me pjesëmarrje synon që t’i japë mundësi të gjithë qytetarëve të një shoqërie, për të dhënë kontributin e tyre në proceset vendimmarrëse, në politikën e një vendi. Gjithashtu, edhe për të marrë të gjitha përfitimet dhe akseset të barabarta nga organet qeveritare³.

Ndërsa për politologun dhe akademikun italian Sartorin termi demokraci në përdorimin e tij si një qeverisje politike, tregon për “*një entitet politik, një formë shteti e qeverisjeje*”⁴

Për Profesorin e shkencave politike Robert Dahl, “*asnjë sistem i qëndrueshëm në botën reale nuk është tërësisht i demokratizuar*”, ndaj ai përdor temin poliarki, i cili përkufizon “*regjime relativisht (por jo krejtësisht) të demokratizuara*”⁵.

Ndërsa historiani dhe diplomati francez *Aleksi De Tokevil* botoi një libër që e titulloi Demokracia në Amerikë. Ky libër është botuar në dy vëllime në vitet 1835 dhe 1840. Në këtë libër që e bëri të famshëm për kohën e tij Tukvil argumenton se “*ideja e së drejtës ajo që u dha mundësinë njerëzve të përcaktonin anarkinë dhe tiraninë dhe që i mësoi ata, se si të ishin të pavarur, pa qenë arrogantë, e si të bindeshin pa qenë servilë... shteti demokratik e zbrit konceptin e të drejtave politike deri në shkallën e shtetasve më të thjeshtë*”⁶.

Për akademikun amerikan Samuel Huntington, *demokracia si një formë e qeverisjes është përcaktuar në lidhje me burimet e autoritetit të qeverisjes, qëllimeve të paraqitura nga qeveria dhe procedurat për konstituimin e qeverisë*⁷

Kështu duke iu referuar literaturës që nga origjina e antikitetit deri në vitet e fundit, literatura na ka dhënë një trajtesë të gjerë të këtij koncepti themelor si një qeverisje politike.

¹ Höffe, O., *Einführung in Aristoteles, Politik*, në Höffe, Otfried (2001), eds., *Aristoteles, Politik*, Oldenbourg Verlag, Berlin, 2001, ff. 5-20, f. 5.

² Schmidt 2008, vepër e cituar, f. 17.

³ Kozeta Ligeja, *Përfshirja e komunitetit në qeverisjen lokale në Shqipëri* Balkan Journal of Interdisciplinary Research IIPCC Publishing, Graz-Austria, 2019, ISSN 2410-759X, f. 96.

⁴ Giovani Sartori, “*Ç është Demokracia*”, Dituria, Tiranë, 1998, fq. 8.

⁵ Robert A Dahl, “*Poliarkia: Pjesëmarrja dhe Opozita*”, Pegj, Tiranë, 2005, f. 7.

⁶ Aleksi De Tokevil, “*Demokracia në Amerikë*”, Kristalina-KH, Tiranë, 2002, f. 85.

⁷ Samuel Huntington, “*Vala e tretë*”, AHS, Tiranë, 2011, f. 8.

3. Kuptimi për sigurinë publike

Siguria publike është funksioni i qeverive që siguron mbrojtjen e qytetarëve, personave në territorin e tyre, organizatat dhe institucionet kundër kërcënimeve për mirëqenien e tyre dhe për prosperitetin e komuniteteve të tyre⁸. Siguria publike nënkupton që qytetarët e një rajoni mund të bashkëjetojnë në harmoni, ku secili respekton të drejtat individuale së të tjerëve. Shteti është garantues i sigurisë publike dhe udhëheqësi i madh kur është fjala për të shmangur ndryshimet në rendin shoqëror. Në këtë kuptim, siguria publike është një shërbim që duhet të jetë universal (të gjithë personat kanë të drejtë) për të mbrojtur integritetin fizik të qytetarëve dhe pronën e tyre.

Për ta bërë këtë, ekzistojnë forca të sigurisë publike (siç janë policia dhe forcat e armatosura), të cilët punojnë në bashkëpunim me pushtetin gjyqësor. Forcat e sigurisë publike synojnë të parandalojnë çdo lloj krimi dhe të ndëshkojnë tanishëm një herë. Është e tyre për të ndjekur penalisht shkelësit dhe për të ofruar drejtësi, e cila do të përcaktojë ndëshkimet përkatëse në përputhje me ligjin. Siguria publike varet gjithashtu nga efektiviteti i policisë, funksionimi i gjyqësorit, politikat e shtetit dhe kushtet sociale. Debati mbi ndikimin e varfërisë në pasigurinë publike është polemik, edhe pse shumica e specialistëve krijojnë një marrëdhënie midis shkallës së varfërisë dhe sasisë së krimeve.⁹

4. Siguria publike në sistemin demokratik

Sipas politikanes franceze, Michelle Alliot – Marie¹⁰ siguria publike është: “Siguria është detyrimi i parë i një Shteti”.

Pjesa më e madhe e shteteve në botë udhëhiqen nga qeverisja demokratike. Sistemi i qeverisjes demokratike bazohet në principet e saj të rëndësishme që e bën një shtet demokratik të funksionojë. Këto parime janë: pëlqimi për qeverisjen, qeverinë përfaqësuese, sundimin e ligjit, të drejtën individuale dhe parimin e njohur të “kontrollit dhe ekuilibrit”. Realizimi apo jo i parimeve demokratike tregon funksionimin e plotë të demokracisë në një shtet të caktuar. Shumica e vendeve demokratike, në legjislacionet e tyre i kanë dhënë rëndësi një pjese të veçantë që lidhet me politikat e sigurisë publike. Këto shtete i kanë emërtuar këto politika me emra të ndryshme si: strategji plane apo koncepte. Çdo qeveri që ndërton një strategji për sigurinë publike, ka krijuar një qasje kombëtare në të cilën përfshihen të gjitha mënyrat, format e duhura për përballjen me rreziqet që i kanosen popullsisë së një shteti.

Qeveritë nëpërmjet strategjive, planeve, doktrinave kombëtare kanë për qëllim që të marrin masa për një proces të vazhdueshëm, vendimmarrje, për përmbushjen e sigurisë publike kombëtare. Në rastin e vendit tonë, Shqipëria ka hartuar strategjinë kombëtare për sigurinë kombëtare. Secila shumicë që vjen në qeverisje nëpërmjet zgjedhjeve elektorale, ka për detyrë që të hartojë, planifikojë, udhëzojë, për ndërtimin e kësaj strategjie me qëllim mbrojtjen e sigurisë kombëtare.

Ligeja, K.
« Sistemi demokratik dhe siguria publike »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

⁸ http://cradpdf.drdc-rddc.gc.ca/PDFS/unc131/p538238_A1b.pdf

⁹ <https://dictionaryofdefinitions.blogspot.com/2016/05/what-is-meaning-definition-of-public.htm>

¹⁰ Ariane Bernard (translation) (23 August 2007). "Excerpts From "Dawn Evening or Night"". *New York Times (in the International Herald Tribune)*. Retrieved 1 August 2013.

Kështu në këtë strategji kombëtare tregohet se: *Siguria, liria dhe mirëqenia janë elemente thelbësore të shoqërive të civilizuara dhe përfaqësojnë themelet, mbi të cilat mbështetet zhvillimi dhe progresi i kombit. Garantimi i një mjedisi që ofron siguri dhe liri për qytetarët është përgjegjësia parësore e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (SSK) të Republikës së Shqipërisë (RSH)*¹¹.

Historia ka treguar se njerëzimi në periudha të ndryshme historike, është përballur me kërcënime të ndryshme. Forma më e përhapur e kërcënimeve kanë qenë luftërat që janë zhvilluar ndërmjet shteteve për interesa të ndryshme kombëtare. Pasojat e zhvillimit të luftërave, sillnin bilanc të lartë në humbjet e jetëve njerëzore. Kështu me kalimin e viteve, me ndryshimin e sistemeve politike njerëzimi ndjeu si nevojë që zgjidhjen dhe arritjen e interesave kombëtare, mos ta shikonin nëpërmjet luftërave, por me zhvillimin e formave të reja si komunikimi midis shteteve.

Sigurisht që këto forma të lehta bashkëpunimi nëpërmjet konsensusit, diplomacisë, debatit konstruktiv, ishin tipare të sistemit demokratik. Shtetet që udhëhiqeshin nëpërmjet sistemit demokratik, ishin në kërkim të formave demokratike të eliminimit të rrezikut kombëtar. Për të fuqizuar kështu parimet demokratike që kishin të bënin me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Këtu përfshiheshin siguria e dinjitetit njerëzor, privatësia, etj.

Në këtë kontekst fuqizimi i sigurisë në një shtet demokratik realizon një raport të mirë me mirëqenien e qytetarëve. Gjë e cila është detyrë thelbësore e udhëheqjes qeverisëse. Vështruar historikisht, të gjitha shoqëritë kanë kaluar dhe sot, gjatë zhvillimit të vet, në mënyrë permanente kalojnë nëpër konflikte të ndryshme, politike, ekonomike dhe ushtarake e të sigurisë, të cilat, sipas mënyrës së manifestimeve, intensitetit dhe pasojave ndikojnë dukshëm në ashpërsimin gjithnjë e më të madh në këtë fushë. Në çdo shoqëri të konsoliduar interesat politike, të sigurisë e të tjera të qytetarëve ndryshojnë e transformohen nga dita në ditë dhe fitojnë përmbajtje të reja, në pajtim me transformimin e përgjithshëm të civilizimit.

Në këtë rrugë shfaqen sfida të ndryshme dhe forma të ndryshme të destruksionit, burime të ndryshme të rrezikut të cilat marrin karakter global dhe vënë në pikëpyetje ekzistencën dhe mbijetesën e njerëzimit. Përveç kësaj, format dhe instrumentet e ndryshme të dhunës nëpërmjet terrorizmit, krimit të organizuar, narkomanisë, mjeteve për zhdukje dhe shkatërrime masive, pa dyshim shprehin gjithë kompleksitetin e qenies së sotme njerëzore¹².

Shtetet me një demokraci të brishtë dhe më një tranzicion të zgjatur, e kanë të nevojshme fuqizimin e sigurisë publike. Kjo për arsye se qytetarët duan të ndjehen të sigurt dhe të qetë në jetët e tyre. Por kur qytetarët përballen me një sërë problematikash në vend sigurisht që lind ndjesia e pasigurisë publike. Kur flasim për problematika i referohemi disa tipareve të funksionimit të qeverisjes në vend. Kështu konkretisht: Në shtetet me një demokraci jo funksionale, janë dalluar këto tipare: qeverisje e mazhorancës që kontrollojnë 3 pushtetet e qeverisjes; në zgjedhjet elektorale dallohen shitblerja e votës, institucione nepotike, jo rekrutim meritokratik, mospërfshirja e qytetarëve në vendimmarrjet e vendimeve politike, partitë politike me një demokraci jo funksionale në strukturat e tyre, udhëheqja politike e lidhur me krimin e organizuar, rritja e

¹¹ *Strategjia e Sigurisë Kombëtare*, Tirane, korrik, 2014

¹² Bashkim Dr. Selmani & Mevledin Dr. Mustafi "Sistemet e sigurisë –Sisteme security", f. 19-37 Furkan ISM Shkup, 2016.

korupsionit në vend, roli i ulët i shoqërisë civile, trazira sociale apo politike, media jo e lirë që të jetë si një pushtet i katërt, mbi të gjitha mosbesimi i qytetarëve në institucionet publike.

Kështu në këtë paraqitje tiparesh qeverisëse, qytetarët e kanë të vështirë për t'u ndjerë të sigurt për të jetuar jetët e tyre. Qytetarët e një shteti demokratik, kërkojnë siguri dhe mirëqenie, paqe në përditshmërinë e tyre. Qytetarët e ndjejnë që politikatat e sigurisë publike janë të dobëta. Madje mund të themi se pjesa më e madhe e tyre ekzistojnë formalisht pa pasur një qëllim në vetvete për realizimin e mirëfilltë të tyre. Mirëpo, pasiguria kombëtare sjell problematika të tjera tek qytetarët. Është mundësia e ekzistencës së kontingjenteve me kosto sociale dhe ekonomike.

Më konkretisht, me kosto sociale dhe ekonomike kuptojmë: Në një shtet të varfër njerëzit përballen me problemet e sipërpërmëndura dhe ato ndjejnë të largohen nga vendet e tyre në një destinacion më të sigurt. Pra rritet dukuria e emigrimit; p.sh. vitet e fundit Shqipëria po përjeton largimin masiv të shqiptarëve në shtete me demokraci funksionale që i jep siguri ekonomike, sociale, mirëqenie paqe për të vazhduar jetët e tyre. Nga sondazhe të ndryshme që janë realizuar nga organizata joqeveritare si *Qendra për Qeverisje të Mirë*¹³ apo *Gallup International*¹⁴ kanë arritur në përfundimin se njerëzit në Shqipëri kanë pasiguri publike ë drejtim social dhe ekonomik. Për këtë arsye qytetarët kanë zgjedhur të largohen gjithnjë e më shumë.

Në një shoqëri demokratike, vetë qeveria ka për detyrë kryesore që të realizojë sigurinë publike. Kuadri ligjor përveç legjislacionit të gjerë në të cilin janë parashikuar strategji kombëtare për sigurimin publik, përmban dhe krijimin e së drejtës penale që e ka këtë përgjegjësi. Struktura më e rëndësishme që luan në ruajtjen e rendit publik është policia. Por, sërish në vendet me një demokraci të brishtë këto struktura të rëndësishme janë jo shumë të fuqishme në rolin e tyre. Më konkretisht Në Shqipëri nisur nga sondazhet që ka zhvilluar Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim¹⁵ qytetarët kanë raportuar se kanë një perceptim të mirë për policinë. Kështu sipas këtij raporti në të cilin thuhet se: *Pothuajse gjysma e të intervistuarve (47%) deklaruan se ata i besojnë më së shumti policisë, ndërsa 14% e të intervistuarve i besojnë plotësisht policisë. Nga ana tjetër, një e katërta (23%) e të anketuarve kanë theksuar se ata kryesisht nuk i besojnë policisë, ndërsa 16% kanë thënë se nuk e besojnë atë aspak. Besimi tek policia mbizotëron me 61%, përkundër 39% që nuk i besojnë këtij institucioni. Ky tregues në fakt është në rritje në krahasim me vitin 2016 kur ky raport ishte 56% dhe 43% përkatësisht*¹⁶.

Përgjigjet ndaj kërcënimeve të sigurisë të shqyrtuara në këtë kuptim më të gjerë kërkojnë pjesëmarrje aktive dhe përpjekje të përbashkëta ndërmjet organizatave ndërkombëtare, institucioneve shtetërore kombëtare, qeverive lokale dhe shoqërisë civile duke përfshirë mediet, grupet e mbikëqyrësve, akademia, komisionet speciale, grupet e policimit në komunitet, ndërmarrjet private, grupet e të drejtave të njeriut, dhe *think tank*. Ajo që është gjithashtu e re në këtë qasje ndaj sigurisë është ndërftja dhe përdorimi i një racionalizimi zhvillimi, pozicionimi i sigurisë në kryqëzimin e qeverisjes, sundimi i ligjit, reforma ekonomike, zgjidhja pas konfliktit dhe proceset e rindërtimit, parandalimi i konflikteve dhe forcat e armatosura dhe reforma policore¹⁷.

¹³ <https://www.zeriamerikes.com/a/4788328.html>

¹⁴ <https://telegرافي.com/sondazh-gallup-international-1-7-milione-shqiptare-deshirojne-te-largohen-nga-vendi/>

¹⁵ <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2017/09/ALB-Survey-2017-ALB.pdf>

¹⁶ Po aty, fq 10

¹⁷ http://pdba.georgetown.edu/Security/security_e.html

Më lart përmendëm që pjesa më e madhe e botës, qeveriset nga sistemi demokratik. Kjo formë e qeverisjes paraqet parimet e saj për një shtet me demokraci funksionale, ku ekziston shteti ligjor. Sa me shtete demokratike funksionale kemi, aq më shumë do të forcohet siguria publike. Për rrjedhojë aq më të kënaqur me qeverisjen dhe me mirëqenien do jenë qytetarët.

Por, për tu arritur në këtë performancë demokratike, shtetet duhet të bëjnë shumë punë duke respektuar parimet apo principet demokratike. Me qëllim që qytetarët të jetojnë më një siguri publike të sigurt në vendin e tyre. Në një shtet demokratik, sa më bashkëpunime midis aktorëve të ndryshëm social, politik, mediatik, biznes, qytetarë të ketë, aq më shumë do të kemi rezultate për arritjen e shtetit të së drejtës. Ky bashkëpunim realizohet përmes komunikimit, dëgjimit, konsultimit, debatit konstruktiv, tolerancës mirëkuptimit, ndërmjet aktorëve, me qëllim arritjen e objektivave demokratike në vend.

5. Përfundime

Si përfundim në këtë artikull mund të përmbledhim se:

Pjesa më e madhe e shteteve të botës qeverisen nga sistemi demokratik. Ajo që vihet re në këto shtetet që jo të gjithë kanë një demokraci funksionale, ku të mbizotërojë shteti i së drejtës. Në shtetet e së drejtës performanca demokratike është e lartë, pasi qeverisja e tyre realizohet duke respektuar parimet demokratike. Si rrjedhojë edhe siguria publike, është e lartë në këto shtete.

Ndërsa në shtetet me demokraci të brishtë, jofunksionale vihen re tipare që lidhen me qeverisje jo të mirë që nuk bazohet në parimet demokratike. Këtë pjesë e tregon performanca e qeverisjes tek qytetarët e vendit. Qytetarët përballen me një paqëndrueshmëri politike, kriza sociale apo politike, mosbesim ndaj institucioneve publike, probleme ekonomike, mos respektim i të drejtave të njeriut, politikanë të lidhur me krimin, afëra me bizneset, media e lidhur me politikës, nepotizmi institucional e tjerë. Si rrjedhojë, qytetarët në këto shtete përjetojnë pasiguri publike që kanë kosto ekonomike, sociale tek pjesa më e madhe e tyre. Shteti ligjor, nëpërmjet qeverisjes demokratike bashkëpunon me anë dialogut, konsensusit me një shumësi aktorësh në vend për të arritur objektivat e sigurimit publik.

Bibliografia

Libra

1. Bufi Ylli, "Tempulli i demokracisë", Ombra GVG, Tiranë, 2010.
2. Dahl Robert, "Poliarkia Pjesëmarrja dhe Opozita", Pegi, Tiranë, 2005.
3. Filo Llambro, "Historia për sistemet e qeverisjes", EXTRA, Tiranë, 2005.
4. Filo, Lambrol., "Sistemi Politik Bashk ,kohor – Evropa", Tiranë, Ideart, 2010.
5. Huntington Samuel, "Vala e trete", AINS, Tiranë, 2011.
6. Omari, L. Anastasi. A, "E drejta Kushtetuese", Shtepia Botuese ABC, Tiranë, 2010
7. Sartori Giovanni, "Ç është Demokracia", Dituria, Tiranë, 1998.
8. Schumpeter, Joseph A. "Kapitalismus, Sozialismus und Demokratie", Bern ,1950.
9. Tokevil De, Aleksii "Demokracia në Amerikë", Botoi Kristalina-KH, Tiranë, 2002.
10. Zaganjori, Xh. Anastasi, A.. Cani, E. "Shteti i së Drejtës në KRSH", Tiranë, 2011.

Burime Interneti

1. http://cradpdf.drdc-rddc.gc.ca/PDFS/unc131/p538238_A1b.pdf
<https://dictionaryofdefinitions.blogspot.com/2016/05/ëhat-is-meaning-definition-of-public.htm>
2. http://pdba.georgetoën.edu/Security/security_e.html
3. <https://www.zeriamerikes.com/a/4788328.html>
4. <https://telegrafi.com/sondazh-gallup-international-1-7-milione-shqiptare-deshirojne-te-largohen-nga-vendi/>
5. <http://idmalbania.org/ëp-content/uploads/2017/09/ALB-Survey-2017-ALB.pdf>

Ligeja, K.

« Sistemi demokratik dhe siguria publike »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

Parandalimi i terrorizmit, dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm, që favorizojnë terrorizmin



■ Av. Sheldiana JANO
sheldaagaraj@yahoo.com

Abstrakt

Terrorizmi ka të bëjë me mohimin e demokracisë dhe të së drejtave të njeriut, që përbëjnë thelbin e asaj që përfaqëson një shtet me ligjzbatues. Shtetet ligjzbatuese janë të vendosura të luftojnë të gjitha aktet e terrorizmit, pa asnjë përjashtim, si krime tepër të rënda. Shtetet, përmes agjencive përkatëse policore kanë detyrën të mbrojnë të gjithë individët brenda juridiksionit të tyre ndaj akteve terroriste, kjo si pjesë e detyrimeve të tyre në kuadrin e të drejtave të njeriut për garantimin e së drejtës për jetën, së drejtës për siguri dhe të drejta të tjera në kuadrin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kjo kërkon që shtetet të përdorin një qasje gjithëpërfshirëse në luftën kundër terrorizmit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë parandalimit dhe luftës kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm, që favorizojnë terrorizmin, duke mbrojtur të drejtat e njeriut dhe shtetin ligjor. Duke qenë se në këtë kontekst, policia luan një rol tepër të rëndësishëm në luftën kundër terrorizmit, merr rëndësi të posaçme fakti që policia të japë llogari për veprimet e veta, me qëllim garantimin e legjitimitetit, besimit, besueshmërisë dhe mbështetjes nga publiku. Përballja me ekstremizmin dhe radikalizmin e dhunshëm që favorizojnë aktet terroriste. Radikalizmi nuk përbën kërcënim për një shoqëri, në rast se nuk lidhet me dhunën apo veprime të tjera të paligjshme, të tilla si: nxitja e urrejtjes, sipas përshkrimit në jurisprudencën që lidhet me legjisllacionin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Radikalizmi mund të rezultojë si një forcë pozitive ndryshimi. Radikalizmi terrorist është një proces dinamik, sipas të cilit individit nis ta pranojë dhunën terroriste si një rrugë të mundshme, madje edhe legjitime të veprimit. Nuk ka asnjë profil të vetëm i cili do të përfshinte të gjithë terroristët, sikundërse nuk ekziston asnjë rrugë “e prerë me thikë”, e cila i çon individët në rrugën drejt terrorizmit. Shtysat e mundshme të radikalizmit terrorist janë të ndryshme dhe komplekse, duke u ndërhur në mënyrë unike për çdo rast specifik. Profilët që ndërtohen mbi bazën e supozimeve të stereotipizuara, mbi bazën e përkatësisë fetare, racore, etnike, gjinore, statusit shoqëror dhe ekonomike etj. jo vetëm që janë diskriminuese, por po ashtu janë edhe të paefektshme.

Jano, Sh.
« Parandalimi
i terrorizmit,
dhe lufta kundër
ekstremizmit
dhe radikalizmit
të dhunshëm,
që favorizojnë
terrorizmin »

Policimi
dhe
Siguria
nr.14, 2019

Fjalëkyçe:

ekstremizmi i dhunshëm, radikalizmi, terrorizmi, parandalimi.

1. Metodologjia

Ky punim ofron një panoramë të gjerë të shpjegimit të konceptit të radikalizmit dhe terrorizmit, politikat që kanë të bëjnë me tematikën kryesore që mund të ndikojë mbi suksesin apo dështimin e përpjekjeve të politikave për nxitjen e qasjes së policimit në komunitet për parandalimin e terrorizmit, si edhe në luftën kundër radikalizmit të dhunshëm. Në Pjesën e parë të tij, punimi trajton disa koncepte kyçe për sa i takon parandalimit të terrorizmit dhe qasjeve me bazë komunitare në luftën kundër terrorizmit. Ndërsa në pjesën e dytë dhe të tretë faktorët që e favorizojnë dhe së fundi strategjitë në luftën kundër parandalimit të terrorizmit, si edhe në luftën kundër radikalizmit të dhunshëm. Punimi mbështetet tek një analizë e përvojës së akumuluar në disa prej vendeve pjesëmarrëse dhe partnerëve të bashkëpunimit të OSBE-së, OKB-së.

2. Hyrje

Parandalimi i terrorizmit, përmes sistemit të drejtësisë në tërësi dhe atij penal në veçanti, kanë detyrimin për të marrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të së gjithë individëve brenda juridiksionit të tyre, nga terrorizmi, si pjesë e detyrimeve të tyre pozitive për garantimin e së drejtës për jetën, së drejtës për integritet fizik dhe të drejta dhe të tjera që kanë si bazë liritë themelore të njeriut.

Rrjedhimisht, ato duhet të përqendrohen tek parandalimi i terrorizmit duke respektuar të drejtat e njeriut dhe shtetin ligjor. Teksa vendet e ndryshme mundohen të gjejnë mënyra për parandalimin më efikas të terrorizmit po shtohen njëkohësisht

Jano, Sh.

« Parandalimi i terrorizmit, dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm, që favorizojnë terrorizmin »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

përpjekjet për të kuptuar pse dhe kur individët kthejnë sytë nga terrorizmi, si ndodh kjo dhe mënyrat sesi kjo mund të parandalohet që në fillimet e veta.

Terrorizmi është një ndër krimet më të rënda. Ai nuk mund dhe nuk duhet të lidhet në asnjë mënyrë me ndonjë kombësi, përkatësi fetare apo etnike. Ndonëse në jurisprudencën ndërkombëtare nuk gjen ndonjë përkufizim të pranuar botërisht për sa i përket terrorizmit, për ta etiketuar një akt si “terrorizëm” do të thotë të vërtetosh jo vetëm që ai mbart disa karakteristika, por gjithashtu që nuk mund të përliqet nga asnjë konsideratë politike, filozofike, ideologjike, racore, etnike apo fetare. Megjithatë, ka një nocion të kontestuar, sipas të cilit legjitimohet përdorimi i disa formave të dhunës në rrethana të veçanta dhe se ky përdorim në këto rrethana nuk duhet të konsiderohet si terrorizëm por sjellje të ndryshme kriminale. Aplikimi i termit mbart gjithashtu implikime të rëndësishme, qoftë në kuadrin kombëtar, qoftë në arenën ndërkombëtare¹.

3. Koncepti i terrorizmit dhe radikalizmit

3.1 Raporti i Drejtësisë me radikalizimin dhe luftën kundër terrorizmit²

Aktet terroriste janë veprime kriminale dhe rrjedhimisht, janë pjesë e tagrit të sistemit të drejtësisë penale. Standardet e të drejtave të njeriut do të zbatohen pavarësisht nëse një incident i caktuar konsiderohet si akt terrorist apo një veprë tjetër që hyn në kategorinë e krimeve të rënda. Një zgjidhje në lidhje me vështirësinë për përkufizimin e terrorizmit mund të jetë përqendrimi tek parandalimi dhe/ose ndëshkimi i sjelljeve me natyrë të mirëfilltë terroriste. Ndonëse ende bashkësia ndërkombëtare nuk ka mundur të gjejë konsensus mbi definicionin e terrorizmit, është rënë dakord që disa akte përbëjnë akte terroriste si p.sh. (rrëmbimi/marrja peng e një avioni, veprime të organizuara kriminale, gjenocide etj), tashmë janë objekt i 18 konventave dhe protokolleve ndërkombëtare të miratuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) apo agjencitë e saj.

3.2 Përkufizime dhe perceptime në lidhje me terrorizmin³

- Terrorizmi nuk mund dhe nuk duhet të lidhet me asnjë kombësi, përkatësi fetare apo etnike. Terrorizmi është: krim i rëndë; kryhet me qëllim për të shkaktuar vdekjen apo dëmtime të rënda trupore, apo për të marrë pengje; dhe
 - provokimin e gjendjes së terrorit tek masa e gjerë e publikut, tek një grup individësh apo tek individë të caktuar, duke frikësuar popullatën apo duke detyruar një qeveri apo organizatë ndërkombëtare të kryejë apo të mos kryejë akte të caktuara.
 - Legjislacioni vendas duhet ta përkufizojë terrorizmin dhe krimet që lidhen me të në një mënyrë të qartë, të saktë, jodiskriminuese dhe joprapavepruese, me qëllim krijimin e një baze për një reagim efikas të drejtësisë penale.
 - Shtetet kanë detyrimin të garantojnë mbrojtje ndaj terrorizmit dhe të sigurohen

¹ Countering Terrorism, Protecting Human Rights: A Manual [Lufta kundër terrorizmit, Mbrojtja e të drejtave të njeriut: Manual] (Varshavë: OSBE/ODIHR, 2007).

² Parandalimi i terrorizmit dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që favorizojnë terrorizmin: qasja e policimit në komunitet Botim i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Vjenë, mars 2014 OSBE 2014.

³ Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

që çdo masë në luftën kundër tij është në përputhje me jurisprudencën ndërkombëtare, në veçanti me jurisprudencën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ligjin për refugjatët dhe ligjin humanitar.

- Për të luftuar terrorizmin me efikasitet nevojiten përpjekje gjithëpërfshirëse dhe strategjike, në mënyrë të posaçme për të parandaluar shndërrimin e njerëzve në terroristë, për të hedhur në erë planet e të dyshuarve si terroristë dhe për t'i sjellë ata përpara drejtësisë në gjykatë.

3.2.1 Çfarë është radikalizmi terrorist?

Radikalizmi nuk përbën kërcënim për shoqërinë, në rast se nuk lidhet me dhunën apo veprime të tjera të paligjshme, si fjala vjen nxitja e urrejtjes, sipas përshkrimit juridik, në përputhje me jurisprudencën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Radikalizmi eventualisht mund të jetë një forcë e një ndryshimi pozitiv. Kështu p.sh., avokatët e të drejtave politike dhe ata të së drejtave të njeriut, të cilët luajtën një rol vendimtar në heqjen e skllavërisë dhe ata që mbështetën të drejtën universale të votës, dikur konsideroheshin si radikalë, duke qenë se ishin kundër ideve dhe opinionëve të përgjithshme mbizotëruese të shoqërive të tyre. *Radikalizmi terrorist përfaqëson një proces, ku një individ nis ta pranojë dhunën terroriste si një rrugë të mundshme, madje edhe legjitime, veprimi. Eventualisht, por jo domosdoshmërisht kjo mund ta bëjë një individ të mbështesë, të veprjë në mbështetje apo të përfshihet në terrorizëm.* Megjithatë, nuk ka asgjë të prerë me thikë në rrugën e përfshirjes në terrorizëm.

Radikalizmi terrorist mund të ndodhë në një sërë rrethanash nga më të ndryshmet dhe me shpejtësi po kaq të ndryshme. Çdo rast radikalizmi terrorist dhe rekrutimi për qëllime terrorizmi është rezultat i një ndërthurjeje unike të një mjedisi lehtësues me rrethanat dhe psikologjinë personale të çdo burri apo gruaje. Nuk ka ndonjë profil të vetëm që do të përshkruante një terrorist, sikundërse nuk ka asnjë rrugë të qartë që të çon drejt terrorizmit. Shtysat e mundshme të radikalizmit terrorist janë të ndryshme, komplekse dhe kombinohen në mënyrë unike për çdo rast.

3.2.2 Rezoluta e OKB-së për terrorizmin

Këshilli i Sigurimit i OKB-së, në rezolutën e vet nr. 1566 (viti 2004) përdor tre kriteret përmbledhëse për të karakterizuar terrorizmin: (i) (synimi); (ii) qëllimi; dhe (iii) sjellja specifike, si më poshtë vijon:

- Vepra penale kundër civilëve, të kryera me synimin e shaktimit të vdekjes apo dëmtimeve të rënda trupore, apo rrëmbim; Negociatat brenda OKB-së vazhdojnë për një projekt-konventë gjithëpërfshirëse mbi terrorizmin, ku do të përfshihej edhe një përkufizim mbi terrorizmin.

- Pavarësisht nëse është i motivuar nga konsiderata politike, filozofike, ideologjike, racore, etnike, fetare apo të ndonjë natyre të ngjashme, me qëllimin e provokimit të një gjendjeje terrori tek publiku i gjerë, tek një grup individësh, apo individë të veçantë, frikësimin e popullatës apo duke detyruar një qeveri apo organizatë ndërkombëtare të kryejë apo të mos kryejë një veprim; dhe

- të gjitha ato veprime kriminale që përbëjnë krime nën dritën, dhe sipas përshkrimit të konventave dhe protokolleve ndërkombëtare në lidhje me terrorizmin. Qasja përmbledhëse e aplikuar në rezolutën nr. 1566 për përkufizimin e terrorizmit u

Jano, Sh.

« Parandalimi i terrorizmit, dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm, që favorizojnë terrorizmin »

Policimi dhe Siguria nr.14, 2019

mbështet nga Raportuesi i parë i Posaçëm i Kombeve të Bashkuara për nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në përballjen me terrorizmi.

Ligjet dhe rregulloret përkatëse duhet të vihen në dispozicion të publikut të gjerë dhe duhet të zbatohen me përpikëri dhe transparencë nga autoritetet publike, duke përfshirë policinë dhe gjyqësorin.

4. Faktorët që favorizojnë terrorizmin dhe radikalizmin

4.1 Mungesa e një mbikëqyrjeje dhe përgjegjshmërie efikase të politikave dhe masave antiterrorizëm

I gjithë sistemi i drejtësisë dhe në veçanti të gjithë oficerët e policisë janë përgjegjës përpara ligjit dhe duhen vënë përpara përgjegjësisë për shkelje të ligjit dhe nënvlerësim të akteve kriminale. Mekanizmat efikase të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies janë dobiprurës si për policinë, ashtu edhe për publikun e gjerë. Ato sigurojnë më shumë objektivizëm në trajtimin e ankesave ndaj veprimeve të policisë dhe ndihmojnë në rritjen e besimit të publikut tek policia. Gjithashtu, ato garantojnë mbrojtje për individë të ndryshëm në rangjet e policisë përmes garantimit të proceseve të paanshme dhe të ndershme në hetimin e ankesave ndaj tyre:

- rrit ndjeshëm rrezikun që veprimet antiterrorizëm të jenë jo vetëm të paefektshme, por edhe antiproduktive, duke shkelur të drejtat e njeriut dhe duke kontribuar rrjedhimisht në radikalizëm⁴; dhe
- qoftë reale apo e perceptuar, minon besimin e publikut tek veprimet antiterrorizëm të autoriteteve publike dhe gatishmërinë e publikut për mbështetje aktive të luftës kundër terrorizmit.

Teksa vendet përpiqen të gjejnë instrumente më efikase për parandalimin e terrorizmit janë shtuar njëkohësisht edhe përpjekjet për të përcaktuar si fillim përse dhe si individët hyjnë në rrugën e terrorizmit dhe sesi mund të evitohet kjo që në fazat fillestare. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë theksuar nevojën për të kuptuar dhe luftuar më mirë fenomenin përmes një qasjeje shumëplanëshe⁵.

4.2 Kushtet dhe rrethanat që favorizojnë terrorizmin

Ndonëse nuk ekziston një grup i qëndrueshëm faktorësh që nxisin radikalizmin terrorist, disa janë evidentuar si më të veçantë. Ndër kushtet që favorizojnë terrorizmin, të cilët njihen nga OKB-ja dhe OSBE-ja, përfshihen “konfliktet e zgjata të pazgjidhura, zhveshja nga aspektet njerëzore e viktimave të terrorizmit në të gjitha format dhe manifestimet e tij, mungesa e sundimit të ligjit, shkelja e të drejtave të njeriut, diskriminimi për shkak të përkatësisë etnike, kombëtare dhe fetare, përjashtimi politik, marginalizimi shoqëror dhe ekonomik dhe keqqeverisja”.

Ekzistojnë një numër kushtesh strukturore të natyrës sociale, ekonomike dhe politike

⁴ Rezoluta nr. 1373 (2001) e miratuar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, mbledhja 4345, datë 28 shtator 2001 (S/RES/1373 (2001)), Rezoluta nr. 1456 (2003) e miratuar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, mbledhja 4688, datë 20 janar 2003 (S/RES/1456 (2003)).

⁵ OSBE, Këshilli Ministror, “Ministerial Statement on Supporting the United Nations Global Counter Terrorism Strategy” [Deklarata Ministrore në Mbështetje të Strategjisë Globale të OKB-së në Luftën Kundër Terrorizmit], Madrid, 30 nëntor 2007.

që mund t'i shtyjë individët drejt terrorizmit, të tilla si⁶: diskriminimi dhe forma të mungesa e aksesit në arsim etj, të cilat nuk mjaftojnë në vetvete për t'u konsideruar si radikalizëm terrorist. Është e rëndësishme të mbahen parasysh një sërë faktorësh të tjerë psikologjikë, ndërpersonale dhe ideologjikë për të shpjeguar mobilizimin. Ndërveprimet sociale, dinamikat në grup dhe marrëdhëniet ndërpersonale luajnë një rol parësor si faktorë tërheqës, me përjashtim të rasteve të radikalizmit të vetëdrejtuar dhe të vetënisur. Njerëzit bëhen pjesë e radikalizmit përmes njohjeve personale, bashkëmohatara, farefisit, ose përzgjidhen nga rekrutues terroristë. Rekrutuesit terroristë identifikojnë, "i gjuajnë" dhe përgatisin burra dhe gra të dobët, i "kapin" ata duke iu siguruar mbështetje materiale dhe/ose psikologjike dhe abuzojnë me besimin e tyre, për t'i manipuluar apo indoktrinuar ata që të përfsihien me terrorizmin.

Faktorët psikologjikë dhe njohës, si p.sh. trauma, ndjenjat negative të zhvendosjes; Ndërveprimet sociale dhe marrëdhëniet ndërpersonale, që e tërheqin një individ në terrorizëm.

- Radikalizmi nuk përbën kërcënim për shoqërinë nëse nuk lidhet me dhunë apo me akte të tjera të paligjshme, si p.sh.: nxitja e urrejtjes, sipas përkufizimit ligjor, në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Radikalizmi mund të shndërrohet në një forcë për ndryshime pozitive.

- Kushtet që favorizojnë terrorizmin, të njohura dhe të pranuar nga OKB-ja dhe OSBE-ja përfshijnë: "konfliktet e zgjatura, të pazgjidhura, zhveshja e viktimave të terrorizmit nga aspektet njerëzore në të gjitha format dhe mënyrat që ai shpalolet, mungesa e rendit, shkelja e të drejtave të njeriut, diskriminimi mbi baza etnike, kombëtare dhe fetare, përjashtimi politik, marginalizimi me karakter ekonomik-shoqëror dhe keqeverisja"⁷.

Në mënyrë që lufta kundër terrorizmit të jetë efektive dhe e qëndrueshme, ajo duhet të përputhet gjithnjë me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

5. Strategjitë dhe lufta kundër radikalizmit dhe terrorizmit

5.1 Qasja strategjike në luftën kundër terrorizmit

Për t'u organizuar, si edhe për të planifikuar dhe zbatuar sulmet e tyre, terroristëve u duhen rekrutë dhe mbështetës, fonde, armë, mundësi udhëtimi pa pengesa, forma të tjera të mbështetjes materiale (si p.sh. mjete komunikimi, vende për t'u fshehur) dhe akses ndaj objektivave të cenueshëm. Rrjedhimisht, që lufta kundër terrorizmit të jetë efikase, kërkohet një qasje gjithëpërfshirëse dhe strategjike, duke u bazuar dhe mbështetur tek një gamë e gjerë politikash dhe masash⁸.

Këto objektiva në mënyrë të përgjithshme mund të kategorizohen si më poshtë

⁶ Andrew Silke, "Becoming a Terrorist" [Si të bëhesh terrorist], në Andrew Silke (ed.), Terrorist, Victims and Society: Psychological Perspectives on Terrorism and its Consequences [Terroristët, viktimat dhe shoqëria]: Perspektivat psikologjike mbi terrorizmin dhe pasojat e tij (Hoboken, NJ: Wiley, 2003).

⁷ "The United Nations Global Counter Terrorism Strategy" [Strategjia e OKB-së në luftën kundër terrorizmit], op. cit., shënim 8; OSBE, "Ministerial Statement on Supporting the United Nations Global Counterterrorism Strategy" [Deklarata Ministrore në Mbështetje të Strategjisë Globale të OKB-së në luftën kundër terrorizmit], op. cit.,

⁸ Raporti i Raportuesit të Posaçëm të OKB-së mbi nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, në përballje me terrorizmin, Martin Scheinin, "Ten areas of best practices in countering terrorism" [Dhjetë fusha të praktikave më të mira në përballjen me terrorizmin],

Jano, Sh.

« Parandalimi i terrorizmit, dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm, që favorizojnë terrorizmin »

Policimi dhe Siguria nr.14, 2019

vijon:

- parandalimi i popullsisë për t'u bërë terroristë;
- dhënia e mundësisë për t'u tërhequr dhe sigurimi i mbështetjes për individët që janë në rrugën drejt kriminalitetit ose janë të përfshirë në të;
- mohimi i mbështetjes, burimeve dhe mjeteve për t'u organizuar apo planifikuar dhe realizuar sulmet për personat e dyshuar si terroristë;
- përgatitje dhe mbrojtje ndaj akteve terroriste, për të ulur cenueshmërinë e objektivave potencialë, në veçanti të infrastrukturës kritike;
- ndjekja e të dyshuarve si terroristë, me qëllim kapjen dhe nxjerrjen e tyre përpara drejtësisë; dhe
- Reagimi ndaj sulmeve terroriste përmes masave proporcionale për zbutjen e impaktit të këtyre sulmeve dhe për t'u ardhur në ndihmë viktimave. Shtetet kanë detyrimin e sigurimit të mbrojtjes kundrejt akteve terroriste dhe kjo kërkon prej tyre vendosjen e një theksi të posaçëm tek parandalimi i terrorizmit. Kjo pasqyrohet në detyrimet e tyre ndërkombëtare juridike dhe në angazhimet politike.

5.2 Parandalimi i terrorizmit dhe demokracia liberale⁹

Lufta kundër terrorizmit në shoqëritë liberale demokratike përballet me shumë sfida. Sfida e parë ka të bëjë me rrjedhën e lirë të informacionit dhe perspektivat shoqëruese për radikalizim.

Eksperti i njohur terrorist Brian Jenkins e përkufizon radikalizimin si “procesi i adoptimit për çdo person ose duke ngulitur te të tjerët një angazhim jo vetëm për një sistem të besimeve [radikale], por për vendosjen e tyre në pjesën tjetër të shoqërisë “. Në praktikë, procesi i radikalizimit ka tendencë të jetë gradual, me besime dhe zakone që ndryshojnë ngadalë me kalimin e kohës deri në pikën e “konsolidimit” . Individit i radikalizuar ushqen një “pikëpamje botërore islame që është e aftë të zhvillohet në racionalizime për të hedhur poshtë çdo kundërargument”.

Qasjet që janë të orientuara drejt komuniteteve në luftën kundër terrorizmit mund të karakterizohen nga:

- partneritete të bazuara tek besimi midis komuniteteve dhe autoriteteve publike;
- angazhimi dhe mbështetja që vjen nga komuniteti për hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e strategjive, politikave dhe masave të ndryshme; dhe
- antiterrorizmi i parë në kuadrin e shqetësimeve për sigurinë e komunitetit, më shumë sesa në këndvështrimin e sigurisë shtetërore. Megjithatë, metodat të cilat tradicionalisht janë lidhur me qasjet që kanë si objektiv komunitetet mund të jenë të orientuara drejt komuniteteve, me mbështetjen e duhur nga vetë komuniteti.

5.3 Aspektet e drejtësisë penale në luftën kundër terrorizmit

Hetimi dhe ndjekja e rasteve kriminale të lidhura me terrorizmin, duke përfshirë nxitjen dhe rekrutimin për qëllime terrorizmi duhet të bazohen mbi fakte specifike, duhet të garantojnë proces dhe gjykim të drejtë, si edhe të jenë në përputhje me ndalimin absolut të torturës apo çdo trajtim apo ndëshkim tjetër mizor, çnjerezor apo degradues,

⁹ Journal for deradicalization , spring 2016 Nr.06, Professor Doctor Tami Amanda Jecoby

me të drejtën e jetës dhe të drejtën e lirisë dhe sigurisë.

Teknikat e posaçme të hetimit përfshijnë ndërhyrje të rënda në aspektet e të drejtave të njeriut, në veçanti të drejtat për gjykim të drejtë dhe fshehtësi. Rrjedhimisht, përdorimi i këtyre teknikave duhet të jetë:

- i kufizuar tek rastet e rënda dhe në përpjesëtim me seriozitetin e çështjes nën hetim; dhe

- i bazuar tek ligjet që përcaktojnë dhe përkufizojnë qartë mekanizmat për autorizimin paraprak, mbikëqyrjen, shqyrtimin *ex post facto* dhe llogaridhënien nën dritën e të drejtave të njeriut, në mënyrë të veçantë të drejtës për gjykim të drejtë dhe shtetit ligjor.

Informacioni, hetimi dhe konsultimet, duke u bazuar në burime të ndryshme të dijeve dhe ekspertizës, mund të kontribuojnë për një të kuptuar dinamik, të bazuar në prova dhe në kontekstin specifik të kërcënimit. Trajtimi i morisë së kushteve që çojnë drejt terrorizmit, sidomos të faktorëve strukturorë dhe atyre shtytës varet nga përpjekjet në fushat që lidhen me terrorizmin, por që nuk janë specifike për përballjen me të, të tilla si:

- adresimi i faktorëve negativë socialë dhe ekonomikë, si p.sh., korrupsioni dhe mungesa e mirëqeverisjes, si edhe nivelet e larta të papunësisë, në veçanti mes të rinjve;

- fuqizimi i institucioneve demokratike dhe shtetit ligjor, duke përfshirë policimin demokratik, nxitjen e dialogut midis shtetit dhe shoqërisë dhe garantimin e respektit për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;

- lufta kundër intolerancës dhe diskriminimit, si edhe nxitja e respektit të përbashkët, bashkëzistencës, marrëdhënieve harmonike mes grupeve etnike, fetare, gjuhësore etj.

5.4 Parandalimi i terrorizmit, koncepte kryesore

Llogaridhënia, legjitimiteti dhe besimi tek antiterrorizmi efikasiteti, legjitimiteti dhe besimi tek veprimi i shtetit në luftën kundër terrorizmit do të minoheshin nëse (shteti, përmes cilësdo agjenci të vet, e përdor pushtetin në shkelle të standardeve ndërkombëtare të së drejtave të njeriut. Kjo situatë do të përkeqësohej më tej nga mungesa, reale apo e perceptuar, e një llogaridhënieje efikase, që do të bënte të mundur mosndëshkimin e agjentëve shtetërorë për masa të paligjshme antiterroriste. OKB përcakton më së shumti një qasje holistike në lidhje me antiterrorizmin, e cila përfshin:

- sigurimin e sa më shumë asistence reciproke juridike në lidhje me çështjet penale që kanë të bëjnë me terrorizmin¹⁰;

- garantimin që çdo person, i cili merr pjesë në financimin, planifikimin, përgatitjen apo kryerjen e akteve terroriste apo në mbështetjen e akteve terroriste, të sillet përpara drejtësisë;

- masa për trajtimin e kushteve që çojnë në përhapjen e terrorizmit;

- masa për parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit; dhe

- masa për garantimin e respektimit të së drejtave të njeriut për të gjithë individët dhe sundimin e ligjit, si baza themelore e luftës kundër terrorizmit. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, me nr. 1373 (viti 2001) përcakton si një detyrim ligjor për të gjitha shtetet krijimin e kuadrit të përshtatshëm ligjor, rregullator dhe institucional, duke përfshirë edhe mosdhënien e asnjë forme mbështetjeje, aktive apo pasive, për njësitë apo personat e përfshirë në akte terroriste.

Jano, Sh.

« Parandalimi i terrorizmit, dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm, që favorizojnë terrorizmin »

Policimi dhe Siguria nr.14, 2019

Në shumë vende, një qasje strategjike ndaj terrorizmit është e përfshirë në politikën kombëtare të sigurimit. Disa vende dhe organizata të tjera kanë hartuar një dokument specifik, i cili është i disponueshëm për publikun, ku përshkruhet strategjia përkatëse për luftën kundër terrorizmit. Këto dokumente strategjike shpesh përdorin terminologji të ngjashme, por me variacione për sa i përket kuptimit aktual të termave.

6. Konkluzione

Bashkëveprimi me individët që i tërheq grupeve të terroristëve dhe radikalistëve, Individët që konsiderohen si “të rrezikuar” për t’u përfshirë në kriminalitet duhet të largohen nga rruga drejt radikalizmit terrorist. Kjo kërkon të dhëna specifike, që personat që janë në gjendje për t’i zbuluar, si p.sh., të afërmit, mësuesit apo punonjësit socialë mund të mos jenë në gjendje t’i njohin.

Këta aktorë të ashtuquajtur të linjës së parë duhet të mbështeten në përpjekjet e tyre për të kuptuar rrezikun e tyre, të vihen në dyshim supozimet dhe stereotipat e krijuara prej tyre, të kuptohet se çfarë lidhjeje faktorësh çon drejt riskut të radikalizmit të dhunshëm, të dinë se çfarë mund të bëjnë në lidhje me të dhe se ku të kërkojnë ndihmë.

Masa me karakter të gjerë veprimi:

- adresimi i kushteve strukturore që çojnë në terrorizëm;
- mbështetja e aktorëve të linjës së parë;
- kundërshtimi i përhapjes së ideve dhe historive që legjitimojnë terrorizmin;
- masa me objektiv të përcaktuar;
- ndjekja dhe ndëshkimi i individëve, të cilët nxisin dhe/ose rekrutojnë individë të tjerë për qëllime terrorizmi, në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut;
- ofrimi i ndihmës për individët që janë në rrugën e terrorizmit;
- angazhimi i individëve që konsiderohen si “të rrezikuar”.

Të gjitha veprimet e tyre dhe agjencive të tyre, ku përfshihet policia, për luftën kundër terrorizmit dhe radikalizmit duhet të jenë në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të shteteve, në veçanti me legjislacionin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

7. Rekomandime

Shtetet kanë detyrime negative dhe pozitive për mbrojtjen e individëve nga diskriminimi. Shtetet jo vetëm nuk duhet të lejojnë diskriminimin, por ato duhet të ndërmarrin veprime kundër diskriminimit, duke përfshirë në disa raste edhe diskriminimin nga individë privatë¹¹. Diskriminimi mund të përkufizohet si trajtimi i diferencuar, që nënkupton dallimin, përjashtimin, kufizimin apo preferencën bazuar në argumente të tilla si: përkatësia racore, ngjyra, gjinia, gjuha, përkatësia fetare, politike, apo ndonjë opinion tjetër, origjina kombëtare apo shoqërore, prona, lindja, përkatësia e një grupi minoritar apo ndonjë status tjetër, që ka si qëllim apo efekt mohimin apo pengesën e njohjes, gëzimit apo ushtrimit nga të gjithë personat.

Përpjekjet në përballjen me terrorizmin dhe radikalizmin duhet të jenë të bazuara

Jano, Sh.
« Parandalimi i terrorizmit, dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm, që favorizojnë terrorizmin »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

¹⁰ Rezoluta nr. 1456 (viti 2003) e Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

¹¹ Guidelines on Freedom of Peaceful Assembly, Second Edition [Udhërrëfytes mbi lirinë e grumbullimit paqësor botimi i dytë] (Varshavë: OSBE/ODIHR, 2010).

mbi fakte, të jenë proporcionale ndaj kërcënimit dhe me natyrë shumëdimensionale. Që lufta kundër terrorizmit të jetë e suksesshme dhe efikase, duke përfshirë edhe aspektin e parandalimit, ajo duhet të zhvillohet gjatë gjithë kohës, në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe me normat e shtetit ligjor. Përballja me terrorizmin dhe radikalizmin kërkon si ndërmarrjen e veprimeve efikase nga ana e drejtësisë penale, në përputhje me standardet ndërkombëtare të së drejtave të njeriut, kundër atyre personave që nxisin terrorizmin dhe/ose kërkojnë të rekrutojnë individë të tjerë në rrugën e terrorizmit, ashtu edhe përpjekje multidisiplinore për adresimin e kushteve që favorizojnë terrorizmin. Ka shumë çështje që lidhen, por që nuk janë specifike për terrorizmin, të cilat duhet të trajtohen me vërtetësi dhe pa i dhënë ngjyrimë të panevojshme të karakterit të sigurisë. Identifikimi i individëve “të rrezikuar” për t’u përfshirë në terrorizmin dhe radikalizmin përbën një çështje shumë delikate dhe me shumë sfida. Aktorët e linjës së parë duhet të mbështeten për të kuptuar atë që përfaqëson terrorizmin dhe radikalizmin në të vërtetë. Ata duhet të mësojnë të dallojnë se cili kombinim faktorësh mund të çojë drejt rritjes së riskut të radikalizmit të dhunshëm, rast pas rasti.

Bibliografi

1. Countering Terrorism, Protecting Human Rights: A Manual [Lufta kundër terrorizmit, Mbrojtja e të drejtave të njeriut: Manual] (Varshavë: OSBE/ODIHR, 2007),
2. Parandalimi i terrorizmit dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që favorizojnë terrorizmin: qasja e policimit në komunitet Botim i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Vjenë, mars 2014 OSBE 2014.
3. Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB)
4. Rezoluta nr. 1373 (2001) e miratuar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, mbledhja 4345, datë 28 shtator 2001 (S/RES/1373 (2001)), Rezoluta nr. 1456 (2003) e miratuar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, mbledhja 4688, datë 20 janar 2003 (S/RES/1456 (2003)), Parandalimi i terrorizmit dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që favorizojnë terrorizmin: qasja e policimit në komunitet 33
5. OSBE, Këshilli Ministror, “Ministerial Statement on Supporting the United Nations Global Counter Terrorism Strategy” [Deklarata Ministrorë në Mbështetje të Strategjisë Globale të OKB-së në Luftën Kundër Terrorizmit], Madrid, 30 nëntor 2007,
6. Andrew Silke, “Becoming a Terrorist” [Si të bëhesh terrorist], në Andrew Silke (ed.), Terrorist, Victims and Society: Psychological Perspectives on Terrorism and its Consequences [Terroristët, viktimat dhe shoqëria]: Perspektivat psikologjike mbi terrorizmin dhe pasojat e tij] (Hoboken, NJ: Wiley, 2003).
7. “The United Nations Global Counter Terrorism Strategy” [Strategjia e OKB-së në luftën kundër terrorizmit], op. cit., shënimi 8; OSBE, “Ministerial Statement on Supporting the United Nations Global Counterterrorism Strategy” [Deklarata Ministrorë në Mbështetje të Strategjisë Globale të OKB-së në luftën kundër terrorizmit], op. cit.,
8. Raporti i Raportuesit të Posaçëm të OKB-së mbi nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, në përballje me terrorizmin, Martin Scheinin, “Ten areas of best practices in countering terrorism” [Dhjetë fusha të praktikave më të mira në përballjen me terrorizmin],
9. Journal for deradicalization , spring 2016 Nr.06, Professor Doctor Tami Amanda Jacoby
10. Rezoluta nr. 1456 (viti 2003) e Këshillit të Sigurimit të OKB-së
11. Guidelines on Freedom of Peaceful Assembly, Second Edition [Udhërrëfyes mbi lirinë e grumbullimit paqësor botimi i dytë] (Varshavë: OSBE/ODIHR, 2010).

Jano, Sh.
 « Parandalimi i terrorizmit, dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm, që favorizojnë terrorizmin »

Policimi dhe Siguria
nr.14, 2019

ENGLISH

A B S T R A C T S

"POLICIMI DHE SIGURIA", NR. 14, APRIL, 2019

Investigative secret and the right of information

- MSc. Besnik SHEHAJ

Abstract

In criminal law and beyond there is a generally good corpus of norms regulating legal relations for the preservation, administration, use, declassification and publication of classified information as state secret, investigative secret or professional secret, as well as the right to information or to protection of personal data. But in everyday life, there are cases where misunderstandings, misinterpretations, violations or, worse, abuses in the application of these legal norms occur, resulting in violations of fundamental constitutional rights, damaging consequences for dignity, life and property of citizens, the violation of the integrity of the law enforcement agencies, the malfunctioning of the rule of law, especially during the criminal process, where this article is focused.

Consequently, some serious criminal events occurring in our country have often been the subject of fierce public debates in print and electronic media, mainly between politicians, analysts or journalists, and representatives of the Police and Prosecution Office. But the biggest damage to these cases is caused by criminal proceedings for these events when the publication of acts or certain investigative actions or the disclosure of the identity of the persons under investigation seriously jeopardizes the validity of the collected evidence, the removal and concealment of the alleged authors occurs, intimidating the subjects and bodies of proceeding, politicizing events and circumstances, and corrupting the parties in the process.

Why are these things happening and how can they be avoided?

This article aims at answering these questions precisely through the analysis of the contradiction between: the obligation to preserve investigative secrets and the right to information during the preventive activity and the investigation of criminal offenses by police officers or prosecuting authorities. By interpreting and addressing the legal norms on the right to information with those for the preservation of investigative secrets, we are attempting to extract some of the causes, relevant factors, harmful consequences, and the forms and ways that affect the deterioration or prosperity of the relationship between these two strands of the criminal proceeding, so metaphorically stated to establish "peace" or reasonable equilibrium between the right to information and the preservation of the investigative secret.

Small Arms and Light Weapons

- Prof. Asc. Dr. Qetsor ORHAN

Abstract

The origin of firearms and the characteristics of their evolution constitute the main object of this paper through which very important conclusions can be drawn on the investigation of the specific characteristics of firearms at different periods of history. The birth of firearms is related to the birth of gunpowder known to originate from remote China during the 9th century. The Chinese gunpowder was then transported to the Middle East, Africa and from there to Europe. Firearms in our country are widely used, but according to researcher Riza Drishti, in the second half of the 14th century and in 1364, for the first time, the firearms appeared, which would later be called weapons of arms infantry.

Forensic researchers are constantly trying to give the best of the judicial process and as such need strong and credible knowledge bases within their different disciplines. Recognition of old weapons that continue to circulate today in various forms will be a valuable source for police officers who deal with the investigation, helping some in deepening the knowledge of this character.

Falsification of documents undermines the normal functioning of state and public institutions

- MSc. Osman QYSTRİ

Abstract

The conclusion that falsification of official documents violates the normal functioning of public and private institutions has taken place everywhere in the administration. In order to deepen the fight against organized crime, ensure high performance in tracing and investigating criminal offenses of forgery of documents; improving the quality of investigative and investigative activity; increasing the integrity of police structures in the fight against crime, based on the philosophy of crime prevention through intelligence-oriented crime and criminal intelligence; creation of a contemporary culture of police case management; building a continuous partnership of law enforcement structures, justice bodies and other public and private actors in detecting, documenting and hacking perpetrators of criminal offenses is a growing demand.

The analysis and study of criminal offenses of "forgery of documents" comes as an obligation to the continuous increase of these crimes; the intensification of the organized crime activity also in the field of falsification of official documents; ongoing reactivation of criminal groups with criminal precedents in the field of counterfeiting. They are a reflection of the changes made in mid-2017, the Criminal Procedure Code, the reformation and restructuring of the police structures of the fight against organized crime May 2017. While drawing on the justice bodies and the structures of the State Police, the creation of SPAK, BKH, task force organization and central and local investigation structures make indispensable in-depth analysis and specialized study of this crime.

Alen Pinkerton - legend of American police
- Prof. Asc. Dr. Stavri SINJARI

Abstract

A prominent policeman, who has a seat in the History of Police Thinking, is Alen Pinkertoni of the American police. His role in the police consists of the successes of a private agency with the status of the fight against crime, detection, investigation, and destruction of dangerous criminals. In terms of the need for calm and public security, when for several years the crime had almost inexpensive hands and challenged the law in America, Pinkertoni as the police chief and founder of a detective agency, worked and acted as a police officer great, unmistakable legend. Hard-line crusher, but discover the right, brave, experienced, experienced police officer who writes, trains and gives messages and experience to young police officers and detectives. The reader, students, and police officers will be able to recognize another well-known American police figure, who gained fame beyond the continent where he worked.

The influence of the size of a state against security and geopolitical factor

- Msc. Qetësor GURRA
Msc. Jonida GURRA

Abstract

In this paper will be addressed the importance of Albania's geopolitical position in the decision-making and positioning of countries in the region and beyond. It will be briefly mentioned the efforts and the seriousness to adhere to and to be dignified with international organizations. To target the main object of this reference it will be given examples of good specimens that will demonstrate that the measure of the state sometimes condenses the supremacy of the states as well as the opposite. If diplomacy is well exposed, with a well - articulated technique, at least if it is tough to grow the assets of a state at least the few assets that can be found can enjoy respect, consideration from rivals and opponents. In the conclusion will be mentioned recommendations that can be considered depending on the circumstances.

Reforming the way of winning the ranks in the State Police

- MSc. Adriatik AGO

Abstract

The recent decision on the annulment of the competition for obtaining the police rank * Komisar *, showed seriousness, accountability and quick reaction by the Head of State Police to the findings of some irregularities or violations of orders being taken in such cases. But besides this, this created situation also speaks for the fact that something does not work in the current scheme of gaining police rankings. Irregularities, which may be of an organizational nature why not and corrupt, are in the right of authority to analyze and maintain their position. This has already become publicly known and certain structures are conducting investigations, whose responsibilities will certainly be classified as disciplinary, administrative or criminal. The object of this article will not be this concern, but supported by this case why not and other cases ascertained over the years, we want to analyze the legal composition on the manner of obtaining police rankings.

The role of Community Policing structures in confronting radicalism and violent extremism.

- MSc. Roland ALUSHANI

In their book, 'Crime Safety and Prevention', American authors O`Block, Donnermeyer, Doeren, say that "extreme crime and violence cause social, economic, health and psychological consequences not only on victims, but also on society in general. a serious social problem that directly reduces the quality of life of individuals and the community. "To respond to this problem, societies have developed policing as an institution where police, among others, are recruited, trained and deployed. In support of this idea, Morgan states that: "The primary police function is to prevent crime and capture criminals."

Traditionally, maintaining law and order in every society has been the exclusive role of police structures. During that time, the police not only encountered difficulties in dealing with crime, but also criticized the non-protagonist nature of relationships with community members. This phenomenon has sparked a wide debate among scholars. Friedman, for example, stated that the police cannot succeed in solving or preventing violence or even crime without the help of the community. Thus, to successfully prevent crime, there must be partnership and community involvement. And perhaps this was a reflection and reaction to this development that would later be presented as the concept of community policing. Community policing is a paradigm shift created on the foundation of community partnership in creating a safe environment for everyone. It is the security mode where people actively participate, where police are not seen as a problem, but as a developing partner and where community members are co-producers of justice service and quality of public safety.

The link between organized crime and terrorism, a threat to security

- MSc. Aiqi NIKOLLA

Abstract

In the age of globalization, the emerging relationship between crime and terrorism poses significant challenges, threats and threats around the world. There is no place in the world that can be protected against terrorism and organized crime. In Europe there is a link between crime and terrorism, where marginalized and informal economy is more vulnerable to radicalization. In other countries, the relationship between organized crime and terrorism has become a close relationship, in which it has become increasingly difficult to make a meaningful difference. Terrorist activities and organized crime often strengthen each other, where terrorists engage directly or indirectly in organized crime activities such as trafficking, smuggling, extortion, kidnapping for ransom and illicit trade in natural resources for financial and / or material gain. Such benefits contribute to undermining state security, stability and social and economic development, which can create the conditions for flourishing organized criminal groups. On the other hand, organized crime groups can use terrorist tactics, including strategic use of violence. The expansion of transnational criminal networks involved in trafficking in drugs, weapons, persons and goods is one of the most serious threats to international security. These networks have benefited from the advances in communications and transportation, to expand their global reach. In many cases, they have converged with terrorist groups and other violent actors. Beyond the threat of self-trafficking, these transnational alliances pose new threats to security. These activities are also the main drivers of the destabilization or criminalization of the weak states where these networks operate, creating alternative power centers of state institutions such as; police, judiciary and local authorities. In this paper we will analyze the common points and the main differences between them, to highlight their linkage and the establishment of such networks, and at the same time to point out the security problems of terrorism and organized crime as threats to national and international security. Terrorism and organized crime are two different forms of criminal activity and a common threat to human security.

The intellectual battles underlying the uprisings for independence.

Fighting through writing, alongside the bloody history of the torches of Albanian patriotism

- MSc. Fatos VELIU

Prof. Dr. Pëllumb DANAJ

MSc. Albana VELI

Abstract

The insurgent struggle of the Albanians against the High Gate of the Ottoman Empire in the years and years ahead of the independence of Albania has been and continued to coincide with the same growth and the colossal diplomatic struggle of outstanding patriots of knowledge, which has provided the baptism of the state between the shattered hordes.

More specifically, it is known that in the fall of 1909, the Turkish parliament banned any organization of national character. They were only allowed as Ottoman organizations and more stringent measures were envisaged for armed patriots, as well as their families.

The Turkish government during those years, even though counting its last days, passed on more stringent measures against Albanians. It stopped the Latin alphabet, shut down schools, set taxes and enforced military service for everyone. It also sent expeditions to disarm Albanians.

But the Albanian people were unstoppable in their path.

The historical and inalienable truth, as noted above, is the fact that in parallel with this unprecedented anti-Albanian aggression, the Ottoman high gate was faced with the titanic effort of the rifle and mainly the patriots of our country. Hundreds of referendums to the high gate and European chancellors have already been identified, which have materialized and coordinated the bloody war of the 30,000 insurgents and preceded the date of the 28th of November 1912.

So in conclusion it can be said with national pride that exactly that war has been documented on popular referendum papers; Over the protests against the High Gate; On demands from the chancellors of the European states to be in the wake of our epochal efforts to secure the rights that have been looted in rivers of blood.

Democratic system and public security

- Kozeta LIGEJA, Phd Candidate

Abstract

The purpose of this article is to analyze the role and functioning of public security policies in a democratic state. The democratic system through the rule of law functions with the implementation of public security policies. Democratic governments aim to guarantee the protection of such components as citizens, territories, public institutions of a country from various threats. Democratic governments aim at maintaining the welfare of their population. The democratic system contributes to the public safety of a particular country. This article will analyze the report of the democratic system with public security. Given this definition, it is worth pointing out the practical value of this direction in the company of a given country to prove the hypothesis raised. The purpose of this document is: through the evidences of theoretical analysis, as well as on cases in the Albanian practice, to prove the hypothesis raised. The overall purpose of the study is the analytical framework regarding of this issue.

Methodology: This article will be based on several study methods. Mainly shall be used the inductive method, passing from specific facts to general conclusions, the description method and the reviewing of literature on this issue.

**Preventing terrorism, and combating extremism and violent radicalism, which favor terrorism
- Av. Sheldiana JANO**

Abstract

Terrorism is about denying democracy and human rights, which are the core of what constitutes a state of law enforcement. Legislative States are determined to fight all acts of terrorism, without exception, as very serious crimes. States, through relevant police agencies, have the duty to protect all individuals within their jurisdiction against terrorist acts, as part of their human rights obligations in guaranteeing the right to life, the right to safety and other rights in the framework of human rights and fundamental freedoms. This requires states to use a comprehensive approach to the fight against terrorism, paying particular attention to preventing and combating extremism and violent radicalization, which favor terrorism, while protecting human rights and the rule of law. Given that in this context, the police play a very important role in the fight against terrorism, it is of particular importance that the police account for their actions in order to guarantee legitimacy, confidence, trust and public support. Facing extremism and violent radicalism that favor terrorist acts. Radicalism does not pose a threat to a society if it is not related to violence or other illegal acts, such as: hate, as described in jurisprudence related to international human rights law. Radicalism can result as a positive change force.

Terrorist radicalism is a dynamic process in which an individual begins to accept terrorist violence as a possible, even legitimate, path of action. There is no single profile that would include all terrorists, as there is no "cut-off" path that leads individuals to the road to terrorism. Possible types of terrorist radicalism are diverse and complex, being uniquely intertwined for each specific case. Profiles that are built on stereotyped assumptions based on religious, racial, ethnic, gender, social and economic status etc. they are not only discriminatory but also ineffective.



"Policimi dhe siguria",
rev. shkenc.

nr. 14, qershor 2019,
ISSN 2413-1334.

Botues: Akademia e Sigurisë,
Policia e Shtetit, RSH
Përmasa: 160X240 mm

ISSN 2413-1334
AKADEMIA E SIGURISË



2 413 1 334000 3



POLICIMI DHE SIGURIA

PRILL 2019



AKADEMIA E SIGURISË
Qendra Kërkimore Shkencore
Rruga e Elbasanit, Sauk, Tiranë



NR

14